

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Eruditi, juristi dhe komentuesi

NASER MEKARIM SHIRAZI

KOMENTIM I PËRSOSUR I KUR'ANIT

(Xhuzi i pestë)

Titulli: ***KOMENTIM I PËRSOSUR I KUR'ANIT***

(Xhuzi i pestë)

Autori: ***Eruditi, juristi dhe komentuesi***

Naser Mekarim SHIRAZI

Recensent: ***Vullnet MERJA***

E përktheu nga arabishtja: ***Agim REÇAJ & Vullnet MERJA***

Radhitja kompjuterike: ***Kumrije QAZIMI***

E redaktoi: ***Liseda RAMAJ***

Korrektura teknike: ***Vjollca KARAJ***

Përkujdesja grafike: ***Sabrie FEZA***

Kapaku: ***Sabrie FEZA***

Botoi: ***Shoqata "FLLADI"***

Copyright: ***Shoqata "FLLADI"***

Shtypshkronja e shtëpisë botuese ***LILLO***

Ajeti 24

﴿وَالْمُحْصَنَاتُ مِنَ النِّسَاءِ إِلَّا مَا مَلَكَتْ أَيْمَانُكُمْ كَتَبَ اللَّهُ عَلَيْكُمْ
وَأُحِلَّ لَكُمْ مَا وَرَاءَ ذَلِكَ أَنْ تَبْتَغُوا بِأَمْوَالِكُمْ مُحْصِنِينَ غَيْرَ
مُسْفِحِينَ ۚ فَمَا اسْتَمْتَعْتُمْ بِهِ مِنْهُنَّ فَآتُوهُنَّ أُجُورَهُنَّ فَرِيضَةً ۚ
وَلَا جُنَاحَ عَلَيْكُمْ فِي مَا تَرَضَيْتُمْ بِهِ مِنْ بَعْدِ الْفَرِيضَةِ ۚ إِنَّ اللَّهَ كَانَ
عَلِيمًا حَكِيمًا﴾

“(Ju ndalohet martesë) edhe me gratë që gjenden nën kurorë, përveç atyre që i zini robëresha. Ky është urdhri i All’lilaut. Ju janë lejuar të tjerat, me kusht që t’i kërkonit me pasuritë tuaja për martesë, e jo për imoralitet. Grave me të cilat martoheni, jepuni dhuratat e detyrueshme. S’ka gjynah për ju, me pëlqimin e të dyja palëve, që ta shtoni apo ta pakësoni sasinë e dhuratës së premtuar. Se, All’lilahu, me të vërtetë, është i Gjithëdituri dhe i Urti.”

Komentimi

Ky ajet vazhdon hulumtimin e mëparshëm rreth grave, me të cilat është e ndaluar martesa. All'llahu i Lartësuar thotë: “(Ju ndalohet martesa) **edhe me gratë që gjenden nën kurorë...**”, që do të thotë se është e ndaluar të martoheni me ato gra që kanë bashkëshortë.

Fjala “*el muhsinat*” është shumësi i “*el muhsinetu*”, e cila rrjedh nga fjala “*el hisn*”, që do të thotë *e ruajtur, e pastër dhe e martuar*. Gruaja e martuar është quajtur me këtë emër, sepse martesa (kurorëzimi) e saj me burrin e bën atë që ta ruajë nderin e saj. Gjithashtu, quhen kështu edhe gratë e pastra, të cilat jetojnë nën hijen e burrit dhe të përkujdesjes së tij, duke ruajtur kështu nderin dhe moralin e tyre nga veprat e këqija dhe imoraliteti.

Me këtë fjalë janë quajtur edhe gratë e lira, sepse liria e tyre është si mburojë ruajtëse për to që nuk lejon askënd t'i shkelë këto kufij pa lejen e tyre. Është mëse e qartë se në këtë ajet, qëllimi i kësaj fjale është për gratë e martuara.

Ky rregull nuk është i posaçëm vetëm për gratë e martuara myslimane, por përfshin edhe gratë jomyslimane. Që do të thotë, se është e ndaluar martesa me to (gratë jomyslimane) të çfarëdo feje qofshin.

Po, në këtë rregull përjashtohen vetëm gratë e martuara prej ithtarëve të Librit, të cilat janë zënë robëresha nga myslimanët në luftë. Islami e ka konsideruar robërinë e tyre si divorc nga bashkëshortët dhe ka lejuar që myslimanët të martohen me to,

pasi që ato të jenë pastruar¹ ose të bashkëveprojnë me to sikurse me robëreshat, siç thotë All'illahu i Lartësuar: “...**përveç atyre që i zini robëresha**”. Ky përjashtim do të thotë që këto gra të martuara që kanë rënë robëresha në duart e myslimanëve nuk konsiderohen të martuara, sepse lidhjet e tyre me burrat e tyre janë ndërprerë po në atë moment kur ato janë zënë robëresha. Është njësoj sikurse ndërpritet lidhja e grave jomyslimane me bashkëshortët e tyre në momentin që ato e përqafojnë fenë islame dhe bashkëshortët e tyre rrinë në fenë e mëparshme (jobesimtarë). Kështu që, ato janë në rreshtin e grave të pamartuara.

Kështu qartësohet se Islami nuk e lejon kurrë që të martohen myslimanët me gra të martuara edhe nëse ato janë prej ithtareve të Librave apo me gra të tjera prej feve të ndryshme. Për këtë, Islami ka caktuar për ato kohëpritje (periudha e pastrimit prej menstruacioneve) dhe e ndalon martesën me to gjatë kësaj periudhe.

Filozofia e këtij rregulli përfytyrohet kështu në këtë grup grash: ato të kthehen në shtëpitë e mosbesimtarëve ose të qëndrojnë në mesin e myslimanëve pa u martuar ose të ndërpresin lidhjet me burrat e parë dhe të martohen me burra të tjerë. Mënyra e parë i kundërshton parimet edukative bazë të Islamit, kurse mënyra e dytë është një vepër e padrejtë. Kështu mbetet vetëm një mënyrë, e cila është mënyra e tretë.

Ka disa transmetime, zinxhiri i të cilave përfundon te Ebu Sejjid El Hudrij, është se ky ajet ka zbritur për robëreshat e luftës

¹ Koha e pastrimit të tyre është pas ndërprerjes së menstruacioneve apo lindjes në rast shtatzanie.

Eutas,¹ ku i Dërguari i All'llahut i lejoi myslimanët që të martoheshin me to (robëreshat), pasi të siguroheshin se ato nuk janë shtatëzana. Kjo është ajo, e cila e përforcon mënyrën e tretë, që e cekëm më lart.

All'llahu i Lartësuar i përforcon këto rregulla, të cilat kanë ardhur për çështjen e ndalimit të martesës me gra meharim² dhe çfarë është e ngjashme me to, ku thotë: **“Ky është urdhri i All'llahut...”** Bazuar në këtë thënie, nuk lejohet kurrë që këto rregulla të ndërrohen apo të zëvendësohen.

Më pas, All'llahu i Lartësuar na tregon lejimin e martesës me të tjera gra përveç atyre që përmenden në këtë ajet dhe në ajetet e mëparshme. Ai thotë: **“...u janë lejuar të tjerat, me kusht që të kërkonit me pasurinë tuaj për martesë e jo për jetë të përkohshme...”** Kjo do të thotë se juve u lejohet që të martoheni me gra të tjera, përveç grupit të lartpërmendur, me kusht që martesa të kryhet sipas ligjeve islame dhe të jetë në përputhje me parimet e jurisprudencës, pastërtisë dhe larg rrugës së devijimit dhe të shthurjes.

Bazuar mbi këtë, kuptimi i fjalës *“muhsiniyne”*, në këtë ajet tregon për gjendjen e pastër të burrave. Shprehja *“gajr musafihijne”*, që rrjedh nga fjala *“sefah”* është përforcuese e këtij përshtkrimi. *“Sifah”* do të thotë *kurvëri* dhe rrjedh nga fjala *“es sefahu”*, që do të thotë hedhje e ujit (ka kuptimin e veprave të kota e të lajthitura). Meqë Kur'ani këtu përdor metonimi, atëherë fjala

¹ Eutas është zona ku ka ndodhur një prej luftimeve islame. Ajo është luginë në shtëpitë e fisit Heuazin.

² Shih ajetin 23 të kësaj sureje në fund të xhuzit të 4 të këtij komentimi.

“*sifahun*” ka kuptimin e kurvërisë dhe të kryerjes së aktit seksual jashtë martese.

Fjalja “...me kusht që t’i kërkon me pasurinë tuaj...” tregon se lidhja bashkëshortore është e detyruar të plotësohet ose nëpërmjet martesës shoqëruar me dhënien e dhuratës (mehrit), ose nëpërmjet pronësimit të robërshës, pasi t’i jepet vlera e saj.¹

Gjithashtu, thënia “...e jo për imoralitet...” në këtë ajet, ka mundësi të tregojë për një të vërtetë se qëllimi i martesës nuk duhet të jetë vetëm për të shuar epshin dhe për t’iu përgjigjur dëshirave seksuale. Martesa është një çështje e rëndësishme, e cila ka një qëllim madhor. Instiktet seksuale gjithashtu, duhet të jenë në shërbim të saj, me qëllim të qëndrueshmërisë së llojit njerëzor dhe mbrojtjen e tij prej ndotjes dhe devijimit.

Martesa e përkohshme në islam

All’llahu i Lartësuar thotë: “**Grave, me të cilat kaloni jetën bashkëshortore jepuni dhuratën e detyrueshme** (për jetesë)”. Pra, është detyrim për burrat që t’u japin dhuratën grave me të cilat jetuan dhe u kënaqën. Kjo pjesë e ajetit tregon për martesën e përkohshme ose për atë që quhet “*el mut’a*”.

Nga ky ajet përfitohet se martesa e përkohshme ka qenë e pranueshme tek myslimanët përpara se të zbriste ky ajet. Për këtë, All’llahu i këshillon myslimanët në këtë ajet që t’u japin grave dhuratën e tyre.

¹ Në ajetin 4 të sures “Muhammed” kemi hulumtuar me detaje rregullat e Islamit rreth lirimit të robërve. Gjithashtu, kemi përmendur hapat e hollësishme në sistemin Islam rreth kësaj teme.

Meqenëse kërkimi rreth kësaj çështjeje është prej kërkimeve të rëndësishme të komentimit, jurisprudencës dhe sociologjisë, duhet që studimi i saj të jetë në disa drejtime:

1- Të dhënat që gjenden në këtë ajet e përforcojnë argumentin e tij për martesën e përkohshme.

2- Martesa e përkohshme ka qenë në kohën e të Dërguarit të All'llahut (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe nuk është abroguar (anuluar).

3- Nevoja, por dhe domosdoshmëria shoqërore për këtë lloj martese.

4- Përgjigjja për disa dilema.

Përsa i përket pikës së parë, patjetër duhet të shpjegojmë disa çështje. Ato janë:

E para: Fjala “*mut'atu*”, nga e cila është marrë fjala “*istemta'tum*”, do të thotë *martesë e përkohshme*. Thënë ndryshe: *El mut'atu* e drejtë legjitime në këtë lloj martese. Tregues për këtë është se kjo fjalë, po me këtë kuptim, përmendet disa herë në transmetimet e të Dërguarit të All'llahut (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe në fjalët e sahabëve (shokëve të Pejgamberit).¹

E dyta: Me të vërtetë, nëse kjo fjalë nuk është me kuptimin e përmendur, por duhet patjetër të komentohet me kuptimin e saj gjuhësor, që është “*el intifau*”, atëherë kuptimi i kësaj pjese të ajetit është: “Nëse kënaqeni me gratë e martuara me martesë të

¹ Shih Tefsiret: *Kenzul Urfan*, *Mexbmaul Bejjan*, *Nuru Tbekalejn*, *El Burhan*.

përhershme, jepuni atyre shpërblimin e vet.” Ndërkohë, ne e dimë që dhënia e mehrit nuk është e kushtëzuar me kënaqësinë dhe dobinë me gratë e martuara me martesë të përhershme. Por duhet t’u jepet mehri i plotë siç është e njohur¹ në mesin e fukahave, ose të paktën gjysma e tij, i jepet gruas kur të bëhet kurorëzimi i martesës së përhershme.

E treta: Sahabët e mëdhenj dhe tabiinët,² si: Ibn Abbasi, dijetar (komentues i madh mysliman), Ubej ibn Kab, Xhabir ibn Abdullah El Ensarij, Umran ibn El Husejn, Said ibn Xhubejr, Muxhahid, Katade, Seddi, si dhe një grup i madh prej komentuesve nga Ehli Synneti dhe shumica e komentuesve të Ehli Bejtit, kanë kuptuar nga ajeti në fjalë rregullin e martesës së përkohshme. Fahredijn Razij, duke pasur parasysh se çfarë është thënë ndaj tij nga dyshimet e shumta në lidhje me çështjet e shijave dhe në doktrinën e tyre, pas një kërkimi të hollësishëm ka thënë: “Ajo çfarë është detyrim që të mbështetemi në këtë temë ne themi që është anuluar dhe mbi këtë përcaktim, por nëse ky ajet tregon se ajo (martesa e përkohshme) është e lejuar kjo nuk do të thotë se ne synojmë t’ia ulim vlerat asaj.” Kjo është një përgjigje duke u mbështetur në leximin e Ubejës dhe të ibn Abasit, ku me të vërtetë, ai lexim e përforcon argumentin se martesa e përkohshme (el mu’atu) është e lejuar dhe se nuk kemi konflikte në këtë çështje. Por, ajo që themi, është se anulimi është diçka e papritur.

¹ Ajo çfarë është e njohur duhet që t’i jepet mehri (dhurata e martesës) në momentin që kryhet kurorëzimi (martesa e përhershme). Nëse ndodh divorci përpara kontaktit seksual, duhet t’i kthehet bashkëshortit gjysma e tij (mehrit).

² Tabiinët janë ata të cilët kanë ardhur pas sahabëve dhe nuk e kanë përjetuar kohën e Profetit (Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij).

E katërta: Imamët e Ehli Bejtit (Paqja qoftë mbi ta!), të cilët janë njerëzit më të ditur për të fshehtat e Shpalljes, janë të një mendimi në komentimin e këtij ajeti me kuptimin e martesës së përkohshme. Për këtë temë kanë ardhur transmetime të shumta.

Transmetohet nga imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) se ai ka thënë: *“Martesa e përkohshme është shpallur në Kur’an dhe është vërtetuar me synnetin e të Dërguarit të All’llahut.”*¹

Transmetohet nga imam Bakiri (Paqja qoftë mbi të!) se në përgjigje të Ebi El Besijr rreth martesës së përkohshme, ka thënë: *“Është zbritur në Kur’an: ‘Grave, me të cilat ju kënaqeni, jepuni dhuratat e detyrueshme.’”*²

Gjithashtu, imam Bakiri (Paqja qoftë mbi të!) në përgjigje të Abdullah ibn Umejr El Lejthij, i cili e ka pyetur për martesën e përkohshme, ka thënë: *“E ka lejuar All’llahu në Librin e Tij dhe në gjuhën e të Dërguarit të Tij. Ajo është e lejuar deri në Ditën e Gjykimit.”*³

Hulumtime

1-A është anuluar ky rregull (ligj)?

Të gjithë dijetarët myslimanë kanë rënë dakord, se në fillim të Islamit, martesa e përkohshme (*el mut’atu*) ka qenë një çështje e lejuar. Polemikat rreth argumentit të këtij ajeti për lejimin e martesës së përkohshme, nuk e mohojnë rregullsinë e ekzistencës

¹ *Tefsiri Burhan*, vëll. 1, f. 360. *Usulul Kafijj*, vëll. 5, f. 449.

² *Tefsiri Burhan*, vëll. 1, f. 360. *Usulul Kafijj*, vëll. 5, f. 449.

³ *Tefsiri Burhan*, vëll. 1, f. 360. *Usulul Kafijj*, vëll. 5, f. 449.

së bazës së këtij rregulli, sepse ata të cilët e kundërshtojnë këtë rregull, e shikojnë konstatimin e tij në synnetin e Profetit (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!). Jo vetëm kaq, por myslimanët, në fillim të Islamit, e kanë zbatuar këtë rregull. Umeri transmetohet të ketë thënë: *“Dy (mut’atu) kënaqësi, kanë qenë në kohën e të Dërguarit të All'llahut dhe unë i ndaloj ato dhe ndëshkoj për to; mut’atu nisa dhe mut’atu haxh.”*¹ Ky është një argument i qartë, se rregulli ka qenë në kohën e Profetit. Ata që e kundërshtojnë këtë rregull, pretendojnë se ky rregull më pas është anuluar (abroguar) dhe kjo lloj martese është ndaluar.

Por, ajo që tërheq vëmendjen është se këto transmetime anuluese, të cilat pretendohen janë shumë të ngatërruara. Disa prej atyre transmetimeve thonë se vetë Profeti e ka anuluar këtë rregull. Këtu del se anuluesi i këtij rregulli të Kur’anit është synneti i Profetit (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!).

Disa të tjerë thonë se anuluesi i tij është ajeti që ndodhet në suren “Et-Talak”, ku All'llahu i Lartësuar thotë: **“O Profet! Nëse i ndani gratë, ndajini ato para kohës së tyre të pritjes.”** Ndërkohë, ky ajet nuk ka lidhje me çështjen e parashtruar në këtë hulumtim, sepse ai flet për divorcin, ndërkohë që martesa e përkohshme (*el mut’atu*) nuk ka divorc dhe ndarja ndërmjet dy palëve në këtë martesë bëhet me përfundimin e kohës që ata kanë vendosur.

E rëndësishmja këtu është se origjina e ligjshmërisë së kësaj martese në kohën e Profetit ka qenë e prerë, e padiskutueshme dhe nuk ka asnjë argument bindës që të konstatojë se ky rregull

¹ Tefsiri *Kenzul Urfan*, vëll. 2, f. 158. *Tefsiri Kurtubij*, vëll. 2, f. 365, komentimi i ajetit 196 të sures “El Bekare.”

është i anuluar (abroguar). Kështu që, është e domosdoshme të gjykojmë për qëndrueshmërinë e këtij rregulli, bazuar edhe në atë çfarë është e -caktuar dhe konstante në shkencën e “Bazave të Jurisprudencës”.

Thënia e njohur e transmetuar nga Umeri, është dëshmia më e mirë për këtë të vërtetë se ky rregull nuk është anuluar në kohën e të Dërguarit të All'llahut (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!).

Pastaj, është mëse e pakundërshtueshme, se askush nuk ka të drejtë që të anulojë rregulla përveç Profetit, me urdhër nga All'llahu i Lartësuar. Sigurisht, porta e anulimit (abrogimit) të rregullave është mbyllur me vdekjen e Profetit (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), përndryshe, çdokush do të mund të anulonte diçka nga rregullat e All'llahut sipas opinionit dhe preferencës së tij. Si rrjedhojë, asgjë nuk do të mbetej nga Sheriati i përhershëm e i përjetshëm. Mendimi personal përballë tekstit Profetik nuk ka asnjë vlerë.

Ajo që tërheq vëmendjen është se në sahihun e Tirmidhiut, i cili është prej sahihave të njohur të Ehli Synnetit dhe po kështu nga Ed Darektenijj, ne lexojmë se një burrë nga Shami e pyeti Abdulla ibn Umerin për temetteun e umres në Haxh. Ibn Umeri i ka thënë: *“E mirë është.”* Burri i ka thënë sërish: *“Babai yt e ka ndaluar këtë.”* Abdullahi i është përgjigjur: *“I mjeri ti! Nëse babai im e ka ndaluar, i Dërguari i All'llahut e ka vepruar dhe ka urdhëruar për*

të. A të marr fjalën e babait tim apo atë çfarë ka urdhëruar i Dërguari i All'llahut? Largohu nga unë!”¹

Po e njëjta gjë është transmetuar edhe në sahihun e Tirmidhiut rreth martesës së përkohshme nga Abdullah ibn Umer.²

Në librin e “El-Muhadherat”, i Ragibit, thuhet se një burrë prej myslimanëve e zbatonte martesën e përkohshme (el mut’ah). Atë e pyetën: “Nga kush e more lejen për të?” Ai u tha: “Nga Umeri.” Ata i thanë: “Si ka mundësi, ndërkohë që Umeri e ka ndaluar këtë veprim dhe ka ndëshkuar për këtë vepër?” U tha: “Thënia e tij “Dy “mut’atu” ka qenë në kohën e Pejgamberit të All'llahut dhe unë i ndaloj ato të dyja dhe ndëshkoj për veprimin e tyre: mut’atu nisa dhe mut’atul haxh. Unë e pranoj transmetimin e tij në legjislacionin e saj në kohën e të Dërguarit të All'llahut dhe nuk e pranoj ndalimin e tyre nga ana e tij.”³

Është edhe një çështje tjetër që patjetër duhet ta cekim këtu. Ata të cilët pretendojnë anulimin e këtij rregulli, përballen me shumë probleme. Prej tyre dallojmë se në shumë transmetime në burimet e Ehli Synnetit thuhet qartë se ky rregull nuk është anuluar në kohën e të Dërguarit të All'llahut (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) asnjëherë, por është ndaluar në kohën e Umerit. Për këtë, është detyrim për ata

¹ Qëllimi i “mut’tul Haxh”, që e ndaloj Umeri, është se nëse ne duam të dimë për Haxhin temetu’ themi se ai është si vijon: Në fillim personi vesh ihramin. Pas kryerjes së riteve të umres, e heq ihramin. Me heqjen e ihramit, atij i lejohet çdo gjë, deri edhe kontakti seksual. Pastaj, në ditën e nëntë të muajit Dhul Hixhe, përsëri vesh ihramin për të kryer ritet e haxhit. Në kohën para Islamit, njerëzit e quanin të parregullt këtë veprim. Ata habiteshin prej atyre që hynin në Mekë ditët e haxhit, kryenin umren dhe zhvishnin ihramin para kohës së haxhit. Por Islami e lejoi këtë. Këtë çështje e përmend qartë edhe ajeti 186 i sures “Bekare”.

² *Sherah Lum’atil Dimashkijeh*, vëll. 2, kapitulli i martesës.

³ Tefsiri *Kenzul Urfan*, vëll. 2, f. 159.

që e pretendojnë këtë anulim që t'u përgjigjen këtyre transmetimeve, numri i të cilave arrin deri në njëzet. Këto transmetime i ka mbledhur dijetari i shquar El-Emijni të detajuar në vëllimin e gjashtë të librit "El-Gadir". Ne do të japim dy shembuj prej saj:

1-Transmetohen në sahihun e Myslimit nga Xhabir ibn Abdullah El-Ensarij se ai ka thënë: *"E kemi kryer martesën e përkohshme me një grusht miell dhe me një grusht hurma në kohën e të Dërguarit të All'llahut dhe në kohën e Ebu Bekrit, derisa Umeri e ndaloi në çështjen e Amru ibn Harith."*¹

2-Në një tjetër hadith në librin "El me'uta" të imam Malikut dhe në "Sunenul Kubra" të Bejhakiut, transmetohet nga Urvetu ibn Zubejr se Khaulet, vajza e Hakimit ka shkuar te Umer ibn Khatab (Zoti qoftë i kënaqur me të!) dhe i ka thënë se Rrabia ibn Umejeh është martuar me martesë të përkohshme. Umeri duke dalë i frikësuar dhe duke shkundur rrobën e tij ka thënë: *"Kjo është martesë e përkohshme (mut'atu)! Sikur ta kasha ndaluar më parë, do ta gurëzoja atë."*²

Në librin "Bidajetul Muxhtehid", të autorit Ibn Rrush El-Endulisij, gjithashtu lexojmë se Xhabir ibn Abdullah ka thënë: *"E kemi kryer martesën e përkohshme në kohën e Profetit (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) në kohën e Ebu Bekrit dhe në gjysmën e periudhës së udheheqjes së Umerit. Më pas Umeri ua ndaloi atë njerëzve."*³

¹ *El Gadijr*, vëll. 6, f. 205-206.

² *El Gadijr*, vëll. 1, f. 210. *Kenzul Ummal*, vëll. 16, f. 520.

³ *Bidajetul Muxhtehid*, vëll. 2, f. 47, kapitulli i martesës.

Problem tjetër është se transmetimet, të cilat flasin për anulimin e rregullit të martesës së përkohshme në kohën e të Dërguarit të All'llahut janë në kundërshtim me njëra-tjetrën. Disa prej tyre thonë se është anuluar në Khajber; disa të tjerë thonë se është anuluar ditën që është çliruar Meka; disa të tjerë thonë në luftën e Tebukut dhe të tjerë thotë në ditën e Eutasit e të tjera të ngjashme me këto. Nga këtu qartësohet se këto hadithe të cilat flasin për anulimin, janë të gjitha të sajura e të pasakta për shkak se janë në kundërshtim të qartë me njëra-tjetrën.

Nga e gjithë kjo që thamë, sqarohet ajo çfarë ka shkruar autori i tefsirit "El-Menar": *"Umeri e ka ndaluar martesën e përkohshme bazuar te mendimi i tij personal dhe sahabët e kanë miratuar. Më pas na është qartësuar se është një gabim, ku i kërkojmë Zotit ta falë atë."*¹

Duhet thënë se as Umeri e askush tjetër, qofshin edhe imamët e Ehli Bejtit që janë pasardhësit e Profetit, nuk kanë aftësinë e anulimit të rregullave, të cialt janë miratuar në kohën e Profetit Muhammed (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Jo vetëm kaq, anulimi nuk ka asnjë kuptim pas vdekjes së Profetit, sepse edhe porta e Shpalljes nga ana e All'llahut është mbyllur me vdekjen e Profetit Muhammed. Kështu, thënia se Umeri e ka ndaluar atë bazuar në mendimin (ixhtihadin) e tij, kjo është e habitshme, sepse ky lloj ixhtihadi konsiderohet "ixhtihad" përballë "tekstit".

Është më e çuditshme se një grup prej fukahave të Ehli Synnetit, ajetet që kanë lidhje me rregullat e martesës, siç është

¹ Tefsiri El Menar, vëll. 5, f. 16.

ajeti i gjashtë i sures “El-Mu’minun”, i konsiderojnë si anuluese të ajetit të martesës së përkohshme. Duket se ata mendojnë se martesa e përkohshme nuk është martesë, ndërkohë që martesa e përkohshme është prej martesës.

2-Martesa e përkohshme është një domosdoshmëri shoqërore

Ka një rregull të përgjithshëm se instikti njerëzor, nëse nuk i përgjigjet në një farë mënyre dëshirës seksuale, njeriu ndjek rrugën e devijuar për t’iu përgjigjur dhe plotësuar dëshirën e këtij instikti. Prej të vërtetave të natyrshme dhe të pamohueshme është se instiktet natyrore nuk mund të asgjësohen menjëherë. Edhe sikur ne të duam ta bëjmë këtë, kjo nuk bëhet, sepse kjo vepër nuk është e drejtë. Kjo vepër është luftim i një ligji prej ligjeve të krijimit. Kështu që, mënyra më e drejtë për ta plotësuar këtë nevojë dhe instikt është ajo e logjikshmja. Le të përfitojmë prej kësaj mënyre në procesin e formimit.

Nuk mund të mohojmë se instikti seksual është një ndër instiktet më të forta që ka njeriu. Ai është aq i fortë, saqë disa analistë të psikologjisë e konsiderojnë këtë si instiktin burimor tek njeriu, nga i cili vijnë të gjitha instiktet e tjera.

Nëse është kështu, atëherë shtrohet çështja: Ka mundësi që njeriu nuk mund të martohet – në shumë raste – me martesë të përhershme në moshë të caktuar, ose ka prej të martuarve, të cilët udhëtojnë për një kohë të gjatë larg bashkëshorteve. Kështu, mund të përballen me nevojën seksuale, e cila duhet përmbushur.

Po të shohim në kohët e sotme, çështja e martesës është bërë mjaft e ndërlikuar për shkak të viteve të gjata të studimeve e

diplomimeve, e cila ka bërë që të rinjtë dhe të rejat të vonohen në martesë. Të paktë janë ata të rinj e të reja në gjendje të martohen në moshë të re. Vallë, cila është rrugëzgjdhja e përshtatshme në këtë gjendje? A do të ishte detyrim që t'i nxisnim njerëzit që ta shtypnin këtë instikt (sikurse veprojnë murgjit dhe murgeshat)? A do të ishte detyrim që t'u linim fushë të lirë për të vepruar çfarë të duan seksualisht në një formë të shfrenuar? Apo të ndiqet një rrugë e tretë e cila largon problemet e martesës së përhershme si dhe largon fëlliqësitë e lirisë seksuale?

Shkurtimisht, themi se martesë e përhershme, as më përpara dhe as në kohët e sotme, nuk ka qenë në gjendje t'i përgjigjet plotësisht nevojave seksuale dhe as të plotësojë dëshirat e të gjitha grupeve dhe shtresave të njerëzve. Për këtë, ne jemi përballë dy zgjedhjeve, që nuk ka të tretë, ose të lejojmë zinanë (kurvërinë) dhe veprat e shëmtuara (sikurse është gjendja sot në shoqëritë materialiste, të cilat e lejojnë imoralitetin me ligj), ose këtë çështje ta kurojmë me lejin e martesës së përkohshme. Cila do të ishte përgjigjja e atyre që kundërshtojnë mendimin e prostitucionit dhe mendimin e martesës së përkohshme nga këndvështrimi i kësaj pyetjeje?

Me të vërtetë, tematika e martesës së përkohshme nuk është e lidhur me kushtet e martesës së përhershme që të thuhet se nuk përshtatet ose nuk përputhet me pamundësinë ekonomike ose nuk është në përshtatje me kushtet e studimit, sikurse nuk të shtyn për të bërë vepra të këqija e të turpshme.

3- Kritikat për martesën e përkohshme

Vërtet, ka kritika dhe qortime rreth martesës së përkohshme, që duhen përmendur dhe duhet patjetër t'u jepet një përgjigje përmbledhëse.

A) Ndoshta dikush thotë: Cili është ndryshimi mes martesës së përkohshme dhe “prostitucionit”? A nuk janë që të dyja për të shitur trupin për të përfituar një shumë të caktuar? Me të vërtetë, martesë e përkohshme nuk është veçse një perde apo mbulesë për veprat e këqija dhe për prostitucionin. Po, dallimi mes këtyre dy çështjeve është procedura, e cila shprehet me fjalë, por ajo nuk është vetëm se thjesht një shprehje.

Përgjigje: Ata të cilët i thonë këto fjalë duket sikur nuk kanë lexuar dhe nuk kanë kuptuar as edhe një gjë nga martesë e përkohshme dhe nga e vërteta e saj, sepse martesë e përkohshme nuk është vetëm dy fjalë që thuhet dhe çdo gjë përfundon. Por, ka procedura të ngjashme me martesën e përhershme, që do të thotë se gruaja që martohet me martesë të përkohshme, gjatë gjithë kohës së kësaj martese, duhet të qëndrojë vetëm me burrin me të cilin ajo martohet me martesë të përkohshme. Kur përfundon koha e përmendur e kësaj martese, është detyrim për gruan që të pastrohet, që do të thotë të mos martohet me një burrë tjetër pa kaluar 45 ditë nga përfundimi i kohës së martesës së përkohshme, derisa të qartësohet nëse ajo është shtatzanë nga burri i parë apo jo.

Ajo është e detyruar që të presë këto ditë, edhe nëse e ka parandaluar shtatzaninë duke përdorur ilaçe. Nëse ngelet shtatzanë me këtë burrë, është detyrim i këtij burri që të mbajë

përgjegjësinë e këtij fëmije, sikurse mban përgjegjësinë e fëmijëve me martesën e përhershme dhe i detyrohen të gjitha procedurat ligjore, sikurse i detyrohen fëmijës me martesë të përhershme. Ndërkohë, prostitucioni nuk përmban asnjë nga këto kushte dhe rregulla. A mund të krahasohet kjo martesë me prostitucionin? Po, me të vërtetë, ndërmjet martesës së përkohshme dhe martesës së përhershme ka disa ndryshime nga ana e trashëgimisë së dy bashkëshortëve¹, shpenzimeve dhe disa rregullave. Por këto ndryshime nuk janë shkak që martesa e përkohshme të krahasohet me prostitucionin. Si përfundim, martesa e përkohshme (el mut'atu) është një lloj martese me procedura dhe rregulla ashtu siç ka edhe martesa e përhershme .

B) Me të vërtetë, martesa e përkohshme i lejon disa njerëz ta plotësojnë epshin e vet, por jo ta keqpërdorin atë nën petkun e kësaj martese. Kështu, disa personalitete nga njerëzit nuk e pranojnë këtë martesë. Edhe disa personalitete prej grave, gjithashtu, e kanë kundërshtuar.

Përgjigja: Cili ligj në ditët e sotme nuk është keqpërdorur? A lejohet që të ndalohet zbatimi i një ligji për shkak të keqpërdorimit të tij, pra, që mund të jetë një ligj në përputhje me natyrën e krijuar (fitratu) dhe që plotëson nevojat e domosdoshme shoqërore? Apo duhet të ndalojmë ata që e keqpërdorin ligjin e saktë e të rregullt?

Po të supozojmë se disa njerëz mund ta shfrytëzonin periudhën e haxhit për t'u shitur drogë haxhilerëve, vallë a duhet

¹ Sigurisht, për sa i përket kësaj çështjeje, nuk ka ndryshim ndërmjet fëmijëve në martesën e përkohshme dhe atyre të martesës së përhershme.

ta ndalojmë këtë veprim të llahtarshëm, apo të ndalojmë njerëzit që të marrin pjesë në këtë kongres madhështor islamik?

E tillë është gjendja edhe në këtë çështje. Nëse vërejmë disa personalitete që e urrejnë këtë procedurë islame (martesën e përkohshme), do të shohim se urrejtja e tyre nuk bazohet në legjislacion, por tek keqpërdoruesit dhe abuzuesit ndaj saj.

Nëse martesa e përkohshme në shoqëritë e sotme do të merrte formën e saj të rregullt, larg çdo abuzimi apo keqpërdorimi dhe të praktikohet në formën e saktë, brenda kushteve dhe procedurave të saj të veçanta, nuk do t'u linte hapësirë disa personave që ta urrenin këtë ligj dhe ta refuzonin atë.

C) Thonë se martesa e përkohshme është shkak që në shoqëri të rriten fëmijë pa familje, sikurse ndodh me fëmijët e paligjshëm (të prostitucionit).

Përgjigje: Me të vërtetë, përgjigjja e kësaj kritike qartësohet plotësisht nga ajo që thamë më sipër, se fëmijët e paligjshëm nuk janë të lidhur me baballarët dhe nënat e tyre nga ana ligjore, kurse fëmijët që lindin nga martesa e përkohshme nuk ndryshojnë në asnjë aspekt nga fëmijët që lindin nga martesa e përhershme, deri edhe në trashëgimi dhe çështje të tjera shoqërore. Ky kundërshtim ka lindur nga mosinteresi dhe mospërkushtimi ndaj të vërtetës së dukshme që ka lidhje me martesën e përkohshme.

4 - "Rasell' dhe martesë e përkohshme

Në përfundim të këtij kërkimi është mëse e dobishme të tregojmë se çfarë ka shkruar në këtë fushë shkrimtari i shquar anglez Bertrand Rasell në librin e tij "Martesë dhe morali", në kapitullin "martesë me dëshirë".

Rasell, pasi ka përmendur propozimin e gjykatësit Benbij Lijndesi të gjykatës për të rinjtë rreth "martesës së kënaqesise" ose "martesës me dëshirë" ka shkruar: Sipas këtij propozimi, rinia duhet që të jetë në gjendje të hyjë në një lloj të ri martesë që ndryshon nga martesë e njohur "martesë e përhershme" në tre drejtime:

E para: Nuk duhet që të dy palët të kenë qëllim fëmijët në këtë lloj martesë. Për këtë, ata duhet t'i njohin më së miri rrugët dhe mënyrat e ndalimit të shtatzanisë.

E dyta: Ndarja mes dy palëve të bëhet në mënyrën më të thjeshtë dhe më të lehtë.

E treta: Pas ndarjes, gruaja nuk meriton asnjë shpenzim nga burri.

Rasell, pasi përmend përmbledhjen e asaj që propozoi Lijndesi, thotë: Unë mendoj se diçka e tillë, po të pranohej nga ligji, do të pranohej edhe nga e gjithë rinia dhe në vençanti nga studentët nëpër universitete. Ata do të hynin në jetën e ortakërisë së përkohshme, jetë kjo, ku gëzon liri, e largët nga mundimet dhe

ndëshkimet e këqija për shkak të lidhjeve seksuale të dalldisura e të shthurura që gjenden në kohët e sotme.¹

Ky propozim, sikurse mund ta shikosh edhe ti i dashur lexues, rreth martesës së përkohshme, i ngjason shumë ligjit të martesës së përkohshme në Islam. Kushtet që ka vendosur Islami në fushën e martesës së përkohshme janë më të qarta dhe më të plota në shumë aspekte, ndaj asaj që propozoi Lijndesi.

Pastaj All'Ilahu i Lartësuar, pas përmendjes së domosdoshmërisë së dhënies së mehrit, thotë: **“Ska gjynah për ju, me pëlqimin e të dy palëve, që ta shtoni apo pakësoni sasinë e dhuratës së premtuar.”** Me këtë, All'Ilahu i Lartësuar na tregon se nuk ka pengesë në ndryshimin e sasisë së dhuratës nëse të dy palët janë të kënaqur. Bazuar në këtë argument, dhurata është një lloj borxhi, i cili mund të shtohet ose të pakësohet nëse dy palët janë të kënaqur. (Nuk ka ndryshim ndërmjet martesës së përhershme dhe martesës së përkohshme, edhe pse ajeti në fjalë, siç e sqaruam edhe më parë, flet për martesën e përkohshme).

Ka edhe një supozim tjetër në komentimin e ajetit që është se nuk ka pengesë që të paraqesin dy palët, pasi të kryhet marrëveshja për martesën e përkohshme, që të shtyjë afatin e kësaj martese. Po kështu, edhe për ndryshimin e dhuratës me pëlqimin e dy palëve. Kjo do të thotë se martesa e përkohshme mund të shtyhet edhe më gjatë edhe sikur koha e saj të jetë në prag të përfundimit. Sigurisht që bashkëshortët duhet të bien dakort që ta shtyjnë periudhën që kanë vendosur në fillim të kësaj martese në një kohë tjetër të përcaktuar duke shtuar sasinë e dhuratës së

¹ Eḏ Zina uel Akhlak, f. 189-190.

përcaktuar në fillim (kemi shpjeguar në këtë tefsir transmetimet e Ehli Bejti).

All'llahu i Lartësuar urdhëron e thotë: **“Se All'llahu me të vërtetë është i Gjithëdijshmi dhe i Urti.”** All'llahu në këtë ajet thotë se rregullat që përmenden, u sigurojnë njerëzve dobi, ndreqje dhe lumturi, sepse All'llahu i Lartësuar është i Gjithëditur për dobitë dhe dëmet e njerëzve. Ai është i Urti për ato ligje që ka vendosur për ata.

Ajeti 25

وَمَنْ لَّمْ يَسْتَطِعْ مِنْكُمْ طَوْلاً أَنْ يَنْكِحَ الْمُحْصَنَاتِ الْمُؤْمِنَاتِ فَمِنْ
 مَا مَلَكَتْ أَيْمَانُكُمْ مِّنْ فَتَيَاتِكُمُ الْمُؤْمِنَاتِ ۚ وَاللَّهُ أَعْلَمُ بِإِيمَانِكُمْ ۚ
 بَعْضُكُم مِّنْ بَعْضٍ ۚ فَإِنْ كُفَّوهُنَّ بِإِذْنِ أَهْلِهِنَّ وَءَاتَوْهُنَّ أَجُورَهُنَّ
 بِالْمَعْرُوفِ مُحْصَنَاتٍ غَيْرِ مُسَفِّحَاتٍ وَلَا مُتَّخِذَاتِ أَخْدَانٍ ۚ فَإِذَا
 أُحْصِنَ فَإِنَّ أَتَيْنَ بِفَاحِشَةٍ فَعَلَيْهِنَّ نِصْفُ مَا عَلَى الْمُحْصَنَاتِ مِنَ
 الْعَذَابِ ۚ ذَلِكَ لِمَنْ خَشِيَ الْعَنَتَ مِنْكُمْ ۚ وَأَنْ تَصْبِرُوا خَيْرٌ لَّكُمْ ۖ وَاللَّهُ

غَفُورٌ رَّحِيمٌ ﴿٢٥﴾

“Cilido nga ju që nuk mund të martohet me gra të lira besimtare, për shkaqe të vështira materiale, le të martohet me një vajzë besimtare që gjendet nën pushtetin tuaj (robërëshë) - e All'llahu e di më së miri besimin tuaj -, se jeni nga njëri-tjetri. Martohuni me to me lejen e familjeve (pronarëve) të tyre. Jepuni dhuratat si është e zakonshme për gra të ndershme e jo imorale të hapura apo të fshehta, që jetojnë me dashnor. Nëse ato, pasi të martohen, bëjnë kurvëri, dënimi i tyre është për gjysmë me

dënimin e grave të lira (të pamartuara). Kjo është për ata nga ju, që kanë frikë se do të bëjnë gabim (kurvëri). Nëse përmbaheni, kjo është edhe më mirë! All'illahu është Falës dhe Mëshirëplotë."

Komentimi

Martesa me robëreshat

Pas hulumtimeve të mëparshme që kishin lidhje me martesën, ka zbritur ky ajet që qartëson kushtet e martesës me robëreshat. Së pari, ajeti thotë: **"Cilido nga ju që nuk mund të martohet me gra të lira besimtare, për shkaqe të vështira materiale, le të martohet me një vajzë besimtare që gjendet nën pushtetin tuaj (robëreshë)..."** Kjo do të thotë se kush prej jush nuk i ka mundësitë financiare që të martohet me grua besimtare që është e lirë dhe që nuk është në gjendje t'i japë mehrin dhe të përballojë shpenzimet, atëherë le të martohet me robëreshë, ku zakonisht, mehri i tyre për martesë është më i pakët dhe kërkesat e tyre janë më të ulta.

Qëllimi me këtë robëreshë në këtë ajet është robëresha e një tjetri, sepse nuk i lejohet të zotit të robëreshës që të martohet me robëreshën e tij dhe të veprojë me të sikurse vepron me bashkëshorten e tij, me kushtet të cilat janë shpjeguar në librat e jurisprudencës islame.

Po ashtu, nga thënia *el mu'minat* në këtë ajet kuptohet se është detyrim që robëresha me të cilën dëshiron të martohesh, të jetë besimtare, derisa të lejohet martesë me të. Duke u bazuar mbi këtë parim, nuk lejohet martesë me robëreshat që janë prej ithtarëve të librit (çifutet dhe të krishterët).

Pastaj, ajo çfarë tërheq vëmendjen, është se Kur'ani i ka përshkruar robëreshat me vajza (*fetajat* që është shumësi i fjalës *fetatur*), ku zakonisht tregon për një respekt të veçantë ndaj femrës. Kjo fjalë përdoret më shumë për vajzat e reja.

Pas këtij rregulli, All'llahu i Lartësuar urdhëron e thotë: **"All'llahu e di më së miri besimin tuaj..."** Me këtë thënie All'llahu do t'ju thotë se ju nuk jeni të detyruar të analizoni besimin e robëreshave. Ju shihni të jashtmen. Të fshehtat i di All'llahu. Ai di çfarë kanë njerëzit në ndërgjegjen e tyre.

Meqenëse disa e kanë urreyer martesën me robëreshat dhe e kanë refuzuar martesën me ta, All'llahu i Lartësuar ka thënë: **"...se janë nga njëri-tjetri..."** Sigurisht që të gjithë jemi nga një baba dhe nga një nënë. Atëherë është detyrim që të mos e refuzoni martesën me robëreshat, të cilat nga ana njerëzore nuk ndryshojnë nga ju. Ato i ngjajnë të tjerave nga ana e vlerave shpirtërore. Boshti i vlerave të tyre është devotshmëria dhe besimi që ato kanë dhe asgjë tjetër. Robëreshat janë nga lloji i juaj dhe të gjithë ju jeni si pjesët e një trupi të vetëm.

Sigurisht, duhet që martesë me robëreshat të kryhet pasi merret leja e familjes së tyre, përndryshe, ajo martesë është e parregullt. Ky është edhe qëllimi i All'llahut të Madhëruar, i Cili thotë: **"...martohuni me ta me lejen e familjeve (pronarëve) të**

tyre..." dhe përshkrimi i pronarëve të tyre me familjet e tyre tregon se nuk lejohet që robëreshat të konsiderohen sikurse të jenë plaçkë apo mall, por është detyrim që të konsiderohen sikur të jenë pjesë e familjes. Prandaj, patjetër duhet që të jetë konsideratë e plotë njerëzore.

Pastaj All'Ilahu i Lartësuar thotë: **"...Jepuni dhuratat si është e zakonshme..."** Nga kjo fjali kuptojmë se dhuratat, të cilat u jepen atyre, duhet të jenë në përshtatje me pozitën e tyre dhe atyre t'u jepet mehiri, që do të thotë se robëresha të jetë poseduese e mehrit edhe pse disa komentues kanë thënë se në këtë ajet ka shkëputje, që do të thotë se origjina është: *(Jepuni pronarëve të tyre dhuratat e tyre)*¹. Ky komentim nuk është i përshtatshëm me paraqitjen e ajetit, edhe pse disa transmetime e përforcojnë atë.

Gjithashtu, robërit dhe robëreshat mund të zotërojnë pasurinë e tyre, të cilën e fitojnë në rrugë të ligjshme.

Po ashtu, nga shprehja *El ma'ruf*, që do të thotë "diçka e zakonshme dhe e njohur", përfitohet se nuk lejohet t'i bëhet padrejtësi robëreshave në përcaktimin e sasisë së mehrit, sepse ai është e drejta e tyre e natyrshme dhe duhet t'u jepet atyre në atë sasi që është e njohur tek njerëzit.

All'Ilahu i Lartësuar përmend një kusht tjetër prej kushteve të kësaj martese. Ai është që burri të zgjedhë për martesë gra të pastra e të ndershme nga robëreshat, që nuk kanë bërë imoralitet. All'Ilahu thotë: **"...të ndershme..."** qoftë në dukje **"...e jo imorale të hapura..."** apo në fshehtësi **"...në formë të fshehtë..."** që të mos kenë dashnor dhe bashkëjetues në fshehtësi.

¹ Tefsiri *Mexhamul Bejan*, fundi i ajetit në fjalë.

Pyetje: Këtu mund të bëhet pyetja: Ndalimi i prostitucionit me thënien: “...e jo imorale të hapura...” mjafton nga ndalimi për të pasur dashnor e bashkëjetues. Përse është përmendur edhe cilësimi i dytë?

Përgjigje: Përgjigja për këtë është se, në kohën e injorancës, disa mendonin se i shëmtuar është prostitucioni dhe imoraliteti i hapur, ndërsa të paturit bashkëjetues, dashnor ose dashnore në fshehtësi, nuk ka qenë e turpshme. Me këtë qartësohet shkaku përse përmenden të dy cilësimet në Kur'an.

Pastaj All'illahu i Lartësuar thotë: “...Nëse ato, pasi të martohen, bëjnë kurvëri, dënimi i tyre është përgjysmë me dënimin e grave të lira (të pamartuara)...” Ky ajet përmbledh një hulumtim rreth ndëshkimit të robërshave, nëse ato dalin jashtë rrugës së ndershmërisë dhe të pastërtisë. Kjo vjen pasi më parë u përmendën disa rregulla të martesës me robërshat dhe pasi u përmendën disa rregulla rreth të drejtave që u takojnë atyre. Rregulli i përcaktuar në këtë fushë është se nëse robërsha bën kurvëri, ndëshkimi i saj është pesëdhjetë goditje me kamxhik, pra sa gjysma e ndëshkimit të gruas së lirë.

Pastaj këtu është diçka që i duhet kushtuar vëmendje. Kur'ani i shenjtë thotë: “...Nëse ato, pasi të martohen...” dhe kuptimi i saj është se ndëshkimi i përmendur konsiderohet për kurvërinë e robërshës, nëse ajo martohet. Dhe çfarë do të thotë kjo? Komentuesit kanë dhënë mendime të ndryshme. Disa kanë thënë se qëllimi është për robërshën që ka burrë. Disa të tjerë kanë thënë se qëllimi është robërsha myslimane me argument se përsëritja dy herë e fjalës *el muhsinetu* në këtë ajet vendos që të jetë një kuptim në të dy rastet. Kjo është nga njëra anë. Nga ana tjetër,

ndëshkimi i grave të lira të martuara është dënimi me gurë dhe jo me goditje (rrahje). Kështu qartësohet se komentimi i parë është komentimi për robëreshën që ka burrë dhe është i papranueshëm sikurse edhe komentimi i dytë, që thotë se qëllimi i fjalës *el muhsinetu* është për myslimanen dhe nuk ka argument për të.

E vërteta është se fjala *muhsinat* në Kur'anin famëlartë me kuptimin e gruas së pastër dhe të ndershme, në përgjithësi, bën që fjala *muhsinat* në këtë ajet të jetë me të njëjtin kuptim. Qëllimi është se atyre robëreshave, të cilat bëjnë vepra të këqija e të pamoralshme me forcë dhe imponim nga kujdestarët e tyre, nuk u zbatohet ligji i goditjeve me kamxhik. Ndërsa robëreshat, të cilat e bëjnë këtë vepër pa forcë e imponim, por që e kanë mundësinë të jetojnë një jetë të ndershme e të pastër, nëse e bëjnë këtë vepër të shëmtuar, ndëshkohen, sikurse ndëshkohen gratë e lira. Nëse është ky lloj ndëshkimi ndaj robëreshve, atëherë është sa gjysma e ndëshkimit të grave të lira që bëjnë kurvëri.

All'Ilahu i Lartësuar, pas këtij rregulli, thotë: **"...që kanë frikë se do të bëjnë gabim (kurvëri)..."** Fjala *el-ant*, në rrënjën e foljorit të saj, vjen nga eshtra (kocka) e vendosur në allçi pas thyerjes, sepse kjo lloj thyerjeje është shumë e dhimshme. Po kështu, përdoret në problemet madhore dhe në fatkeqësi.

Me këtë shprehje, Kur'ani famëlartë ka për qëllim të tregojë se martesë me robëreshat është për atë që vuan nga presioni i fortë për arsye të fuqisë së instiktit seksual dhe nuk është në gjendje të martohet me gra të lira. Bazuar mbi këtë opinion, nuk i lejohet të martohet me robëresha vetëm këtij lloji.

Filozofia e këtij rregulli mund të jetë se në atë kohë robëreshat nuk kanë patur mundësinë të edukohen mirë. Për këtë, ato patën mangësi të brendshme morale dhe shpirtërore. Është mëse e natyrshme që fëmijët e lindur nga kjo martesë të përfitojnë karakteristikat morale të nënave të tyre. Për këtë arsye, Islami ka paraqitur mënyrën më të saktë për t'i liruar robërit gradualisht, deri sa të mos sprovohen me këtë rrugë të keqe. Në të njëjtën kohë, i ka lejuar robërit të martohen ndërmjet tyre.

Pas kësaj, All'llahu i Lartësuar thotë: **"...nëse përmbaheni, kjo është edhe më e mirë..."** që do të thotë se nëse ju bëni durim nga martesa me robëreshat dhe nuk bini në imoralitet (kurvëri), është një gjë më e mirë dhe më e dobishme.

Në fund, All'llahu i Madhëruar thotë: **"...All'llahu është Falës dhe Mëshirues."** Sigurisht, All'llahu ua fal gjynahet, gabimet që ju i keni bërë nga padija dhe Ai është i Gjithmëshirshëm për ju.

Ajetet 26 - 28

يُرِيدُ اللَّهُ لِيُبَيِّنَ لَكُمْ وَيَهْدِيَكُمْ سُنْنَ الَّذِينَ مِنْ قَبْلِكُمْ وَيَتُوبَ عَلَيْكُمْ
وَاللَّهُ عَلِيمٌ حَكِيمٌ ﴿٢٦﴾ وَاللَّهُ يُرِيدُ أَنْ يَتُوبَ عَلَيْكُمْ وَيُرِيدُ الَّذِينَ
يَتَّبِعُونَ الشَّهَوَاتِ أَنْ تَمِيلُوا مَيْلًا عَظِيمًا ﴿٢٧﴾ يُرِيدُ اللَّهُ أَنْ تَخَفَّ عَنْكُمْ
وَخُلِقَ الْإِنْسَانُ ضَعِيفًا ﴿٢٨﴾

“All’l-lahu dëshiron që t’ju sqarojë, t’ju udhëzojë në rrugën e të dërguarve të mëparshëm dhe t’jua pranojë pendimet tuaja. All’l-lahu është i Gjithëdijshëm dhe i Urtë.”

“All’l-lahu dëshiron që t’jua pranojë pendimet tuaja, por ata që jepen pas epsheve, dëshirojnë që të largoheni krejtësisht nga udha e drejtë.”

“All’l-lahu dëshiron që t’jua lehtësojë (barrët), pasi njeriu është krijuar si një qenie e pafuqishme.”

Komentimi

Përse këto kritere?

All'llahu i Madhëruar pasi na i shpjegoi e na i qartësoi në ajetet e mëparshme, kriteret, limitet dhe rregullat e ndryshme në fushën e martesës, ka mundësi që në mendjen e dikujt të lindë pyetja: Cili është qëllimi i të gjitha këtyre kritereve dhe përse këto kufij ligjorë? A nuk ishte më e mirë që njerëzve t'u lihej liria e plotë në këto çështje që t'u jepej mundësia të përfitonin dhe të mësonin në këtë fushë sikurse bëjnë robtë e kësaj bote, që mundohen me të gjitha mënyrat për të arritur kënaqësitë e saj?

Ajetet në fjalë janë përgjigje për të gjitha këto pyetje, sepse All'llahu i Madhëruar thotë: **“All'llahu dëshiron që t'ju sqarojë, t'ju udhëzojë në rrugën e të dërguarve të mëparshëm dhe t'jua pranojë pendimet tuaja...”** Kjo do të thotë se All'llahu ua qartëson juve këto të vërteta nëpërmjet këtyre ligjeve dhe ju udhëzon në atë që është më e dobishme për ju. Dijeni se këto rregulla nuk janë të posaçme vetëm për ju, sepse ato gjendeshin edhe tek ata që ishin para jush dhe që kanë qenë në rrugën e drejtë. Në shtesë të kësaj, All'llahu i Lartësuar dëshiron që t'ju falë juve dhe t'ju rikthejë mirësinë e Tij. Falja dhe mirësitë ndërpriten për shkak të devijimit tuaj nga rruga e drejtë. E gjitha kjo realizohet nëse ju e braktisni rrugën e devijimit, të cilën e keni ndjekur në kohën e injorancës, para Islamit. **“...All'llahu është i Gjithëdijshtëm dhe i Urtë.”** Ai i di të fshehtat e rregullave, i legjitimon ato për ju bazuar te urtësia. All'llahu e përforcon atë që u tha më lart me thënien e Tij: **“All'llahu dëshiron që t'jua pranojë pendimet tuaja, por ata që**

jepen pas epsheve, dëshirojnë që të largoheni krejtësisht nga udha e drejtë." Ata, të cilët i pasojnë epshtet dhe që janë të zhytur në gjynahe, dëshirojnë që ju të devijoni nga rruga e lumturisë. Ata dëshirojnë që t'i toleroni në ndjekjen e epsheve dhe të zhyteni plotësisht në gjynahe.

Si mendoni, a janë këto kritere garaci për lumturinë tuaj, për të mirën dhe dobinë tuaj apo është liria e shthurur e shoqëruar me degjenerim, prishje morali dhe shkatërrim total?

Vërtet, këto ajete, u përgjigjen edhe pyetjeve të personave që jetojnë në kohët e sotme, edhe atyre, të cilët i kundërshtojnë këto rregulla dhe kritere të domosdoshme e që kanë lidhje me çështjet seksuale. Ata u thonë atyre: Liritë absolute e të pakontrolluara janë vetëm mirazh. Ato sjellin vetëm devijim e shkatërrim të madh në rrugën e lumturisë dhe përsosurisë së njeriut. Po ashtu, sjellin ndëshkime të ashpra, disa prej të cilave i shohim me sy, siç janë: shkatërrimet e familjeve, krimet e shëmtuara e të neveritshme seksuale, shfaqja e sëmundjeve të pashërueshme, dhimbjet e mëdha shpirtërore e psikike dhe lindja e fëmijëve të jashtëligjshëm, të cilët, janë shkak i shtimit të kriminalitetit.

Pas gjithë kësaj, All'llahu i Lartësuar thotë: **"All'llahu dëshiron që t'jua lehtësojë (barrët), pasi njeriu është krijuar si një qenie e pafuqishme."** Ky ajet tregon një pikë tjetër që është se rregullat e mëparshme në fushën e lirisë së martesës me robërshat me kushtet e përcaktuara, në të vërtetë nuk është vetëm se një lehtësim dhe zgjerim, sepse njeriu është krijesë e dobët. Përderisa ai përballet me furtunat e ndryshme të instiktit, të cilat e impresionojnë dhe e sulmojnë vazhdimisht, duhet patjetër që

atij t'i propozohen dhe t'i gjenden mënyra dhe rrugë ligjore për t'i kënaqur dhe për t'i mposhtur instiktet e tij, me qëllim që të jetë i aftë ta ruajë vetveten nga devijimi dhe nga rënia në humnerën e humbjes.

Ajetet 29 - 30

يَأْتِيهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا لَا تَأْكُلُوا أَمْوَالَكُمْ بَيْنَكُمْ بِالْبَاطِلِ إِلَّا أَنْ
تَكُونَ تِجَارَةً عَنْ تَرَاضٍ مِّنْكُمْ ۚ وَلَا تَقْتُلُوا أَنْفُسَكُمْ ۚ إِنَّ اللَّهَ كَانَ بِكُمْ
رَحِيمًا ﴿٢٩﴾ وَمَنْ يَفْعَلْ ذَلِكَ عُدْوَانًا وَظُلْمًا فَسَوْفَ نُصْلِيهِ نَارًا ۚ
وَكَانَ ذَلِكَ عَلَى اللَّهِ يَسِيرًا ﴿٣٠﴾

“O ju që keni besuar, mos e përvetësoni pasurinë e njëri-tjetrit në mënyrë të palejueshme, përveç rastit kur ajo është tregti me pëlqim të dyanshëm dhe mos e vritni veten (dhe njëri-tjetrin)! Vërtet, All’llahu është i Mëshirshëm me ju.”

“Këdo prej jush që e bën këtë përdhunisht dhe padrejtësisht, Ne, pa dyshim, do ta hedhim në zjarr. Kjo është shumë e lehtë për All’llahun.”

Komentimi

Siguria shoqërore ka lidhje me sigurinë ekonomike

Ajeti i parë prej këtyre dy ajeteve, në të vërtetë, përbën një rregull kryesor të ligjeve islame në fushën që ka lidhje me veprimet dhe shkëmbimet financiare. Me këtë ajet, juristët (fukahatë) e Islamit i argumentojnë të gjitha çështjet që kanë lidhje me veprimet dhe shkëmbimet financiare.

Ky ajet u drejtohet besimtarëve dhe u thotë: **“O ju që keni besuar, mos e përvetësoni pasurinë e njëri-tjetrit në mënyrë të palejueshme...”** Kjo do të thotë se çdo veprim ndaj pasurisë së njëri-tjetrit, pa të drejtë ose pa arsye të logjikshme, është i ndaluar dhe haram në këndvështrimin Islam. Të gjitha këto çështje Islami i ka përfshirë nën titullin “batil”, që do të thotë i palejuar e i padrejtë, i cili ka një kuptim të gjerë. Siç e dimë, fjala “batil” është e kundërta, antonimi i fjalës “el hak”, që do të thotë “e drejtë”. Pra, fjala “batil” i përfshin të gjitha ato që nuk janë të drejta dhe të lejuara edhe çdo gjë që nuk e ka një qëllim.

Në ajetet e tjera të Kur'anit përforcohet ky kuptim me frazeologji të ngjashme me frazën e treguar në këtë ajet. All'Ilahu i Lartësuar thotë: **“Dhe për shkak se përvetësonin padrejtësisht pasurinë e njerëzve.”**¹ Kur i qorton, tregon jehudinjtë (çifutët) dhe përmend veprat e tyre të shëmtuara. Në suren “El Bekare”, ajeti 188, All'Ilahu i Lartësuar thotë: **“Mos ia merrni pasurinë njëri-tjetrit padrejtësisht.”** Ky ajet sqaron se paraqitja e njerëzve nëpër gjykata, shfrytëzimi dhe shpërdorimi i pasurisë së tjetrit

¹ Sure “En Nisa”, ajeti 161.

padrejtësisht dhe me argumente të dobëta e jo të ligjshme është i ndaluar.

Bazuar mbi këtë argument, nën këtë adresë të përgjithshme hyn çdo ngjyrë prej ngjyrave të armiqësisë, të mashtrimit; të gjitha veprimet financiare që kanë lidhje me kamatën, veprimet ekonomike të panjohura e të dyshuara, përdorimi i mallrave të pavlera sipas gjykimit të poseduesve të mendjes dhe tregtia me mallrat që sjellin shkatërrim dhe që janë të ndaluara të tregtohen.

Komentimi i fjalës “batil” në disa transmetime me kuptimin e bixhozit¹, të kamatës² dhe të tjera të ngjashme me këto, në të vërtetë është prej përmendjes së vërtetësive të qarta të kësaj fjale dhe nuk është si përkufizim.

Fjala “El ekel”, që do të thotë ngrënie, ka edhe kuptim figurative, që do të thotë *përvetësim*.

All’llahu i Lartësuar, pas këtyre frazave të lartpërmendura, thotë: “...**përveç rastit kur ajo është tregti me pëlqim të dyanshëm...**” Kjo frazë është përjashtim nga ligji i përgjithshëm. Sipas terminologjisë quhet “përjashtim i ndërprerë”, që do të thotë se ajo që ka ardhur në këtë frazë nuk e përfshin rregullin e përgjithshëm të mëparshëm, por është cekur si përforcues dhe përkujtues.

Duke u bazuar mbi këtë, të gjitha llojet e veprimeve dhe shkëmbimeve tregtare të njohura ndërmjet njerëzve, nëse bien dakort të dy palët me një formë të pranueshme, ato janë të lejueshme dhe të pranueshme në këndvështrimin Islam. (Me

¹ Uesailu Shia; vëll. 17, f. 166-167.

² Tefsiri Ali ibn Ibrahim Kumijj; vëll. 1, f. 136.

përjashtim të rasteve ku ka ndalim të qartë për hir të interesave të posaçme.)

Në fund të këtij ajeti, All'Ilahu i Lartësuar e ndalon njeriun që të kryejë vetëvrasje ku thotë: **"...dhe mos e vritni veten** (dhe njëri-tjetrin)!" Kjo fjalë ka ardhur e shoqëruar me fjalën e Tij: **"Vërtet, All'Ilahu është i Mëshirshëm me ju."** Pra, e ndalon vetëvrasjen. Kjo do të thotë se All'Ilahu është Mëshirues. Ashtu sikurse nuk e lejon vrasjen e dikujt, po ashtu nuk ua lejon juve që të vrisni veten tuaj. Në transmetimet e Ehli Bejtit (Paqja qoftë mbi ta!) ky ajet është komentuar me kuptimin e vetëvrasjes."¹

Pyetje: Ç'lidhje ka mes çështjes së vetëvrasjes dhe veprimit me pa të drejtë në pasurinë e njerëzve?

Përgjigje: Përgjigjja e kësaj pyetjeje është krejtësisht e qartë. Në të vërtetë, Kur'ani i tregon këto dy rregulla në mënyrë të njëpasnjëshme në një pikë të rëndësishme shoqërore, që është se marrëdhëniet ekonomike në shoqëri nuk janë të ndërtuara mbi baza të drejta, nëse ekonomia shoqërore nuk është në rrugë të drejtë dhe nëse gjendet padrejtësi dhe veprim agresiv ndaj pasurisë së tjetrit, atëherë shoqëria është e goditur me një lloj vetëvrasjeje, e cila përfshin gjithë shoqërinë.

Vërtet, ngjarjet dhe luftërat që ndhodhin në shoqëritë e ndryshme në kohët e sotme janë dëshmia më e mirë dhe argumenti më i fortë për këto të vërteta. Meqenëse All'Ilahu është Mëshirues dhe Falës ndaj robve dhe krijesave të Tij, Ai u ka tërhequr vërejtjen dhe i ka paralajmëruar që të largohen nga kjo çështje. Ai i nxit që të largohen nga shkëmbimet tregtare

¹ Tefsiri *Mexhmaul Bejan*, fundi i ajetit në fjalë. Tefsiri *Nuru Thakalejn*, vëll. 1, f. 472.

ekonomike të padrejta dhe u ka tërhequr vërejtjen prej ekonomisë së sëmure, e cila i çon shoqëritë në shkatërrim, në rënie dhe në gjakderdhje.

Po ashtu, All'llahu paralajmëron duke thënë: **“Këdo prej jush që e bën këtë përdhunisht dhe padrejtësisht, Ne, pa dyshim, do ta hedhim¹ në zjarr...”** Pra, kush i kundërshton këto rregulla, e injoron këtë paralajmërim, e përvetëson pasurinë e të tjerëve padrejtësisht dhe vret veten me dorën e vet, nuk e godet vetëm ndëshkimi i dhimbshëm i kësaj bote, por edhe zjarri dhe zemërimi i All'llahut. E kjo gjë është e lehtë për All'llahun, i Cili thotë: **“...Kjo është shumë e lehtë për All'llahun.”**

¹ Fjala “es salij” ka kuptimin e afrimit tek zjarri. Po ashtu, i thuhet edhe ngrohjes, djegies dhe vulosjes me zjarr. Në ajetin e përmendur është përdorur me kuptimin e djegies me zjarr.

Ajeti 31

إِنْ تَجْتَنِبُوا كَبَائِرَ مَا تُهَوِّنُ عَنْهُ نُكْفِّرْ عَنْكُمْ سَيِّئَاتِكُمْ وَنُدْخِلْكُمْ

مُدْخَلًا كَرِيمًا ﴿٣١﴾

“Në qoftë se ju u shmangeni gjynaheve të mëdha, që ju janë ndaluar, Ne do t’ju falim gabimet tuaja të vogla dhe do t’ju shpiem në një vend të nderuar.”

Komentimi

Gjynahet e mëdha dhe gjynahet e vogla

All’llohu i Lartësuar në këtë ajet me qartësinë më të madhe urdhëron e thotë: **“Në qoftë se ju u shmangeni gjynaheve të mëdha, që u janë ndaluar, Ne do t’ua falim gabimet tuaja të vogla dhe do t’ju shpiem në një vend të nderuar.”**

Nga kjo thënie përfitohet se gjynahet ndahen në dy grupe:

Grupi i parë janë ato që Kur’ani i shenjtë i quan gjynahe të mëdha.

Grupi i dytë janë ato që Kur’ani i shenjtë i quan vepra të këqija.

Në ajetin 32 të sures “En Nexhm”, në vend të fjalës *es seji’etu* është përdorur fjala *el lememu* dhe në ajetin 49 të sures “El Kehf” gjendet edhe fjala *sagijretun* (të vogla) edhe fjala *kebijretun* (të mëdha). All’llahu i Lartësuar thotë: **“Çfarë është ky libër që nuk paska lënë asnjë vepër të madhe apo të vogël pa e shënuar atë.”**

Nga këto shprehje të përmendura vërtetohet me qartësi se gjynahet ndahen në dy lloje të caktuara. Ndonjëherë u thuhet gjynahe të mëdha dhe të vogla, ndonjëherë u thuhet gjynahe të mëdha dhe vepra të këqija dhe ndonjëherë tjetër u thuhet gjynahe të mëdha dhe *el lummem*.¹

Është detyrim që të dimë se cilat janë kriteret në përcaktimin e gjynaheve të vogla dhe të mëdha. Nëse i kthehemi kuptimit gjuhësor të gjynaheve të mëdha, do të gjejmë se ato janë të gjitha në kundërshtim me Islamin. Shenja e kësaj rëndësie është Kur’ani, i cili nuk është mjaftuar vetëm me ndalimin e kryerjes së tyre, por përmend menjëherë kërcënimin me ndëshkim në zjarrin e Xhehennemit, si për shembull: për vetëvrasjen, prostitucionin, kamatën etj. Për këtë ka ardhur në transmetimet e Ehli Bejtit (Paqja qoftë mbi ta!) thënia: *“Mëkatet e mëdha janë ato që All’llahu i Lartësuar i ndëshkon me zjarr.”* Përmbledhja e këtij hadithi është transmetuar nga Imam Bakir, nga Imam Sadik dhe nga Imam Ali ibn Musa Err Rrida (Paqja qoftë mbi ta!).²

Bazuar mbi këtë parim, është e lehtë që të njihen gjynahet e mëdha. Në disa transmetime thuhet se numri i gjynaheve të mëdha është shtatë. Në disa të tjera thuhet se janë njëzet, e në disa

¹ Fjala “El lummem” ka kuptimin e punëve të vogla dhe të parëndësishme.

² Tefsiri *Nurul Thakalejni*, vëll. 1, f. 473. *Usulul Kefj*, vëll. 2, f. 276.

transmetime të tjera thuhet se numri i tyre arrin në shtatëdhjetë. Disa transmetime flasin për gjynahet e mëdha që janë në shkallë të parë; disa të tjera flasin për gjynahet e mëdha që janë në shkallë të dytë; disa tregojnë se të gjitha gjynahet janë gjynahe të mëdha.

Paqartësi

Mund të thuhet se ky ajet i nxit njerëzit që të bëjnë mëkate të vogla, sikurse thotë se s'ka problem të veprosh gjynahe të vogla, me kusht largimin nga gjynahet e mëdha.

Përgjigje

Përgjigjja për këtë paqartësi sqarohet në frazën e përmendur në këtë ajet, ku Kur'ani famëlartë thotë: **"...Ne do t'jua falim gabimet tuaja të vogla..."** që do të thotë se braktisja e gjynaheve të mëdha, veçanërisht kur është mundësia e kryerjes së tyre, forcon devotshmërinë në shpirtin e njeriut, e cila e mbron dhe e pastron atë nga gjynahet e vogla.

Në të vërtetë, ky ajet është i ngjashëm me ajetin 114 të sures "Hud", ku All'llahu i Lartësuar thotë: **"Vërtet, veprat e mira i largojnë veprat e këqija."** Kjo tregon për ndikimet e punëve të mira. Kjo është e ngjashme me atë që thamë se nëse njeriu i largohet lëndëve të dëmshme e të rrezikshme helmuese, ka shëndet të mirë dhe imunitet të fortë, atëherë ky imunitet e mbron nga ndikimet e këqija të disa ushqimeve jo të përshtatshme dhe të dëmshme për shëndetin trupor dhe shpirtëror.

Thënë ndryshe: Largimi nga mëkatet e vogla dhe falja e tyre konsiderohet si një lloj shpërblimi i brendshëm shpirtëror për

braktisësin e gjynaheve të mëdha. Ky është një ndikim i fortë inkurajues për t'iu larguar gjynaheve të mëdha.

Hulumtime

Kur shndërrohet gjynahu i vogël në gjynah të madh?

Këtu duhet patjetër të ndalemi në një pikë të rëndësishme që është se gjynahet e vogla mbeten gjynahe të vogla, nëse ato nuk përsëriten. Në shtesë të kësaj, ato nuk burojnë nga mendjemadhësia, vetëpëlqimi dhe padrejtësia, sepse gjynahet e vogla, sikurse përfitohet nga Kur'ani dhe nga hadithet, shndërrohen në gjynahe të mëdha në rastet:

1- Kur vazhdohen dhe përsëriten gjynahet e vogla: Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: *“Nuk ka gjynahe të vogla me këmbgulje.”*

2- Kur gjynahqari e bën gjynahun e vogël me mendjemadhësi, me kokëfortësi, me mosbindje dhe në kundërshtim të urdhrave të All'llahut. Kjo përfitohet nga ajetet e ndryshme të Kur'anit, siç është thënia e All'llahut të Lartësuar në suren “En Naziat”, ajetet 37- 39, ku thuhet: **“Atëherë, ai që ka shkelur gjithçka dhe ka parapëlqyer jetën e kësaj bote, sigurisht që do të ketë për strehë Xhehennemin.”**

3- Kur gjynahqari e nënvlerëson gjynahun e vet dhe e konsideron si të vogël. Në librin Nehxhul Belaga thuhet: *“Gjynahet më të mëdha janë ato gjynahe, të cilat, vepruesi i tyre, i nënvlerëson.”*

4- Kur bëhet gjynahu nga një person i cili ka pozicion të veçantë shoqëror në mesin e njerëzve dhe gjynahu i tij nuk llogaritet si gjynahu i të tjerëve. Në Kur'anin e shenjtë, në suren "Ahzab", ajeti 30, All'llahu i Lartësuar thotë: **"O ju gratë e të Dërguarit! Ata prej jush që bëjnë një turp të hapur do të kenë ndëshkim të dyfishtë."**

Është transmetuar nga i Dërguari i All'llahut se ai ka thënë: *"Kush vendos një rregull të keq, gjynahu do të jetë për të dhe për atë që e vepron dhe nuk i pakësohet asgjë nga gjynahu i tyre."*¹

5 - Kur gjynahqari të jetë i kënaqur me gjynahun që ka bërë dhe të mburret me të. Është transmetuar nga i Dërguari i All'llahut se ka thënë: *"Kush bën një gjynah dhe qesh, do të hyjë në zjarr të Xhehennemit duke qarë."*²

6- Kur e konsideron vonimin e ndëshkimit të shpejtë për gjynahun, si argument të kënaqësisë së All'llahut të Lartësuar. Në këtë rast, robi e mendon veten të ruajtur nga ndëshkimi dhe të sigurtë nga dënimi ose e mendon veten se ka një pozitë të All'llahu që nuk e ndëshkon atë për mëkatin që ka kryer, siç thuhet në suren "El Muxhadele", ajeti 8, i cili flet për disa mëkatarë mendjemëdhenj të zhytur në gjynahe, ku thotë: **"Por nuk na dënon All'llahu për këtë që po flasim?!"** Kur'ani famëlartë u përgjigjet duke thënë: **"Xhehennemi është një dënim i mjaftueshëm për ata."**

¹ Mehxhetul Bejda, vëll. 7, f. 1.

² Uesailu Shija vëll. 15, f. 304 dhe 338.

Ajeti 32

وَلَا تَتَمَنَّوْا مَا فَضَّلَ اللَّهُ بِهِ بَعْضَكُمْ عَلَى بَعْضٍ لِلرِّجَالِ نَصِيبٌ مِّمَّا
 كَتَبُوا وَلِلنِّسَاءِ نَصِيبٌ مِّمَّا كَتَبْنَ وَسْأَلُوا اللَّهَ مِنْ فَضْلِهِ إِنَّ اللَّهَ
 كَانَ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمًا ﴿٣٢﴾

“Mos i lakmoni ato gjëra, me anë të të cilave All’llahu i ka bërë disa nga ju të dallohen mbi të tjerët: meshkujt do të kenë pjesë prej asaj që kanë punuar e po ashtu edhe femrat do të kenë pjesë prej asaj që kanë punuar. Kërkoni prej All’llahut nga mirësitë e Tij. Vërtet, All’llahu është i Ditur për çdo gjë.”

Shkaku i zbritjes

Komentuesi i shquar i Kur’anit, Et Tabrasijj në tefsirin e tij *Mexhmaul Bejjan*, ka thënë: Thuhet se Umu Seleme (një nga bashkëshortet e Profetit) ka thënë: “O i Dërguar i All’llahut! Në luftë marrin pjesë burrat dhe nuk marrin pjesë gratë. Përse na takon ne gjysma e trashgëmisë? Atëherë, zbriti ky ajet.¹

¹ Tefsiri *Mexhmaul Bejjan*, fundi i ajetit në fjalë. Tefsiri *El Kebijr*, vëll. 10, f. 64.

Në tefsirin *El Menar* lexojmë: Një grup prej burrave të myslimanëve kanë thënë: Shpresojmë që të kemi prioritet dhe mirësi më shumë se gratë me të mirat tona në Botën Tjetër, sikurse kemi prioritet në trashëgimi. Shpërblimi ynë të jetë dy herë më shumë se sa i grave. Një grup nga gratë myslimane kanë thënë: Shpresojmë që të jenë gjynahet tona sa gjysma e gjynaheve të burrave në Botën Tjetër, sikurse është për ne trashëgimia sa gjysma e trashëgimisë së tyre në këtë botë. Atëherë, zbriti ky ajet.¹

I njëjti shkak zbritjeje është përmendur edhe në tefsirin '*Fijj Dhikalil Kur'an'* dhe në tefsirin '*Rruhul Meanijj'* me një ndryshim të vogël.

Komentimi

Ndryshimi në pjesën që i takon burrit dhe gruas nga trashëgimia – sikurse e lexuam në shkakun e zbritjes – ka bërë që të lindin disa pyetje te disa njerëz. Mesa duket, ata nuk e kanë vëmendjen se ky ndryshim qëndron për shkak të shpenzimit që i takon plotësisht burrit. Kurse gratë nuk kanë asnjë detyrim për shpenzimet e familjes. Edhe shpenzimi për gratë është detyrë e burrave. Për këtë, ajo që merr gruaja është sa dyfishi i asaj që merr burri.

Prandaj edhe All'llahu i Madhëruar thotë: **“Mos i lakmoni ato gjëra, me anë të të cilave All'llahu i ka bërë disa nga ju të dallohen mbi të tjerët...”** Për çdo lloj dallimi dhe ndryshimi ka gjëra të fshehta të padukshme për ju. Sido që të jenë këto dallime e

¹ Tefsiri *Mexhmaul Bejjan*, fundi i ajetit në fjalë. Tefsiri *El Kebijj*, vëll. 10, f. 64.

ndryshime, qofshin nga ana e krijimit, e gjinisë apo edhe nga ana e cilësive të tjera trupore dhe shpirtërore, ato përbëjnë bazën e sistemit shoqëror në mesin tuaj. Mund të jetë dallim nga ana e të drejtave për shkak të pozicionit dhe të pozitës së ndryshme, siç është dallimi dhe ndryshimi në pjesën e trashëgimisë. Të gjitha llojet e këtyre dallimeve dhe ndryshime janë të ngritura mbi bazën e drejtësisë dhe të legjislacionit të urtë të All'llahut. Sikur interesi dhe dobia juaj të ishin ndryshe nga kjo, Ai do t'ua qartësonte dhe do t'ua ligjëronte juve.

Kësisoj, shpresimi dhe urimi i ndërrimit të kësaj gjendjeje është një lloj kundërshtimi i dëshirës së All'llahut, e cila është vetë e vërteta dhe e drejta.

Por nuk duhet që të mendojnë gabim se ajeti në fjalë tregon për dallimin e shpikur, i cili u shfaq si rezultat i pushtimit dhe i shfrytëzimit shtresor në shoqëri, por ajeti tregon për ndryshime të natyrshme. Dallimet e shpikura nuk janë prej dëshirës së All'llahut dhe nuk është gabim shpresimi dhe urimi i ndryshimit të tyre. Në të vërtetë, dallimet e shpikura janë të padrejta dhe jologjike. Prandaj është detyrim përpjekja për largimin dhe zhdukjen e tyre. Për shembull: Nuk është e mundur që gratë të shpresonin që të ishin burra, sikurse nuk është e mundur që burrat të shpresonin që të ishin gra, sepse prania e këtyre dy gjinive është çështje e domosdoshme për sistemin shoqëror e njerëzor. Mirëpo, ky dallim gjinor nuk duhet të merret si argument që një gjini të shkelë të drejtat e gjinisë tjetër. Nga këtu, ata që e marrin këtë ajet si shkak për të konstatuar dallimin e padrejtë shoqëror ose e marrin si argument të këtij dallimi, vërtet ata gabojnë shumë rëndë.

Pas kësaj fraze, menjëherë All'llahu i Lartësuar thotë: **"...meshkujt do të kenë pjesë prej asaj që kanë punuar e po ashtu, edhe femrat do të kenë pjesë prej asaj që kanë punuar..."** Kjo do të thotë se çdo burrë dhe çdo grua ka pjesën e vet nga veprat e tyre, nga përpjekjet e tyre, nga pozicioni i tyre, sido që të jetë ky pozicion natyror (si është dallimi ndërmjet dy gjinive burrë e grua) apo jonatyror, i cili lind nga dallimet për arsye të përpjekjeve zgjedhëse.

Është e vlefshme që të përmendim se fjala "*iktisab*", që do të thotë të arrish diçka me punë, ka një kuptim të gjerë, ku përfshin përpjekjet zgjedhëse dhe po ashtu, përfshin edhe ato që fiton njeriu me anë të veprave të tij.

Pastaj All'llahu i Lartësuar thotë: **"...Kërkoni prej All'llahut nga mirësitë e Tij..."**, që do të thotë se në vend që të shpresoni dhe të uroni këtë përparësi, kërkoni nga mirësitë e All'llahut. Kërkojini Atij që me butësinë dhe bujarinë e Tij t'ju begatojë me mirësitë e Tij të ndryshme dhe t'ju japë mbarësi dhe shpërblim të mirë. Kështu do të jeni burra e gra të lumtur. Në çdo gjendje lutjuni dhe kërkojini Atij atë që është më e mira për ju dhe që ju siguron juve lumturinë e vërtetë. Mos shpresoni në atë që është thjesht iluzion apo që ju e imagjinoni. Është mëse e qartë se kërkimi i mirësive dhe i kujdesit të All'llahut nuk ka kuptimin se njeriu nuk duhet të përpiket bazuar te shkaqet dhe faktorët. Patjetër, ai duhet t'i kërkojë mirësitë e All'llahut dhe mëshirën e Tij ndërmjet shkaqeve që Ai ka vendosur në këtë gjithësi.

Pastaj All'llahu i Lartësuar thotë: **"...Vërtet, All'llahu është i Ditur për çdo gjë."** Pra, Ai e di se çfarë ka nevojë sistemi shoqëror dhe se çfarë është e detyruar nga ky dallim, qoftë nga ana

natyrore apo nga ana e të drejtave. Për këtë nuk ka vend as për padrejtësi, as për dallim të padrejtë në veprat e Tij. All'llahu i Lartësuar është i Mirëinformuar se çfarë kanë njerëzit në zemrat e tyre dhe i Gjithëditur për të fshehtat dhe qëllimet e tyre. Ai e di se kush e ka shpresën e gabuar dhe kush e ka shpresën të vërtetë e pozitive.

Kërkim

Përse ky dallim natyror ndërmjet njerëzve?

Pyetje: Përse janë krijuar disa me më shumë dhunti dhe aftësi dhe disa të tjerë janë krijuar me më pak dhunti dhe aftësi? Përse disa janë më të bukur dhe disa të tjerë nuk janë fare të bukur? Përse disa kanë karakteristika të larta dhe të fuqishme trupore dhe disa të tjerë jo? A është i përshtatshëm ky dallim për drejtësinë e Zotit?

Përgjigje: Për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve, duhet t'i hedhim një vështrim pikave të mëposhtme:

1- Vërtet, disa dallime trupore dhe shpirtërore në mesin e njerëzve kanë lindur nga ndryshimi i shtresave dhe i padrejtësive shoqërore, ose nga neglizhenca e personit, i cili nuk ka lidhje me rregullin e krijimit dhe me sistemin e ekzistencës. Për shembull, shumë prej fëmijëve të pasanikëve janë më të fortë e më të bukur sesa fëmijët e fukarenjve. Ata kanë më shumë dhunti dhe aftësi për shkak se grupi i parë (fëmijët e pasanikëve) gëzojnë më shumë mundësi nga ana e të ushqyerit dhe e përkujdesjes shëndetësore, ndërkohë që grupi tjetër (fëmijët e fukarenjve) janë të privuar nga

ato mundësi. Ka shumë njerëz që i humbasin fuqitë trupore e shpirtërore për shkak të papunësisë, të dembelizmit, neglizhencës ose abuzimit.

Këto dallime ne duhet t'i konsiderojmë dallime të shpikura dhe false. Asgjësimi i tyre arrihet nëpërmjet asgjësimit të sistemit shtresor (klasave) dhe nëpërmjet përhapjes së drejtësisë shoqërore në jetën e njerëzve. As Kur'ani famëlartë dhe as Islami nuk i miratojnë këto dallime dhe nuk pranojnë asnjë ngjyrë prej ngjyrave të atyre dallimeve raciste.

2- Vërtet, pjesa tjetër e dallimeve dhe e llojeve të tjera të tyre, është një çështje e natyrshme dhe diçka e domosdoshme nga domosdoshmëritë e ndërtimit të natyrës njerëzore, por edhe domosdoshmëri prej domosdoshmërive të jetës njerëzore. Kjo do të thotë se në një shoqëri prej shoqërive, edhe nëse gëzon drejtësi të plotë shoqërore, është e pamundur që të jenë të gjithë personat e kësaj shoqërie të barabartë, të kenë një formë të vetme, sikur të jenë prodhuar në laborator ose në fabrikë. Por, patjetër duhet të gjenden disa ndryshime dhe dallime. Duhet ta dinë se dhuntitë e dhëna nga All'Ilahut dhe aftësitë trupore e shpirtërore janë ndarë – në përgjithësi – në atë mënyrë ku secili person të ketë një pjesë nga ato dhunti dhe ato aftësi dhe jo që disa t'i kenë të gjitha dhuntitë dhe të tjerët të mos kenë asgjë prej tyre. Ka njerëz që gëzojnë fuqi të mjaftueshme trupore, një tjetër ka aftësi fizike, një tjetër ka talent në poetikë, një tjetër ka pasion tregtinë, dikush ka zgjuarsin të lartë rreth teknologjisë apo bujqësisë e kështu me radhë.

E rëndësishme është që shoqëritë dhe individët t'i zbulojnë këto dhunti e aftësi dhe të bëjnë edukimin dhe zhvillimin e tyre në një

mjedis të shëndoshë, me qëllim që çdo njeri të shfaqë aftësitë e tij dhe të përfitojë prej tyre.

3- Është detyrim që t'i kujtojmë lexuesit se shoqëria është si trupi i njeriut që ka nevojë për qelizat, për damarët dhe për muskujt. Sikur trupi i njeriut të përbëhej i gjithi nga qeliza të vogla, sikurse qelizat e syrit dhe të trurit, nuk do të jetonte gjatë. Sikur të përbëhej i gjithë trupi nga qeliza të mëdha e të trasha, siç janë ato të eshtrave që nuk njohin përkulje, do të humbiste fuqia e plotë për të kryer veprime. Patjetër duhet që qelizat e trupit të jenë të ndryshme e të llojllojshme, që disa prej tyre të kryejnë procesin e të menduarit, disa të tjera atë të shikimit, disa të tjera atë të dëgjimit dhe disa të tjera atë të folurit.

Patjetër duhet që të ekzistojë “shoqëria e plotë” nga prania e elementëve që kanë aftësi, dhunti, shije dhe përbërje të ndryshme të llojllojshme trupore dhe mendore. Por kjo nuk do të thotë që disa shtresa të shoqërisë të vuajnë privimin, t’u zvogëlohet shërbimi ose të përçmohet roli i tyre, njësoj sikurse përfiton çdo qelizë e trupit, edhe pse ekziston dallimi dhe ndryshimi mes tyre.

Thënë ndryshe: Këto forma ndryshimi dhe dallimi në strukturën shpirtërore dhe trupore e natyrore (të cilat nuk janë as të padrejta dhe as të imponuara) janë të caktuara nga “urtësia e All’llahut” dhe nga drejtësia, e cila kurrë nuk mund të shkëputet nga urtësia e All’llahut.

Për shembull, sikur të ishin qelizat e trupit të njeriut të krijuara në një formë të vetme, kjo do të ishte e largët nga urtësia e All’llahut. Po ashtu, është e zbrazët nga drejtësia, e cila ka

kuptimin e vendosjes së diçkaje në vendin e vet dhe të përshtatshëm. Po kështu, nëse njerëzit do të ngjasonin një ditë prej ditëve në mendim ose në dhunti e aftësi, do të shkatërrohej struktura e shoqërisë në po atë ditë.

Atëherë, çfarë përmendet në këtë ajet në fushën e përparësisë dhe të dallimit në natyrën e burrit dhe të gruas dhe në krijimin e tyre, në të vërtetë është treguese për këtë temë, se nëse të gjithë njerëzit do të ishin burra ose gra, shumë shpejt do të zhdukej lloji i njerëzimit dhe do të humbiste një pjesë të kënaqësisë së tij të lejuar.

Nëse disa e kundërshtojnë këtë dhe pretendojnë se kjo çështje nuk është në përshtatje me drejtësinë All'llahut, ky kundërshtim nuk është i logjikshëm, sepse ata e kanë kuptuar urtësinë e këtij dallimi dhe nuk janë persiatur në këtë ajet.

Ajeti 33

وَلِكُلِّ جَعَلْنَا مَوْلَىٰ مِمَّا تَرَكَ الْوَالِدَانِ وَالْأَقْرَبُونَ ۚ وَالَّذِينَ عَقَدَتْ
أَيْمَانُكُمْ فَأَتَوْهُمْ نَصِيحُهُمْ ۚ إِنَّ اللَّهَ كَانَ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ شَهِيدًا



“Gjithkujt Ne i kemi caktuar trashëgimtarët për çdo gjë që lënë prindërit ose të afërmit, ndërsa atyre me të cilët keni bërë marrëveshje, jepuni pjesën e vet. Sigurisht që All’Ilahu është Dëshmitar për çdo gjë.”

Komentimi

Përsëri Kur’ani i kthehet edhe një herë çështjes së trashëgimisë, ku thotë: **“Gjithkujt Ne i kemi caktuar trashëgimtarët¹ për çdo gjë që lënë prindërit ose të afërmit...”**, që do të thotë se çdo burri ose gruaje u kemi bërë trashëgimtarë që trashëgojnë atë çfarë lenë prindërit dhe të afërmit, e cila duhet të ndahet ndërmjet tyre sipas rregullave të veçanta.

Në të vërtetë, kjo frazë është përmbledhja e procedurave të trashëgimisë, të cilat i kemi përmendur në ajetet e mëparshme në

¹ Kjo fjalë është “el meualije”, që ka kuptimin e lidhjes e të bashkimit. Përdoret për të gjithë pjesëtarët që kanë një lloj lidhjeje me njëri-tjetrin. Në disa raste ka kuptimin e lidhjes së veliut me pasuesit e tij. Në ajetin në fjalë, ka kuptimin e trashëgimtarëve.

çështjen e të afërmve. Dhe, kjo frazë është parathënie për një rregull që do të shpjegojmë më pas.

Më pas, All'llahu i Lartësuar vazhdon duke thënë: **"...ndërsa atyre me të cilët keni bërë marrëveshje, jepuni pjesën e vet..."** pra, jepjani atyre, me të cilët keni bërë marrëveshje për pjesën e vet nga trashëgimia.

Përshkrimi i marrëveshjes me kontratën e djathtë (marrëveshja që shkruhet me dorën e djathtë) është se në të shumtën e rasteve njeriu përfiton nga dora e djathtë për të kryer punët e tij.

Le të shikojmë se kush janë ata, të cilët e kanë bërë këtë marrëveshje dhe ata, të cilëve, patjetër duhet që t'u jepet pjesa e trashëgimisë.

Disa komentues supozojnë se qëllimi me këtë marrëveshje janë burri e gruaja, sepse ata të dy e kanë lidhur marrëveshjen bashkëshortore ndërmjet tyre. Por ky supozim duket i largët, sepse përshkrimi për marrëveshjen e martesës me "*akdul jemiyn*", e të ngjashëm me të, me Kur'anin e shenjtë është shumë i rrallë. Për më tepër, ajo është përsëritje e temave të mëparshme.

Kuptimi më i afërt në këtë ajet është marrëveshja "*damanul xherijreh*", që ka qenë e përhapur para Islamit. Islami e ndryshoi pasi miratoi anët pozitive të saj, që është: "dy palët të kontraktajnë mes tyre se do të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin në formë vëllazërore dhe secili ta ndihmojë tjetrin në raste problemesh. Nëse njëri vdes para tjetrit, ai e trashëgon pasurinë e tij."

Këtë lloj marrëveshjeje vëllazërore dhe të sinqertë e ka lejuar, e ka vendosur dhe e ka miratuar Islami. Islami e ka përforcuar se trashëgimia është e mundur për shak të kësaj marrëveshjeje. Nëse nuk ka trashëgimtarë prej të afërmve, që do të thotë se nëse personi nuk ka të afërm nga farefisi, atëherë atë (trashëgimtarin) e trashëgon “*daminu¹ xherijreh*”, i cili nënshkroi mes tij dhe atij tjetrit këtë marrëveshje. (Për sqarime të mëtejshme shih çështjen e trashëgimisë në librat e jurisprudencës.)²

All’llahu i Lartësuar e mbyll këtë ajet duke thënë: **“...Sigurisht që All’llahu është Dëshmitar për çdo gjë.”** Nëse nuk ia jepni pjesën trashëgimtarëve dhe nuk ia jepni të plota të drejtat e tyre, All’llahu është i Ditur për këtë gjë dhe asgjë nuk i fshihet Atij prej asaj që ju bëni, sepse Ai për çdo gjë është Dëshmitar dhe për çdo gjë është i Gjithëditur.

¹ Daminu, ka kuptimin e garantuesit.

² Mënyra e aktit “Damanul xherijreh” është kështu: Bëj marrëveshje me ty që të më përkrahësh dhe të të përkrah, të logjikosh për mua dhe të logjikoj për ty, të më trashëgosh dhe të të trashëgoj. Pala tjetër thotë: “Pranoj.”

Ajeti 34

الرِّجَالُ قَوَّامُونَ عَلَى النِّسَاءِ بِمَا فَضَّلَ اللَّهُ بَعْضَهُمْ عَلَى بَعْضٍ وَبِمَا أَنْفَقُوا مِنْ أَمْوَالِهِمْ^ج
 فَالصَّالِحَاتُ قَانِتَاتٌ حَافِظَاتٌ لِّلْغَيْبِ بِمَا حَفِظَ اللَّهُ^ج وَالَّتِي تَخَافُونَ نُشُوزَهُنَّ^ج
 فَعِظُوهُنَّ^ج وَأَهْجُرُوهُنَّ فِي الْمَضَاجِعِ وَاصْرَبُوهُنَّ^ط فَإِنْ أَطَعْنَكُمْ فَلَا تَبْغُوا عَلَيْهِنَّ سَبِيلًا^ق
 إِنَّ اللَّهَ كَانَ عَلِيمًا كَبِيرًا ﴿٣٤﴾

“Meshkujt kanë autoritet mbi gratë, meqë All’l-lahu u ka dhënë disa cilësi mbi ato dhe meqë ata shpenzojnë për mbajtjen e tyre. Gra të mira janë ato të dëgjueshmet, që ruajnë fshehtësitë që ka urdhëruar All’l-lahu. Sa i përket grave që ju i druheni mosbindjes dhe sjelljes së keqe nga ana e tyre, këshillojini, (e nëse kjo s’bën dobi) mos i pranoni në shtrat dhe (në fund) i rrihni ato (lehtas). Por, nëse ato ju binden, atëherë mos i ndëshkoni më. All’l-lahu, me të vërtetë, është i Lartësuar dhe i Madhëruar!”

Komentimi

Autoriteti në sistemin familjar

Në fillim të këtij ajeti, All'llahu i Madhëruar thotë: **“Meshkujt kanë autoritet mbi gratë... .”** Duhet patjetër që kjo frazë të qartësohet. Familja është një shoqëri e vogël e përbashkët. Për këtë, ashtu siç ka nevojë një shoqëri e madhe për një udhëheqës dhe kujdestar për çështjet e saj, po ashtu edhe familja ka nevojë për një drejtues. Patjetër duhet që të veçohet burri ose gruaja me këtë mision dhe të jetë njëri kryetari i familjes dhe tjetri të jetë në postin e ndihmësit dhe të përkrahësit, që punon e vepron nën mbikëqyrjen e kryetarit.

Me të vëretë, Kur'ani e qartëson se pozicioni i autoritetit, i udhëheqjes dhe i përkujdesjes së familjes duhet që t'i jepet burrit. Është detyrim që kjo frazë të mos keqkuptohet, sepse qëllimi i kësaj shprehjeje nuk është sundimi, padrejtësia dhe privimi, por qëllimi është që udhëheqja të jetë një e vetme dhe e rregulluar (sistemuar), e cila mban përgjegjësitë e saj duke marrë parasysh parimin e konsultimit.

Kjo çështje duket më e qartë në kohët e sotme se sa në kohët e kaluara. Çdo institucion, i përbërë qoftë edhe nga dy persona të ngarkuar për të kryer një vepër, duhet të ketë një kryetar dhe një zëvendës që e ndihmon atë. Në të kundërt, do të mbizotëronte çrregullimi dhe rrëmuja në punët e këtij institucioni. Aktivitetet e tij do të zbeheshin dhe nuk do t'i realizonte qëllimet dhe synimet e veta. Po kështu është edhe gjendja përsa i përket

familjes. Duhet që drejtimi i familjes t'i ngarkohet burrit për të administruar familjen.

Ky funksion i jepet mashkullit, sepse ai gëzon shumë veçori e karakteristika, siç është fuqia për barazpeshim mes të menduarit dhe ndjenjës (emocionit), zotërimi i një fuqie trupore më të madhe se ajo e femrës. Me të parën, ka mundësinë e të menduarit dhe të të planifikuarit ashtu siç duhet, kurse me të dytën, ka mundësinë e mbrojtjes së familjes. (E kundërta është tek femra, e cila gëzon një forcë të madhe ndjenjash dhe emocionesh në brendinë e saj.)

Në shtesë të kësaj që u përmend, përballë asaj që ai mbart nga shpenzimi për fëmijët dhe bashkëshorten dhe përballë premtimit se do t'i kryejë të gjitha shpenzimet e domosdoshme, duke filluar nga mehri e deri te administrimi i përshtatshëm ekonomik i familjes, atij i takon detyra e udhëheqjes dhe e autoritetit në sistemin familjar.

Sigurisht, ka disa femra që janë superiore ndaj bashkëshortëve të tyre në disa anë. Por rregullat, sikurse e thamë edhe më parë, vendosen duke marrë parasysh shumicën dhe jo disa persona veç e veç. Nuk ka dyshim se në përgjithësi burrat janë superiorë ndaj grave për nga aftësia e kryerjes së këtij misioni. Por, edhe gratë mund të kryejnë detyra të tjera që padyshim janë të rëndësishme.

Vërtet, ajeti: **“...meqë All’llahu u ka dhënë disa cilësi mbi ato dhe meqë ata shpenzojnë për mbajtjen e tyre...”** tregon po për këtë të vërtetë, sepse pjesa e parë e kësaj fjalie thotë se ky autoritet është për shkak të dallimit që e ka krijuar All’llahu tek njerëzit në dobi të vazhdimësisë së jetës së njeriut. Kurse, në

pjesën tjetër, thotë se burrat janë ngarkuar me misionin e shpenzimeve financiare në drejtim të grave dhe të fëmijëve të tyre.

Por dhënia e një detyre dhe e një autoriteti të tillë burrit nuk do të thotë se burri është më i privilegjuar nga ana njerëzore në këtë jetë dhe nuk e bën atë të dallueshëm edhe në Jetën Tjetër, sepse dallimi dhe përparësia në atë Ditë kanë si bosht kryesor vetëm devotshmërinë. Ka raste që personaliteti i ndihmësit mund të jetë më superior se sa personaliteti i kryetarit, por kryetari është më lart se ndihmësi i tij në drejtimin dhe administrimin që i është besuar. Kështu që është më i përshtatshëm dhe më meritues në këtë fushë.

Më pas, All'Ilahu i Lartësuar vazhdon e thotë: **"...Gra të mira janë ato të dëgjueshmet, që ruajnë fshehtësitë që ka urdhëruar All'Ilahu..."** Kjo do të thotë se gratë, për sa u përket detyrave që u janë dhënë rreth familjes, janë në dy grupe:

Grupi i parë: Ato janë "*salihat*", që do të thotë gra të mira e të sinqerta dhe jo të devijuara. Janë "*kanitat*", që do të thotë të bindura ndaj detyrave të familjes dhe "*hafidhat lil-gajb*", që do të thotë se i ruajnë të drejtat e bashkëshortëve dhe çështjet e tyre jo vetëm në praninë e tyre, por edhe në mungesë të tyre. Kjo do të thotë se ato nuk bëjnë asnjë tradhti ndaj tyre në pasuri, në nder, ose në ruajtjen e personalitetit të burrit në shoqëri. Ato i ruajnë të fshehtat e familjes në mungesën e tyre dhe kryejnë përgjegjësitë e tyre, të cilat ua ka vendosur All'Ilahu e të cilat i përshkruan ky ajet: **"...që ka urdhëruar All'Ilahu..."**. Këto urdhra i zbatojnë në formën më të mirë.

Është mëse e natyrshme që burrat janë të detyruar që t'i respektojnë këto gra, t'i ruajnë të drejtat e tyre dhe të mos ua humbasin ato.

Gratë e pabindura dhe neglizhente

Grupi i dytë: Janë gratë, të cilat nuk i kryejnë detyrat dhe detyrimet e tyre dhe tek ato duken shenjat e mosbindjes. Atëherë, burrat kanë detyra ndaj këtyre grave që të merren me to hap pas hapi dhe mbi të gjitha, është detyrim që të ruajnë drejtësinë dhe të mos e kalojnë kufirin. Ato detyra janë:

1- Këshilla

Hapi i parë që burrat duhet të ndjekin ndaj këtyre lloj grave, të cilave u duken shenjat e rebelimit, të mosbindjes dhe të armiqësisë, është këshillimi i tyre, siç thotë All'llahu i Lartësuar në këtë ajet: **"...Sa i përket grave që ju i druheni mosbindjes dhe sjelljes së keqe nga ana e tyre, këshillojini..."** Bazuar në këtë thënie, ato gra, të cilat i tejkalojnë rregullat familjare dhe kufijtë e tyre, para çdo gjëje, duhet t'u kujtohen atyre, nëpërmjet këshillës dhe udhëzimit, detyrat dhe detyrimet që ato kanë ndaj familjes dhe përfundimin e kësaj mosbindjeje dhe armiqësie.

2 - Distancimi nga shtrati

Ky hap vjen pasi nuk sjell dobi këshilla. All'llahu i Lartësuar thotë: **"... (e, nëse kjo s'bën dobi), mos i pranoni në shtrat..."** Me këtë qëndrim, me largimin e tyre nga shtrati shfaqni

pakënaqësi ndaj bashkëshortes, sepse, ndoshta ky qëndrim i lehtë ndikon tek ato.

3 - Rrahja

Nëse ato vazhdojnë në rebelimin, në mosbindjen e tyre për të kryer detyrat dhe detyrimet e tyre; nëse e kanë kaluar cakun (kufirin) dhe ecin përsëri në rrugën e kokëfortësisë, ku as këshilla, as largimi nga shtrati nuk sjellin dobi dhe nuk ka mbetur rrugë tjetër vetëm se përdorimi i forcës, atëherë vjen pjesa e rrahjes: “...dhe (në fund) i rrihni ato (lehtas)... .” Kjo është për t’i nxitur ato që t’i kryejnë detyrat e tyre bashkëshortore. Islami e ka lejuar këtë formë për t’u bërë presion atyre dhe për t’i nxitur ato që t’i kryejnë detyrimet e tyre.

Paqartësi: Ka mundësi që dikush të kundërshtojë duke thënë: Si ua lejon Islami burrave që të përdorin ndëshkimin fizik (rrahjen)?

Përgjigje: Përgjigja rreth këtij kundërshtimi nuk duket e vështirë duke vështuar kuptimin e këtij ajeti dhe të trasmetimeve të ardhura për të qartësuar domethënien e ajetit dhe çfarë gjendet në librat e jurisprudencës islame dhe duke parë gjithashtu se çfarë paraqesin sot dijetarët e psikologjisë prej sqarimeve shkencore në këtë fushë. Këto çështje do t’i përmbledhim në disa pika.

E para: Ky ajet lejon që të përdoret ndëshkim fizik ndaj atij që nuk respekton detyrat dhe detyrimet e tij, kur për të nuk vlen asnjë metodë tjetër. Kjo mënyrë nuk është diçka e re dhe e veçantë për Islamit në jetën e njerëzve, sepse të gjitha ligjet dhe rregullat në botë përdorin mënyrat e forcës fizike ndaj atij që nuk pranon me rrugët paqësore për ta nxitur atë që të mbajë përgjegjësitë që i

takojnë dhe për të kryer detyrimet dhe detyrat e tij. Këto ligje dhe rregulla ka raste të veçanta ku nuk mjaftohen vetëm me rrahjen apo dhunën fizike, por shkojnë edhe më tej, duke përdorur ndëshkime edhe më të rrepta, saqë arrinjë deri në vrasje.

E dyta: Ndëshkimi i lejuar, në këtë rast, duhet të jetë i lehtë. Goditja nuk duhet të lëndojë, të shkaktojë fraktura e plagë në trup dhe as goditje që shkaktojnë nxirje, sikurse është e shpjeguar në librat e jurisprudencës islame.

E treta: Sot, dijetarët analistë të psikologjisë mendojnë se disa gra (femra) ankohen nga gjendja depresive e cila quhet “el Mazukhijeh”. Kjo bën që femra kur rrihet, qetësohet. Kjo gjendje sipas tyre, arrin deri në atë gradë saqë femra ndien kënaqësi, prehje dhe qetësi nëse ajo rrihet me një rrahje të lehtë.

Ndoshta për këta persona kjo mënyrë mund të jetë paralajmërim i lehtë trupor për shërimin psikik të tyre.

Është mëse e pranueshme se nëse një prej këtyre mënyrave ndikon tek gruaja e pabindur dhe ajo bindet dhe kthehet për të kryer detyrat dhe detyrimet e saj bashkëshortore e familjare, burri nuk ka të drejtë ta ndëshkojë gruan e tij dhe as t'i bëjë keq asaj. Për këtë All'Ilahu i Lartësuar thotë: **“...Por, nëse ato ju binden, atëherë mos i ndëshkoni më...”**

E nëse thuhet se kjo lloj mosbindjeje, padrejtësie dhe rebelimi ndaj detyrave bashkëshortore dhe familjare, gjithashtu, ndodhin edhe tek burrat, a i përfshinjë këto masa edhe burrat? Pra, a mund të zbatohen këto procedura edhe ndaj burrit apo jo? Si përgjigje për këtë, themi: Po, edhe burrat e pabindur dënohen me ndëshkim fizik, sikurse ndëshkohen gratë e pabindura.

Gjykatësi islam është i detyruar që t'ua kujtojë burrave të devijuar detyrat dhe detyrimet e tyre me mënyra të ndryshme, deri edhe me forcë (që është një lloj ndëshkimi fizik).

Është e njohur historia e një burri, i cili i bënte padrejtësi gruas së tij dhe nuk e pranonte të vërtetën. Atëherë, imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) e ka kërcënuar atë me shpatë dhe ai i është bindur.¹

All'llahu i Lartësuar, në fund të këtij ajeti, u kujton edhe një herë burrave që të mos e keqpërdorin pozicionin e tyre si kryefamiljarë, kujdestarë dhe autoritarë mbi familjet e tyre. Ata duhet të mendojnë fuqinë e All'llahut të Madhëruar, e cila është mbi çdo fuqi. All'llahu thotë: **"...All'llahu, me të vërtetë, është i Lartësuar dhe i Madhëruar!"**

¹ *Biharul Ennar*, vëll. 41, f. 57.

Ajeti 35

وَإِنْ خِفْتُمْ شِقَاقَ بَيْنِهِمَا فَابْعَثُوا حَكَمًا مِّنْ أَهْلِهِ وَحَكَمًا مِّنْ أَهْلِهَا
 إِنْ يُرِيدَا إِصْلَاحًا يُوَفِّقِ اللَّهُ بَيْنَهُمَا إِنَّ اللَّهَ كَانَ عَلِيمًا خَبِيرًا ﴿٣٥﴾

“Nëse i druheni ndarjes midis burrit e gruas, atëherë caktoni një ndërmjetës nga ana e burrit dhe një nga ana e gruas. Në qoftë se ata dëshirojnë paqësim, All’llahu sjell marrëveshje midis tyre. All’llahu, me të vërtetë, është i Gjithëditur dhe i Mirëinformuar.”

Komentimi

Gjykimi i pajtimit familjar

Në këtë ajet flitet për çështjen e shfaqjes së mosmarrëveshjes dhe të konfliktit ndërmjet dy bashkëshortëve. Ajeti thotë: “Nëse i druheni ndarjes midis burrit e gruas, atëherë caktoni një ndërmjetës nga ana e burrit dhe një nga ana e gruas...”, që të negociojnë dhe t’i afrojnë pikëpamjet e bashkëshortëve. Pastaj All’llahu i Lartësuar thotë: “...Në qoftë se ata dëshirojnë paqësim...”, që do të thotë se është detyrim që të dy pajtuesit dhe përfaqësuesit e dy bashkëshorteve të hynë në negociata me qëllim të pastër dhe dëshirë të sinqertë për t’i pajtuar. Nëse janë të tillë, All’llahu i ndihmon ata të dy dhe i mbarëson në pajtimin mes dy bashkëshortëve.

Për t'i paralajmëruar dy ndërmjetësit dhe për t'i nxitur ata që të përdorin nijetin e mirë, në fund të këtij ajeti, All'illahu i Madhëruar thotë: **"...All'illahu, me të vërtetë, është i Gjithëditur dhe i Mirëinformuar."**

Vërtet, gjykata e pajtimit familjar, për të cilën tregon ky ajet, është një nismë madhështore e Islamit. Kjo gjykatë dallohet me veçanti, të cilat nuk i ka asnjë gjykatë tjetër. Prej atyre veçorive janë:

1- Mjedisi familjar është një mjedis i ndjeshëm. Për këtë, etaloni që duhet ndjekur në këtë mjedis ndryshon nga etaloni që ndiqet në mjediset e tjera. Kjo do të thotë se ashtu siç nuk është e mundur që në gjykatat e krimeve të punohet me etalonin e dashurisë dhe të ndjeshmërisë, po ashtu edhe në mjedisin familjar nuk mund të zbatohen ligje dhe rregulla të ashpra e të prera që nuk kanë shpirtin e butësisë. Këtu duhet që mosmarrëveshjet familjare të zgjidhen me mënyra të buta, sipas mundësisë. Prandaj edhe Kur'ani na urdhëron që të dy ndërmjetësit e kësaj gjykate të kenë lidhje farefisnore dhe afërsie me dy bashkëshortët, që të kenë mundësi të krijojnë ndjenjën e pajtimit ndërmjet tyre. Është mëse e natyrshme që kjo veçori është veçoria e kësaj lloji gjykate të posaçme, që nuk ekziston në asnjë gjykatë tjetër.

2- Me të vërtetë paditësi dhe i padituri në gjykatat e zakonshme, janë të detyruar që të zbulojë çdo gjë të fshehtë, nën dobinë e mbrojtjes së vetave të tyre. Është mëse e pranueshme se nëse dy bashkëshortët do t'i zbulonin të fshehtat e njëri-tjetrit para të huajve, secili do ta lëndonte tjetrin. E nëse do të ktheheshin në shtëpi me urdhër gjykate, nuk do të ishte ajo gjendja e pastër dhe e harmonisë si më përpara. Ata do të

vazhdonin ta jetonin jetën e tyre si dy persona të huaj e të detyruar që të kryenin detyrat e caktuara. Këtë e ka treguar edhe eksperiencia, e cila ka vërtetuar se dy bashkëshortë, që janë të detyruar të gjykojnë në këto gjykata, do ta zgjidhnin mosmarrëveshjen, por nuk do të ktheheshin si dy bashkëshortë të mëparshëm.

Të tillë shembuj nuk paraqiten në gjykatat e pajtimit familjar, për shkak të turpit nga të pranishmit. Nëse parashtrohen, ato paraqiten në mjedisin familjar ose përpara të afërmëve, që nuk ka ndonjë ndikim të keq, sikurse e shpjeguem më lart.

3- Me të vërtetë, dy ndërmjetësit, në gjykatat e zakonshme, nuk ndiejnë përgjegjësi të plotë në çështjet e divergjencës dhe të mospajtimit. Atyre nuk u intereson se si përfundon kjo çështje që është në gjykatë. Atyre nuk u intereson nëse kthehen të dy bashkëshortët të pajtuar apo të ndarë.

Ndërkohë që gjykata e pajtimit familjar është plotësisht e kundërt nga gjykatat e zakonshme. Përderisa dy ndërmjetësit në këtë gjykatë kanë lidhje farefisnore dhe afrimiteti me bashkëshortët, si bashkimi, ashtu edhe ndarja kanë një ndikim të madh në jetën e të dyve nga ana shpirtërore dhe nga ana e përgjegjësisë. Për këtë, ata të dy përpiqen me të gjitha mundësitë e tyre që të realizojnë pajtimin, paqen dhe harmoninë mes dy bashkëshortëve.

4- Të tilla gjykata nuk kanë as edhe një problem, nuk kanë nevojë për shpenzime të mëdha dhe nuk ndihet në to ndjenja e humbjes dhe përfundimi i keq që ndjehen prej gjykatave të zakonshme. Këto gjykata e kanë mundësinë e realizimit të

qëllimeve pa patur nevojë për asnjë procedurë zyrtare dhe në një kohë më të shkurtër. Nuk mund të fshihet se dy ndërmjetësuesit duhet të jenë nga mesi i dy familjeve dhe të jenë të njohur, të besueshëm dhe të arsyetueshëm. Me këto veçori që i përmendëm qartësohet se këto gjykata gëzojnë më tepër mundësi për pajtimin mes bashkëshortëve.

Me të vërtetë, çështja e dy ndërmjetësuesve, kriteret që duhen të kenë, kopetencat e tyre dhe se çfarë gjykojnë mes dy bashkëshortëve, janë të shpjguara me përpikëri në librat e jurisprudencës islame. Prej atyre kriterëve janë që ata ndërmjetësues të jenë në moshë të madhe, të logjikshëm, të drejtë dhe të vetëdijshëm në punët e tyre.

Përsa i përket mundësisë së zbatimit të ligjit të tyre në të drejtë të të dy bashkëshortëve, disa dijetarë kanë thënë se duhet të zbatohet çdo gjë që ata të dy vendosin. Me sa duket, edhe nga thënia “hakemun” në këtë ajet përfitohet i njëjti kuptim, sepse koncepti i gjykimit dhe i vendimit është zbatim i rregullit, sido që të jetë. Por shumica e dijetarëve thonë se duhet të zbatohet ajo çfarë kanë thënë dy ndërmjetësit në çështjen e pajtimit ndërmjet dy bashkëshortëve dhe në largimin e divergjencës dhe të konfliktit ndërmjet tyre. Kurse, gjykimi i tyre të dyve me divorc, nuk zbatohet i vetëm. Fundi i ajetit që tregon për çështjen e pajtimit është më i përshtatshëm. Për më tepër njohuri në këtë fushë, lexo librat e jurisprudencës islame.

Ajeti 36

﴿وَأَعْبُدُوا اللَّهَ وَلَا تُشْرِكُوا بِهِ شَيْئًا ۖ وَبِالْوَالِدَيْنِ إِحْسَنًا وَبِذِي الْقُرْبَىٰ
وَالْيَتَامَىٰ وَالْمَسْكِينِ وَالْجَارِ ذِي الْقُرْبَىٰ وَالْجَارِ الْجُنُبِ وَالصَّاحِبِ
بِالْجَنبِ وَابْنِ السَّبِيلِ وَمَا مَلَكَتْ أَيْمَانُكُمْ ۚ إِنَّ اللَّهَ لَا يُحِبُّ مَن كَانَ
مُخْتَلًا فَخُورًا﴾

“Adhuroni All’llahun dhe mos i shoqëroni Atij asgjë (në adhurim); silluni mirë me prindërit, me të afërmit, me jetimët, me të varfërit, me fqinjët e afërt dhe të largët, me atë që keni pranë, me udhëtarin (që ka mbetur ngushtë) dhe me ata që janë robër nën pushtetin tuaj. Në të vërtetë, All’llahu nuk i do njerëzit arrogantë e mburraveçë.”

Komentimi

Ajeti në fjalë sqaron disa prej të drejtave islame, që përfshijnë: të drejtat ndaj All’llahut, të drejtat ndaj njerëzve, normat e moralit me njerëzit. Nga këto të drejta përfitohen dhjetë mësimë:

1- “Adhuroni All’llahun dhe mos i shoqëroni Atij asgjë (në adhurim)...”

Me të vërtetë, ky ajet i fton njerëzit, para çdo gjëje, të adhurojnë All’llahun dhe t’i binden Atij, i Cili është i Vetëm dhe t’i largohen politeizmit (shirkut) dhe idhujtarëve. Adhurimi i All’llahut është baza e Islamit.

Sigurisht, thirrja në njësimin dhe adhurimin e All’llahut të Vetëm e pastron shpirtin, e bën njetin të sinqertë, forcon dëshirën dhe përforcon vendosmërinë e njeriut që të kryejë punë të dobishme.

Meqenëse ajeti në fjalë sqaron disa të drejta islame, në fillim dhe para çdo të drejte, ai flet për të drejtat e All’llahut ndaj njerëzve. Ajeti thotë: **“Adhuroni All’llahun dhe mos i shoqëroni Atij asgjë (në adhurim)...”**

2- “...silluni mirë me prindërit...”

Pastaj ky ajet tregon për të drejtat e prindërve dhe porositi për sjellje të mirë me ta. Nuk ka dyshim se e drejta e prindërve është prej çështjeve madhore, që Kur’ani famëlartë dhe feja islame i kushtojnë një rëndësi të madhe. Të pakëta janë çështjet që gëzojnë një rëndësi kaq të madhe sa ç’është çështja e respektimit të prindërve, e cila përmendet krah thirrjes në njësimin e All’llahut në adhurim. Kjo përmendet në katër vende në Kur’anin famëlartë.¹

¹ Sure “El Bekare”, ajeti 83; Sure “El Enam”, ajeti 151; Sure “El Isra” ajeti 23 dhe ajeti në fjalë.

Nga fraza e përsëritur, **“Silluni mirë me prindërit”**, përfitohet se ka një lidhje mes këtyre dy çështjeve. Në të vërtetë, çështja është si vijon: Meqenëse mirësia më e madhe është mirësia e ekzistencës dhe e jetës së dhuruar nga ana e All'llahut të Madhëruar, edhe kjo çështje ka lidhje me prindërit, sepse fëmija është pjesë prej ekzistencës së prindërve. Për këtë, mosrespektimi i prindërve është në një rresht me shirkun (idhujtarinë).

Rreth të drejtave të prindërve ne kemi hulumtime të detajuara në fundin e ajeteve përkatëse në suren “El Isra” dhe në suren “Lukman”.

3- “...me të afërmit...”

Më pas, ajeti porositi që të sillemi mirë me të afërmit. Edhe kjo çështje është një prej çështjeve që Kur'ani famëlartë i ka dhënë rëndësi të madhe, nganjëherë me emërtimin “siletu rrahm”, që do të thotë “lidhjet farefisnore” dhe herë tjetër me emërtimin “El ihsan ilel kurba”, që do të thotë “sjellja e mirë me të afërmit”. Me këtë porosi, Islami do që të forcohen lidhjet ndërmjet të gjithë njerëzve. Përveç kësaj, ai do që të shtohen lidhjet në pjesët përbërëse të shoqërisë, që janë familja dhe farefisi, me qëllim që të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin kur duken probleme dhe ngjarje të ndryshme, si dhe, për të ruajtur të drejtat e tyre.

4- “...me jetimët...”

Pastaj ajeti flet për të drejtat e jetimëve dhe i porositi besimtarët që të sillen mirë me ta dhe t'i nderojnë ata. Në çdo shoqëri ka fëmijë jetimë për shkak të faktorëve të ndryshëm dhe harresa apo neglizhenca ndaj tyre nuk kërcënon vetëm jetimët,

por kërcënon gjithë shoqërinë. Kjo sepse, nëse fëmijët jetimë lihen pa kujdestari dhe ruajtje dhe nuk marrin dashuri dhe butësi, shndërrohen në persona të shthurur, të prishur, të rrezikshëm e kriminelë. Bazuar në këtë, mirësjellja me jetimët është njëherësh mirësjellje ndaj individit dhe shoqërisë.

5- “...me të varfërit...”

Më pas, All’llahu i Latësuar përmend në këtë ajet të drejtat e të varfërve, sepse edhe në shoqëritë e shëndosha, të cilat udhëhiqen nga drejtësia, ka njerëz që vuajnë nga paaftësia që i ndalon ata nga lëvizja dhe aktiviteti. Nuk ka dyshim se kush i harron apo i neglizhon ata, ai i ka kundërshtuar të gjitha bazat dhe vlerat njerëzore. Prandaj duhet patjetër që ata të ndihmohen dhe t’u largohet varfëria.

Nëse varfëria dhe mospasja me të cilat vuajnë njerëzit e shëndetshëm e kanë burimin tek devijimi nga parimet dhe bazat e drejtësisë shoqërore, atëherë edhe këto duhen luftuar.

6-“...me fqinjët e afërt...”

Në vazhdim, ajeti porosit për sjellje të mirë me fqinjët e afërt. Ka supozime të ndryshme të komentuesit rreth kuptimit të thënies “fqinjët e afërt” (*el xharu dhil kurba*). Disa prej tyre kanë thënë se ka kuptimin e fqinjësisë së afërt nga farefisi. Por ky komentim duket i largët, duke marrë parasysh frazat e përparshme të këtij ajeti, të cilat tregojnë për të drejtat e të afërmeve. Prandaj, patjetër kuptimi duhet të jetë për afërsi vendi dhe jo afërsi farefisi, sepse fqinjët e afërt e meritojnë më shumë respektin dhe të drejtat se sa të tjerët. Ose, kuptimi i fqinjit të afërt, mund të jetë për njerëzit nga ana e fesë dhe e besimit.

7- "...dhe të largët..."

Pastaj, ajeti porositi që të silleni mirë me fqinjët e largët. Ashtu siç e thamë edhe më parë, qëllimi me fjalën "i largët" është për largësi vendore sepse siç përmendet edhe në hadithe, dyzet shtëpi përpara, mbrapa, majtas, djathtas, konsiderohen komshij ose fqinj.¹ Kjo përfshin afërsisht të gjitha qytezat e vogla. Po ta marrim shtëpinë e çdo personi si epiqendrën e rrethit që ndodhet në shtrirjen e rrezeve të saj në çdo anë dyzet shtëpi, me një llogaritje të lehtë, sqarohet sipërfaqja e këtij rrethi ku totali i shtëpive që ndodhen në këtë rreth është afërsisht pesë mijë shtëpi. Është e natyrshme se janë të rralla ato qyteza, të cilat kanë më shumë se kaq shtëpi.

Është e vlefshme që të meditojmë se në këtë ajet, në shtesë të fqinjëve të afërt, Kur'ani flet qartë edhe për fqinjët e largët, sepse fjala *fqinj*, zakonisht, ka një kuptim të kufizuar ku përfshin vetëm fqinjët e afërt.

Sipas Islamit, e drejta e fqinjit nuk është e kufizuar vetëm me fqinjët myslimanë, por ato të drejta përfshijnë, gjithashtu, edhe fqinjët jomyslimanë (përveç atyre që i luftojnë myslimanët dhe u kanë shpallur armiqësi).

Me të vërtetë, e drejta e fqinjit në Islam ka një rëndësi të madhe dhe arrin deri aty, sa në porositë e njohura të prijësit të besimtarëve, imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!) lexojmë: "*I Dërguari*

¹ Tefsiri Nurul Thakalejn, vëll. 1, f. 480. Usulul Kafijj, vëll. 2, f. 669.

*i All'lahut porosiste vazhdimisht për ata (fqinjët), derisa menduam se ai do t'i jepte atyre trashëgimi."*¹

(Ky hadith është transmetuar gjithashtu edhe në librat e Ehli Synetit. Është transmetuar në tefsirin *El Menar* dhe në tefsirin *El Kurtubij*. Kjo është transmetuar edhe nga Buhariu, i cili e ka përcjellë nga i Dërguari i All'lahut (Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!).²

Është transmetuar në një hadith tjetër nga i Dërguari i All'lahut se një ditë, ai ka thënë: *"Betohem në All'lahun se nuk beson, betohem në All'lahun se nuk beson, betohem se nuk beson. I thuhet : O i Dërguari i All'lahut, kush nuk beson? Ka thënë: Ai njeri, fqinji i të cilit nuk është i sigurt prej tij dhe prej të keqes së tij."*³

Në një hadith tjetër thuhet se Profeti (Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: *"Kush beson në All'lahun dhe në Ditën e Gjykimit, të sillet mirë me fqinjët e tij."*⁴

Është transmetuar nga imam Xhaferr ibn Muhammed Es Sadik se ai ka thënë: *"Mirësjellja me fqinjët shton mirësi dhe shton jetgjatësi."*⁵

Në botën tonë materialiste, ku nuk e njeh fqinji fqinjin, ose kur nuk e njeh as emrin e fqinjit të tij as pas njëzet vjetësh fqinjësie, duket qartë ndriçimi i mësimit islam rreth të drejtave të fqinjit. Islami i ka dhënë një rëndësi të madhe lidhjes së

¹ *Nehxhul Belaga*, letra 48.

² Tefsiri *El Kamil* i Ibn Ethijjr, vëll. 2, f. 260.

³ Tefsiri *Kurtubijj*, vëll. 3, f. 1754, fundi i ajetit në fjalë.

⁴ Tefsiri *El Menar*, vëll. 5, f. 92.

⁵ Tefsiri *Es Safijj*, vëll. 1, f. 449.

brendshme shpirtërore dhe bashkëpunimit njerëzor. Ndërkohë, këto lidhje dhe ndjenja në jetën e teknologjisë materiale, dita-ditës po shkojnë drejt zhdukjes, duke ia lënë vendin ashpërsisë, arrogancës dhe çmendurisë.

8- “...me atë që keni pranë...”

Ajeti porositi për shokun dhe shoqëruesin. Duhet ditur se thënia “me atë që keni pranë” ka një kuptim më të gjerë sesa shoku apo shoqëruesi. Në të vërtetë, ajo përfshin çdo person apo shok të njeriut që e shoqëron vazhdimisht apo përkohësisht (sikurse ai që e shoqëron një njeri në udhëtim për disa orë). Komenti i fjalës “me atë që keni pranë”, në disa transmetime është për shoqëruesin, si për shembull: “shoqëruesi yt në udhëtim”¹ ose për atë që i shkon për qëllim të dobisë së tij, si për shembull: “*I larguari prej teje shpreson në dobinë tënde.*”² Qëllimi këtu nuk është veçimi i kësaj teme për ata, por është një lloj zgjerimi në kuptimin e kësaj fjale, e cila përfshin, gjithashtu, edhe këto raste. Në këtë mënyrë ky ajet është çështje e përgjithshme për mirësjelljen me të gjithë ata që ka lidhje njeriu, qoftë shok i afërt, shok i benik, shoqërues në udhëtim, nxënës, këshilltar, shërbëtor etj.

Thënia “me atë që keni pranë”, në disa transmetime është komentuar për bashkëshorten. Këtë e ka transmetuar autori i tefsirit El Menar, autori i tefsirit Ruhul Meanijj dhe Kurtubijju në

¹ *Biharul Ennuar*, vëll. 4, f. 9. Tefsiri *Ajashijj*, vëll. 1, f. 241.

² Tefsiri *Mexhmaul Bejjan*, komentimi i këtij ajeti.

fundin e këtij ajeti, duke e përcjellë nga Aliu. Por nuk është e largët që të jetë një nga këto kuptime.

9- “...me udhëtarin (që ka mbetur ngushtë)...”

Ajeti në fjalë porositi për ata, të cilëve u ndodh diçka në udhëtim në një vend të huaj. Udhëtar është ai, i cili në udhëtim është nevojtar, edhe nëse ka mundësi të jetë i pasur në vendin e vet. Emërtimi i këtij personi *udhëtar* (që ka mbetur ngushtë)-(ibn sebiji) është sepse nuk e njohim që ta autribuojmë tek një familje apo fis. Por, këto lloj njerëzish duhet që t'i mbrojmë e t'i ndihmojmë vetëm sepse ata janë udhëtarë në udhëtim dhe kur është shfaqur nevoja e tyre për ndihmë dhe për mbështetje.

10 - “...dhe me ata që janë robër nën pushtetin tuaj...”

Në fund, ky ajet porositi që të sillemi mirë me robërit dhe me ata që ndodhen nën pushtetin tuaj. Ky ajet, në të vërtetë, ka filluar me të drejtat ndaj All'llahut të Lartësuar dhe ka përfunduar me të drejtat që i takojnë robërve e kjo, për të mos i shkëputur këto të drejta nga njëra-tjetra.

Për këtë, ky ajet nuk është i vetmi që të porositi për robërit. Por, kjo çështje përmendet gjithashtu edhe në ajete të tjera.

Në shtesë të kësaj që u tha, Islami ka vendosur një program të hollësishëm për lirimin e robërve gradualisht, i cili në përfundim çon në lirimin e plotë të tyre. Rreth kësaj do të flasim në ajetet ku përmendet kjo çështje.

Në mbyllje të këtij ajeti, All'llahu i Madhëruar thotë: **“...Në të vërtetë, All'llahu nuk i do njerëzit arrogantë e mburraveçë.”**

Me këtë All'llahu i Lartësuar e paralajmëron çdo person që kundërshton dhe thyen urdhrat e All'llahut, që refuzon zbatimin e të drejtave ndaj të afërmve, ndaj prindërve, jetimëve, të varfërve, rrugëtarëve e shokëve, për shkak të mendjemadhësisë dhe kapriçove, se ai do të përballet me zemërimin e All'llahut dhe do të privohet nga ndihma e Tij. Nuk ka dyshim se kush privohet nga mëshira e All'llahut dhe nga ndihma e Tij, ai është privuar nga çdo e mirë.

Këtë kuptim e përforcojnë edhe transmetimet e ardhura për komentimin e këtij ajeti. Prej tyre, është se një shok i Profetit ka thënë: *“Unë isha tek i Dërguari i All'llahut (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe ai lexoi këtë ajet: “Në të vërtetë, All'llahu nuk i do njerëzit arrogantë e mburraveçë.””* Ai kujtoi mendjemadhësinë dhe e quajti prej gjynaheve të mëdha. Shoku i Profetit qau. I Dërguari i All'llahut i tha: *“Çfarë të bëri ty që të qash?”* Ai tha: *“O i Dërguari i All'llahut! Me të vërtetë, unë e dua bukurinë deri edhe tek lidhëset e këpucëve.”* Profeti i tha: *“Ti je prej banorëve të Xhenetit, sepse nuk është prej mendjemadhësisë që të përmirësosh ecjen, por mendjemadhësi është kur përbuz të vërtetën dhe përçmon njerëzit.”*

Përmbledhja: Ajo që fitohet nga fraza e fundit është se burimi i shirkut dhe shkelja e të drejtave të të tjerëve është nga egoizmi dhe mendjemadhësia. Të drejtat e jetimëve, të fukarenjve dhe të robërve, i zbaton vetëm ai njeri që është i zbukuruar me shpirtin e modestisë dhe që e mohon egon e tij.

Ajetet 37- 39

الَّذِينَ يَبْخُلُونَ وَيَأْمُرُونَ النَّاسَ بِالْبُخْلِ وَيَكْتُمُونَ مَا آتَاهُمُ
 اللَّهُ مِنْ فَضْلِهِ ۗ وَأَعْتَدْنَا لِلْكَافِرِينَ عَذَابًا مُهِينًا ﴿٣٧﴾ وَالَّذِينَ
 يُنْفِقُونَ أَمْوَالَهُمْ رِئَاءَ النَّاسِ وَلَا يُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ وَلَا بِالْيَوْمِ الْآخِرِ
 وَمَنْ يَكُنِ الشَّيْطَانُ لَهُ قَرِينًا فَسَاءَ قَرِينًا ﴿٣٨﴾ وَمَا ذَا عَلَيْهِمْ لَوْ ءَامَنُوا
 بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ وَأَنْفَقُوا مِمَّا رَزَقَهُمُ اللَّهُ ۖ وَكَانَ اللَّهُ بِهِمْ عَلِيمًا ﴿٣٩﴾

“(e as) ata që janë koprracë, të cilët kërkojnë që edhe të tjerët të bëhen koprracë dhe fshehin atë që ua ka dhuruar All’llahu nga mirësitë e Tij. Ne kemi përgatitur për mohuesit ndëshkim poshtërues.”

“(Ai nuk i do) as ata që ndajnë nga pasuria e tyre sa për sy e faqe të botës dhe që nuk e besojnë All’llahun e as Ditën e Kiametit. Ai që ka për shok djallin, dihet sa shok i keq është!”

“E ç’dëm do të kishin ata sikur të besonin All’llahun dhe Ditën e Kiametit dhe të ndanin nga pasuria që u ka dhënë All’llahu?! All’llahu di çdo gjë për ta.”

Komentimi

Shpenzimi për t'u dukur dhe shpenzimi për hir të All'llahut

Ajeti i parë prej këtyre tre ajeteve, në të vërtetë, është vijimësi e ajeteve të mëparshme që flet për mendjemëdhenjtë. Ajeti thotë: **“(e as) ata që janë koprracë, të cilët kërkojnë që edhe të tjerët të bëhen koprracë...”**. Përveç kësaj, ata gjithmonë përpiqen që t'u fshehin të tjerëve ato mirësi që All'llahu u ka dhënë atyre, me qëllim që shoqëria të mos marrë asgjë nga ato. All'llahu i Lartësuar thotë: **“...dhe fshehin atë që ua ka dhuruar All'llahu nga mirësitë e Tij...”**

Pastaj ajeti tregon për përfundimin e këtij grupi njerëzish dhe fundin e çështjes së tyre, ku thotë: **“...Ne kemi përgatitur për mohuesit ndëshkim poshtërues...”** Ndoshta e fshehta e përdorimit të kësaj thënieje për këtë grup është se fjala “bukhl”, që do të thotë koprraci, në të shumtën e rasteve, buron nga mosbesimi, sepse koprracët nuk kanë besim të plotë në dhuntitë dhe në premtimet madhështore të All'llahut për punëmirët. Ata e mendojnë se ndihmesa e të tjerëve dhe përkrahja e tyre sjellin fatkeqësi.

Ndërsa biseda për poshtërimin e tyre me ndëshkim është sepse ndëshkimi i përshtatshëm për mendjemadhësinë është ndëshkimi poshtërues.

Është e domosdoshme që të kuptohet se koprracia nuk veçohet vetëm me çështjet ekonomike, por përfshin çdo lloj prej dhuratave të All'llahut. Ka shumë njerëz që nuk vuajnë nga

ndjenja e koprracisë në fushën ekonomike, por ata janë koprracë në përhapjen e dijes ose të këshillave.

Pastaj All'Ilahu i Lartësuar përmend një cilësi tjetër prej cilësive të mendjemëdhenjve ku thotë: “(Ai nuk i do) **as ata që ndajnë nga pasuria e tyre sa për sy e faqe të botës dhe që nuk e besojnë All'Ilahun e as Ditën e Kiametit...**” Sigurisht ata nuk e shpenzojnë pasurinë e tyre në rrugën e All'Ilahut dhe as për ta fituar kënaqësinë e Tij, por e shpenzojnë për t'u dukur tek njerëzit, me qëllim që të fitojnë lavdërimin e tyre, poste dhe karrierë. Kështu, qëllimi i tyre në shpenzim nuk është që t'u shërbejnë njerëzve dhe të fitojnë kënaqësinë e All'Ilahut të Lartësuar. Për këtë, ata nuk e kufizojnë shpenzimin me atë që e meriton, por gjithmonë mendojnë se si është e mundur që të përfitojnë nga ky shpenzim dhe se si t'i realizojnë dëshirat dhe qëllimet e tyre personale, siç është forcimi i pozitës së tyre në shoqëri. Kjo, sepse ata nuk besojnë në All'Ilahun dhe as në Ditën e Gjykimit. Për këtë shkak, shpenzimi i tyre nuk ka shtytës shpirtërore që duhet të gjendet në shpenzim.

Shtytësi i tyre për të shpenzuar është që ata të arrijnë famën dhe personalitetin mashtrues e falsifikues në këtë rrugë. Edhe kjo është prej ndikimeve të mendjemadhësisë dhe vjen si rezultat i egoizmit.

Vërtet, ata kanë zgjedhur shejtanin për shoqërues dhe për shok: “**...Ai që ka për shok djallin, dihet sa shok i keq është!**” Për atë kurrë nuk do të ketë të ardhme më të mirë sesa ajo e shejtanit, sepse logjika e tyre është logjikë e shejtanit dhe sjellja e tyre është e njëjtë me sjelljen e djallit. Djalli është ai që u thotë atyre se shpenzimi me sinqeritet sjell varfëri: “**Djalli ju frikëson**

me skamje e varfëri.”¹ Për këtë, ata ose bëhen koprracë duke ndaluar shpenzimin dhe dhënien për të ndihmuar (siç tregohet në ajetin e mëparshëm) ose shpenzojnë kur ky shpenzim u siguron atyre dobi personale e interesa vetjake (siç tregon ajeti në fjalë).

Nga ky ajet mësohet sesa ndikon shoku i keq në jetën e njeriut dhe ndoshta ky ndikim e çon edhe në shkatërrim të plotë.

Gjithashtu, përfitohet se marrëdhënia e mendjemëdhenjve me djallin dhe me veprat djallëzore është një marrëdhënie e vazhdueshme dhe jo e përkohshme, sepse ata kanë zgjedhur shejtanin për shok dhe shoqërues.

Këtu All'llahu i Lartësuar shpreh keqardhje për gjendjen e këtij grupi njerëzish dhe thotë: **“E ç’dëm do të kishin ata sikur të besonin All'llahun dhe Ditën e Kiametit dhe të ndanin nga pasuria që u ka dhënë All'llahu?! ...”** Çfarë do t'i gjente ata po ta braktisnin këtë sjellje, të ktheheshin në rrugën e drejtë, të shpenzonin prej atyre të mirave që i ka furnizuar All'llahu në rrugën e All'llahut me singëritet dhe jo me hipokrizi e mburrje?! Me këtë, ata do të mund të fitonin kënaqësinë e All'llahut dhe të mirësoheshin me mëshirën dhe ndihmën e Tij, e kështu të fitonin lumturinë e kësaj bote dhe të Botës Tjetër.

Përse nuk mendojnë dhe nuk e hedhin vështrimin në sjelljet e tyre? Përse vallë e kanë lënë rrugën e All'llahut, e cila është më e dobishmja dhe më e mira dhe zgjedhin një rrugë tjetër, e cila nuk sjell veçse fatkeqësi dhe humbje?

¹ Sure “El Bekare”, ajeti 268.

Sido që të jetë, All'llahu i di më së miri veprat dhe qëllimet e tyre dhe ata i shpërblen në bazë të asaj që kanë punuar: **"...All'llahu di çdo gjë për ta."**

Shpenzimi në ajetin e mëparshëm, që fliste për shpenzimin për t'u dukur, është i shoqëruar me thënien "shpenzojnë pasuritë e tyre (junfikune emualehum)", kurse në këtë ajet është i shoqëruar me thënien **"nga pasuria që u ka dhënë All'llahu"**. Ky dallim në shprehje ka mundësi që të tregojë për tri pika:

E para: Në shpenzimin për t'u dukur, nuk merret parasysh hallalli i pasurisë apo harami i saj. Ndërkohë, në shpenzimin për hir të All'llahut merret parasysh hallalli (lejueshmëria) i pasurisë dhe duhet të jetë vërtetues i thënies **"nga pasuria që u ka dhënë All'llahu."**

E dyta: Në shpenzimin për t'u dukur, gjendet mburrja dhe egoizmi. Kurse ata që e shpenzojnë për hir të All'llahut, të cilët besojnë se All'llahu është Ai, i Cili i ka furnizuar me atë çfarë ata kanë, nuk shpenzojnë me mburrje e egoizëm.

E treta: Shpenzimi për t'u mburrur në përgjithësi është i kufizuar tek pasuria, sepse ata shpenzues janë të privuar nga çdo kapital shpirtëror. Shpenzimi për hir të All'llahut përfshin të gjitha dhuntitë e Zotit, si: pasuria, dituria, pozita, pozicioni shoqëror e të ngjashme me këto nga çështjet materiale e shpirtërore.

Ajeti 40

إِنَّ اللَّهَ لَا يَظْلِمُ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ وَإِنْ تَكُ حَسَنَةً يُضْعِفْهَا وَيُؤْتِ مِنْ لَدُنْهُ

أَجْرًا عَظِيمًا ﴿٤٠﴾

“Vërtet, All’llahu nuk bën padrejtësi asnjë grimë, por, nëse (dikush) bën mirësi, All’llahu ia shumëfishon atë dhe i jep shpërblim të madh.”

Komentimi

Çfarë është grimca?

Fjala “edh dher’rretu” do të thotë milingonë e vogël që nuk shihet. Disa kanë thënë se ajo është prej pjesëve të pluhurit në dritare, e cila duket kur depertojnë rrezet e diellit. Thuhet se është pluhuri i hollë që përhapet mes duarve të njeriut nëse i vendos në tokë dhe pastaj u fryn atyre.

Më pas, me këtë fjalë është quajtur dhe emërtuar çdo gjë që është shumë e vogël. Sot përdoret dhe ka për qëllim gjithashtu atë që përbëhet nga elektroni dhe protoni. Më parë, me këtë fjalë janë quajtur pjesët e pluhurit, sepse ato kanë qenë pjesët më të vogla të trupit. Sot është vërtetuar se pjesa më e vogël e trupat e përbërë është molekula dhe pjesa më e vogël e trupave të thjeshtë (jo të përbërë) është grimca (atomi). Në gjuhën shkencore është

përzgjedhur fjala *grimcë* për ato grimca të vogla, të cilat nuk shihen me sy, por edhe që nuk mund të shihen as me mikroskopët më të fuqishëm elektronikë. Ekzistenca e tyre ndihet përmes ligjeve dhe formulave shkencore dhe fotografimi i tyre është bërë me mjete tepër të sofistikuar.

Fjala “mithkal” pra, “eth thikl”, që do të thotë *grimcë e vogël*, në të vërtetë, ka kuptimin e një trupi mjaft delikat dhe të vogël.

Ajeti në fjalë thotë se All’llahu nuk i bën kujt padrejtësi, qoftë edhe sa pesha e grimcës. Ai shumëfishon të mirën që bën ndonjë prej jush dhe e shpërblen me shpërblim të madh: **“Vërtet, All’llahu nuk bën padrejtësi asnjë grimë, por, nëse (dikush) bën mirësi, All’llahu ia shumëfishon atë dhe i jep shpërblim të madh.”**

Në të vërtetë, ky ajet u drejtohet jobesimtarëve koprracë dhe atyre, për të cilët u fol në ajetin e mëparshëm se ndëshkimet që ju godasin juve, në të vërtetë, nuk janë gjë tjetër veçse shpërblim i punëve që keni bërë, sepse juve nuk ju godet asnjë padrejtësi nga ana e All’llahut. Nëse ju do të braktisnit mosbesimin, koprracinë dhe do të ndiqnit rrugën e All’llahut, do të fitonit shpërblime të mëdha e të shumëfishta.

I duhet hedhur patjetër vështrim edhe fjalëve “da’fun” dhe “muda’afun” në gjuhën arabe, që do të thonë *barazim i diçkaje me diçka tjetër ose shumëfishim*. Bazuar në këtë, ky ajet nuk i kundërshton ajetet e tjera, të cilat thonë se shpërblimi i shpenzimit për hir të All’llahut të Lartësuar arrin në dhjetëfish e deri në shtatëqindfish...

Sido që të jetë, ajeti flet për mirësinë e All'llahut ndaj robve të Tij, të cilët nuk i ndëshkon për veprat e këqija dhe për gjynahet që kanë bërë. Nëse bëjnë një të mirë, atyre u shumëfishohet shpërblimi.

Na mbetet të kuptojmë se përse All'llahu nuk bën padrejtësi? Arsyeja është e qartë, sepse, në përgjithësi, padrejtësia buron: nga injoranca (padija), nga nevoja ose nga mungesa shpirtërore.

All'llahu është i ditur për çdo gjë, është i Vetmjaftueshëm dhe Ai nuk ka asnjë mangësi, pra, është e pamundur që të burojë prej Tij padrejtësia. Ai kurrë nuk bën padrejtësi. Jo se nuk ka mundësi, por sepse Ai është i Urtë dhe i Gjithëditur. Çdo ekzistencë në gjithësi Ai e vendos në vendin e saj. All'llahu çdo njeriu ia bën llogarin në bazë të veprave, të sjelljeve dhe të qëllimeve të tij.

Ajetet 41 - 42

فَكَيْفَ إِذَا جِئْنَا مِنْ كُلِّ أُمَّةٍ بِشَهِيدٍ وَجِئْنَا بِكَ عَلَى هَؤُلَاءِ شَهِيدًا ﴿٤١﴾
يَوْمَئِذٍ يَوَدُّ الَّذِينَ كَفَرُوا وَعَصَوُوا الرُّسُولَ لَوْ تَسَوَّى بِهِمُ الْأَرْضُ وَلَا
يَكْتُمُونَ اللَّهَ حَدِيثًا ﴿٤٢﴾

“Si do të bëhet kur prej çdo populli të sjellim dëshmitarë dhe të të sjellim ty (o Muhammed) për dëshmitar mbi të gjithë ata?!”

“Atë ditë, ata që nuk kanë besuar dhe që nuk i janë bindur të Dërguarit, do të dëshironin të rrafshoheshin me tokën, por All’lilahun nuk mund t’i fshehin asnjë fjalë.”

Komentimi

Dëshmitarët në Ditën e Kiametit

Pas ajeteve të mëparshme që flisnin rreth ndëshkimit të gjynahqarëve dhe rreth shpërblimit të të bindurve, vijnë këto ajete, ku ajeti i parë prej tyre, tregon për çështjen e dëshmitarëve në Ditën e Kiametit dhe thotë: **“Si do të bëhet kur prej çdo populli të sjellim dëshmitarë dhe të të sjellim ty (o Muhammed) për dëshmitar mbi të gjithë ata?!”** Bazuar në këtë ajet, Profeti i çdo ymeti do të jetë dëshmitar për ymetin e tij. Përveç dëshmisë së Profetit, në atë Ditë do të dëshmojnë gjymtyrët e njeriut, Toka në

të cilën ka jetuar dhe melekët e All'llahut do të dëshmojnë për veprat dhe punët e bëra. Profeti Muhammed (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), që është Profeti i fundit dhe më i madhi i të gjithëve Profetëve, do të jetë dëshmitar për ymetin e tij. Si do të munden gjynahqarët, me të gjithë këta dëshmitarë, të mohojnë një të vërtetë prej të vërtetave dhe ta shpëtojnë veten nga përfundimi i veprave të tyre?!

E njëjtë me këtë përmbajtje gjendet edhe në ajetet e tjera të Kur'anit, ku prej tyre janë: ajeti 143 në suren "El Bekare", ajeti 89 në suren "En Nahl" dhe ajeti 78 në suren "El Haxh."

Këtu shtrohet pyetja: Si kryhet dëshmia e Profetëve për punët e popujve të tyre dhe si do të jetë ajo dëshmi?

Nëse kuptimi i fjalës "të gjithë ata" tregon për myslimanët, siç thuhet në tefsirin Mexhmaul Bejjan, atëherë përgjigja e kësaj pyetjeje është plotësisht e qartë, sepse çdo Profet, përderisa është i pranishëm në mesin e popullit të tij, ai do të jetë dëshmitari për punët e tyre dhe pastaj vijnë këshilltarët e tij dhe udhëheqësit e tij të mbrojtur, ku edhe ata do të jenë dëshmitarë mbi veprat e atij populli.

Për këtë thuhet për të drejtën e Mesihut, hazreti Isait (Paqja qoftë mbi të!) se Ditën e Kiametit ai, duke iu përgjigjur pyetjes së All'llahut të Madhëruar, do të thotë: **"Unë nuk u kam thënë asgjë tjetër, përveç asaj që më ke urdhëruar Ti: 'Adhuronit All'llahun, Zotin tim dhe Zotin tuaj!' Kam qenë dëshmitar, për sa kohë që**

kam jetuar midis tyre dhe, qëkurse më more mua, vetëm Ti ishe Mbikëqyrës i tyre. Ti je Dëshmitar për çdo gjë.”¹

Por disa komentues të Kur’anit kanë supozuar se fjala “të gjithë ata” tregon për dëshmitarët e popujve të mëparshëm. Kjo do të thotë: Ne të kemi bërë ty, o Profet, dëshmitar mbi dëshmitarët e popujve të Profetëve. Ky kuptim përmendet edhe në disa transmetime.² Bazuar në këtë, kuptimi i këtij ajeti është se çdo Profet është dëshmues për punët e popullit të tij edhe pas vdekjes, nëpërmjet dëshmisë së brendshme shpirtërore. Po kështu është edhe gjendja e Profetit islam, ku shpirti i tij i pastër është dëshmues – gjithashtu nëpërmjet dëshmisë së brendshme shpirtërore – për punët e ymetit të tij dhe të të gjithë popujve të mëparshëm. Me këtë rrugë është e mundur që edhe të sinqertit, të pastërtit e të devotshmit të jenë dëshmitarë e të arrijnë në atë gradë të lartë të njohjes.

Atëherë kuptimi i gjithë kësaj është prania e shpirtit të Profetit Muhammed (Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) që nga fillimi i krijimit, sepse kuptimi i dëshmisë është dituria e shoqëruar me praninë. Por ky komentim nuk është i përshtatshëm me atë çfarë është transmetuar nga Profeti Isa (Paqja qoftë mbi të!), sepse ajeti i lartpërmendur thotë se Isai nuk ka qenë dëshmitar për të gjithë ymetin e tij, por vetëm sa ka qenë gjallë (mendo thellë!).

Ndërsa, nëse e marrim kuptimin e dëshmisë me dëshmi veprorë, që do të thotë që veprat e individit të jenë “model” dhe

¹ Sure “El Maide”, ajeti 117.

² Shih tefsiri *Nurul Thekalejn*, vëll. 1, f. 481. Tefsiri *El Burhan*, vëll. 2 f. 79.

etalon për veprat e të tjerëve, atëherë komentimi do të jetë i zbrazët nga problemet, sepse çdo Profet, i cili ka veçori e cilësi dalluese, është shembulli më i mirë për popullin e tij. Duke bërë krahasimin e cilësive të njerëzve me cilësitë e të Dërguarit, mund të njihet punëmiri dhe punëkeqi. Përderisa Profeti Muhammed është më i madhi i Profetëve dhe i të dërguarve të All'llahut, atëherë të gjitha cilësitë dhe veçoritë e tij janë kriter për personalitetin e të gjithë Profetëve dhe të dërguarve.

Sigurisht, këtu mbetet vetëm një pyetje, që është: A ka ardhur dëshmia me këtë kuptim apo jo? Duke patur parasysh se punët, veprat dhe mendimet e burrave shembullorë praktikisht dëshmojnë se është e mundur që një person të ngrihet deri në këtë gradë dhe të shpalosë këtë pozitë shpirtërore, themi se jo, por shembulli i këtij kuptimi nuk duket i largët.

Atëherë jobesimtarët dhe kundërshtuesit e Profetit do të pendohen kur ta shohin me sytë e tyre atë gjykatë të drejtë të Zotit. Ata do të përballen me dëshmitarët, mohimi i dëshmisë së të cilëve, është i pamundur. Me të vërtetë, ata do të pendoheshin me një pendim të madh deri në atë gradë, sa që do të uronin sikur të ishin dhe, e të ishin të barabartë me tokën, sikurse thotë Kur'ani famëlartë në këtë ajet: **"Atë ditë, ata që nuk kanë besuar dhe që nuk i janë bindur të Dërguarit, do të dëshironin të rrafshoheshin me tokën..."**

Po i njëjti përshkrim ka ardhur edhe në suren "En Nebe", ajeti 40, ku All'llahu i Lartësuar thotë: **"Kur jobesimtari do të thotë: 'Ah, sikur të isha pluhur!'"**

Por fjala “leu teseuua” tregon për një çështje tjetër që është se jobesimtarët, jo vetëm që urojnë të ishin dhe, por dëshmojnë gjithashtu që edhe shenjat e varreve të tyre të humbnin dhe të rrafshoheshin, që të mos i mbetej as gjurmë, as lajm e as shenjë.

Në këtë gjendje ata nuk mund të mohojnë asnjë të vërtetë dhe as të fshehin ndonjë gjë: **“...por All’llahut nuk mund t’i fshehin asnjë fjalë.”**, sepse nuk ka rrugë e as mënyrë për mohim ose fshehje me praninë e të gjitha këtyre dëshmive.

Këto thënie nuk bien ndesh me atë që përmendet në disa ajete të tjera, të cilat thonë se në Ditën e Kiametit do të ketë jobesimtarë që do të fshehin të vërtetat e që do të përgënjeshtrojnë,¹ sepse ata mohojnë dhe fshehin përpara se të flasin dëshmitarët dhe para se t’ju vijë dëshmia. Ndërsa pas dëshmisë nuk ka hapësira as për fshehje e as për mohim, por patjetër pranohen të gjitha të vërtetat.

Është transmetuar nga prijësi i besimtarëve, imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) në disa ligjërata të tij se për Ditën e Kiametit ai ka thënë: *“U vulosen gojat dhe nuk flasin. Flasin duart, dëshmojnë këmbët dhe shprehen lëkurat për atë çfarë kanë punuar dhe All’llahut nuk i fshihet asnjë fjalë.”*²

Disa komentues supozojnë se qëllimi i thënies: **“...por All’llahut nuk mund t’i fshihet asnjë fjalë”** është sepse ata jobesimtarë do të dëshironin sikur të mos kishin fshehur asnjë të vërtetë në këtë dynja, veçanërisht ato të vërteta rreth Profetit Muhammed (Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe

¹ Sure “El En’am”, ajeti 22-23. Sure “El Muxhadele”, ajeti 8.

² Tefsiri *Nuru Thakalejn*, vëll. 1, f. 482. Tefsiri *Ajsbijj*, vëll. 1, f. 242.

mbi familjen e tij!). Duke u bazuar mbi këtë, kjo fjali është e lidhur me fjalinë **“do të dëshironin të rrafshoheshin me tokën”**. Mirëpo, ky komentim nuk është në përputhje me dukjen e fjalës **“nuk mund t'i fshehim”**, e cila është folje e kohës së tashme. Sikur të ishte kuptimi ashtu siç e përmend ky grup, atëherë do të thuhej: **“lem jektumu”** (nuk do të fshihnin).

Ajeti 43

يَتَأْتِيهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا لَا تَقْرُبُوا الصَّلَاةَ وَأَنْتُمْ سُكَرَىٰ حَتَّىٰ تَعْلَمُوا مَا
تَقُولُونَ وَلَا جُنُبًا إِلَّا عَابِرِي سَبِيلٍ حَتَّىٰ تَغْتَسِلُوا وَإِنْ كُنْتُمْ مَّرْضَىٰ أَوْ
عَلَىٰ سَفَرٍ أَوْ جَاءَ أَحَدٌ مِّنْكُم مِّنَ الْغَايِطِ أَوْ لَمَسْتُمُ النِّسَاءَ فَلَمْ تَجِدُوا
مَاءً فَتَيَمَّمُوا صَعِيدًا طَيِّبًا فَامْسَحُوا بِوُجُوْهِكُمْ وَأَيْدِيكُمْ ۖ إِنَّ اللَّهَ كَانَ

عَفُوًّا غَفُورًا ﴿٤٣﴾

“O ju që keni besuar. Mos u falni kur jeni të dehur, prisni të kthjelloheni e të dini se ç’flisni; as kur jeni të papastër (xhunub) – përveçse nëse jeni duke udhëtuar, derisa të laheni. Dhe, nëse jeni të sëmurë ose gjendeni në udhëtim ose keni kryer nevojën natyrore, ose keni prekur gratë (keni bërë marrëdhënie seksuale) dhe nuk gjeni ujë, atëherë merrni tejenum me dhe, fërkoni fytyrën dhe duart tuaja me dhë të pastër. All’lillahu, me të vërtetë, është Shlyes dhe Falës i gjynaheve.”

Komentimi

Disa rregulla të jurisprudencës

Nga ky ajet përfitohen disa rregulla legislative (fikhije)

1- Ndalimi i faljes së namazit në gjendje të dehur: Kjo do të thotë se nuk lejohet që i dehuri ta falë namazin, sepse namazi nuk është i rregullt kur njeriu është i dehur. Filozofia në këtë është e qartë, sepse namazi është bashkëbisedimi i robit me Zotin e vet. Robi i lutet e i kërkon falje Zotit. Të gjitha këto duhet të kryhen patjetër në një gjendje plotësisht të kuptueshme dhe të dehurit janë shumë larg nga kjo gjendje. All'llahu i Lartësuar thotë: **“O ju që keni besuar. Mos u falni kur jeni të dehur, prisni të kthjelloheni e të dini se ç’flisni...”**

Këtu dikush mund të pyesë: A nuk kuptohet nga ky ajet se ndalimi i pijeve dehëse është nëse qëndron ndikimi dhe dehja deri në kohën e namazit, kurse në gjendje të tjera (jashtë namazit) lejohet?

Përgjigjja e kësaj pyetjeje do të vijë e detajuar tek komentimi i ajetit 90 të sures “El Maide”. Porse, përgjigjja e përmbledhur e kësaj pyetjeje është: Islami ka përdorur shumë rregulla në mënyrën e ndryshimit shkallë-shkallë. Për shembull: Ndalimin e alkoolit Islami e ka ndaluar në disa periudha. Ka filluar me cilësimin e pijeve alkoolike se ato nuk janë të mira dhe të miratuara për të përfituar riskun (sikurse është në ajetin 67 të sures “En Nahl”), pastaj e ka ndaluar afrimin në namaz kur dehja është për shkak të alkoolit (siç thuhet në këtë ajet). Më pas, Islami ka krahasuar mes dobive dhe dëmeve të alkoolit, ku e keqja

mbizotëron, siç thuhet në suren “El Bekare”, ajeti 219 dhe së fundi, e ka ndaluar rreptësisht alkolin, me urdhër të prerë, siç thuhet në suren “El Maide”, ajeti 90.

Nuk ka metodë më të mirë sesa kjo për të pastruar shoqërinë nga rrënjët e prishura shoqërore dhe morale të shpërndara në thellësinë e shoqërisë. Kjo metodë e përgatit gradualisht individin e pastaj vjen lajmi për ndalimin përfundimtar.

Patjetër duhet vëmendja rreth një çështjeje shumë të rëndësishme, e cila është se ky ajet nuk e lejon në asnjë mënyrë pirjen e alkoolit. Ai flet vetëm për çështjen e afrimit në namaz në gjendje të dehur dhe hesht në lidhje me rregullin e pirjes së alkoolit në gjendje dhe raste të tjera.

Është një temë që patjetër duhet përmendur: Ky ajet, në shumë transmetime të librat e shiave dhe të synive është komentuar me dehjen e gjumit e që do të thotë: Mos u afroni në namaz përderisa nuk e keni larguar plotësisht gjumin nga sytë tuaj, që të kuptoni se çfarë thoni! Mesa duket, ky komentim është përfituar nga kuptimi i fjalisë **“prisni të kthjelloheni e të dini se ç’flisni”**, edhe pse nuk hyn në vërtetësinë e dehjes.¹

Thënë ndryshe: Nga thënia e All’llahut të Lartësuar: **“prisni të kthjelloheni e të dini se ç’flisni”** përfitohet ndalimi i faljes së namazit në gjendjet kur njeriu nuk është i përqendruar, goftë për shkak të dehjes apo të gjumit.

¹ Tefsiri *Nurul Thakalejn*, vëll. 1, f. 483. Tefsiri *Kurtubij*, vëll. 3, f. 1171.

Nga kjo fjali, gjithashtu, përfitohet se është më mirë të mos falet namazi në gjendje dembelizmi. Ka mundësi që për këtë shkak është përcjellë edhe thënia e imam Bakirit (Paqja qoftë mbi të!): *“Mos u ço për namaz kur je i dembelosur, as kur je i përgjumur, as kur je i rënduar, sepse All’llahu i Lartësuar i ka ndaluar besimtarët që ta kryejnë namazin kur ata janë në gjendje të dehur...”*¹

2- Namazi i parregullt në gjendje xhunubllëku, për të cilën e tregon ajeti me thënien: **“...as kur jeni të papastër (xhunub)...”** Më pas, All’llahu i Lartësuar e përjashton këtë rregull me thënien e Tij: **“...përveçse nëse jeni duke udhëtuar...”**, që do të thotë se nëse ju nuk gjeni ujë në udhëtim, u lejohet që ta falni namazin, me kusht që të merrni tejemum, siç thotë edhe ajeti.

Ka komentim tjetër për këtë ajet që ka ardhur në transmetime,² i cili thotë se qëllimi me namaz në këtë ajet është për vendin e faljes së namazit, pra xhamia. Për këtë, kuptimi është: Mos hyni në xhami kur jeni të papastër (xhunub). Pastaj e ka përjashtuar kalimin në xhami me thënien: **...përveçse nëse jeni duke udhëtuar...”**, që do të thotë se u lejohet që të kaloni nëpër xhami, por jo të qëndroni në të.

Nga disa transmetime përfitohet se një grup myslimanësh i ndërtuan shtëpitë e tyre rreth xhamisë së Profetit. Sa herë që hynin dhe dilnin, kalonin nëpër xhami. Ai i ka lejuar ata që të kalonin edhe kur ishin të palarë (xhunub), por pa qëndruar në të.

Por, patjetër duhet që të tregojmë kujdes se sipas këtij komentimi fjala *namaz* në këtë ajet ka ardhur me dy kuptime.

¹ Tefsiri *Nurul Thakalejn*, vëll. 1, f. 483.

² *Uesailu Shia*, vëll. 1, f. 486.

Kuptimi i parë është për namazin në vetvete dhe kuptimi i dytë është për vendin ku falet. E kjo për shkak të pranisë së qartësimit të të dy rregullave të ndryshme në këtë ajet. Njëri rregull është ndalimi për të hyrë në namaz në gjendje të dehur dhe tjetri, ndalimi për të hyrë në xhami në gjendje të papastër (xhunub).

3- Lejimi i faljes së namazit dhe kalimi në xhami pas larjes, që është e qartë në thënien e All'Ilahut të Lartësuar: **"...derisa të laheni..."**

4- Tejemumi për ata që kanë arsye: Më pas, ky ajet tregon për rregullin e tejemumit për ata që kanë arsye, ku thotë: **"...Dhe, nëse jeni të sëmurë ose gjendeni në udhëtim..."**. Vërtet, në këtë frazë të këtij ajeti janë përmbledhur të gjitha rastet e tejemumit. Rasti i parë është nëse gjendet dëm në përdorimin e ujit; rasti i dytë, nëse dikush e ka të vështirë të gjejë ujë. All'Ilahu i Lartësuar thotë: **"...ose keni kryer nevojën natyrore, ose keni prekur gratë** (keni bërë marrëdhënie seksuale)...", ku tregon shkaqet kur duhet të merret tejemumi. Kuptimi i kësaj thënieje është: Nëse kryeni nevojën dhe kryeni marrëdhënie me gratë **"...dhe nuk gjeni ujë..."**, pra nuk jeni në gjendje të gjeni ujë ose ta përdorni atë: **"...atëherë merrni tejemum me dhe..."**.

Pastaj All'Ilahu i Lartësuar sqaron mënyrën e marrjes së tejemumit, ku thotë: **"...fërkoni fytyrën dhe duart tuaja me dhë të pastër..."**.

Në fund, ajeti thotë se ky rregull i përmendur ka ardhur si lehtësim për ju, sepse All'Ilahu është shumë Falës dhe Mbulues i gjynaheve të robit të Tij: **"All'Ilahu, me të vërtetë, është Shlyes dhe Falës i gjynaheve."**

Hulumtime

Këtu duhet patjetër të përmenden disa pika:

1- Frazja në arabisht “fe lem texhidu maen” domethënë: **“dhe nuk gjeni ujë”**. Ajo fillon me gërmën “fe” dhe është e lidhur me frazën **“ose gjendeni në rrugë”**. Ajo ka kuptimin se nëse ju jeni në udhëtim dhe nuk gjeni ujë për të marrë abdes ose për t’u larë (gusël), merrni tejemum, sepse kjo gjendje është e rrallë për njeriun që banon në qytet. Nga këtu qartësohet pavërtetësia e thënies së disa komentuesve, siç është për shembull autori i tefsirit *El-Menar*, se mjafton vetëm udhëtimi që njeriu të detyrohet me marrjen e tejemumit në vend të abdesit edhe nëse udhëtari gjen ujë. Edhe germa “fe” e ndarjes, në thënien e All’llahut të Lartësuar ku thotë: **“dhe nuk gjeni ujë”** e bën të pavlefshme këtë thënie, sepse nga ajo kuptohet se ka raste që në udhëtim nuk gjendet ujë. Këtu nuk gjendet as alternativa për praktikimin e tejemumit dhe as urdhër që nuk e detyron tejemumin. Është e habitshme se autori i tefsiri *El Menar* i ka sulmuar juristët islamë në këtë fushë pa asnjë arsye.

2 - Fjala “euv”, në thënien e All’llahut: **“...ose keni kryer nevojën natyrore”** vjen me kuptimin e lidhëzës “ue”, dhe sepse nuk mjafton thjesht vetëm sëmundja apo udhëtimi për të marrë tejemum, por tejemumi duhet të merret nëse realizohen detyrimet e tejemumit apo të guslit në këto raste.

3- Me të vërtetë “dëlirësia në qartësim” në Kur’an, ka bërë që Kur’ani në këtë ajet, po ashtu edhe në shumë ajete të tjera, të

përdorë shprehje që nga njëra anë të kuptohet qëllimi dhe nga ana tjetër kuptimi të mos jetë i habitshëm e i papërshtatshëm, ku thotë: **“ose keni kryer nevojën natyrore”**.

Qartësim: Fjala “gait”, ndryshe nga ajo që kuptohet sot, që do të thotë *kryerja e nevojës*, nga ana gjuhësore, do të thotë vend i ulët në tokë, në të cilën shkonin njerëzit, banorët e shkretëtirës dhe udhëtarët në atë kohë për të kryer nevojën, që njerëzit të mos i shikonin. Bazuar në këtë, kuptimi i kësaj fjalie është: kur dikush prej jush të kthehet nga vendi i ulët, që nënkupton kryerjen e nevojës.

Ajo që tërheq vëmendjen është se Kur’ani ka përdorur fjalinë **“ndonjëri prej jush”**, në vend të përemrit shumës të vetës së tretë “xhi’tum”, me qëllim që të ruajë veçorinë e dëlirësisë së qartësimi, që shfaqet shumë në Kur’anin famëlartë.

Po kështu është gjendja kur Kur’ani famëlartë bën fjalë për marrëdhënien seksuale, për të cilën flet me shprehjen: **“ose keni prekur gratë”** dhe fjala “el lemsu” është një aludim i mrekullueshëm për kontaktin seksual.

4- Rreth veçorive të tejumumit do të flasim me detaje tek tefsiri i ajetit 6 në suren “El Maide”, që thotë: **“me dhe të pastër.”**

5- Filozofia e tejumumit: Shumë njerëz pyesin: Cila është dobia që të përplasim duart në tokë dhe pastaj të fshijmë fytyrën dhe shpinën e duarve, kur ne e dimë se shumica e tokës është e papastër dhe mbartëse e mikrobeve dhe e baktereve?

Në përgjigje të kësaj pyetjeje, do të tregojmë dy pika të rëndësishme:

E para: Dobia morale

Tejemumi është një prej adhurimeve, ku duket qartë shpirti i adhurimit me plot kuptimin e fjalës, sepse njeriu me duart që goditi tokën, fërkon ballin e tij, që është ndër pjesët më fisnike të trupit të tij. Me këtë veprim, ai shfaq nënshtimin ndaj All'llahut dhe modestinë në praninë e Tij. Në këtë gjendje, ai sikur thotë: “O Zoti im, me të vërtetë, fytyra ime dhe duart e mia të përulen Ty deri në skajin më të largët të nënshtimit dhe të modestisë”. Pas këtij veprimi, ai i drejtohet All'llahut për kryerjen e namazit dhe për të gjitha adhurimet që janë të kushtëzuara me gusul dhe abdes. Në këtë mënyrë, tejemumi mbledh në brendinë e njeriut shpirtin dhe ndjenjën e nënshtimit ndaj All'llahut të Lartësuar dhe zhvillon tek njeriu cilësinë e bindjes. Ai zhvillon në të virtytin e modestisë e të thjeshtësisë, si dhe, e ushtron në adhurimin dhe falënderimin e All'llahut të Madhëruar për gjithçka që i ka dhënë.

E dyta: Dobia shëndetësore

Sot është vërtetuar se toka përmban sasi të mëdha bakteresh. Këto baktere që ndodhen në tokë punojnë për nxjerrjen e lëndëve organike dhe shkatërrojnë të gjitha llojet e dekompozimeve. Për këtë, kur varrosen trupat e njerëzve të vdekur ose të kafshëve të ngordhura, shohim se ato shpërbëhen dhe dekompozohen brenda një periudhe të shkurtër nga ndikimi i sulmit të baktereve mbi to. Është mëse e pranueshme se po të mos ishte kjo veçori në Tokë, i gjithë rruzulli tokësor do të shndërrohej në një vatër të qelbur vrasëse.

Me të vëretë, toka ka një veçori që i ngjan **antibiotikut**, i cili ka ndikim shumë të madh në vrasjen dhe në asgjësimin e baktereve.

Bazuar në atë që u përmend, Toka nuk është vetëm e papastër, por është edhe pastruese e papastërtive. Nga ky aspekt, ajo mund ta zëvendësojë ujin me një dallim të vetëm se uji i pastron mikrobet dhe mikrobet largohen me ujin, ndërkohë që Toka (dheu) vetëm i vret mikrobet.

Duhet përmendur se toka me të cilën marrim tejenum, duhet që të jetë e pastër, sikurse thotë Kur’ani famëlartë me fjalën e tij të bukur: **“dhe të pastër”**.

Është mëse e vlefshme që të kujtojmë se fjala *“saiid”* rrjedh nga fjala *“suud”*, që tregon se lloji më i mirë i dheut, i cili duhet të përzgjidhet për të marrë tejenum është dheu që ndodhet mbi sipërfaqen e tokës. Kjo do të thotë se është ajo tokë, të cilën e rrahin rrezet e diellit, që është e mbushur me ajër dhe me baktere që vrasin dhe shkatërrojnë mikrobet. Nëse dheu që përdoret për tejenum është i pastër, tejenumi luan rolin e pastërtisë, pa shkaktuar as edhe një dëm (Për këtë do të flasim në pjesën e fundit të tefsirit të ajetit 6 të sures *“El Maide”*.).

Ajetet 44 - 45

أَلَمْ تَرَ إِلَى الَّذِينَ أُوتُوا نَصِيبًا مِّنَ الْكِتَابِ يَشْتُرُونَ الضَّلَالَةَ وَيُرِيدُونَ أَن
تَضِلُّوا السَّبِيلَ ﴿٤٤﴾ وَاللَّهُ أَعْلَمُ بِأَعْدَائِكُمْ ۚ وَكَفَى بِاللَّهِ وَلِيًّا وَكَفَى بِاللَّهِ
نَصِيرًا ﴿٤٥﴾

“A nuk i sheh ti (o Muhammed!) ata që iu është dhënë një pjesë prej Librit? Ata e ndërrojnë të mirën me të keqen dhe dëshirojnë që edhe ju të humbisni rrugën e drejtë.”

“All’llahu i di më së miri armiqtë tuaj. All’llahu mjafton si Mbrojtës për ju. All’llahu mjafton si Ndihmës për ju.”

Komentimi

Në këto dy ajete All’llahu i Lartësuar i drejtohet Profetit të Tij, Muhammedit (Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) me fjali habitore dhe çuditëse, duke i thënë: **“A nuk i sheh ti (o Muhammed!) ata që iu është dhënë një pjesë prej Librit? Ata e ndërrojnë të mirën me të keqen dhe dëshirojnë që edhe ju të humbisni rrugën e drejtë.”**, që do të thotë se është e habitshme çështja e atyre që u është dhënë një pjesë e Librit, sepse në vend që të udhëzonin të tjerët dhe t’i drejtonin ata në dritën e asaj çfarë u ka ardhur nga udhëzimi, ata e

ndërrojnë këtë të mirë me humbjen e tyre dhe duan që t'ju çojnë edhe juve në humbje.

Me këtë mënyrë, ajo çfarë u shpall për udhëzimin e tyre dhe të të tjerëve, u shndërrua në mjet për humbjen tyre, për shkak të qëllimit të keq, sepse ata kurrë nuk kanë qenë me të vërtetën, por çdo gjë e shihnin me syrin e hipokrizisë, të zilisë dhe të materializmit.

Pastaj All'llahu i Lartësuar thotë se nëse ata ju shfaqin juve pamjen e miqësisë, në të vërtetë, ata janë armiq të tuaj të përбетuar: **"All'llahu i di më së miri armiq të tuaj..."**

A ka armiqësi më të madhe sesa urrejtja e udhëzimit tuaj dhe kundërshtimi i lumturisë tuaj, herë me gjuhë e herë me këshilla? Për të arritur qëllimet e tyre të liga, ata përpiqen në çdo vend dhe në çdo kohë duke përdorur të gjitha metodat e ndryshme dhe rrugët e posaçme.

Por ju mos iu frikësoni asnjëherë armiqësisë së tyre dhe mos iu trembni qëndrimit armiqësor të tyre, sepse ju nuk jeni të vetëm në fushën e kësaj armiqësie. Juve ju mjafton All'llahu, i Cili është Udhëheqësi, Kujdestari dhe Ndihmësi juaj: **"...All'llahu mjafton si Mbrojtës për ju. All'llahu mjafton si Ndihmës për ju."** Vërtet, ata nuk mund t'ju bëjnë asgjë. Nëse nuk ia vini veshin fjalëve të tyre dhe cytjeve të tyre, atëherë nuk mbetet asnjë vend për frikën dhe shqetësimin.

Nga thënia **"...që iu është dhënë një pjesë prej Librit?"** përfitohet se ajo që kishin ata prej Librit, nuk ka qenë gjithçka që kishte libri i Zotit, "Teurati", por ishte një pjesë prej tij. Kjo është në përshtatje edhe me të vërtetat e historisë së njohur. Ato të vërteta tregojnë për humbjen a për devijimin e një pjese të madhe të Teuratit të vërtetë gjatë kohëve.

Ajeti 46

مِّنَ الَّذِينَ هَادُوا تُحَرِّفُونَ الْكَلِمَ عَنْ مَوَاضِعِهِ ۚ وَيَقُولُونَ سَمِعْنَا وَعَصَيْنَا
وَأَسْمَعُ غَيْرَ مُسْمِعٍ وَرَاعِنَا لَيًّا بِأَلْسِنَتِهِمْ وَطَعْنَا فِي الدِّينِ وَلَوْ أَنَّهُمْ قَالُوا
سَمِعْنَا وَأَطَعْنَا وَأَسْمَعُ وَانْظُرْنَا لَكَانَ خَيْرًا لَهُمْ وَأَقْوَمَ وَلَٰكِن لَّعَنَهُمُ اللَّهُ
بِكُفْرِهِمْ فَلَا يُؤْمِنُونَ إِلَّا قَلِيلًا ﴿٤٦﴾

“Në mesin e hebrenjve ka nga ata që i nxjerrin fjalët nga konteksti i tyre dhe i thonë Profetit: “Dëgjuam, por nuk të bindemi”! dhe “Dëgjo, mos dëgjofsh!” dhe “Ra’iná!”, duke shtrembëruar (shprehjet) me gjuhën e tyre dhe duke shpifur për fenë. Po sikur ata të kishin thënë: “Dëgjuam dhe u bindëm!” dhe “Dëgjo!” e “Shikona neve!”, kjo do të ishte më e mirë dhe më e drejtë për ata. All’Ilahu i mallkoi ata për shkak të mohimit të tyre, prandaj ata nuk besojnë, përveç një numri të vogël.”

Komentimi

Një vepër tjetër e jehudinjeve

Pas shpjegimit të ajeteve të mëparshme, ky ajet flet për cilësitë e një grupi prej armiqve të Islamit dhe për disa qëndrime e vepra të tyre.

Së pari, ajeti thotë se një prej veprave të atij grupi ishte devijimi i të vërtetave dhe ndryshimi i vërtetësive të urdhrave të All'Ilahut: **“Në mesin e hebrenjve ka nga ata që i nxjerrin fjalët nga konteksti i tyre...”**, që do të thotë se një grup prej jehudinjeve i devijojnë fjalët nga konteksti i vërtetë i tyre. Ky devijim mund të jetë nga ana shprehimore ose mund të jetë nga ana kuptimore dhe praktike.

Nga fjalët vijuese përfitohet se qëllimi i devijimit është për devijimin e kontekstit të fjalës dhe ndryshimit të fjalëve, sepse pas kësaj fjalie, All'Ilahu i Lartësuar thotë: **“...dhe i thonë Profetit: ‘Dëgjuam, por nuk të bindemi...’”**! Pra, në vend që të thonë *“dëgjuam dhe u bindëm”* ata thonë *“dëgjuam dhe nuk u bindëm”*. Kjo i ngjason plotësisht thënies së atij që thotë me tallje *“t’i urdhëron, por ne nuk dëgjojmë”*.

Më pas, ajeti flet për një pjesë tjetër të thënieve të tyre armiqësore të përziera me shpirtin kundërshtues e sfidues. Ata thonë: **“Dëgjo, mos dëgjofsh!...”**. Me këtë mënyrë, këta njerëz duan të ruajnë grupin e pakujdesshëm. Përveç kësaj, ata përdorin edhe armën e devijimit të të vërtetave dhe të mashtrimit në predikimin e librave qiellorë, të cilët përbënin rrugën e vërtetë për

shpëtimin e atij grupi dhe të popullit të tyre nga kthetrat e të padrejtëve dhe tiranëve, siç ishte Faraoni. Ata përdornin armën e talljes dhe të përbuzjes, që janë arma e egoizmit dhe e mendjemadhësisë dhe metoda e kokëfortëve dhe e të pabindurve. Në disa raste, përdornin edhe fraza me kuptim të ndryshëm për t'i tallur myslimanët, të cilat myslimanët e singertë i thonin shpesh në prani të të Dërguarit të All'llahut, siç ishte fjala "Ra' ina", e cila do të thotë *kujdesu për ne dhe na jep afat*.

Myslimanët e singertë, në fillim të Islamit, frazën *kujdesu për ne dhe na jep afat* e përsërisnin shpesh përpara Profetit që të dëgjonin zërin dhe fjalët e tij në një formë më të përsosur. Por ky grup prej jehudinjeve e përdornin këtë fjali për t'i bërë keq Profetit dhe e keqpërdornin. Kur e përmendnin në prani të Profetit, e përmendnin me kuptimin e saj në gjuhën hebraishte: "Dëgjo, mos dëgjofsh!" ose me shprehje "Dëgjuam dhe nuk dëgjojmë" ose me kuptim tjetër në gjuhën arabe, që do të thotë budallallëk e përçmim. Sipas tyre qëllimi i punës së Profetit – All'llahu na ruajtë! – është mashtrimi i njerëzve dhe shfrytëzimi i naivitetit të tyre.

Të gjitha këto kanë patur si qëllim që të zhduknin të vërtetat me gjuhët e tyre dhe të injoronin fenë e vërtetë dhe legjislacionin e drejtë. All'llahu i Lartësuar thotë **"...duke shtrembëruar (shprehjet) me gjuhën e tyre dhe duke shpifur për fenë..."**

Fjala "el leju" ka kuptimin e përdredhjes, si për shembull: "fetele el habele" (përdrodi litarin). Po ashtu, ka edhe kuptimin e ndryshimit, të devijimit, falsifikimit.

Pastaj All'llahu i Lartësuar thotë: **"...Po sikur ata të kishin thënë: 'Dëgjuam dhe u bindëm!' dhe 'Dëgjo!' e 'Shikona ne!'**, kjo do të ishte më e mirë dhe më e drejtë për ata...". Kjo do të thotë se nëse ata do të ndiqnin rrugën e vërtetë dhe do të hiqnin dorë nga kokëfortësia dhe mosbindja, nga kundërshtimi i së vërtetës, nga sjelljet e këqija e të thonin: *"...e dëgjuam fjalën e All'llahut dhe iu bindëm asaj që dëgjuam, prandaj dëgjoji fjalët tona dhe na jep kohë të kuptojmë plotësisht të vërtetat..."*, kjo do të ishte më e mirë dhe më e dobishme për ata dhe do të kishte më shumë pajtim me drejtësinë, logjikën e shëndoshë dhe moralin e pastër.

Në fund të ajetit All'llahu i Lartësuar thotë: **"...All'llahu i mallkoi ata për shkak të mohimit të tyre, prandaj ata nuk besojnë, përveç një numri të vogël."** Pra, ata nuk heqin dorë nga kjo sjellje e shëmtuar. Ata janë larguar nga mëshira e All'llahut për shkak se mohuan dhe u bënë tiranë. Zemrat dhe mendjet e tyre u gurëzuan dhe u bënë të vdekura, u bënë të vështira që të ringjallen me shpejtësi, me përjashtim të disave që zotërojnë mendje dhe zemër të pastër. Këta janë të gatshëm t'i pranojnë të vërtetat dhe të dëgjojnë thirrjen e vërtetë të besimit.

Disa dijetarë e kanë konsideruar këtë fjali prej të fshehtave të Kur'anit, sepse, ashtu sikurse lajmëron në këtë ajet, jehudinjtë nuk kanë besuar përgjatë gjithë historisë islame dhe nuk i janë përgjigjur së vërtetës, me përjashtim të një grupi të pakët prej tyre, ndërsa të tjerët, që janë shumica, kanë mbetur deri më sot armiq dhe kundërshtarë të rreptë të Islamit. Ata akoma mundohen të thurin kurthe dhe intriga ndaj kësaj feje të pastër e të drejtë.

Ajeti 47

يٰۤاَيُّهَا الَّذِيْنَ اٰتَوْا الْكِتٰبَ ءَامِنُوْا بِمَا نَزَّلْنَا مُصَدِّقًا لِّمَا مَعَكُمْ مِّنْ قَبْلٍ
 اَنْ نَّطْمِسَ وُجُوْهًا فَنَرُدَّهَا عَلٰى اَدْبَارِهَا اَوْ نَلْعَنَهُمْ كَمَا لَعَنَّا اَصْحٰبَ
 السَّبْتِ ۚ وَكَانَ اَمْرُ اللّٰهِ مَفْعُوْلًا ﴿٤٧﴾

“O ju, të cilëve ju është dhënë Libri! Besoni atë që kemi zbritur si vërtetues të asaj që keni në duar para se t’ua fshijmë fytyrat e t’ua kthejmë prapa ose t’ju mallkojmë ashtu siç i mallkuam shkelësit e sebtit (ditës së shtunë). Urdhri i All’llahut do të zbatohet doemos.”

Fundi i të pabindurve

Pas ajeteve të mëparshme që bënë fjalë rreth ithtarëve të Librit, ky ajet u drejtohet përsëri atyre, ku All’llahu i Lartësuar thotë: **“O ju, të cilëve ju është dhënë Libri! Besoni atë që kemi zbritur si vërtetues të asaj që keni në duar...”** Kjo do të thotë: Besoni në Kur’anin famëlartë, në të cilin ju gjeni po ato shenja dhe lajmërimë, ashtu siç kanë ardhur në librat tuaj. Nuk ka dyshim se ju jeni më parësorët që duhet t’i besoni kësaj feje të pastër, sepse i keni argumentet dhe shenjat.

Pastaj All'illahu i Lartësuar i kërcënon ata që t'i binden të vërtetës dhe ta pranojnë atë përpara se t'i godasë një prej dy ndëshkimeve:

I pari: Zhdukja e plotë e pamjes së tyre. Zhduken të gjitha pjesët me të cilat shohin, me të cilat dëgjojnë dhe kuptojnë të vërtetat e pastaj u kthehen fytyrat nga prapa, sikurse thotë All'illahu i Lartësuar: **"...para se t'ua fshijmë¹ fytyrat e t'ua kthejmë prapa..."**

Ndoshta nuk është nevoja të përmendim se qëllimi me këtë frazë është pezullimi i mendjeve dhe i shqisave të tyre që ata të mos shohin e të mos arsyetojnë të vërtetat e jetës dhe devijimi nga rruga e drejtë, sikurse ka ardhur në hadithin nga imam Bakiri (Paqja qoftë mbi të!) se qëllimi është: *"Do t'i fshijmë ata nga udhëzimi dhe do t'i kthejmë prapa në humbjen e tyre si poshtërim për ta, që nuk do të shpëtojnë asnjëherë."*²

Qartësim: Ithtarët e Librit, veçanërisht jehudinjtë, me gjithë ato argumente dhe shenja, kundërshtonin t'i përgjigjeshin të vërtetës nga mendjemadhësia dhe kokëfortësia duke e shfaqur qëndrimin e tyre refuzues në shumë raste. Kështu kokëfortësia dhe mashtrimi dita-ditës u bënë natyra e dytë e tyre. Dukeshin sikur mendimet e tyre ishin fshirë, sytë e tyre ishin verbuar dhe veshët e tyre ishin shurdhuar. Të tillë njerëz është e natyrshme që të zbrapsen në rrugët e jetës, në vend që të përparojnë. Ky është shpërblimi i të gjithë atyre që e mohojnë të vërtetën me

¹ Fjala "et tams" ka kuptimin e zhdukjes së gjurmëve me fshirje. Për shembull, ndodh kur shembet një shtëpi dhe zhduken të gjitha gjurmët e saj. Kjo fjalë përdoret edhe me aludim për atë që humbet gjurmët dhe karakteristikat.

² Tefsiri *Mexhmanul Bejjan*, vëll. 2 f. 55.

mendjemadhësi. Kjo e vërtetë është e ngjashme me atë për të cilën folëm në fillim të ajetit 6 të sures “El Bekare.”

Bazuar në këtë, kuptimi i fshirjes së gjurmëve dhe kthimi prapa në ajetin në fjalë është për fshirje shpirtërore, mendore dhe prapambetje shpirtërore.

Ndërsa ndëshkimi i dytë, me të cilin All'llahu i ka kërcënuar, është mallkimi dhe largimi nga mëshira e Tij, ku thotë: **“...ose t’ju mallkojmë ashtu siç i mallkuam shkelësit e sebtit (ditës së shtunë)...”**¹ Këtu lind pyetja: Cili është ndryshimi mes këtyre dy kërcënimeve përderisa ndahen nga njëri-tjetri me fjalën **“ose”**?

Disa komentues kanë thënë se kërcënimi i parë përfshin anën shpirtërore, kurse kërcënimi i dytë përfshin anën e jashtme dhe fshirjen trupore, sipas thënies së All'llahut në këtë ajet: **“...siç i mallkuam shkelësit e sebtit (ditës së shtunë)...”**. Dhe ne e dimë sepse shkelësit e Sabtit, sikurse qartësohet nëse i kthehemi sures “El Araf”, janë shfarosur fizikisht.

Disa komentues të tjerë mendojnë se ky mallkim dhe largim nga mëshira e All'llahut gjithashtu përfshin anën shpirtërore, me një ndryshim të vetëm, se kërcënimi i parë tregon për devijimin, humbjen e kthimin pas, për të cilin i ka goditur ata dhe kërcënimi i dytë tregon për shkatërrimin e tyre (që është një prej kuptimeve të mallkimit).

¹ Njerëzit e ditës së shtunë janë ata, historia e të cilëve do të përmendet në komentimin e ajeteve 163-166 në suren “A’raf”. Ata janë një grup jehudinësh, të cilët u detyruan që të mos punonin ditën e shtunë. Por ata shkuan për gjueti në atë ditë, edhe pse i ndaloi Profeti i tyre dhe u bënë të pabindur dhe kundërshtues. Për këtë All'llahu i ndëshkoi ashpër ata.

Përmbledhja e thënies: Ithtarët e Librit me këmbënguljen e tyre për të kundërshtuar të vërtetën, bien, kthehen mbrapa dhe shkatërrohen.

Këtu lind edhe një pyetje tjetër: A është vërtetuar (zbatuar) ky kërcënim ndaj tyre apo jo?

Nuk ka dyshim se kërcënimi i parë është vërtetuar dhe realizuar ndaj shumicës së tyre, ndërsa kërcënimi i dytë është vërtetuar në disa prej tyre. Shumë prej tyre janë vrarë në luftrat islame dhe pengesa dhe fuqia e tyre u zhduk. Me të vërtetë, historia botërore dëshmon se si janë përballur me presione të shumta në shumë vende të ndryshme, ku kanë humbur edhe shumë persona dhe fuqi. Edhe sot akoma jetojnë në kushte dhe gjendje të vështira dhe të ashpra.

All'llahu i Lartësuar e mbyll këtë ajet duke thënë: **“Urdhri i All'llahut do të zbatohet doemos.”** për t'i përforcuar këto kërcënime, se nuk ka forcë e fuqi në Tokë që të përballët me vullnetin dhe dëshirën e All'llahut.

Ajeti 48

إِنَّ اللَّهَ لَا يَغْفِرُ أَنْ يُشْرَكَ بِهِ وَيَغْفِرُ مَا دُونَ ذَلِكَ لِمَنْ يَشَاءُ ۚ وَمَنْ

يُشْرِكْ بِاللَّهِ فَقَدْ افْتَرَىٰ إِثْمًا عَظِيمًا ﴿٤٨﴾

“Vërtet, All’llahu nuk fal që të adhurohet dikush apo diçka tjetër veç Atij, por gjynahet e tjera më të vogla ia fal kujt të dojë. Kushdo që i bën shok All’llahut (në adhurim), ka bërë gjynah të tmerrshëm.”

Komentimi

Hapësira e gjerë e ajeteve të Kur’anit

Ajeti në fjalë lajmëron qartë se të gjitha gjynahet, gabimet dhe mëkatet janë të falshme, me përjashtim të politeizmit (shirkut), sepse ai nuk falet kurrë. Ai falet vetëm nëse politeisti, idhujtari (mushriku) heq dorë nga shirku, pendohet dhe bëhet monoteist. Thënë ndryshe: Asnjë gjynah i vetëm nuk mund ta zhdukë besimin. Po ashtu, asnjë punë e sinqertë nuk mund ta shpëtojë njeriun, nëse ajo është e shoqëruar me shirk. **“Vërtet, All’llahu nuk fal që të adhurohet dikush apo diçka tjetër veç Atij, por gjynahet e tjera më të vogla ia fal kujt të dojë...”**

Lidhja e këtij ajeti me ajetet e mëparshme është se jehudinjtë dhe të krishterët, në një formë ose tjetër, kanë qenë

politeistë, idhujtarë. Çdo grup ka qenë idhujtar në një formë të caktuar. Në këtë ajet Kur'ani i paralajmëron që ta lënë këtë besim të prishur, të cilin nuk e përfshin falja dhe mëshira.

Në mbyllje të këtij ajeti, Kur'ani qartëson argumentin e kësaj çështjeje, ku thotë: **“...Kushdo që i bën shok All'llahut (në adhurim), ka bërë gjynah të tmerrshëm.”**

Ky ajet është prej ajeteve që i qetëson monoteistët për mëshirën dhe butësinë e All'llahut të Lartësuar. Sepse në këtë ajet All'llahu i Lartësuar ka qartësuar mundësinë e faljes së të gjitha gjynaheve dhe gabimeve, përveç shirkut (politeizmit). Ky ajet, ashtu siç thuhet edhe në një hadith të prijësit të besimtarëve, imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!), është ajeti më i zgjeruar. Ai ka thënë: *“Për mendimin tim, në Kur'an nuk ka ajet më të zgjeruar se ky ajet.”*

Ibn Abasi ka thënë: *“Tetë ajete kanë zbritur në suren “En Nisa”, që janë mirësi për këtë ymet (popull) në këtë jetë.”* Prej atyre, ai ka numëruar edhe këtë ajet.¹

Ka shumë njerëz që bëjnë gjynahe të mëdha e pastaj e humbasin shpresën nga mëshira dhe falja e All'llahut të Madhëruar përgjithmonë. Humbja e shpresës bën që ata ta vazhdojnë jetën e tyre në rrugën e gjynaheve dhe të gabimeve me të njëjtën forcë e këmbëngulje. Mirëpo shpresa te falja e All'llahut dhe te mëshira e Tij është mënyra më e mirë mbrojtëse për ata dhe është pengesa më e mirë për vazhdimësinë e tyre në gjynahe. Bazuar në këtë, ky ajet ka si qëllim çështjen edukative.

¹ Tefsiri *Mexhmanul Bejjan*, komentimi i këtij ajeti.

Mund të thuhet se ky ajet, në të njëjtën kohë, i frymëzon dhe i nxit njerëzit në kryerjen e gjynaheve, meqenëse ka premtim për faljen e të gjitha mëkateve me përjashtim të idhujtarisë (politeizmit).

Nuk ka dyshim se qëllimi me premtimin e faljes nuk është për premtimin absolut dhe të zbrazët nga kushtet, por ai premtim përfshin ata persona të cilët paraqesin për vetveten e tyre një lloj ndreqjeje dhe meritimi për faljen, sikurse e treguam më lart. Me të vërtetë, vullneti i All'llahut në këtë ajet dhe në ajetet e tjera të ngjashme me këtë, ka për qëllim urtësinë e Tij, sepse vullneti e Tij nuk është i ndarë kurrë nga urtësia e Tij. Është prej urtësisë së All'llahut se askush nuk e fiton faljen e Tij pa e merituar atë.

Bazuar në këtë, anët dhe dimensionet e përkryera edukative në këtë ajet janë në një standart shumë të Lartë dhe më lart sesa keqpërdorimi i premtimit që ndodhet në këtë ajet.

Hulumtime

Shkaqet e faljes së gjynaheve

Ajo që duhet të vërehet është se ky ajet nuk ka lidhje me çështjen e pendimit, sepse pendimi i pastron të gjitha gjynahet dhe gabimet, deri edhe shirkun. Por qëllimi është mundësia e përfshirjes së faljes së All'llahut për ata që nuk pendohen, pra për ata të cilët vdesin para se të pendohen për gjynahet e tyre.

Sqarim: Në shumë ajete kur'anore përfitohet se mënyrat për të arritur faljen e Zotit janë të shumta. Ato mund t'i përkufizojmë në pesë pika:

1-Pendimi dhe kthimi tek All'llahu është i shoqëruar me pendim nga gjynahet e mëparshme, me vendosmërinë e heqjes dorë nga gjynahet në të ardhmen dhe me shlyerjen e veprave të këqija me vepra të mira. Ka shumë ajete që flasin për këtë çështje dhe prej tyre është thënia në ajetin 25 të sures "Esh Shura", që thotë: **"Ai e pranon pendimin e robve të Vet, i fal gjynahet."**

2-Veprat e mira janë shumë të rëndësishme dhe ato bëhen shkak për faljen e veprave të këqija, sikurse thotë All'llahu i Madhëruar në suren "Hud", ajeti 114: **"...sepse veprat e mira i shlyejnë veprat e këqija."**

3- Ndërmjetësimi (shefaati), të cilin e kemi shpjeguar në vëllimin e parë tek komentimi i ajetit 48 në suren "El Bekare".

4- Largimi nga gjynahet e mëdha, të cilat detyrojnë faljen e gjynaheve të vogla, sikurse e shpjeguam në komentimin e ajetit 31 dhe 32 të kësaj sureje.

5- Falja e All'llahut, e cila përfshin persona që e meritojnë atë, sikurse u shpjegua në këtë ajet.

Këtu përsërisim ato që thamë më parë se falja e All'llahut është e kushtëzuar me vullnetin e Tij dhe se çështja nuk është absolute dhe e pakushtëzuar. Ky vullnet përfshin ata persona, të cilët e vërtetojnë praktikisht meritën e tyre për këtë mirësi të All'llahut.

Nga këtu qartësohet se përse politeizmin (shirkun) nuk e përfshin falja dhe mëshira e All'llahut. Shkaku në këtë është se shirku i shkëput krejtësisht lidhjet me All'llahun e Lartësuar. Shirku është në kundërshtim me çdo fe dhe legjislacion qiellor si dhe me çdo ligj dhe etikë të natyrshme.

Ajetet 49 - 50

أَلَمْ تَرَ إِلَى الَّذِينَ يُزَكُّونَ أَنْفُسَهُمْ^ج بَلِ اللَّهُ يُزَكِّي مَن يَشَاءُ وَلَا يُظْلَمُونَ
فَتِيلًا ﴿٤٩﴾ أَنْظِرْ كَيْفَ يَفْتَرُونَ عَلَى اللَّهِ الْكَذِبَ^ط وَكَفَىٰ بِهِ إِثْمًا مُّبِينًا



“A nuk i ke parë ata që e kujtojnë veten të dëlirë? Jo, All’llahu dëlir kë të dojë dhe askush nuk do të pësojë as padrejtësinë më të vogël.”

“Shiko si shpifin ata gënjeshtër kundër All’llahut. Mjafton kjo shpifje si gjynah i qartë.”

Shkaku i zbritjes

Është transmetuar në shumë tefsire të Kur’anit në komentimin e këtij ajeti se jehudinjtë dhe të krishterët i mendonin vetat e tyre si të përzgjedhur. Ata, sikurse e shohim në ajetet kur’anore që flasin për ata, thonin: “**Ne jemi bijtë e All’llahut dhe të dashurit e Tij**”. Në suren “El Maide”, ajeti 18, dhe në suren “El Bekare”, ajeti 111, All’llahu i Lartësuar thotë: “**Askush nuk do të hyjë në Xhenet, përveç hebregjeve ose të krishterëve.**” Dhe

kështu zbritën këto ajete që hedhin poshtë pretendimet dhe imagjinatat e tyre.¹

Komentimi

Pastrimi i shpirtit

Në ajetin e parë, All'llahu i Madhëruar thotë: **“A nuk i ke parë ata që e kujtojnë veten të dëlirë?...”** Këtu flitet për një nga cilësitë e këqija, me të cilën mund të sprovohen shumë njerëz dhe popuj. Ajo është cilësia e lavdërimit të vetvetes, e pastrimit të shpirtit dhe e pretendimit të mbartjes së cilësive të mira.

Pastaj All'llahu i Madhëruar thotë: **“...Jo, All'llahu dëlir kë të dojë...”**. Vetëm All'llahu është Ai që i lavdëron njerëzit dhe i pastron në përputhje me mundësitë dhe aftësitë që kanë, në bazë të veprave të mira, pa asnjë shtesë apo pakësim, në bazë të urtësisë dhe të dëshirës dhe jo bazuar në lojë apo tallje. Për këtë, All'llahu i Lartësuar nuk i bën askujt padrejtësinë më të vogël: **“...dhe askush nuk do të pësojë as padrejtësinë më të vogël.”**²

Në të vërtetë, mirësi është ajo, të cilën, All'llahu i Lartësuar e konsideron mirësi dhe jo ajo që e pretendojnë njerëzit për vetat e tyre bazuar tek egoizmi i tyre, duke u bërë kështu padrejtësi vetave të veta dhe të tjerëve.

¹ *Biharul Ennuar*, vëll. 9, f. 74.

² Fjala “el fetijl”, që gjendet në ajet, ka kuptimin e fijes së hollë që ndodhet mes dy anëve të farës së hurmës arabe. Ajo vjen edhe me kuptimin figurativ për sendet shumë të vogla dhe delikate. Originaliteti i kësaj fjale është “fetele”, që do të thotë “perdrehtje”.

Kjo thënie u drejtohet jehudinje dhe të krishterëve, të cilët pretendojnë për vetat e tyre disa mirësi pa asnjë argument dhe e konsiderojnë veten e tyre si populli i përzgjedhur duke thënë nganjëherë: **“Zjarri nuk do të na prekë, vetëm në ca ditë të numëruara.”**¹ dhe: **“Ne jemi bijtë e All’llahut dhe të dashurit e Tij”**². Mirëpo kuptimi i kësaj thënieje nuk është i veçantë për një popull apo grup, por përfshin të gjithë njerëzit dhe popujt e goditur me këtë sëmundje dhe me këtë cilësi të keqe.

Në ajetin 32 të sures “En Nexhm”, Kur’ani famëlartë u drejtohet të gjithë myslimanëve: **“Prandaj mos u lavdëroni me pafajsinë tuaj! Ai i njeh më së miri ata që ruhen nga gjynahet.”**

Burimi i kësaj vepre është mahnitja me vetveten dhe vetpëlqimi. Vetpëlqimi, i cili shfaqet dalëngadalë kur lavdërohet vetja dhe quhet e pastër, përfundon në mendjemadhësi dhe në tirani ndaj të tjerëve.

Me të vërtetë, ky zakon i keq është prej zakoneve të përhapura tek popujt, shoqëritë dhe personat. Ai është burim i shumë fatkeqësive shoqërore dhe i luftrave e i tiranisë dhe i shtypjes ndaj të tjerëve.

Historia na tregon se si disa popuj pretendonin se ishin më lart se të tjerët bazuar te kjo ndjenjë mashtruese, duke u dhënë të drejtë vetave të tyre sundimin e të tjerëve dhe shfrytëzimin e tyre.

Arabët, në kohën e xhahilijetit (para Islamit) megjithë prapambetjen, varfërinë, degradimin dhe devijimin, i mendonin vetat e tyre si më të Lartët. Kjo gjendje ishte e përhapur deri edhe

¹ Sure “El Bekare”, ajeti 80.

² Sure “El Maide”, ajeti 18.

tek fiset, ku një fis e konsideronte veten e tij më të mirë dhe më të Lartë se sa fiset e tjera.

Ndenja e epërsisë tek gjermanët dhe izraelitët ka shkaktuar luftra botërore dhe luftra rajonale.

Në fillim të Islamit, jehudinjtë dhe të krishterët e vuanin këtë ndjenjë të gabuar dhe këtë hamendësi. Për këtë, ata e kishin të rëndë t'i pranonin të vërtetat e Islamit. Për këtë shkak, Kur'ani famëlartë, në ajetin e dytë, e mohon me forcë në këtë hamendësi dhe epërsi të tyre dhe e konsideron një përgënjeshtim ndaj All'llahut të Lartësuar, shpifje ndaj Tij dhe mëkat të madh.

All'llahu i Lartësuar thotë: **“Shiko si shpifin ata gënjeshtria kundër All'llahut. Mjafton kjo shpifje si gjynah i qartë.”** pra, shiko se si ky grup me pretendimin e këtyre virtyteve për vetat e tyre nga njëra anë dhe duke iu dedikuar All'llahut nga ana tjetër, ata shpifin ndaj Tij. Sikur për këta grupe të mos kishte tjetër gjynah përveç këtij, vetëm ai do të mjaftonte për ndëshkimin e tyre.

Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) në hadithin e njohur që i drejtohet Hamamit, në të cilin përshkruan cilësitë e të devotshmëve, thotë: *“Nuk janë të kënaqur me veprat e tyre të pakta dhe nuk kërkojnë shumë. Ata vetveten e tyre e akuzojnë dhe prej veprave të tyre mëshirohen. Nëse ndonjëri prej tyre pastrohet, i frikësohet asaj që thonë për të dhe thotë: Unë jam më i ditur se të tjerët për veten time dhe All'llahu i Lartësuar është më i ditur se unë për vetveten time! O All'llah, mos më dëno mua për atë çfarë ata thonë. Më bëj mua më të mirë sesa ajo që mendojnë dhe më fal mua ato që nuk i dinë.”*

Ajetet 51 - 52

أَلَمْ تَرَ إِلَى الَّذِينَ أُوتُوا نَصِيبًا مِّنَ الْكِتَابِ يُؤْمِنُونَ بِالْجَبَتِ
وَالطَّغُوتِ وَيَقُولُونَ لِلَّذِينَ كَفَرُوا هَؤُلَاءِ أَهْدَىٰ مِنَ الَّذِينَ ءَامَنُوا
سَبِيلًا ﴿٥١﴾ أُولَٰئِكَ الَّذِينَ لَعَنَهُمُ اللَّهُ ۖ وَمَن يَلْعَنِ اللَّهُ فَلَن تَجِدَ لَهُ نَصِيرًا



“A nuk i ke parë ata që u është dhënë një pjesë e Librit që besojnë në idhuj dhe hyjni të rreme dhe thonë për jobesimtarët: ‘Këta janë në rrugë më të drejtë se ata që besojnë.’”

“Këta janë ata që i ka mallkuar All’llahu dhe, atë që e mallkon All’llahu, nuk do t’i gjendet ndihmues.”

Shkaku i zbritjes

Shumica e komentuesve të Kur’anit, për shkaku të zbritjes së këtyre dy ajeteve, kanë thënë: Pas luftës së Uhudit, një prej personaliteteve jehudinj, Ka'b ibn Eshref, me shtatëdhjetë jehudinj të tjerë u nisën për në Mekë për të bërë aleancë me jobesimtarët e Mekës kundër të Dërguarit të All’llahut, duke shkelur marrëveshjen që ishte lidhur mes tyre dhe të Dërguarit të All’llahut.

Ka'b ibn Eshref shkoi në shtëpinë e Ebu Sufjanit, i cili i priti shumë mirë. Ndërsa jehudinjtë e tjerë qëndruan në shtëpitë e kurejshëve. Banorët e Mekës kanë thënë: *“Me të vërtetë, ju jeni ithtarët e Librit (Teuratit) dhe të Muhammedit (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), poseduesit të Librit dhe nuk besojmë se ky është një mashtrim prej jush. Nëse dëshiron që të dalim me ju (të luftojmë kundër Muhammedit) bëji sexhde këtyre dy idhujve dhe thuaj besoj në to.”* Ai veproi.

Pastaj Ka'b ibn Eshref u sugjeroi banorëve të Mekës: *“O banorët e Mekës le të vijnë prej jush tridhjetë burra dhe prej nesh tridhjetë dhe të bashkojnë zemrat tona me Qaben dhe të betohemi në Zotin e kësaj shtëpie se jemi të vendosur për ta luftuar Muhammedin (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!).”* Ata e bënë këtë betim. Pasi u larguan, Ebu Sufjani i thotë Kabit: *“Me të vërtetë, ti je një burrë që e ke lexuar librin dhe mëson dhe ne jemi analfabetë dhe se nuk e dimë se cili prej nesh është në rrugë të drejtë dhe më afër të vërtetës, ne apo Muhammedi?!”*

Ka'bi i thotë: *“Ma trego fenë tuaj.”* Ebu Sufjani tha: *“Ne bëjmë kurban devetë "el keuma" (që është deve madhështore) për haxhinjtë, u japim ujë, respektojmë mikun, e ndalojmë të keqen, mbajmë lidhjet farafisnore, bëjmë umren te Shtëpia e Zotit tonë, bëjmë tavaf rreth saj dhe jemi banorët e haremit (Qabes) dhe Muhammedi është larguar nga feja e baballarëve tanë, ka prerë lidhjet farefisore, është larguar nga Haremi (Qaben) dhe nga feja jonë e vjetër. Feja e Muhammedit është e re.”*

Pastaj Ka'bi ka thënë: “Betohem në All’llahun se ju jeni në rrugë më të drejtë se Muhammedi.” Dhe All’llahu i Lartësuar i zbriti këto ajete duke iu përgjigjur atyre dhe si kundërshtim për ta.¹

Komentimi

Lajkatarët

Ajeti i parë i këtyre dy ajeteve, sikurse e tregon në shkakun e zbritjes së këtij ajeti, tregon një cilësi tjetër prej cilësive të rëndomta, të papëlqyer të jehudinjeve, që është: Për të arritur qëllimet e tyre i bënë lajka çdo grupi prej grupeve. Për t'u afruar sa më shumë me jobesimtarët e Mekës, i bënë sexhde idhujve të tyre, duke injoruar çdo gjë që kishin lexuar në librat e tyre, apo që kishin mësuar rreth cilësive të të Dërguarit të All’llahut dhe rreth madhështisë së Islamit. Jo vetëm kaq, por edhe pse jehudinjtë ishin prej ithtarëve të Librit dhe kishin të përbashkëta mes tyre dhe Islamit dhe që ishin më të shumta se të përbashkëtat që i bashkonin me politeistët, ata arritën që t'i kënaqnin jobesimtarët duke e quajtur besimin e tyre politeist, me gjithë paganizmat dhe devijimet e tij, më të mirë se sa besimi i pastër islam. Në mënyrë të habitshme, në këtë ajet, All’llahu i Lartësuar thotë: **“A nuk i ke parë ata që u është dhënë një pjesë e Librit që besojnë në idhuj dhe hyjni të rreme...?!”,** që janë idhujt.

Mirëpo, ata nuk binden me kaq dhe nuk ndalojnë në këtë limit. Për këtë, All’llahu i Lartësuar thotë: **“...dhe thonë për**

¹ Tefsiri *Mexhmaul Bejan*, fundi i ajetit në fjalë. Tefsiri Durrul Menthur, vëllimi 2, faqe 171.

jobesimtarët: 'Këta janë në rrugë më të drejtë se ata që besojnë.'"

Idhujt dhe hyjnitë e rreme

Fjala "el xhibt" është përdorur veçanërisht në këtë ajet të Kur'anit të shenjtë. Ai është emër i palakuar dhe nuk është i njohur në gjuhën arabe. Thuhet se ai ka kuptim "siher", që do të thotë *magji* ose "sahir", që do të thotë *magjistar* ose *shejtan* në gjuhën e Habeshive. Pastaj ka hyrë në gjuhën arabe dhe është përdorur me këtë kuptim ose me kuptimin *idhull* ose, *i adhuruar tjetër* në vend të All'llahut. Thuhet se origjina e saj është "xhibes" pastaj është ndërruar germa "sin" me germën "te".

Ndërsa fjala "tagut" është përdorur në tetë vende në Kur'anin famëlartë dhe ajo, sikurse e kemi thënë në vëllimin e parë në këtë tefsir, në shpjegimin e ajetit 256 të sures "Bekare", është hipërbolë¹ nga lënda e fjalës "tug'jan", që do të thotë *shkelje* dhe *tejkallim i cakt.* Me këtë fjalë quhet çdo gjë që e kalon cakun. Për këtë janë quajtur me këtë emër edhe shejtani, udhëheqësit tiranë, çdo i adhuruar në vend të All'llahut dhe çdo rrugë që të çon tek e pavërteta dhe padrejtësia. Ky është kuptimi i përgjithshëm i këtyre dy fjalëve.

Përsa i përket kuptimit të këtyre dy fjalëve në këtë ajet, komentuesit e Kur'anit janë ndarë në disa grupe. Disa prej tyre kanë thënë se janë dy emra të dy idhujve, të cilëve u kanë bërë

¹ Tefsiri *El Menar*, vëllimi 3, faqe 35.

sexhde jehudinjtë, që e përmendëm në tregimin e mëparshëm. Disa të tjerë kanë thënë se fjala "xhibit" këtu ka kuptimin e idhullit e ndërsa "tagut" janë adhuruesit e idhujve ose ruajtësit e tyre, të cilët përfaqësonin shkrimin e biografive të idhujve, të cilët thonin gënjeshtër për të mashtruar njerëzit.¹

Ky kuptim është më i përshtatshëm me atë çfarë ka ardhur në shkakun e zbritjes tek komentimi i këtij ajeti, sepse jehudinjtë iu përlulën idhujve, ashtu sikurse u përlulën para adhuruesve të tyre paganë.

Më pas, All'llahu i Lartësuar, në ajetin e dytë qartëson të ardhmen e atyre lajkatarëve, ku thotë: **"Këta janë ata që i ka mallkuar All'llahu dhe, atë që e mallkon All'llahu, nuk do t'i gjendet ndihmues."**

Me të vërtetë, jehudinjtë, sikurse thotë ky ajet, me lajkat e tyre skandaloze nuk arritën asnjë rezultat, por përkundrazi, në fund u mposhtën dhe është e vërtetuar lajmërimi i Kur'anit të shenjtë për ta.

Në të vërtetë, këto ajete në fjalë edhe pse kanë zbritur për një grup të veçantë (jehudinjtë), nuk janë të posaçme vetëm për ata. Ato përfshijnë çdo person lajkatar, i cili sakrifikon me pozitën dhe personalitetin e tij, por edhe me besimin e tij në rrugën e arritjes së synimeve shtazarake dhe qëllimeve të ulta.

Me të vërtetë, këta do të jenë më të largët nga mëshira e All'llahut në këtë botë dhe në Botën Tjetër. Në përgjithësi, çështja e tyre përfundon me humbje.

¹ Tefsiri *Tibhjan*, Tefsiri *Rubul Meanijj*, komentimi i këtij ajeti.

Është e vlefshme të kujtohet se gjendja dhe cilësitë e tyre poshtëruese që përmenden këtu, gjenden edhe në këtë kohë tek jehudinjtë. Ne shohim se ata nuk ndalojnë nga asnjë lajkatim, sido që të jenë kushtet, për të arritur qëllimet e tyre. Për këtë, ata vuajnë humbjen dhe mposhtjen gjatë historisë së tyre, në të shkuarën e në të tashmen.

Ajetet 53 - 55

أَمْ هُمْ نَصِيبٌ مِّنَ الْمُلْكِ فَإِذَا لَا يُؤْتُونَ النَّاسَ نَقِيرًا ﴿٥٣﴾ أَمْ تَحْسُدُونَ
النَّاسَ عَلَىٰ مَا آتَاهُمُ اللَّهُ مِنْ فَضْلِهِ ۖ فَقَدْ ءَاتَيْنَا آلَ إِبْرَاهِيمَ الْكِتَابَ
وَالْحِكْمَةَ وَءَاتَيْنَاهُم مَّلَكًا عَظِيمًا ﴿٥٤﴾ فَمِنْهُمْ مَّنْ ءَامَنَ بِهِ وَمِنْهُمْ مَّنْ
صَدَّ عَنْهُ ۚ وَكَفَىٰ بِجَهَنَّمَ سَعِيرًا ﴿٥٥﴾

"A do të kenë ata ndonjë pjesë të pushtetit? Nëse është kështu, ata nuk do t'u jepnin njerëzve as sa puçërza e bërthamës."

"A mos i kanë zili njerëzit për çfarë u ka dhuruar All'Ilahu nga të mirat e Veta? Ne u dhamë pasardhësve të Ibrahimit Librin e urtësinë, si dhe një pushtet të madh."

"Disa prej tyre e besuan atë e disa iu shmangën atij. Për ata mjafton Xhehennemi përcëllues."

Komentimi

Në komentimin e dy ajeteve të mëparshme thamë se jehudinjtë, për të kënaqur idhujtarët e Mekës, dëshmuan se idhujtarizmi kurejsh është më i mirë se monoteizmi (besimi në një Zot të vetëm) i myslimanëve. Jo vetëm kaq, por ata i bënë sexhde idhujve. Në këto ajete, All'llahu i Lartësuar na qartëson se kjo vepër e tyre nuk ka vlerë, për dy arsye:

1- Jehudinjtë, nga ana e pozitës shoqërore, nuk e kanë atë vlerë që i bën të meritueshëm për të gjykuar dhe për të drejtuar çështjet e njerëzve dhe njerëzit nuk ia kanë dhënë asnjëherë atyre të drejtën dhe lirinë e udhëheqjes dhe të gjykimit mes tyre, që të jenë shembull i kësaj vepre. All'llahu i Lartësuar thotë: "A do të kenë ata ndonjë pjesë të pushtetit?**", ku ata me të vërtetë nuk do të kenë asnjë pozicion të pranueshëm për pushtetin materialist e shoqëror tek njerëzit, sepse shpirti manipulues rritet në mes qënies së tyre me forcë deri në atë gradë, sa që ata, nëse arrijnë deri në atë pozicion që nuk ua japin askujt të drejtën e vet por, e veçojnë çdo gjë për veten e tyre, ku All'llahu i Lartësuar thotë: "**A do të kenë ata ndonjë pjesë të pushtetit?..."****

Përveç kësaj, ata nuk zotërojnë asnjë aftësi dhe meritë për udhëheqje materiale dhe shpirtërore tek njerëzit sepse shpirti i hakmarrjes është i ngulitur në qenien e tyre deri në atë shkallë sa që nuk i japin të drejtën askujt dhe çdo gjë e përvetësojnë për vetat e tyre. "**...Nëse është kështu, ata nuk do t'u jepnin njerëzve as sa puçërza e bërthamës."**

2- Me të vërtetë, këto rregulla të pabaza e kanë burimin tek smira e tyre urryese ndaj të Dërguarit të All'Ilahut dhe familjes së tij të ndershme dhe për këto ato humbasin çdo vlerë. Ata, me padrejtësinë dhe mosbesimin e tyre humbën pozitën e Profetësisë dhe të udhëheqjes. Për këtë, ata nuk dëshirojnë që të arrijë asnjë njeri prej njerëzve këtë pozicion. Prandaj e kishin zili të Dërguarin e All'Ilahut dhe familjen e tij, të cilët i përfshiu kjo dhunti e Zotit dhe iu dha atyre ky pozicion fisnik dhe i lartë. Me sjelljen e tyre dhe me rregullat e pabaza, ata përpiqen të zbusin përvëlimin e smirës në qenien e tyre: **"A mos i kanë zili njerëzit për çfarë u ka dhuruar All'Ilahu nga të mirat e Veta?..."**

Pastaj All'Ilahu i Lartësuar thotë: **"Përse habiteni për pozitën e lartë që Ne i kemi dhënë Profetit dhe fisit Hashimit? All'Ilahu iu dha juve dhe i dha familjes së Ibrahimit Libër qiellor, dituri, urtësi, zgjuarsis dhe një pushtet të gjerë (siç ishte pushteti i Musait, i Sulejmanit dhe i Dautit) por ju, fatkeqësisht, e keqpërdorët udhëheqjen tuaj dhe i humbët ato mirësi materiale e shpirtërore të shumta e të vlefshme për shkak të zemërngurtësisë dhe të këqijave tuaja."** All'Ilahu i Lartësuar thotë: **"...Ne u dhamë pasardhësve të Ibrahimit Librin e urtësinë, si dhe një pushtet të madh."**

Qëllimi i fjalës *njerëzit* në thënien e Tij: **"A mos i kanë zili njerëzit"**, siç e përmendëm edhe më lart, është për të Dërguarin e All'Ilahut dhe familjen (Ehli Bejtin) e tij, sepse fjala *njerëzit* përdoret edhe për një grup prej tyre, kurse përdorimi i saj për një person, pra vetëm për Profetin, nuk është i rregullt, nëse nuk ka argument.

Në shtesë të kësaj, thënia *familja e Ibrahimit* është një argument tjetër se qëllimi i fjalës *njerëz* është për Profetin dhe familjen e tij. Nga ky argument, përfitohet se nuk ka pse të habiteni, nëse i kemi dhënë fisit Hashimit këtë pozitë, sepse edhe familjes së Ibrahimit Ne i kemi dhënë atë pozitë materiale e shpirtërore, për shkak se i meritojnë ato.

Ka ardhur e qartë në transmetimet e Ehli Bejtit dhe të Ehli Syneetit se qëllimi i fjalës “njerëz” në këtë është për familjen e Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!).

Është transmetuar nga imam Bakiri (Paqja qoftë mbi të!) në fund të komentimit të këtij ajeti, i cili ka thënë: *“All'Ilahu ka bërë prej tyre të dërguar, pejgamberë dhe prijësa. Si e pranojnë familjen e Ibrahimit dhe mohojnë familjen e Muhammedit (Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)?”*¹

Në një transmetim tjetër nga imam Sadiku, imam Aliun, kur e pyetën për ata ndaj të cilëve kanë smirë në këtë ajet, u përgjigj: *“Ne jemi ata që na kanë mëri e zili”*.²

Është transmetuar në Ed Durul Menthur nga ibn Mundhir Et Tabaranij se ibn Abasi për këtë ajet ka thënë: *“Ne jemi ata njerëz dhe s'ka të tjerë.”* Pastaj, në ajetin pasardhës, Kur'ani i shenjtë thotë: **“Disa prej tyre e besuan atë e disa iu shmangën atij. Për ata mjafton Xhehennemi përcëllues.”** që do të thotë se në atë kohë kishte prej njerëzve që e besuan Librin që iu zbrit familjes së Ibrahimit. Por kishte prej tyre që nuk u mjaftuan vetëm me

¹ Tefsiri *Burban*, vëll. 1 f. 376. Tefsiri *Ruhul Meanijj*, vëll. 5, f. 52.

² Tefsiri *Burban*, vëll. 1 f. 376. Tefsiri *Ruhul Meanijj*, vëll. 5, f. 52.

mosbesimin në atë Libër, por ndalonin edhe të tjerët që t'i besonin. Për këtë ata do të hyjnë në zjarrin përvëlues të Xhehennemit dhe do të kenë ndëshkim të rreptë.

I njëjti përfundim do të jetë për të gjithë ata që mohojnë Kur'anin e shenjtë që i është zbritur të Dërguarit të All'lahut, Profetit Muhammed (Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!).

Hulumtime

Roli i smirës në krime

Smirë “hased” do të thotë të dëshirosh që të tjerëve t'u largohet mirësia, e kanë apo nuk e kanë atë të mirë vetë ata. Bazuar mbi këtë, smiraku përpiqet me të gjitha mundësitë që mirësitë të mos arrijnë tek të tjerët ose e dëshiron këtë por jo që ato mirësi të kalojnë tek ai (smiraku).

Me të vërtetë, smira është burimi i shumë fatkeqësive dhe mundimeve shoqërore sepse:

1- Vërtet, smiraku shpenzon të gjitha ose një pjesë të energjive të tij trupore e mendore, të cilat duhet të shpenzohen për qëllimet shoqërore, në rrugën e shkatërrimit dhe të shembjes së asaj që gjendet e ndërtuar. Për këtë, ai shpenzon forcën dhe fuqinë e tij personale së bashku me forcat dhe fuqitë shoqërore.

2- Smira është nxitëse e shumë krimeve në këtë botë. Nëse studiojmë shkaqet origjinale të krimeve, vrasjeve, vjedhjeve, mësymjes, e të ngjashme me këto vepra, do të shohim me qartësi se shumica e tyre burojnë nga smira.

Ndoshta ky është shkaku që smirën e kanë ngjasuar me shkëndijat e zjarrit që mund të kërcënojë qenien e smirakut apo edhe të shoqërisë në të cilën jeton duke përhapur dëm dhe rrezik në mesin e saj.

Një dijetar thotë: Vërtet, smira është cilësia (vesi) më e keqe dhe duhet të konsiderohet armiku më i rreptë i lumturisë. Është detyrë e njeriut që të përpiket për ta larguar atë.

Me të vërtetë, shoqëritë në të cilat gjenden smirakë me horizonte të ngushta, janë shoqëri të prapambetura. Në të shumtën e rasteve, smirakët janë elementë dëshpërues dhe persona të sëmurë që vuajnë nga lodhje dhe dhimbje trupore e psikike. Prandaj, sot është bërë mëse e pranueshme se shumica e sëmundjeve dhe e dhimbjeve trupore (fizike) vijnë nga shkaqet psikike. Ne vërejmë në këtë kohë hulumtime të detajuara mjekësore rreth këtyre sëmundjeve.

Duhet përmendur se këtë çështje e përforcojnë edhe hadithet e imamëve të fesë dhe të udhëheqësve të Islamit. Në një trasmentim të imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!) lexojmë: “Trupi i shëndetshëm është nga smira e pakët” dhe në disa transmetime të tjera lexojmë: “Çudi prej pavëmendshmërisë së smirakëve ndaj shëndetit të trupave”.

Kanë ardhur transmetime që qartësojnë se smira e dëmton smirakun përpara se të dëmtojë atë që i bëhet smirë. Jo vetëm kjo, smira e çon smirakun deri në vrasje dhe vdekje të ngadaltë.

3- Me të vërtetë, smira, nga ana shpirtërore, konsiderohet prej shenjave të personalitetit të dobët, nyja e së keqes, argument i injorancës dhe horizontit të ngushtë, shenjë e besimit të pakët. Smiraku, në të vërtetë, e mendon veten e vet më të dobët ose me më pak mundësi për të arritur në atë pozitë që ka arritur personi

ndaj të cilit ka smirë, ose e mendon veten e vet më lart. Për këtë, smiraku përpiket që ta ulë poshtë personin ndaj të cilit ka smirë. Me këtë veprim kundërshton urtësinë e All'llahut të Lartësuar që është Dhurues i të gjitha këtyre mirësive dhe i të gjitha dhuntive. Gjithashtu, ky veprim i smirakut bie ndesh edhe me çështjen e dhënies së All'llahut Bujar, i Cili i jep kujt të dojë prej njerëzve nga mirësitë e Tij.

Për këtë, në hadithin e imam Sadikut (Paqja qoftë mbi të!) ka ardhur: "Smira buron nga verbimi i zemrës, mohimi i mirësive të All'llahut. Të dyja këto janë dy krahë të mosbesimit (kufr). Për shkak të smirës, biri i Ademit bie në humbje të përjetshme dhe në shkatërrim që nuk shpëton kurrë prej tij."¹

Kur'ani i shenjtë na e thotë qartë se vrasja e parë që ndodhi në sipërfaqen e Tokës ishte për shkak të smirës.²

Në librin "Nexhul Belaga", imam Aliu thotë: "*Me të vërtetë, smira e djeg besimin sikurse i djeg zjarri drutë.*"³ Kjo sepse smirakut, pak e nga pak, i shtohet mendimi i keq për All'llahun dhe për urtësinë e drejtësisë së Tij. E kjo e çon smirakun që të dalë nga rruga e drejtë e besimit.

Me të vërtetë, ndikimet negative dhe dëmet materiale dhe shpirtërore të smirës si për personin, ashtu edhe për shoqërinë, janë të shumta. Kjo që ne përmendëm është vetëm një përshkrim i shpejtë i disa prej ndikimeve dhe dëmeve të smirës.

¹ *Mustedrekul Vesail*, vëll. 2, f. 327.

² Sure "El Maide", ajeti 27.

³ *Nexhul Belaga*, ligjërata 86.

Ajetet 56 - 57

إِنَّ الَّذِينَ كَفَرُوا بِآيَاتِنَا سَوْفَ نُصْلِيهِمْ نَارًا كُلَّمَا نَضِجَتْ جُلُودُهُمْ
 بَدَّلْنَاهُمْ جُلُودًا غَيْرَهَا لِيَذُوقُوا الْعَذَابَ إِنَّ اللَّهَ كَانَ عَزِيزًا حَكِيمًا
 وَالَّذِينَ ءَامَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ سَنُدْخِلُهُمْ جَنَّاتٍ تَجْرَى مِنْ
 تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا أَبَدًا هُمْ فِيهَا أَزْوَاجٌ مُطَهَّرَةٌ وَنُدْخِلُهُمْ ظِلًّا
 ظَلِيلًا

"Ata që s'besojnë në shenjat Tona, Ne padyshim, do t'i djegim në zjarr. Sapo t'u digjet lëkura, Ne do t'ua ndërrojmë atë me lëkurë tjetër, për të përjetuar dënimin. Me të vërtetë, All'lahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë."

"Sa për ata që besojnë dhe punojnë vepra të mira, Ne do t'i shpiem në kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe ku do të banojnë përgjithmonë. Ata do të kenë bashkëshorte të pastra dhe Ne do t'i shpiem në hije të dendura."

Komentimi

Pas ajeteve të mëparshme, këto dy ajete shpjegojnë të ardhmen e besimtarëve dhe të jobesimtarëve. Në ajetin e parë All'llahu i Lartësuar thotë: **"Ata që s'besojnë në shenjat Tona, Ne padyshim, do t'i djegim në zjarr. Sapo t'u digjet lëkura, Ne do t'ua ndërrojmë atë me lëkurë tjetër, për të përjetuar dënimin. Me të vërtetë, All'llahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë."**

Shkaku i ndërrimit të lëkurës, është se kur piqet lëkura, pakësohet ndenja e dhimbjes tek njeriu. Me qëllim që të mos i lehtësohet ndëshkimi dhe që të ndiejë plotësisht njeriu dhimbjen dhe ndëshkimin, ndërrohet lëkura dhe në vend të lëkurave të pjekura vijnë lëkura të reja. Ky përfundim është si rezultat i injorimit të urdhrave të All'llahut dhe i kundërshtimit të së vërtetës e të së drejtës dhe refuzim i bindjes ndaj All'llahut të Lartësuar.

Në mbyllje të ajetit, All'llahu i Lartësuar thotë: **"...Me të vërtetë, All'llahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë."** që do të thotë se All'llahu i Lartësuar me fuqinë e Tij është i Plotfuqishëm që t'i ndëshkojë gjynahqarët dhe nuk e bën këtë ndëshkim si për tallje, por bazuar tek urtësia.

Pastaj, në ajetin e dytë, All'llahu i Lartësuar vazhdon e thotë: **"Sa për ata që besojnë dhe punojnë vepra të mira, Ne do t'i shpiem në kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe ku do**

të banojnë përgjithmonë. Ata do të kenë bashkëshorte të pastra dhe Ne do t'i shpiem në hije të dendura."

Kjo do të thotë se Ne u kemi premtuar atyre që bëjnë vepra të mira, se do t'i fusim në Xhennetin nën të cilin rrjedhin lumenj, që do të pinë nga ai ujë dhe jetojnë përgjithmonë në të. Në shtesë të kësaj, atyre do t'u jepen bashkëshorte të pastra në prehrin e të cilave do të gjejnë kënaqësinë shpirtërore dhe trupore. Ata do të mirësohen me hije të përjetshme në vend të hijes kalimtare dhe ata nuk i shqetësojnë erërat përvëluse dhe as i ftohti i rreptë.

Hulumtime

Nga çështjet që u duhet dhënë përkushtim dhe që janë të dobishme, në krahasimin mes këtyre dy ajeteve, është gjithë përfshirja e mëshirës së All'llahut dhe përparësia e mëshirës së Tij mbi zemërimin e Tij. Kjo sepse në ajetin e parë përmendet ndëshkimi i jobesimtarëve që fillon me fjalën "seufe" që do të thotë "do t'i". Ndërkohë që premtimi i All'llahut për besimtarët fillon me germën "sijn"- "*senudkhiluhum*", do t'i fusim ata. Në gjuhën arabe është e njohur se fjala "seufe" përdoret për të ardhmen e largët. Kurse germa "sijn" përdoret për të ardhmen e afërt. Ndërkohë shohim se këto dy ajete kanë lidhje në Botën Tjetër dhe shpërblimi i besimtarëve dhe ndëshkimi i jobesimtarëve në atë botë, për nga ana e distancës kohore për ne është e përbashkët.

Atëherë ndryshimi ndërmjet dy konteksteve tregon për shpejtësinë dhe hapësirën e gjerë të mëshirës së All'llahut dhe limitimin e zemërimit të Tij. Kjo i përngjan po të njëjtës shprehje,

të cilën ne e përsërisim kur bëjmë lutje: *"O Ti, mëshira e të Cilit paraprin zemërimin e Tij."*¹

Pyetje: Ka mundësi që një kundërshtar të kundërshtojë duke thënë se ajeti në fjalë thotë: Ne, sa herë që të digjen lëkurat e gjynahqarëve jobesimtarë ua ndërrojmë me lëkura të tjera që të shijojnë ndëshkimin. Ku ndërkohë që lëkurat e gjynahqarëve janë lëkurat origjinale dhe ndëshkimi i lëkurave të reja është në kundërshtim në drejtësinë e All'llahut.

Përgjigje: Të njëjtën pyetje e ka bërë më përpara ibn Ebu Auxha, një burrë i njohur materialist. Një ditë, imam Sadiku e lexoi këtë ajet në prani të këtij burri. Kur mbaroi, ibn Ebu Auxha, i tha: *"Cili është mëkati i tjetrit?"*, pra, cili është mëkati i lëkurave të reja? Imami iu përgjigj shkurtimisht dhe me kuptim të thellë: *"Ajo është ajo dhe ajo është tjetra."* Që do të thotë se lëkurat e reja janë po të njëjtat lëkura të mëparshme ku ndërkohë janë të tjera.

Ibn Ebi Auxha, i cili e dinte se kjo frazë e shkurtër ka një të fshehtë i tha: *"Ma shembëllo këtë me diçka nga kjo jetë."* Imami i tha: *"A e ke parë kur një person thyen enën prej balte dhe e çon te ndreqësi i saj dhe e kthen atë në gjendjen e saj të më parshme e mbetet po ajo."*²

Nga këto transmetime përfitohet dhe kuptohet se lëkurat e reja përbëhen nga të njëjtat elemente të lëkurave të vjetra. Që do të thotë se elementët janë po ato edhe pse ndryshon forma.

Duhet patur parasysh se shpërblimi dhe ndëshkimi në realitet janë të lidhur me shpirtin e njeriut dhe forcën e tij perceptuese dhe trupi është gjithmonë mjet për të përcjellë shpërblimin dhe ndëshkimin në shpirtin e njeriut.

¹ *Biharul Anwar*, vëll. 87, f. 158.

² *Mexhalis* i Shejkh Et Tusijj. *El Ihtixbach* i Et Tabrasijj, vëll. 2, f. 354.

Ajeti 58

﴿ إِنَّ اللَّهَ يَأْمُرُكُمْ أَنْ تُؤَدُّوا الْأَمَانَاتِ إِلَىٰ أَهْلِهَا وَإِذَا حَكَمْتُمْ بَيْنَ

النَّاسِ أَنْ تَحْكُمُوا بِالْعَدْلِ ۚ إِنَّ اللَّهَ نِعِمَّا يَعِظُكُمْ بِهِ ۚ إِنَّ اللَّهَ كَانَ سَمِيعًا

بَصِيرًا ﴿٥٨﴾

"All'illahu ju urdhëron që amanetet t'ua ktheni atyre që u përkasin dhe, kur të gjykoni midis njerëzve, të gjykoni drejtë. Vërtet, All'illahu ju këshillon mrekullueshëm dhe vërtet, All'illahu dëgjon çdo gjë dhe vështrohet të gjitha punët."

Shkaku i zbritjes

Transmetohet në tefsirin "Mexhmaul Bejjan" dhe në tefsiret e tjera islame se ky ajet ka zbritur kur i Dërguari i All'illahut hyri në Mekën e ndershme triumfues dhe çlirues. Profeti e ftoi të vinte Othman ibn Talha, kujdestarin e Qabes, për t'i kërkuar çelësat e Qabes së madhërishtme që ta pastronte nga idhujt dhe putat që ishin të vendosura në të. Kur Profeti (Paqja dhe bekimet e All'illahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) përfundoi pastrimin, Abasi i kërkoj atij çelësat që të bashkonte detyrën e kujdestarisë dhe të dhënies ujë. Këto dy detyra ishin të nderuara e të lavdishme tek arabët. Mesa duket, Abasi, në këtë rast, ka

dashur të përfitonte nga pozicionin shoqëror dhe politik i djalit të vëllait për interesat e tij personale. Mirëpo Profeti (Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) veprimi të kundërtën. Ai, pasi e pastroi Qaben nga idhujt dhe putat, urdhëroi Aliun që t'ia kthente çelësat Othman ibn Talhas. Ai e bëri këtë dhe lexoi ajetin: **"All'Ilahu ju urdhëron që amanetet t'ua ktheni atyre që u përkasin"**.¹

Komentimi

Dy rregulla të rëndësishme islame

Ajeti në fjalë, si shumë prej ajeteve, edhe pse ka zbritur për diçka të veçantë, porse ai në të vërtetë përmban një rregull të përgjithshëm për të gjithë, thotë qartë: **"All'Ilahu ju urdhëron që amanetet t'ua ktheni atyre që u përkasin..."**

Është mëse e qartë se fjala *amanet* ka një kuptim të gjerë që përfshin çdo gjë, qoftë materiale apo shpirtërore. Është detyrim për çdo mysliman, sipas thënies së qartë të këtij ajeti, që të mos tradhëtojë askënd në çdo amanet pa përjashtim, sido që të jetë personi i amanetit mysliman apo jo mysliman. Në të vërtetë, ky është nen në "Konventën e Islamit për të drejtat e njeriut", tek e cila, të gjithë njerëzit janë të barabartë.

¹ *Mexhmaul Bejjan*, vëll. 3, f. 682.

Është e vlefshme të përmendet se amaneti i përmendur në shkakun e zbritjes nuk është vetëm amanet material. Nga ana tjetër, i zoti i atij amaneti që iu kthye (Othmani), ka qenë politeist.

Pastaj, All'llahu i Lartësuar, në pjesën e dytë të ajetit flet për një rregull tjetër të rëndësishëm që është çështja e drejtësisë në gjykim. All'llahu i Lartësuar thotë: **"...dhe, kur të gjykoni midis njerëzve, të gjykoni drejt..."**, që do të thotë se All'llahu iu këshillon se duhet të zbatoni drejtësinë kur të gjykoni ndërmjet njerëzve dhe të gjykoni me drejtësi.

Pastaj, All'llahu i Lartësuar, si përforcim të këtyre dy mësimëve, thotë: **"...Vërtet, All'llahu ju këshillon mrekullueshëm..."** Gjithashtu për ta përfocuar këtë, All'llahu i Lartësuar thotë: **"... dhe vërtet, All'llahu dëgjon çdo gjë dhe vështron të gjitha punët."** All'llahu është Ai, i Cili mbikëqyr punët tuaja, dëgjon bisedat tuaj dhe shikon veprat tuaja.

Ky është një tjetër rregull i përgjithshëm që përfshin të gjitha llojet e gjykimit dhe të qeverisjes, çështje të vogla qofshin apo të mëdha. Ne lexojmë në hadithet islame se dy fëmijë shkruan diçka dhe e çuan çështjen e tyre tek imam Hasan ibn Ali për të gjykuar se cili ishte shkrimi më i mirë. Aliu (Paqja qoftë mbi të!) e pa Hasanin dhe i tha: *"O biri im. Shiko si do të gjykosh, sepse All'llahu do të pyesë ty për atë gjykim në Ditën e Kiametit"*¹

Me të vërtetë, këto dy rregulla të rëndësishme - ruajtja e amanetit dhe drejtësia në gjykim dhe udhëheqje - përbëjnë një rregull të fortë e të drejtë në shoqërinë njerëzore. Nuk drejtohen

¹ Tefsiri *Mexhmanul Bejjan*, vëll. 3, f. 64. Tefsiri *Rubul Xhinan*, vëll. 5, f. 63.

çështjet materiale a shpirtërore të shoqërisë, nëse nuk zbatohen këto dy parime.

Parimi i parë thotë se pasuria, pushteti, përgjegjësitë dhe kapitalet njerëzore, kulturat dhe historitë e ndryshme, të gjitha këto janë amanete të All'llahut që i ka dorëzuar në duart e disa personave të ndryshëm në shoqëri. Të gjithë janë të detyruar që t'i ruajnë këto amanete dhe të përpiqen për t'i kthyer e dorëzuar ato tek i zoti dhe të mos i tradhëtojnë asnjëherë. Nga ana tjetër, meqenëse shoqëritë kanë mosmarrëveshje në interesa dhe në dobi mes tyre, për këtë kërkohet zgjidhje nga udhëheqja e drejtë dhe gjykim i drejtë derisa të eliminohen të gjitha llojet e ndasive të padrejta nga jeta shoqërore.

Sikurse e thamë edhe më lart, amaneti nuk kufizohet vetëm në pasurinë që njerëzit e lenë tek njëri-tjetri, por edhe dijetarët në shoqëri gjithashtu janë mbartës të amanetit. Është detyrim i tyre që të mos i fshehin të vërtetat. Edhe fëmijët janë amanet i Zotit të prindërit. Ata nuk duhet të neglizhojnë në edukimin dhe në mësimin e tyre. Nëse e bëjnë këtë, kanë tradhëtuar amanetin e All'llahut, i Cili i ka urdhëruar ata që ta kryejnë. Jo vetëm kaq, por e gjithë ekzistenca e njeriut dhe të gjitha fuqitë e vendosura në të janë amanete nga All'llahu, të cilat njeriu duhet të përpiqet t'i ruajë ato sikurse është detyrim që të ruaj shëndetin e trupit të tij dhe pastërtinë e shpirtit të tij. Të ruajë energjitë dhe fuqitë e rinisë shpërthyesë dhe mendimet e tij. Për këtë, njeriut nuk i lejohet të vrasë veten, apo ta dëmtojë atë. Në disa hadithe dhe tekste islame përfitohet se dijet e imamatit dhe të fshehtat e tij, të cilat çdo imam ia dorëzon imamit tjetër që vjen pas tij, përfshihet në këtë ajet.¹

¹ *Nurul Thekalejja*, vëll. 1, f. 495-496.

Është mëse e vlefshme që të përmendet se çështja e përçarjes së amanetit në këtë ajet është përmendur para çështjes së drejtësisë. Ndoshta kjo është për shkak se në çështjen e drejtësisë në gjykim dhe në udhëheqje ndodhin gjithmonë tradhti, sepse në origjinë njerëzit janë besnikë ndaj amanetit. Nëse një person ose disa persona devijojnë nga kjo origjinë, atëherë rolin e ka drejtësia për t'u mësuar atyre detyrat dhe përgjegjësitë e tyre.

Hulumtime

Rëndësia e amanetit dhe drejtësia në Islam

Për këtë çështje ka dëshmi dhe vërtetësi të madhe e të pashoqe në burimet islame. Të shumta janë transmetime rreth saj. Hadithet e mëposhtme sqarojnë vërtetësinë e kësaj çështjeje:

1- Transmetohet nga imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) se ka thënë: *"Mos shikoni në ndejtjen gjatë në ruku e në sexhde të një njeriu, sepse ajo gjë i është bërë zakon dhe nëse e lë, ndihet i vetmuar, por shikoni vërtetësinë e fjalës së tij dhe të kryerjes së amanetit."*¹

2- Ka ardhur në një hadith tjetër nga imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) se ai ka thënë: *"Me të vërtetë, Aliu e arriti atë pozitë tek i Dërguari i All'llahut me fjalën e vërtetë dhe kryerjen e amanetit."*²

3- Në një hadith nga imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!), i cili i ka thënë njërit prej shokëve të tij, thuhet: *"Dijeni se, sikur goditësi i Aliut me shpatë dhe vrasësi i tij do të linte tek unë amanet dhe do të këshillohej me mua dhe unë t'ia pranoja, unë do t'ia ktheja atij amanetin."*³

¹ Nurul Thekalejjn, vëll. 1 f. 495-496.

² Nurul Thekalejjn, vëll. 1, f. 495-496.

³ Nurul Thekalejjn, vëll. 1, f. 495-496.

4- Në transmetimet e transmetuara nga burimet e shijave dhe të synive nga Profeti (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) lexojnë këtë hadith brilant që thotë: *"Cilësitë e dyfytyrëshit janë tre: kur flet, gënjen; kur premtan, e thyen premtimin dhe nëse i besohet, tradhëton."*¹

5- I Dërguari i All'llahut i ka thënë imam Aliut: *"Bëj drejtësi ndërmjet dy personave kundërshtarë me vështirimin tënd dhe me fjalën tënde."*²

¹ *Sunen Tirmidhij*, vëll. 4, f. 130. *Sunen Nisaijij*, vëll. 6, f. 329.

² *Tefsiri Mexhmaul Bejjan*, vëll. 3, f. 64.

Ajeti 59

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا أَطِيعُوا اللَّهَ وَأَطِيعُوا الرَّسُولَ وَأُولَى الْأَمْرِ مِنْكُمْ فَإِن تَنَزَعْتُمْ فِي شَيْءٍ فَرُدُّوهُ إِلَى اللَّهِ وَالرَّسُولِ إِن كُنتُمْ تُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ
 الْآخِرِ ۚ ذَٰلِكَ خَيْرٌ وَأَحْسَنُ تَأْوِيلًا ﴿٥٩﴾

"O ju që keni besuar! Bindjuni All'llahut, bindjuni të Dërguarit dhe atyre që drejtojnë punët tuaja. Nëse nuk pajtoheni në ndonjë gjë, drejtojuni All'llahut dhe të Dërguarit, nëse besoni All'llahun dhe Ditën e Kiametit. Kjo për ju është më e mira dhe shpjegimi më i bukur."

Komentimi

Ky ajet dhe disa ajete që vijnë më pas, hulumtojnë për një nga çështjet më të rëndësishme islame që është çështja e udhëheqjes dhe caktimi i udhëheqësve dhe i konsultuesve të vërtetë për myslimanët në çështje të ndryshme fetare dhe shoqërore.

Së pari: Ajeti i urdhëron besimtarët që t'i binden All'llahut të Lartësuar. Duhet që të gjitha bindjet e besimtarit të përfundojnë tek bindja e All'llahut të Madhëruar. Dhe, çdo udhëheqje dhe

kujdestari duhet të burojë nga kujdestaria dhe udhëheqja e All'Ilahut dhe nga vetë Veta e Tij e Shenjtë dhe të jetë kjo udhëheqje dhe kujdestari sipas vullnetit dhe dëshirës së All'Ilahut, sepse Ai është Udhëheqësi dhe Sunduesi i gjithësisë dhe çdo udhëheqje dhe sundim duhet të jetë me lejen dhe urdhrin e Tij: **"O ju që keni besuar! Bindjuni All'Ilahut..."**

Së dyti: Ajeti urdhëron për ndjekjen e të Dërguarit (Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe për bindje ndaj tij. Ai është Profeti i pamëkat (ma'sum), i cili nuk flet prej vetes së Tij dhe nuk lëviz me anë të uni-t. Ai është Profeti, i cili është mëkëmbësi i All'Ilahut në mesin e njerëzve. Fjala e tij është fjala e All'Ilahut. Atij i është dhënë kjo pozitë nga ana e All'Ilahut të Lartësuar. Për këtë, bindja ndaj All'Ilahut është sipas Krijimit dhe udhëheqësisë së Vetës së Shenjtë. Kurse bindja ndaj Profetit dhe zbatimi i urdhrave të tij burojnë nga urdhri i All'Ilahut. Ndoshta edhe përsëritja e fjalës "etiuu" (bindjuni), në këtë ajet tregon këtë ndryshim mes dy bindjeve ku All'Ilahu i Lartësuar thotë **"...bindjuni të Dërguarit..."**

Së treti: All'Ilahu i Lartësuar urdhëron për bindje ndaj "ulul emri", atyre që drejojnë çështjet e myslimanëve nga mesi i shoqërisë islame, të cilët u ruajnë njerëzve çështjet e fesë dhe të dynjasë së tyre. All'Ilahu i Lartësuar thotë: **"...dhe atyre që drejojnë punët tuaja..."**

Kërkim

A - Kush janë udhëheqësit "*ulul emri*"?

Ka shumë thënie mes komentuesve për kuptimin e frazës "*ulul emri*" që gjendet në këtë ajet. Mendimet rreth kësaj mund të përmbliidhen siç vijon:

1 - Një grup komentuesisht të Ehli Synetit kanë thënë se "*ulul emri*" në këtë ajet janë prijësit dhe udhëheqësit në çdo kohë e në çdo vend dhe nuk kanë veçuar asnjë prej tyre.¹ Atëherë, rezultati i këtij mendimi është se të gjithë myslimanët e kanë detyrim që t'i binden çdo qeverisjeje dhe udhëheqjeje, sido që të jetë struktura e saj, edhe nëse është qeverisja e Mongolëve dhe shteti i tyre i padrejtë.

2 - Disa komentues të tjerë, si për shembull, autori i tefsirit "*El Menar*" dhe autori i tefsirit "*Fi Dhilalil Kur'an*" e të tjerë kanë thënë se "*ulul emri*" janë përfaqësuesit e të gjitha shtresave të popullit nga udhëheqësit, drejtuesit dhe dijetarët dhe ata që kanë pozicione në të gjitha fushat e ndryshme të jetës së njerëzve. Mirëpo nuk është detyrim bindja absolute e tyre pa asnjë kusht a kriter, por ajo bindje është e kushtëzuar që të mos jetë në kundërshtim me rregullat dhe procedurat islame.

3 - Një grup tjetër komentuesish kanë thënë se "*ulul emri*" janë udhëheqësit shpirtërorë dhe mendimtarë, pra dijetarët dhe

¹ Tefsiri Durrul Menthur, vëll. 2, f. 572, fundi i ajetit në fjalë.

arsyetuesit e drejtë dhe të ditur plotësisht për përmbajtjen e Kur'anit dhe të Syneetit.¹

4 - Kanë thënë disa komentues të Ehli Syneetit se qëllimi me këtë fjalë është vetëm për katër kalifat e drejtë,² të cilët patën postin e kalifatit pas Profetit dhe nuk përfshin tjetër kënd. Duke u bazuar mbi këtë, "ulul emri" nuk kanë prani në kohët e tjera.

5- Disa komentues e komentojnë frazën "ulul emri" me shokët e Profetit (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!).³

6 - Ka një supozim tjetër, se qëllimi me këtë fjalë është për udhëheqësit ushtarak myslimanë dhe prijësit e ushtrisë dhe grupimeve.⁴

7 - Të gjithë komentuesit shiitë kanë rënë dakort se "ulul emri" janë imamët e ruajtur nga gjynahet⁵, të cilëve u është dhënë udhëheqja materiale dhe shpirtërore e ymetit islam nga ana e All'llahut të Lartësuar dhe Profetit (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) në të gjitha sferat e jetës dhe nuk përfshin tjetër kënd përveç tyre me përjashtim të atij që emërohet nga ana e tyre dhe merr në dorë administrimin islam të shoqërisë islame nga ana e tyre. Duhet gjithashtu t'i bindeni nëse i plotëson kushtet e caktuara dhe nuk lejohet t'i bindeni se është thjesht *ulul emri*, por se është zëvendësi dhe sipërmarrësi nga ana e tyre.

¹ Tefsiri *Durrul Mentbur*, vëll. 2, f. 572, fundi i ajetit në fjalë.

² Tefsiri *Durrul Mentbur*, vëll. 2, f. 572, fundi i ajetit në fjalë.

³ Tefsiri *Durrul Mentbur*, vëll. 2, f. 572, fundi i ajetit në fjalë.

⁴ Tefsiri *Durrul Mentbur*, vëll. 2, f. 572, fundi i ajetit në fjalë.

⁵ *Usulul Kafij*, vëll., 1, f. 187 dhe 189.

Dhe tani paraqesim në formë të përmbledhur komentimet (tefsiret) e lartpërmendura:

Nuk ka dyshim se komentimi i parë nuk përshtatet me kuptimin e ajetit dhe me shpirtin e mësimave islame. Sepse nuk është e mundur që bindja e pakushtëzuar ndaj çdo qeverie, si do që të jetë natyra e saj, të krahasohet me bindjen e All'llahut dhe të Profetit. Për këtë, dijetarët e mëdhenj të Ehli Synetit, po ashtu edhe dijetarët shiitë, janë përballur për të mohuar këtë mendim dhe komentim.

Po ashtu edhe komentimi i dytë. Ai nuk përputhet me përgjithësinë e ajetit sepse ajeti e detyron bindjen ndaj udhëheqësit pa asnjë kusht apo limit.

Gjithashtu, edhe komentimi i tretë që thotë se "ulul emri" janë dijetarët e drejtë dhe të njohur mirë me Kur'anin dhe Synetin, nuk përputhet me përgjithësinë e ajetit, sepse bindja dhe ndjekja e dijetarëve janë të kushtëzuara dhe prej atyre kushteve është që thëniet e tyre të mos jenë një kundërshtim me Kur'anin dhe Synetin. Bazuar mbi këtë, nëse dijetarët gabojnë ose devijojnë nga rruga e drejtë, për shkak se ata nuk janë të ruajtur nga gjynahet, atëherë nuk është detyrim bindja ndaj tyre. Ajeti e detyron në formë të pakufizuar bindjen ndaj "ulul emri" njësoj si bindja ndaj Profetit (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Bindja ndaj dijetarëve, me të vërtetë, është në rregullat të cilat i përfitojnë nga Kur'ani dhe Syneti. Në këtë mënyrë, bindja ndaj këtyre nuk është tjetër përveçse bindje ndaj All'llahut dhe ndaj të Dërguarit të Tij.

Ndërsa komentimi i katërt (përkufizimi i "ulul emri" në katër kalifat e parë), çon në mospraninë e "ulul emri" në mesin e

myslimanëve në atë kohë dhe në mospraninë e argumentit për këtë veçim.

Komentimi i pestë dhe i gjashtë që përveçojnë këtë temë me udhëheqjen e sahabëve dhe të udhëheqësve ushtarakë të mysli-manëve, kanë të njëjtin problem si komentimi i katërt, që do të thotë se nuk ka asnjë argument gjithashtu për këtë veçim.

Një grup komentuesish syni, si dijetari i shquar Egjiptian Muhammed Abdo, duke ndjekur atë çfarë ka thënë komentuesi i njohur Fahredin Razi, kanë dashur të pranojnë supozimin e dytë që thotë se "ulul emri" janë përfaqësuesit e shtresave dhe grupeve të ndryshme të shoqërisë islame prej dijetarëve dhe udhëheqësve të kushtëzuar me disa kushte, si për shembull të jetë mysli-man (sikurse përfitohet nga fjala "prej jush" në ajet), gjykimi i tyre të mos jetë në kundërshtim me Kur'anin dhe Synetin, të udhëheqin me liri e zgjedhje dhe jo me dhunë, të udhëheqin sipas interesave të mysli-manëve etj.

Meqenëse ata mendojnë se i gjithë ymeti dhe të gjithë përfaqësuesit e tij nuk gabojnë dhe nuk bashkohen në gabim, ose thënë ndryshe, i gjithë ymeti është i ruajtur nga gjynahet dhe gabimet (ma'sum), ose ymeti me cilësinë e tij është i ruajtur, atëherë rezultati i këtyre kushteve është detyrimi i bindjes së kësaj udhëheqjeje në formë të plotë pa kusht, sikurse bindja ndaj Profetit (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Por ky komentim ka disa kundërshtime dhe probleme:

Së pari: Konsensusi në çështjet shoqërore rrallë miratohet dhe rrallë realizohet. Bazuar në këtë, ky mendim detyron gjendje

konsesusi në shumicën e çështjeve të myslimanëve në formë të përhershme.

Nëse ata dëshirojnë të pranojnë mendimin e shumicës, atyre u thuhet sepse shumica nuk janë kurrë të ruajtur nga mëkatet. Për këtë nuk është detyrim bindja e pakufizuar ndaj tyre.

Së dyti: Në shkencën e bazave të fesë është konstatuar se nuk gjendet argument rreth të qenit të gjithë ymetit i ruajtur (ma'sum) nga gjynahet pa praninë e imamet të ruajtur në mesin tyre.

Së treti: Një ndër kushtet që përmendin përkrahësit e këtij komentimi është që udhëheqja e "ulul emri" të mos jetë në kundërshtim me Kur'anin dhe Synetin. Atëherë është detyrim që të shohim se kush është ai që e përcakton se ky rregull apo gjykim është në kundërshtim me Kur'anin dhe Synetin apo jo?

Nuk ka dyshim se kjo është përgjegjësi e juristëve dhe e dijetarëve që janë të ditur me njohuritë e Kur'anit dhe të Synetit. Kjo do të thotë se bindja e udhëheqësve nuk lejohet pa miratimin e dijetarëve (muxhtehidëve) dhe është detyrim që bindja ndaj dijetarëve të jetë më e madhe se bindja ndaj udhëheqësve. Dhe kjo nuk është në përputhje me aparencën e ajetit të begatë.

Është e qartë se ata i kanë konsideruar dijetarët pjesë nga udhëheqësit por, në të vërtetë, sipas këtij komentimi, dijetarët dhe muxhtehidët janë mbikëqyrësit dhe konsultuesit e lartë nga pjesa e përfaqësuesve të ndryshëm të ymetit dhe nuk janë në të njëjtin nivel me përfaqësuesit e ymetit. Kjo sepse është detyrë e dijetarëve dhe e juristëve që të kontrollojnë veprat e të tjerëve dhe të

përcaktojnë përputhshmërinë e atyre veprave sipas Kur'anit dhe Syneetit. Për këtë, dijetarët janë konsultuesit e lartë të tyre. Dhe kjo nuk i përshtatet komentimit të mësipërm dhe nuk është në përputhje me të.

Duke u bazuar mbi këtë, komentimi i dytë përballet me disa probleme dhe kritika.

Atëherë, mbetet një komentim i vetëm dhe i zbrazët nga të gjitha kundërshtimet e mëparshme dhe ai është komentimi i shtatë, komentimi i "ulul emri" me imamët e ruajtur nga gjynahet (ma'sumune) për shkak të përputhshmërisë së këtij komentimi me domosdoshmërinë e bindjes së përfituar nga ky ajet. Kjo sepse pozita e "el ismetu" (të ruajturit nga gjynahet) e ruan imamin dhe e mbron atë nga çdo gjynah dhe gabim. Në këtë mënyrë, është detyrim bindja ndaj urdhrit të tij (imamit) është sikurse urdhrit të Dërguarit, pa kusht dhe limit dhe është detyrim që të vendoset në një pozitë me bindjen e të Dërguarit (Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Po të shihet me vëmendje ajeti, do të shohim se fjala "etiiu" (bindjuni), nuk përsëritet para fjalës "ulul emri".

Është e vlefshme që të përmendet se disa komentues të njohur të Ehli Syneetit, prej tyre komentuesi i njohur Fahrudin Razi, e ka pranuar këtë të vërtetë në fillim të thënieve të tij në komentimin e këtij ajeti, ku ka thënë: *"Me të vërtetë, All'llahu i Lartësuar ka urdhëruar në mënyrë të prerë në këtë ajet që t'u bindemi udhëheqësve. Ai për të cilin All'llahu urdhëron për bindje nda tij, duhet të jetë i ruajtur nga gjynahet..."*¹

¹ Tefsiri Kebijjr, vëllimi 10, faqe 144.

Kështu shohim që Fahrudin Raziu, me gjithë problemet e shumta që ka në çështje të ndryshme shkencore, ai e ka pranuar këtë argument se udhëheqësit duhet të jenë të ruajtur nga gjynahet (ma'sumun). Ajo që është më e rëndësishmja është se ai nuk ka qenë i njohur me medh'hebin e Ehlul Bejtit të familjes së Profetit dhe imamët e këtij medh'hebi dhe e anashkaloi supozimin që "ulul emri" të jenë persona të caktuar nga ymeti. Për këtë, është detyruar ta komentojë "ulul emri" me kuptimin e të gjithë ymetit, ose me kuptimin e përfaqësuesve në përgjithësi të grupeve të ymetit. Ndërkohë, ky supozim nuk mund të pranohet nga ai, sepse udhëheqësit, sikurse e thamë më lart, duhet që të jenë prijësit e shoqërisë islame dhe formimi i shtetit Islam dhe udhëheqja e myslimanëve të arrihet me ta. Ne dimë se nuk është e mundur as në qeverisjen e përgjithshme (e përbërë nga i gjithë ymeti) dhe as te përfaqësuesit e grupeve të saj, që të realizohet unifikim dhe konsensus absolut në mendim, sepse arritja e konsensusit nga ana e ymetit ose nga ana e përfaqësuesve të saj në çështje të ndryshme shoqërore, politike, kulturore, morale dhe ekonomike nuk është e lehtë dhe në përgjithësi nuk realizohet. Gjithashtu, ndjekja e shumicës nuk konsiderohet si ndjekje e "ulul emri". Kështu që fjalët e Razit dhe ata që ndjekin atë prej dijetarëve bashkëkohorë, detyrojnë që të mosfunksionojë çështja e bindjes ndaj udhëheqësit (ulul emri) ose të bëhet çështje shumë e rrallë dhe shumë e veçantë.

Nga të gjitha ato që thamë, rezulton se ky ajet vërtetohet dhe përforcon argumentin e udhëheqjes së imamëve të ruajtur nga gjynahet, të cilët përfaqësojnë më të mirët e ymetit islam.

B- Përgjigje e pyetjeve

Ka kundërshtime dhe kritika mbi komentimin e shtatë, të cilat, është e vlefshme të parashtrohen.

1- Nëse është qëllimi me “që drejtojnë punët tuaja” (ulul emri) imamët e ruajtur nga gjynahet, kjo nuk përshtatet me fjalën "uulij", e cila është në numrin shumës sepse imami i ruajtur në çdo kohë është vetëm një person dhe jo më shumë.

Përgjigja e kësaj pyetjeje: Imami i ruajtur (ma'sum), edhe pse është një person i vetëm në çdo kohë, sërish imamët e shumtë në kohë të ndryshme formojnë një grup. Ne e dimë se ajeti nuk na përcakton punën e njerëzve në një kohë të vetme.

2- Me të vërtetë, udhëheqësit (ulul emri) me këtë kuptim nuk kanë qenë në kohën e Profetit (Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Atëherë, si na urdhëron Kur'ani për bindje ndaj tyre?

Me të vërtetë, përgjigja e kësaj pyetjeje qartësohet nga fjalët e mësipërme, sepse ajeti nuk kufizon (apo nuk ka kuptimin) një kohë të veçantë, por qartëson punën e myslimanëve dhe detyrat e tyre në të gjitha kohërat. Thënë ndryshe: Mund të themi se udhëheqësit (ulul emri) në kohën e Profetit ka qenë vetë Profeti, sepse ai ka patur dy pozita: pozitën e të dërguarit, e cila përmendet në këtë ajet, ku All'Ilahu i Lartësuar thotë: “...dhe bindjuni të Dërguarit” dhe pozitën e udhëheqjes së ymetit islam, të cilën e ka shprehur Kur'ani, ku thotë: “...dhe atyre që drejtojnë punët tuaja” (ulul emri).

Bazuar në këtë, udhëheqësi dhe *ulul emri* i ruajtur në kohën e Profetit ka qenë vetë Profeti, sepse në shtesë të pozitës së tij si i dërguar si përcjellës i rregullave dhe çështjeve islame, ai ka patur edhe pozitën e udhëheqjes së ymetit edhe drejtimin e çështjeve të tyre. Ndoshta edhe mospërsëritja e shprehjes " dhe bindjuni" ndërmjet të Dërguarit dhe "ulul emri" mund të tregojë për këtë që thamë.

Pozita e të Dërguarit dhe pozita e udhëheqjes janë dy pozita përbashkuar në personalitetin e të Dërguarit të All'llahut, por pozita e dytë përmbushet tek çdo imam dhe për imamin është vetëm pozita e udhëheqjes.

3- Nëse është qëllimi me fjalën "...dhe atyre që drejtojnë punët tuaja" (*ulul emri*) se ata janë imamët e ruajtur, përse All'llahu i Lartësuar në vazhdim të këtij ajeti tregon për çështjen e divergjencës dhe të mospajtimit ndërmjet myslimanëve, ku thotë: **"Nëse nuk pajtoheni në ndonjë gjë, drejtojuni All'llahut dhe të Dërguarit, nëse besoni All'llahun dhe Ditën e Kiametit. Kjo për ju është më e mira dhe shpjegimi më i bukur."**? Ne këtu nuk shikojmë asnjë thënie për "që drejtojnë punët tuaja" (*ulul emri*), por ka përmendur Librin e Tij (Kur'anin) dhe Profetin (Synetin) si burim ku myslimanët duhet të kthehen në rast mospajtimi dhe divergjence.

Në përgjigjen e këtij paradoksi duhet të themi:

E para: Me të vërtetë, ky paradoks nuk është i posaçëm vetëm për komentimin shiit të këtij ajeti, por ky paradoks, gjithashtu, gjendet edhe tek komentimet e tjera, nëse ne meditojmë pak më thellë.

E dyta: Nuk ka dyshim se mospajtimi dhe divergjenca që gjenden në shprehjen e këtij ajeti është mospajtimi dhe divergjenca në rregulla e procedura dhe jo për çështjet që kanë lidhje me pjesët e qeverisë dhe të udhëheqjes islame, sepse në këtë çështje është detyrim që t'u bindemi udhëheqësve (ulul emri), siç thuhet qartë në fjalinë e parë të ajetit në fjalë.

Duke u bazuar mbi këtë, qëllimi me mospajtim është për mospajtimin në procedurat dhe rregullat e përgjithshme islame, legjimitetit i të cilave kthehet tek All'llahu dhe i Dërguari i Tij, sepse ne e dimë që imami është vetëm zbatues i këtyre rregullave të Zotit dhe nuk është as vënës rregullash dhe as abrogues i këtyre rregullave, por është detyrë e imamit është që t'i zbatojë ato rregulla të All'llahut dhe të Dërguarit të Tij në jetën e ymetit. Për këtë ka ardhur në hadithet e Ehli Bejtit se ata kanë thënë: *"Nëse ju vjen një lajm nga ne që e kundërshton Librin e All'llahut dhe Synetin e Profetit të Tij, hidheni pas shpine dhe mos e pranoni atë."* pra, është e pamundur që ne të themi atë çfarë kundërshton Librin e All'llahut dhe Synetin e Profetit të Tij.

Kështu që burimi i parë ku duhet të kthehen myslimanët për t'i zgjidhur mospajtimet e tyre në rregullat islame është All'llahu i Lartësuar dhe Profeti i Tij, të cilit i është shpallur Libri. Kur imamët e ruajtur sqarojnë rregulla, me të vërtetë, ato rregulla nuk janë veçse të shkëputura nga Libri i All'llahut ose janë prej dijeve që kanë arritur tek ata nga Profeti i nderuar (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Me këtë qartësohet shkaku i mospërmendjes së udhëheqësit (ulul

emri) në anën e burimit të zgjidhjes së mospajtimeve në rregullave të përmendura në këtë pjesë të këtij ajeti.¹

C- Dëshmia e haditheve

Janë transmetuar hadithe në burimet islame që e përforcojnë se komentimi **“...dhe atyre që drejtojnë punët tuaja”** (ulul emri) janë imamët e Ehli Bejtit (Paqja qoftë mbi ta!).

1- Komentuesi i njohur islam Ebu Hajan El Endulisij El Magribij (që ka vdekur në vitin 756) në Tefsirin e tij "Bahrul Muhijt" ka shkruar se ky ajet është zbritur për Aliun (Paqja qoftë mbi të!) dhe për Ehli Bejtin e tij.²

2- Dijetari i njohur synit, Ebu Beker ibn Mu'min Esh Shijrazij, në librin e tij "Risaletul Itihad" (sipas transmetimit të El Kashij në El Menakib), transmeton nga ibn Abasi se ajeti në fjalë ka zbritur për Aliun, kur atë e la i Dërguari i All'llahut zëvendës në Medine (në luftën e Tebukut) dhe Aliu i tha: *"O i Dërguari i All'llahut, a po më lë mua me gratë dhe fëmijët?"* I Dërguari i All'llahut i tha: *"A nuk dëshiron të jesh tek unë në gradën (pozitën) e Harunit tek Musai kur i tha: Ji zëvendësi im në popullin tim dhe ndreqi ata?"* All'llahu i Lartësuar thotë: **“...dhe atyre që drejtojnë punët tuaja.”**³

¹ Kur shohim se All'llahu i Madhëruar në ajetin 83 të kësaj sureje e kthen ymetin për zgjidhjen e disa mospajtimeve të tij tek ulil emri, qëllimi i këtij mospajtimi nuk është për mospajtimin në rregullat dhe ligjet e përgjithshme islame, por, ashtu siç do ta mësojmë në komentimin e këtij ajeti, bëhet fjalë për mospajtimin në çështjet që kanë lidhje me mënyrën e zbatimit të rregullave islame. Në komentimin e ajetit 83 do të vijmë edhe shpjegimet e detajuara me ndihmën e All'llahut.

² Tefsiri *Bahrul Muhijt*, vëll. 3, f. 425.

³ Ihkakul Hak, vëll. 3, f. 425.

3- Esh Shejkh Sulejman Hanefij El Kanduzijj, që është prej dijetarëve të shquar të Ehli Syneetit, në librin e tij “Jenabijjul Meudetü” ka transmetuar nga Selim ibn Kajs El Hilalij i cili ka thënë: “Një burrë shkoi te Aliu (Paqja qoftë mbi të!) dhe i tha: Më thuaj gjënë më të paktë kur robi është besimtar, kur robi është jobesimtar dhe kur robi është i humbur. Imami i tha: “Ti pyete dhe tani kuptoje përgjigjen... Më e pakta që robi të jetë i humbur është kur robi nuk njeh argumentin e All'Ilahut të Lartësuar dhe dëshmitarin e Tij për robtë e Vet, për të cilin All'Ilahu i Lartësuar i ka urdhëruar ata që t'i binden atij dhe ka detyruar udhëheqjen e tij. I thashë: “O prijësi i besimtarëve, m'i përshkruaj ata. Ai tha: Janë ata, të cilët i ka shoqëruar (përmendur) All'Ilahu i Lartësuar me Veten e Tij e më të Dërguarin e Tij: **“O ju që keni besuar! Bindjuni All'Ilahut, bindjuni të Dërguarit dhe atyre që drejtojnë punët tuaja. Nëse nuk pajtoheni në ndonjë gjë, drejtojuni All'Ilahut dhe të Dërguarit, nëse besoni All'Ilahun dhe Ditën e Kiametit. Kjo për ju është më e mira dhe shpjegimi më i bukur.”**

I thashë: “Më bëftë All'Ilahu kurban për ty, ma qartëso më tepër.” Ai tha: “Janë ata, për të cilët, i Dërguari i All'Ilahut, në fund të Hytbes së fundit ka thënë: Me të vërtetë, unë ju kam lënë juve dy gjëra. Nuk do të humbisni pas meje, nëse ju kapeni pas atyre të dyjave: Librin e All'Ilahut të Lartësuar dhe pasardhësit e familjes sime.”¹

4- Po kështu, i njëjti dijetar ka shkruar në librin “Jenabiul Meudeh” dhe në librin “El Menakib” në tefsirin e Muxhahidit se ky ajet ka zbritur për prijësin e besimtarëve, Aliun (Paqja qoftë mbi të!).²

5- Janë transmetuar hadithe të shumta në burimet e shiave, si në librin “El Kafijj”, “Tefsir Ajashij” dhe në librat e Sadukut e në

¹ Jenabiul Meudeh, f. 116. Biharul Ennuar, vëll. 61, f.17.

² Jenabiul Meudeh, f. 114.

të tjerë, ku të gjithë dëshmojnë se qëllimi i thënies "ulul emri" që përmendet në këtë ajet është për imamët e ruajtur nga gjynahet. Disa prej atyre haditheve përmendin edhe emrat e tyre (imamëve) një e nga një.¹

¹ *Tefsiri Burhan*, komentimi i këtij ajeti.

Ajeti 60

أَلَمْ تَرَ إِلَى الَّذِينَ يَزْعُمُونَ أَنَّهُمْ ءَامَنُوا بِمَا أُنزِلَ إِلَيْكَ وَمَا أُنزِلَ مِنْ
قَبْلِكَ يُرِيدُونَ أَنْ يَتَحَاكَمُوا إِلَى الطَّاغُوتِ وَقَدْ أُمِرُوا أَنْ يَكْفُرُوا بِهِ
وَيُرِيدُ الشَّيْطَانُ أَنْ يُضِلَّهُمْ ضَلَالًا بَعِيدًا ﴿٦٠﴾

"A nuk i ke parë ti (o Muhammed!) ata (hipokritë) që pohojnë se kanë besuar në atë që të është shpallur ty dhe Profetëve të tjerë para teje? Ata kërkojnë gjykimin e zotave të rremë, ndërkohë që janë urdhëruar t'i mohojnë ata. Djalli dëshiron që t'i nxjerrë ata krejtësisht nga udha e drejtë."

Shkaku i zbritjes

Mes një jehudiu dhe një personi nga myslimanët dyfytyrësh (hipokrit) gjendej armiqësi dhe mospajtim. Ata ranë dakort që të gjykoheshin tek një person. Meqenëse jehudiu e njihte drejtësinë e Profetit (Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të!), e dinte se nuk e pranon ryshfetin dhe nuk bën padrejtësi në gjykim, tha: "Ju gjykoj ju te Muhammedi." Por hipokriti tha: "Jo, por ndërmjet meje dhe teje të gjykojë Kab ibn Eshref (sepse ai e pranonte ryshfetin dhe ishte prej të njohurve jehudinj)." Kështu, hipokriti e

refuzoi gjykimin tek i Dërguari i All'llahut. Atëherë zbriti ky ajet që i qorton të tillë persona dhe e refuzon fuqishëm këtë qëndrim të turpshëm të tyre.¹

Disa komentues kanë përmendur shkaqe të tjera për zbritjen e këtij ajeti, ku dëshmohet se disa myslimanë të rinj, në fillim të Islamit, vazhdonin me zakonet e tyre si në kohën para Islamit dhe i gjykonin çështjet tek dijetarët e jehudinëve apo tek murgjit. Atëherë, zbriti ky ajet që e ndalon rreptësisht këtë zakon të turpshëm.²

Komentimi

Udhëheqja e tiranëve

Ky ajet, në të vërtetë, është plotësues i ajetit të mëparshëm, sepse ajeti i mëparshëm i ftonte besimtarët që t'i bindeshin All'llahut, të Dërguarit të Tij, udhëheqësve të drejtë (ulul emri) dhe që të gjykohej sipas Librit të All'llahut dhe Synetit të të Dërguarit të Tij. Ky ajet e ndalon gjykimin tek tirani, i padrejti dhe ndalon ndjekjen e urdhrit, gjykimin dhe udhëheqjes së tij.

Fjala "tagut" – sikurse e kemi shpjeguar edhe më parë – rrjedh nga fjala "tug'jan". Kjo fjalë, me të gjitha përkufizimet e saj, do të thotë *tejkallim, shkelje e kufijve, mospërfillje e kushteve dhe e kritereve*. Ose, ka kuptimin e gjithçkaje që është mjet për padrejtësinë, rebelimin e arrogancën.

¹ Tefsiri *Mexhmaul Bejan*, komentimi i këtij ajeti.

² Tefsiri *El Menar*, vëll. 5, f. 222.

Duke u bazuar në këtë, kushdo që gjykon me padrejtësi quhet "tagut", sepse ai ka tejkaluar kufijtë e All'Ilahut dhe ka shkelur ligjet e drejta dhe drejtësinë. Në hadithin e imam Xha'fer ibn Muhammed Sadik (Paqja qoftë mbi të!) thuhet: *"Tagut është çdo person që gjykohet tek ai dhe ky gjykon me padrejtësi."*

Ajeti në fjalë i ndalon myslimanët që ta çojnë çështjen e gjykimit tek të tillë gjykatës, ku thotë: **"A nuk i ke parë ti (o Muhammed!) ata (hipokritë) që pohojnë se kanë besuar në atë që të është shpallur ty dhe Profetëve të tjerë para teje? Ata kërkojnë gjykimin e zotave të rremë, ndërkohë që janë urdhëruar t'i mohojnë ata..."** Pastaj, Kur'ani shton e thotë: **"...Djalli dëshiron që t'i nxjerrë ata krejtësisht nga udha e drejtë."**, që do të thotë se gjykimi tek i padrejti është kurth i shejtanit për t'i devijuar besimtarët nga rruga e drejtë.

Nuk është e fshehtë se ky ajet - ashtu sikurse ajetet e tjera kur'anore, përmban rregull të përgjithshëm dhe qartëson një ligj dhe rregull të përvetshëm për të gjithë myslimanët në çdo kohë dhe në çdo vend dhe u tërheq vërejtjen atyre që të mos shkojnë tek të padrejtët dhe të kërkojnë gjykim prej tyre, sepse kjo nuk i përshtatet besimit në All'Ilahun dhe në Librat e Tij. Përveç kësaj, kjo vepër e bën njeriun që të humbasë rrugën e drejtë dhe e çon atë në pellgun e padrejtësisë dhe larg së vërtetës dhe drejtësisë.

Me të vërtetë, të këqijat e këtyre gjykimeve dhe ndikimi i tyre në shkatërrimin e strukturës së shoqërisë njerëzore, të marrëdhënieve dhe parimeve të saj janë mëse të dukshme. Ato janë faktorë ndikues në prapambetjen dhe shkatërrimin e shoqërive njerëzore.

Ajetet 61- 63

وَإِذَا قِيلَ لَهُمْ تَعَالَوْا إِلَى مَا أَنْزَلَ اللَّهُ وَإِلَى الرَّسُولِ رَأَيْتَ الْمُنْفِقِينَ
يَصُدُّونَ عَنْكَ صُدُودًا ﴿٦١﴾ فَكَيْفَ إِذَا أَصَابَتْهُمْ مُصِيبَةٌ بِمَا قَدَّمَتْ
أَيْدِيهِمْ ثُمَّ جَاءُوكَ تَحْلِفُونَ بِاللَّهِ إِنْ أَرَدْنَا إِلَّا إِحْسِنًا وَتَوْفِيقًا ﴿٦٢﴾ أُولَئِكَ
الَّذِينَ يَعْلَمُ اللَّهُ مَا فِي قُلُوبِهِمْ فَأَعْرِضْ عَنْهُمْ وَعِظْهُمْ وَقُلْ لَهُمْ فِي
أَنْفُسِهِمْ قَوْلًا بَلِيغًا ﴿٦٣﴾

"Po kur u thuhet atyre: 'Ejani tek ajo që ka shpallur All'llahu dhe tek i Dërguari', i sheh hipokritët se si largohen prej teje me neveri."

"Si do të jetë gjendja e tyre kur t'i godasë fatkeqësia, për shkak të asaj që vetë kanë punuar e të vijnë te ti, duke u betuar në All'llahun e duke thënë: 'Ne kemi dashur vetëm të bëjmë mirësi dhe pajtim.'"

"Këta janë ata, për të cilët All'llahu e di se ç'kanë në zemrat e tyre. Largohu prej tyre, këshilloji dhe thua ju fjalë që i prekin në zemër."

Komentimi

Rezultati i gjykimit të idhujtarisë

Pas ndalimit të rreptë të gjykimit tek i padrejti dhe tek udhëheqësit tiranë që u përmend në ajetin e mëparshëm, këto tre ajete studiojnë rezultatin e të tilla rregullave dhe të tilla gjykimeve, si dhe atë me të cilën hipokritët pasojnë për të shfajësuar gjykimin e tyre tek i padrejti dhe tek udhëheqësi i devijuar dhe tiran.

Në ajetin e parë, All'llahu i Lartësuar thotë: **"Po kur u thuhet atyre: 'Ejani tek ajo që ka shpallur All'llahu dhe tek i Dërguari', i sheh hipokritët se si largohen prej teje me neveri."**

Në të vërtetë, Kur'ani Famëlartë thotë në këtë ajet se gjykimi tek i padrejti nuk është një gabim kalimtar që mund të shërohet ose të kurohet me disa lutje, por këmbëngulja në këtë veprim zbulon dobësimin e besimit të tyre dhe shpirtin e hipokrizisë tek ata. Është detyrim që të kenë kujdes dhe të kthehen në udhëzimin e thirrjes së të Dërguarit të All'llahut dhe ta pranojnë gabimin e tyre. All'llahu i Lartësuar thotë: **"Ejani tek ajo që ka shpallur All'llahu dhe tek i Dërguari', i sheh hipokritët se si largohen prej teje me neveri."**

Në ajetin e dytë e qartëson këtë të vërtetë se ata hipokritë, kur ngatërrohen në një fatkeqësi si rezultat i qëndrimit dhe i veprave të tyre, ballafaqohen me rrugë të mbyllur dhe kthehen nga detyrimi dhe mërzia: **"Si do të jetë gjendja e tyre kur t'i**

godasë fatkeqësia, për shkak të asaj që vetë kanë punuar e të vijnë te ti..."

Në këtë gjendje, ata betohen se qëllimet e tyre në gjykimin tek të tjerët nuk janë veçse mirësi dhe pajtueshmëri mes dy palëve, ku All'llahu i Lartësuar thotë: **"...duke u betuar në All'llahun e duke thënë: 'Ne kemi dashur vetëm të bëjmë mirësi dhe pajtim.'"**

Këtu duhen përmendur dy pika:

E para: Duhet që të vërejmë se cili është qëllimi nga vështirësia dhe sprovat që i goditi ata?

Nuk është e largët që të jetë kjo goditje dhe fatkeqësi, e cila e ka burimin tek të këqijat dhe mjerimet e zbatimit të gjykit të tiranëve dhe të padrejtëve, sepse nuk ka dyshim se gjykimi i dalë nga persona jo të drejtë dhe zullumqarë, edhe nëse është i dobishëm për njërën palë, me kalimin e kohës, ky gjykim sjell përhapjen e shkatërrimit, të padrejtësisë, të rrëmujës dhe të tronditjes së strukturës shoqërore. Për këtë, shumë shpejt, ata që shkojnë tek të padrejtët për gjykim, do të përballen me dëmet e veprës së tyre dhe do të pendohen shumë shpejt për atë që vepruan.

Disa komentues e mendojnë se qëllimi me fjalën "fatkeqësi" është turpi që i ndjek hipokritët, ose janë fatkeqësitë që i godasin ata me urdhrin e All'llahut të Lartësuar, siç janë fatkeqësitë e papritura.

E dyta: Vallë, qëllimi i hipokritëve me fjalën “mirësi”, a është për mirësinë e palës ankuese apo për Profetin (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)?

Është e mundur që qëllimi i tyre të jetë për të dyja. Ata përdorën argumente qesharake për ta kryer gjykimin tek i padrejti dhe prej atyre argumenteve ishte thënia e tyre se gjykimi tek i Dëguari i All'llahut nuk i përshtatet dhe nuk i shkon pozicionit të tij, sepse, në përgjithësi, ndodh grindje dhe ngritje zërash mes gjykatësve dhe ankuesve. Kjo nuk i përshtatet pozicionit të të Dërguarit të All'llahut të Lartësuar dhe nuk është në përputhje me pozitën e tij.

Përveç kësaj, gjykimi gjithmonë përfundon me dëmin e njëres nga të dy palët dhe kjo sjell armiqësi ndaj gjykatësit. Me këto shembuj dhe argumente të pabaza duket se ata përpiqen të shfajësojnë vetat dhe qëndrimet e tyre të kota. Pretendimi i tyre se mosgjykimi tek Profeti është për të mos e nënçmuar atë, është supozim i kotë dhe i pabazë.

Ndoshta kanë kërkuar shfajësim, duke thënë se qëllimi i tyre nuk ka qenë në themel material, por ka qenë për të arritur pajtim mes dy palëve.

All'llahu i Lartësuar, në ajetin e tretë, zbulon maskën e fytyrave të tyre dhe hedh poshtë shfajësimet e tyre mashtruese e gënjeshtare, ku thotë: **"Këta janë ata për të cilët All'llahu e di se ç'kanë në zemrat e tyre..."**

Megjithëkëtë, All'llahu i Lartësuar e urdhëron të Dërguarin e Tij që të largohet nga egoizmi dhe ndëshkimet e tyre, ku thotë: **"...Largohu prej tyre..."**

Profeti i toleronte me sa mundej hipokritët, për arsye se shfaqnin Islamin, sepse ai ishte i urdhëruar të bashkëpunonte me ata sipas shfaqjes së besimit të tyre të jashtëm.

Pastaj, All'llahu i Lartësuar e urdhëron të Dërguarin e tij që t'i këshillojë ata dhe të depërtojë në zemrat e tyre me fjalë bindëse dhe këshilla mbresëlënëse, duke i thënë: **"...këshilloji dhe thuaju fjalë që i prekin në zemër."**

Ajeti 64

وَمَا أَرْسَلْنَا مِنْ رَّسُولٍ إِلَّا لِيُطَاعَ بِإِذْنِ اللَّهِ ۚ وَلَوْ أَنَّهُمْ إِذْ ظَلَمُوا
 أَنْفُسَهُمْ جَاءُوكَ فَاسْتَغْفَرُوا اللَّهَ وَاسْتَغْفَرَ لَهُمُ الرَّسُولُ لَوَجَدُوا اللَّهَ
 تَوَّابًا رَحِيمًا ﴿٦٤﴾

“Ne i kemi nisur të Dërguarit vetëm me qëllimin që njerëzit, me lejen e All'Ilahut, t'u binden atyre. Dhe në qoftë se ata, kurdo që t'i bëjnë padrejtësi vetave të tyre, vijnë tek ti për t'i kërkuar falje All'Ilahut dhe i Dërguari t'i lutej All'Ilahut për shfajësimin e tyre, do ta vërenin, se All'Ilahu, me të vërtetë, është Pranues i pendimit dhe Mëshirëplotë.”

Komentimi

Në ajetet e mëparshme Kur'ani famëlartë dënoi gjykimin tek gjykatësit e padrejtë. Në këtë ajet, All'Ilahu i Lartësuar thotë: “Ne i kemi nisur të Dërguarit vetëm me qëllimin që njerëzit, me lejen e All'Ilahut, t'u binden atyre...” Sigurisht, Ne i dërguam Profetët që njerëzit t'u binden atyre me lejen e All'Ilahut dhe me urdhrin e Tij dhe askush të mos i kundërshtojë, sepse ata janë të dërguarit dhe ambasadorët e All'Ilahut, si dhe janë udhëheqësit e

shtetit të Zotit. Bazuar në këtë, është detyrim i të gjithë njerëzve që t'u binden atyre nga ana e qartësimit të rregullave të All'Ilahut dhe nga ana e mënyrës së zbatimit të tyre dhe të mos mjaftohen vetëm me pretendimin e besimit.

Nga kjo shprehje përfitohet se qëllimi i dërgimit të Profetëve është bindja e të gjithë njerëzve ndaj tyre. Nëse disa njerëz e keqpërdorin lirinë e tyre dhe nuk u binden Profetëve, faji është i tyre dhe i askujt tjetër. Kështu që ky ajet mohon besimin e (xhebrijinëve), të cilët thonë: Njerëzit janë dy grupesh: një grup që është i detyruar me bindjen që në fillim dhe grupi tjetër që është i detyruar të bëjë gjynahe që në fillim.

Kjo përfitohet edhe nga shprehja **“Me lejen e All'Ilahut”**, se çdo gjë që kanë Profetët është nga All'Ilahu. Thënë ndryshe: Detyrimi i bindjes së tyre nuk është i qenësishëm, por është me urdhrin e All'Ilahut dhe nga ana e Tij.

Pastaj All'Ilahu i Lartësuar e lë portën e pendimit (pas këtyre ajeteve) të hapur për gjynahqarët, për ata të cilët gjykojnë tek të padrejtët dhe mizorët me to dhe për të gjithë ata që mëkatojnë në një formë ose në një tjetër. All'Ilahu i Lartësuar thotë: **"Dhe në qoftë se ata, kurdo që t'i bëjnë padrejtësi vetave të tyre, vijnë tek ti për t'i kërkuar falje All'Ilahut dhe i Dërguari t'i lutej All'Ilahut për shfajësimin e tyre, do ta vërenin, se All'Ilahu, me të vërtetë, është Pranues i pendimit dhe Mëshirëplotë."**

Është i vlefshëm meditimimi se Kur'ani në vend që të thotë se ata kundërshtuan urdhrin e All'Ilahut dhe u gjykuan tek i padrejti dhe mizori, thotë: **"...kurdo që t'i bëjnë padrejtësi vetave të tyre"**.

Kjo tregon se dobia e bindjes ndaj All'llahut dhe të Dërguarit të Tij ju kthehet po juve dhe kundërshtimi i urdhrave të tyre është prej llojit të padrejtësisë që ju u bëni vetave tuaja. Kjo bën që jeta juaj materiale të shkatërrohet dhe çon gjithashtu në shkatërrimin dhe rrënimin tuaj shpirtëror.

Në të vërtetë, ky ajet, në thelbin e vet, u përgjigjet të gjithë atyre që e konsiderojnë një lloj shirku (idhujtarie) ndërmjetësimin e të Dërguarit të All'llahut dhe të imamit, sepse ajeti flet qartë se ndërmjetësimi i Profetit tek All'llahu i Lartësuar dhe kërkimi i faljes nga ai për faljen e gjynaheve është ndikues dhe detyrues për pranimin e pendimit dhe për përfshirjen në mëshirën e All'llahut.

Në qoftë se ndërmjetësimi i Profetit dhe lutja e tij për gjynahqarët është shirk (idhujtari), atëherë si është e mundur që Kur'ani t'i urdhërojë gjynahqarët me një urdhër të tillë? Sigurisht, duhet që gjynahqarët të pendohen dhe të kthehen nga rruga e gabuar, pastaj për pranimin e pendimit të tyre, të përfitojnë nga kërkimi i faljes nga Profeti (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!).

Është mëse e pranueshme se nuk është detyrë e Profetit (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) që të falë gjynahet, por ai i kërkon falje të posaçme All'llahut. Ky ajet është një përgjigje e hapur për ata të cilët e mohojnë legjitimitetin apo dobinë e ndërmjetësimit.

Ajo që tërheq vëmendjen është se Kur'ani nuk thotë: “O i Dërguari i All'llahut, fali ata!”, por thotë: “...dhe i Dërguari t'i lutej”. Kjo thënie, ndoshta, tregon që Pejgamberi (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) të

përfitojë nga pozita e tij dhe të kërkojë falje për gjynahqarët pendues.

Kjo temë (ndikimi i kërimit të faljes së Profetit për besimtarët) është përmendur gjithashtu në ajete të tjera të Kur'anit, si: në suren "Muhammed", ajeti 19, në suren "El Munafikun", ajeti 5, në suren "Teube", ajeti 114, të cilat tregojnë kërkimin e faljes së Ibrahimit për babain (xhaxhain) e tij dhe të tjera ajete që ndalojnë kërkimin e faljes për idhujtarët (mushrikët). Kuptimi i tyre është për lejueshmërinë e kërimit të faljes për besimtarët. Po ashtu, në disa transmetime përfitohet se melekët kërkojnë falje te All'llahu për grupet e besimtarëve që janë gjynahqarë (sure "Gafir", ajeti 77 dhe sure "Esh Shura", ajeti 5).

Me fjalë përmbledhëse: Ka shumë ajete që e tregojnë këtë të vërtetë se Profetët, ose melekët, ose besimtarët e singertë e të vërtetë, mund të kërkojnë falje për disa gjynahqarë dhe kërkitimi i faljes se tyre është ndikues tek All'llahu. Dhe ky është një ndër kuptimet e ndërmjetësimit të Profetit (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), të melekëve, apo të besimtarëve të singertë për gjynahqarët dhe gabimtarët. Mirëpo, sikurse e kemi thënë, ndërmjetësimi kërkon që të gjendet aftësia dhe meritimi tek vetë gjynahqarët.

Është e habitshme se në disa thënie të disa komentuesve përfitohet se ata e konsiderojnë kërkimin e faljes së Profetit (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) në këtë ajet si të lidhur me ndodhitë e veçanta për Profetin dhe jo për të gjitha gjynahet. Me këtë, ata sikur duan të thonë se nëse dikush i bën keq Profetit duhet që t'i kërkohet falje atij, që All'llahu i Lartësuar ta falë për atë të keqe dhe të pendohet.

Por është mëse e qartë se vajtja për gjykim te dikush tjetër dhe jo te Profeti nuk është padrejtësi personale që ka për qëllim personalitetin e Profetit, por është kundërshtim i pozitës së tij. Thënë ndryshe: është një kundërshtim i urdhrit të All'llahut edhe nëse, supozohet, se kjo është padrejtësi personale drejtuar personalitetit të Profetit. Kur'ani nuk ka për qëllim këtë çështje dhe nuk përqendrohet në të, por ai përqendrohet tek çështja se ai gjykim tek i padrejti është në kundërshtim me urdhin e All'llahut dhe përçmim ndaj dëshirës së Tij.

Nëse ne i bëjmë dikujt padrejtësi na mjafton kënaqësia e atij personi. Ku është nevoja për të kërkuar falje dhe lutje për gjynahqarët? Sikur ta komentojmë këtë ajet me këtë lloj komentimi, çfarë do të themi për të gjitha ato ajete të cilat flasin për kërkimin e faljes së Profetëve, melekëve dhe besimtarëve për gjynahqarët? A është pozita në to pozitë e të drejtave personale?

Ajeti 65

فَلَا وَرَبِّكَ لَا يُؤْمِنُونَ حَتَّىٰ يُحَكِّمُوكَ فِيمَا شَجَرَ بَيْنَهُمْ ثُمَّ لَا يَجِدُوا

فِي أَنْفُسِهِمْ حَرَجًا مِّمَّا قَضَيْتَ وَيُسَلِّمُوا تَسْلِيمًا ﴿٦٥﴾

"Jo, për Zotin tënd, ata nuk do të jenë besimtarë të vërtetë, derisa të të marrin ty për gjyqtar për kundërshtitë mes tyre; e pastaj, të mos ndiejnë kurrfarë dyshimi ndaj gjykimit tënd dhe të të binden ty plotësisht."

Shkakut i zbritjes

Mes Zubejr ibn Auami - që ishte prej muhaxhirëve (emigrantëve) - dhe një personi nga Ensarët (përkrahësit) ndodhi një konflikt për ujitjen e hurmave të tyre që ishin në një vend të afërt. Ata e ngritën çështjen tek Profeti (Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Megjithatë hurmat e Zubejrit ndodheshin në një pozicion më të lartë se hurmat e Ensariut, i Dërguari i All'Ilahut i tha Zubejrit: *"Ujiti dhe pastaj dërgoje ujin tek komshiu yt."* (kështu ka qenë një zakon në atë kohë për dy kopshte që ndodheshin pranë njëri -tjetrit). Ensariu u zemërua për gjykimin e drejtë të të Dërguarit të All'Ilahut dhe i tha: *"O i Dërguari i All'Ilahut! Po sikur të ishte djali i hallës tënde?"* Të Dërguarit të All'Ilahut i ndryshoi ngjyra e fytyrës prej shqetësimit

nga qëndrimi i Ensariut dhe i fjalëve të tij. Atëherë zbriti ajeti në fjalë që u tërheq vërejtjen myslimanëve ndaj të tilla qëndrimeve.

Në disa komentime janë përmendur shkaqe të tjera për zbritjen e këtij ajeti të cilët janë shumë të ngjashëm me këtë të lartpërmendurin. (shiko tefsirin Et Tibjan i Et Tabrasij , dhe tefsirin El Manar)¹

Komentimi

Dorëzimi përpara së vërtetës

Shkaqet e veçanta të zbritjes së ajeteve nuk e mohojnë kuptimin e përgjithshëm të atyre. Për këtë, ky ajet mund të konsiderohet plotësues i atij hulumtimi që gjendej tek ajetet e mëparshme.

Në këtë ajet All'llahu është betuar se njerëzit nuk mund të kenë besimin e vërtetë vetëm nëse ata gjykohen tek Profeti dhe nuk shkojnë për gjykim tek asnjë tjetër përveç tij: **"Jo, për Zotin tënd, ata nuk do të jenë besimtarë të vërtetë, derisa të të marrin ty për gjyqtar për kundërshtitë mes tyre..."**

Pastaj All'llahu i Lartësuar thotë se është detyrim i tyre që ata vetëm te ti të gjykohen dhe për më tepër të jenë të kënaqur për atë çfarë ti gjykon për ata, qoftë ky gjykim në dobinë e tyre apo në dëm të tyre, të mos ndiejnë në veten e tyre asnjë pakënaqësi e as të mos kenë kundërshti dhe së fundi, të dorëzohen plotësisht: **"... e**

¹ Tefsiri *Mexhmanul Bejan*, fundi i ajetit në fjalë. *Biharul Enuar*, vëll. 22, f.19.

pastaj, të mos ndiejnë kurrfarë dyshimi ndaj gjykimit tënd dhe të të binden ty plotësisht."

Ndoshta shqetësimi i brendshëm prej gjykimeve mund të jetë i dëmshëm për njeriun, edhe nëse në shumicën e rasteve është një çështje jo përzgjedhëse, porse në gjurmët e edukimit të vazhdueshëm moral njeriu mund të arrijë shpirtin e dorëzimit përpara së vërtetës dhe përluljen ndaj drejtësisë, veçanërisht duke menduar pozitën e vërtetë të Profetit (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Prandaj, nuk duhet të shqetësohet nga gjykimi i tij dhe as nga gjykimet e dijetarëve që vijnë pas Tij. Sido që të jetë, është detyrim i të gjithë myslimanëve të vërtetë që gjithmonë ta rrisin dhe ta zhvillojnë shpirtin e bindjes ndaj së vërtetës dhe të dorëzimit përpara drejtësisë në vetat e tyre.

Ajeti në fjalë qartëson shenjat e besimit të vërtetë e të ngulitur në tri faza:

1- Të gjykohen tek Profeti (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), në atë divergjencë që ata kanë, qoftë e vogël apo e madhe dhe të mos gjykohen tek të padrejtët dhe tiranët.

2- Të mos ndiejnë asnjë dyshim apo pakënaqësi në gjykimet e drejta të Profetit (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), të cilat në realitet janë vetë urdhrat e All'llahut dhe të mos mendojnë për keq ndaj këtyre gjykimeve.

3- T'i zbatojnë këto gjykime në periudhën e zbatimit të tyre me zbatim të plotë dhe të dorëzohen plotësisht përpara së vërtetës.

Është mëse e qartë se pranimi i çdo feje dhe i rregullave të saj, nëse janë në dobi të njeriut dhe në përputhje me interesat dhe synimet e tij, nuk mund të jetë argument i besimit të tij për atë fe. Por kjo vërtetohet nëse këto rregulla janë të drejtim të kundërt me dobitë dhe interesat e tij në aparençë, edhe nëse janë në përputhje me të vertetën dhe të drejtën në realitet. Nëse pranohen këto rregulla me një pranim të plotë, atëherë ky është argument për besimin e fortë dhe të qëndrueshëm të njeriut.

Është transmetuar nga imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) në komentimin e këtij ajeti se ka thënë: *“Nëse populli e adhuron All’llahun të Vetëm e të Pashoq, e falin namazin, e japin zekatin, e vizitojnë Shtëpinë e All’llahut, e agjërojnë Muajin e Madhërueshëm të Ramazanit, pastaj thonë për diçka që e ka bërë All’llahu dhe i dërguari i Tij, përse e ka bërë këtë e këtë dhe sikur të bënte të kundërtën që ka bërë ose nëse ekziston në zemrat e atyre kjo gjë, ata janë politeistë. Pastaj lexoi ajetin në fjalë dhe tha: Është detyrim i juaji që të jeni plotësisht të bindur”¹*

Nga ky ajet përfitojmë dy gjëra të rëndësishme:

1- Me të vërtetë, ky ajet është një argument për pagabueshmërinë e Profetit (Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) sepse urdhri për t’iu bindur plotësisht përpara të gjithë urdhrave, rregullave, thënieve dhe veprave të Tij, por edhe dorëzimi me zemër dhe bindja e brendshme, gjithashtu, janë argument i qartë se i Dërguari i All’llahut nuk gabon në gjykimet dhe mësimet e tij dhe nuk e thotë atë që kundërshton të vërtetën, sepse Ai është i pagabueshëm nga gjynahet e mëdha dhe gabimet e vogla.

¹ *Usulul Kafijj*, vëll.1, f. 390. Tefsir *Ajashijj*, vëll. 1, f. 255-256.

2- Me të vërtetë, ky ajet hedh poshtë çdo mendim personal (ixhtihad) përballë tekstit të transmetuar nga i Dërguari i All'lahut dhe mohon legjislacionin e çdo mendimi personal në ato çështje të qarta që na kanë mbërritur nga All'lahu dhe nga i Dërguari i Tij.

Bazuar në këtë, ajo çfarë shohim në historinë islame nga ixhtihadi i disa personave përballë rregullave të All'lahut dhe të thënieve Profetike dhe thënia e tyre se Profeti ka thënë ashtu dhe ne themi kështu, para nesh nuk është gjë tjetër, veçse t'i lëmë ato dhe t'u themi se kanë punuar në kundërshtim të qartë me këtë ajet dhe kanë kundërshtuar kontekstin e tij.

Ajetet 66 - 68

وَلَوْ أَنَّا كَتَبْنَا عَلَيْهِمْ أَنْ اقْتُلُوا أَنْفُسَكُمْ أَوْ أَخْرِجُوا مِنْ دَيْرِكُمْ مَا فَعَلُوهُ
إِلَّا قَلِيلٌ مِّنْهُمْ ^ط وَلَوْ أَنَّهُمْ فَعَلُوا مَا يُوعَظُونَ بِهِ لَكَانَ خَيْرًا لَهُمْ وَأَشَدَّ
تَثْبِيثًا  وَإِذَا لَّا تَيْنَهُمْ مِّن لَّدُنَّا أَجْرًا عَظِيمًا  وَلَهَدَيْنَهُمْ صِرَاطًا
مُّسْتَقِيمًا 

"Sikur Ne t'i urdhëronim ata: "Vritni veten!" ose: "Lini shtëpitë tuaja!", pak prej tyre do ta bënë këtë. E sikur të vepronin ata siç këshilloheshin, kjo për ata do të ishte më mirë dhe do të ishin më të fortë në besim."

"Atëherë, Ne, pa dyshim, do t'u jepnim shpërblim të madh nga ana Jonë"

"Dhe me siguri do t'i udhëzonim në rrugë të drejtë."

Komentimi

Në plotësim të hulumtimit të mëparshëm rreth atyre që, në disa raste, ndiejnë pakënaqësi në drejtim të gjykimeve të drejta të Profetit (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi

familjen e tij!), Kur'ani këtu tregon për disa detyrime dhe detyra të rënda në popujt e mëparshëm, ku thotë: **"Sikur Ne t'i urdhëronim ata: 'Vritni veten!' ose: 'Lini shtëpitë tuaja!', pak prej tyre do ta bënë këtë..."** Pra, Ne nuk i kemi urdhëruan ata me detyra të vështira e të papërballueshme. Sikur Ne t'i detyronim ata me atë që detyruam popujt e mëparshëm (siç ishin jehudinjtë, të cilët u urdhëruan që të vritnin njëri-tjetrin si shpagim për atë veprim që bënë që ishte adhurimi i viçit, ose të largoheshin nga vendi i tyre i dashur) si do ta përballonin atë detyrim?

Me të vërtetë, ata nuk përballuan një gjykim të lehtë të dhënë nga Profeti (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) në çështjen e ujitjes së hurmave dhe nuk iu bindën këtij gjykimi të drejtë. Vallë, a munden ata që të kryejnë misione më të rëndësishme, të kenë përgjegjësi fizike dhe t'i kalojnë me sukses sprovat e vështira? Sikur Ne t'i urdhëronim ata që të vrisnin veten e tyre (të vritnin njëri-tjetrin) ose të linin vendin e tyre të dashur, këtë nuk do ta bënë vetëm se një pakicë prej tyre.

Me të vërtetë, çështja "përgatitja për vrasje" i ngjason - sipas thënieve të komentuesve - çështjes "largim nga atdheu" në disa drejtime, sepse trupi dhe atdheu është plotësisht shpirti i njeriut dhe vendi është si trupi i njeriut. Ashtu sikurse përgatitja për vrasje, po ashtu, edhe lënia e vatanit ku ka lindur dhe është rritur është çështje e vështirë për shpirtin e njeriut.

Pastaj, All'llahu i Lartësuar thotë: **"E sikur të vepronin ata siç këshilloheshin, kjo për ata do të ishte më mirë dhe do të ishin më të fortë në besim."** Kjo ka kuptimin se nëse ata do t'i pranonin këshillat e Profetit (Paqja dhe bekimet e All'llahut

qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), kjo do të ishte në dobinë e tyre dhe do të ishte shkak për forcimin e besimit të tyre.

Ajo që tërheq vëmendjen është se Kur'ani në këtë ajet i konsideron këshillë urdhrat dhe rregullat e Zotit. Kjo tregon se urdhrat e mësipërm nuk janë urdhra në interes të Ligjvënësit (All'Ilahut) apo që i sjellin dobi Atij, por, në të vërtetë, këto këshilla janë të dobishme për ju. Për këtë, All'Ilahu thotë: **"E sikur të vepronin ata siç këshilloheshin, kjo për ata do të ishte më mirë dhe do të ishin më të fortë në besim."** Sigurisht, kjo është për të forcuar besimin dhe për të ngulitur rrënjët e tij në zemrat dhe shpirtrat e tyre.

Patjetër duhet të ndalemi në këtë pikë, se All'Ilahu i Lartësuar në mbyllje të këtij ajeti thotë **"dhe do të ishin më të fortë në besim."** Vërtet, sa më shumë të këmbëngulë njeriu që të ecë në rrugën e bindjes ndaj All'Ilahut dhe në rrugën e zbatimit të urdhrave të Tij, atij do t'i shtohet më shumë besimi dhe palëkundshmëria e tij. Kjo do të thotë se bindja e urdhrave të All'Ilahut është një lloj ushtrimi shpirtëror. Me anë të përsëritjes së saj tek njeriu arrihet fuqia dhe qëndrueshmëria më e madhe. Kjo është sikurse ushtrimet fizike. Me anë të tyre, njeriu arrin të fitojë fuqi trupore dhe asgjë nuk e mposht atë e as ta mashtrojë ose ta lëkundë atë.

Pastaj, në ajetin e dytë, All'Ilahu i Lartësuar qartëson dobinë e tretë prej dobive të dorëzimit dhe të bindjes ndaj urdhrave të All'Ilahut, ku thotë: **"Atëherë, Ne, pa dyshim, do t'u jepnim shpërblim të madh nga ana Jonë"**. Pra, në shtesë të shpërblimit të madh që përmendëm, Ne do t'u japim atyre

shpërblim shumë të madh nga ana Jonë, të cilin njeriu nuk e percepton dot.

Në ajetin e fundit, të ajeteve në fjalë, All'llahu i Lartësuar tregon përfundimin e katërt, ku thotë: **"Dhe me siguri do t'i udhëzonim në rrugë të drejtë."** Është mëse e qartë se qëllimi me këtë hidaje (udhëzim) nuk është udhëzim drejt origjinës së fesë, por qëllimi është për mirësitë e reja, që All'llahu u jep këtyre robve punëmirë. Kjo i ngjason ajetit 17 të sures "Muhammed", ku All'llahu i Lartësuar thotë: **"Sa për ata që ndjekin rrugën e drejtë, Ai ua shton udhëzimin."**

Është transmetuar se kur ka zbritur thënia e All'llahut të Lartësuar: **"Sikur Ne t'i urdhëronim ata: 'Vritni veten!...'"**, një person nga myslimanët ka thënë: *"Beto hem në All'llahun, se nëse do të na urdhëronte, do ta bënim. Falënderimi i takon All'llahut që na ka falur për këtë."* Kur këto fjalë i shkuan të Dërguarit të All'llahut, ai tha: *"Me të vërtetë, nga ymeti i im ka burra, besimi i të cilëve, është më i fortë në zemrat e tyre sesa malet e patundur."*¹

¹ Tefsijri *Fi Dhibalil Kur'an*, vëll. 2, f. 428. *Biharul Anuar*, vëll. 22, f. 20. Tefsijri *Meschmaul Bejan*, fundi i ajetit në fjalë.

Ajetet 69 - 70

وَمَنْ يُطِيعِ اللَّهَ وَالرَّسُولَ فَأُولَٰئِكَ مَعَ الَّذِينَ أَنْعَمَ اللَّهُ عَلَيْهِمْ مِنَ النَّبِيِّينَ
وَالصِّدِّيقِينَ وَالشُّهَدَاءِ وَالصَّالِحِينَ ۖ وَحَسُنَ أُولَٰئِكَ رَفِيقًا ﴿٦٩﴾ ذَٰلِكَ
الْفَضْلُ مِنَ اللَّهِ ۚ وَكَفَىٰ بِاللَّهِ عَلِيمًا ﴿٧٠﴾

"Kushdo që i bindet All'Ilahut dhe të Dërguarit, do të jetë me ata, të cilëve All'Ilahu u ka dhënë shumë dhunti: me Profetët, me të vërtetët, me dëshmorët dhe me punëmirët! Eh sa shokë të mrekullueshëm janë këta!"

"Kjo dhunti është nga All'Ilahu, e mjafton që All'Ilahu e di çdo gjë."

Shkaku i zbritjes

Një nga shokët e të Dërguarit të All'Ilahut që quhej "Theuban" e ka dashur shumë atë dhe nuk duronte që të rrinte larg tij. Një ditë, atij i kishte ndryshuar ngjyra e fytyrës dhe dukej i dobët. Shkoi te Profeti. Profeti e pyeti: "O Theuban, përse të ka ndryshuar ngjyra e fytyrës?" Ai iu përgjigj: "O i Dërguari i All'Ilahut, as nuk jam i sëmurë dhe as nuk kam dhimbje, por u bëra kështu sepse unë nuk të kam parë dhe më mori malli për ty. Pastaj kujtova Botën Tjetër

(Ahiretin) dhe kam frikë se unë nuk do të të shoh ty. E nëse hyj në Xhennet do të jem më ulët se pozita jote dhe nëse nuk hyj në Xhennet, unë nuk do të të shoh ty asnjëherë." Dhe zbritën këto dy ajete që përgëzojnë se të tillë të bindur do të jenë me Profetët, me ata që i ka zgjedhur All'llahu dhe i ka mirësuar në Xhennet.

Pastaj Profeti ka thënë: *"Betohem në Atë që shpirti im ndodhet në dorë të Tij nuk e ka besimin e plotë rob i derisa të jem unë më i dashur se vetvetja e vet, se prindërit e vet, se familja e vet, se fëmijët e vet dhe se të gjithë njerëzit."* Pra, të jetë mysliman i bindur plotësisht ndaj mësimëve dhe urdhërave të mia."¹

Komentimi

Shoqëruesit në Xhennet

Në këtë ajet Kur'ani sqaron një veçori tjetër prej veçorive të atij që i bindet All'llahut dhe të Dërguarit të Tij. Në të vërtetë është plotësues i veçorive që u përmendën në ajetet e mëparshme. Ajo veçori është shoqërimi i atyre të cilëve All'llahu i ka mirësuar dhe është me ta, ku thotë: **"Kushdo që i bindet All'llahut dhe të Dërguarit, do të jetë me ata të cilëve All'llahu u ka dhënë shumë dhunti..."**

Sikurse thamë, në suren "El Fatiha", ata të cilët All'llahu i ka mirësuar, janë ata që kanë ecur në rrugën e drejtë, që nuk kanë bërë gjyhanë dhe nuk janë prej atyre të devijuarve.

¹ *Biharul Envar*, vëll. 22, f. 87-88. Tefsiri *Mexhmaul Bejjan*, komentimi i këtij ajeti.

Pastaj, në sqarim të kësaj fjalie, ajeti i tregon dhe i kufizon ata që All'llahu i ka mirësuar, që janë katër grupe dhe përbëjnë katër shtyllat e kësaj tematike. Ata janë:

1- Profetët: Janë të dërguarit e All'llahut të Lartësuar, të cilët ishin pionierë, udhëheqës dhe thirrës të njerëzimit në rrugën e drejtë: **“me Profetët”**.

2- Të vërtetët: Ata janë të vërtetët në thënie dhe e vërtetojnë besimin e tyre me vepra të mira. Ata konstatojnë e nuk janë thjesht pretendues të besimit, por janë besimtarë të vërtetë në urdhrat e All'llahut dhe në mësimet e Tij ku All'llahu i Lartësuar thotë: **“me të vërtetët”**.

Nga kjo shprehje qartësohet se nuk ka pozitë më të lartë pas Profetësisë, se pozita e vërtetësisë. Kjo vërtetësi nuk kufizohet vetëm në vërtetësinë e fjalës, por është vërtetësi në thënie dhe në vepra, vërtetësi në ushtrime dhe qëndrime. Vërtetësia përfshin gjithashtu amanetin dhe sinqeritetin, sepse amaneti është vërtetësi në punë, ashtu sikurse është vërtetësia amanet në thënie. Nuk ka cilësi më të shëmtuar pas mosbesimit (kufrit) sesa gënjeshtria (el kidhbu), hipokrizia (en nifak) dhe tradhtia (el khijanetu) në thënie e në vepra. Duhet theksuar se fjala "es sidijk" është trajta hiperbolizuese e të qenit i vërtetë dhe ka kuptimin e vërtetësisë nga jashtë dhe nga brenda.

Në disa hadithe, fjala “Sidijk” është komentuar për Aliun dhe për imamët e Ehli Bejtit të Profetit (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij)¹. Dhe ky komentim, sikurse e thamë më lart, është për anën e qartësimin të

¹ *Usulul Kafij*, vëll. 2, f. 78. *Biharul Envar*, vëll. 16, f. 354-355.

vërtetësisë së plotë e të qartë të këtij ajeti dhe nuk përfitohet prej tij veçimi e as ndarja.

3- Dëshmorët: Janë ata që janë vrarë në rrugë të All'Ilahut dhe në rrugë të besimit të pastër, ose ata të cilët dëshmojnë në Botën Tjetër për njerëzit dhe për veprat e tyre: **"me dëshmorët"**.

4- Punëmirët: Janë ata, të cilët, me punët e tyre të mira dhe të dobishme dhe me ndjekjen e Profetëve dhe të urdhrave të tyre, arriten në grada të larta: **"dhe me punëmirët! Eh sa shokë të mrekullueshëm janë këta!"**

Për këtë, është komentuar në transmetimet dhe hadithet tona, se fjala "punëmirët" është për të zgjedhurit nga shokët e imamëve (Paqja qoftë mbi ta!).

Pika e vlefshme që duhet të përmendet është se përmendja e këtyre katër fazave mund të jetë tregues se për ndërtimin e një shoqërie të shëndoshë e punëmirë patjetër duhet të fillohet me: Profetët, që janë udhëheqësit dhe udhëzuesit drejt udhëzimit të vërtetë; pastaj ata i ndjekin predikuesit e vërtetë në fjalë e veprë. Veprat e tyre vërtetojnë thëniet e tyre në predikime dhe ata janë përhapës të të vërtetave në çdo vend; pastaj pas fazës së ndërtimit mendor dhe fetar, grupe njerëzish vihen përballë individëve shkatërrues e devijues dhe kundër atyre që pengojnë të vërtetën dhe të drejtën. Ata sakrifikojnë me vetat e tyre dhe japin jetën e tyre për hir të vërtetës dhe të drejtës. Rezultati i këtyre përpjekjeve është dukja e punëmirëve dhe qëndrueshmëria e shoqërisë së pastër e të drejtë.

Është mëse e qartë se punëmirët duhet që t'i kryejnë këto tri detyra, pra: të udhëheqin, të predikojnë dhe të sakrifikojnë, me

qëllim që prushi i së vërtetës të qëndrojë i ndezur si pishtar i ndritur për brezat e ardhshëm.

Po ashtu, nga përmbajtja e këtyre ajeteve, përfitohet kjo e vërtetë se çështja e shoqërimit të punëmirëve dhe shoqërimi i shokëve të mirë ka një rëndësi të madhe, e cila konsiderohet si pjesa e fundit plotësuese e mirësive të All'llahut, me të cilat Ai i ka mirësuar të bindurit në Xhennet.

Përveç mirësive dhe veçantive që fitojnë, do të kenë privilegjin që të shoqërohen edhe me Profetët, me të vërtetët, me dëshmorët dhe me punëmirët.

Ndoshta është e tepërt për t'u thënë se shoqërimi i këtyre katër grupeve nuk do të thotë se ata janë në të njëjtën pozitë dhe se ata, në të gjitha aspektet, janë në të njëjtën gradë, por do të thotë se për secilin nga ata ka një pjesë të veçantë që është në përputhje me dhuntitë e Zotit. Ata janë si pemët e një kopshti, si bimët dhe lulet e tij, të cilat edhe pse janë në një vend dhe të gjitha përfitojnë nga drita e diellit dhe nga shiu, ato nuk janë të barabarta në masën e përfitimit prej diellit dhe shiut. Gjithashtu, ato nuk janë të barabarta në vlerë.

Pastaj, në ajetin pasardhës, All'llahu i Lartësuar qartëson rëndësinë e kësaj veçorie të madhe (sigurisht shoqërinë e të pastërve, të zgjedhurve). Me të vërtetë, kjo është një dhunti nga ana e All'llahut dhe Ai është i Gjithëditur për gjendjen e robve të Tij, për aftësitë dhe për qëllimet e tyre: " **Kjo dhunti është nga All'llahu, e mjafton që All'llahu e di çdo gjë.**" Ai nuk gabon në shpërblim dhe ndëshkim.

Ajeti 71

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا خُذُوا حِذْرَكُمْ فَانْفِرُوا ثُبَاتٍ أَوْ اَنْفِرُوا جَمِيعًا



"O ju që keni besuar! Bëhuni syçelë (kundër armikut) e luftojeni atë, qoftë grupe-grupe ose të gjithë së bashku!"

Komentimi

Fjala “hidhrun” do të thotë *zgjim, maturi, kujdesje, syçelë*, për një rrezik të mundshëm, sikurse e ka kuptimin nganjëherë mënyra, e cila do të ndihmonte për të ruajtur e për t’i bërë ballë rrezikut. E ndërsa fjala “thubat” do të thotë grupe të ndara dhe njëjësi i saj është “thubtetun”, që do të thotë *grup*.

Kur’ani, në këtë ajet, u drejtohet të gjithë myslimanëve dhe u paraqet atyre dy mësimë të domosdoshme për të ruajtur ekzistencën e tyre dhe të shoqërisë islame në drejtim të çdo rreziku që e kërcënon ekzistencën e saj.

Në fillim të tij, ajeti i urdhëron myslimanët që të jenë syçelë e vigjilentë dhe të qëndrojnë në gjendje të gatshme për t'u bërë ballë armiqve dhe i paralajmëron ata nga pavëmendshmëria ndaj kësaj çështjeje. All'illahu i Lartësuar thotë: **"O ju që keni besuar! Bëhuni syçelë (kundër armikut)..."**

Pastaj ajeti urdhëron që të përfitohet nga mënyrat dhe taktikat e ndryshme në përballje me armikun nga mësymjet në formë grupesh ose në formën e ushtrisë së unifikuar e të bashkuar nëse është nevoja për mësymjen. Por në të dy këto raste, patjetër duhet që t'i bëhet ballë bashkarisht, siç thotë ajeti: **"...e luftojeni atë, qoftë grupe-grupe ose të gjithë së bashku!"**

Disa komentues të Kur'anit kanë thënë se fjala "el hidhr", në këtë ajet, do të thotë "armë" dhe s'ka kuptim tjetër. Ndërkohë që fjala "el hidhr" ka kuptim të gjerë dhe nuk kufizohet me kuptimin e armës. Pastaj, ajeti 102 i kësaj sureje tregon qartë se fjala "el hidhr" nuk ka kuptimin e armës: **"e i lini armët, por edhe atëherë, bëhuni syçelë"** dhe lejimi i heqjes së armëve (në namaz) së bashku me vigjilencën, syçelësinë tregon se fjala *hidhret* nuk e ka kuptimin armë. Ky ajet përfshin absolutisht çështjen e të gjithë myslimanëve në çdo kohë. Ky urdhër u bën thirrje myslimanëve që të jenë syçelë e vigjilentë dhe përherë të gatshëm që t'i bëjnë ballë çdo të papriture nga ana e armiqve dhe të ruajnë sigurinë e ymetit dhe kjo të bëhet gjithmonë nëpërmjet rrugës së përgatitjes materiale e shpirtërore.

Fjala "el hidhr", me kuptimet e saj të gjera, përfshin çdo lloj mjeti mbrojtës material dhe shpirtëror që myslimanët duhet ta përdorin. Duhet që ata të jenë të aftë të njihen me mundësinë e

armikut si nga ana e forces, ashtu edhe e numrit, me metodat e tij luftarake me strategjinë dhe forcën e armëve të tyre, me mënyrën e ballafaqimit të armatimit të tij dhe të ruajtjes nga rreziku i tij. Në këtë mënyrë, myslimanët sigurojnë nga ana veprorë atë çfarë kërkon prej tyre fjala “hidhr” nga përgatitja, vigjilenca dhe kujdesja për t'i bërë ballë çdo sulmi të papritur.

Çështja e vigjencës përfshin edhe përgatitjen shpirtërore, kulturore dhe ekonomike për të mobilizuar të gjitha mundësitë njerëzore dhe për të përfituar nga llojet më të forta të armëve dhe më të sofistikuara në kohën e kërkuar. Po kështu, të jenë të përgatitur me njohjen e formës dhe të mënyrës së përdorimit të këtyre armëve. Nëse myslimanët do të të interesoheshin për këtë çështje dhe do ta zbatonin në jetën e tyre të përditshme, ata do ta largonin dështimin dhe mposhtjen nga vetat e tyre dhe nga bashkësia e tyre gjatë historisë së tyre të mbushur me ngjarje.

Edhe diçka tjetër që kuptohet nga ky ajet është ndryshimi i formave të përballjes së armikut sipas domosdoshmërisë, kohës dhe kushteve. Nëse përballja me armikun kërkon grupe të ndara, do t'u detyrohej përdorimi i kësaj mënyre me të gjitha çfarë ka nevojë nga numri dhe mundësitë. Ka mundësi që pozicioni i armikut është në atë formë që ka nevojë për një grup të përbashkët për t'u përballur. Për këtë, është detyrë e myslimanëve që të përgatisin mjetet e duhura si në numër, ashtu edhe në armatim për këtë sulm.

Nga këtu qartësohet se këmbëngulja e disave se për myslimanët duhet të ketë një mënyrë të vetme përballjeje pa asnjë ndryshim në taktikë, nuk bazohet në logjikë të shëndoshë dhe nuk

e mbështet eksperiencia. Është në kundërshtim me shpirtin e mësimave islame.

Ndoshta ky ajet, gjithashtu, tregon se çështja më e rëndësishme është realizimi i qëllimeve të vërteta, qoftë në ndjekjen e një mënyrë të vetme ose të ndjekjes së disa lloje mënyrash.

Nga fjala “xhemian” (të gjithë), kuptohet se të gjithë myslimanët janë të detyruar të marrin pjesë në çështjen e përbaljes me armikun dhe ky rregull nuk është i posaçëm vetëm për një grup të caktuar.

Ajetet 72 - 73

وَإِنَّ مِنْكُمْ لَمَنْ لَّيَبْطِئَنَّ فَإِنْ أَصَابَكُمْ مُصِيبَةٌ قَالْ قَدْ أَنْعَمَ اللَّهُ عَلَيَّ إِذْ
لَمْ أَكُنْ مَعَهُمْ شَهِيدًا ﴿٧٢﴾ وَلَئِنْ أَصَابَكُمْ فَضْلٌ مِّنَ اللَّهِ لَيَقُولَنَّ كَأَن لَّمْ
تَكُنْ بَيْنَكُمْ وَبَيْنَهُ مَوَدَّةٌ يَلْبِئَنِي كُنتُ مَعَهُمْ فَأَفُوزَ فَوْزًا عَظِيمًا ﴿٧٣﴾

"Në të vërtetë, disa prej jush ngurrojnë për të shkuar në luftë. Nëse ju ndodh ndonjë fatkeqësi, ndonjëri thotë: 'Vetë All'lahu më ka shpërblyer mua për të mos u gjendur i pranishëm me ta.'"

"E nëse ju arrin ndonjë e mirë nga All'lahu, ai atëherë, me siguri thotë - a thua se nuk ka midis tij dhe jush dashamirësi -: 'Ah, sikur të kisha qenë me ata e të arrija sukses të madh!'"

Komentimi

Pas ardhjes së urdhrit të përgjithshëm myslimanëve për xhihad dhe përgatitjes për t'u bërë ballë armiqve, që u përmendën në ajetin e përparshëm, këto dy ajete qartësojnë qëndrimin e hipokritëve ndaj xhihadit dhe zbulon hezitimin e tyre. Ata këmbëngulnin që të mos merrnin pjesë në xhihad në rrugën e

All'Ilahut: "Në të vërtetë, disa prej jush¹ ngurojnë² për të shkuar në luftë..."

Kur kthehen muxhahidët (luftëtarët) nga fusha e betejës, ose kur arrijnë lajmet e luftimeve të tyre, nëse atyre u ndodh diçka e papëlqyeshme në luftë, hipokritët i shikon duke biseduar me kënaqësi se All'Ilahu i mirësoi që nuk morën pjesë me luftëtarët në atë luftë dhe gëzohen për mospraninë për të parë atë luftë të tmerrshme. All'Ilahu i Lartësuar thotë: **"... Nëse ju ndodh ndonjë fatkeqësi, ndonjëri thotë: 'Vetë All'Ilahu më ka shpërblyer mua për të mos u gjendur i pranishëm me ta.'"**

Kur atyre u shkon lajmi i fitores së myslimanëve muxhahidijnë dhe i marrjes së plaçkave të luftës, ndryshon qëndrimi i atyre hipokritëve. Në fytyrat e tyre duket mërzia dhe pendimi dhe kanë ndjesinë se janë të huaj dhe sikur nuk kanë asnjë lidhje me myslimanët duke përsëritur shprehjen e keqardhjes. All'Ilahu i Lartësuar thotë: **"E nëse ju arrin ndonjë e mirë nga All'Ilahu, ai atëherë, me siguri thotë - a thua se nuk ka midis tij dhe jush dashamirësi -: 'Ah, sikur të kisha qenë me ata e të arrija sukses të madh!'"**

Në ajet ka kuptim material për triumfin sipas mendimit të hipokritëve. Ai që e sheh martirizimin dhe vrasjen në rrugën e All'Ilahut si fatkeqësi dhe e quan shpëtimin nga vrasja apo

¹ Duhet thënë se ajeti i lartpërmendur u flet besimtarëve, por githashtu edhe hipokritëve. Frazja "minkum", prej jush, i bën hipokritët pjesë prej besimtarëve e kjo sepse hipokritët gjithmonë gjendeshin në mesin e besimtarëve. Nga këtu llogariten pjesë e tyre.

² Fjala "lejteenne" vjen nga fjala "el bet'u" - ngurim në lëvizje. Kjo do të thotë se ata ngurojnë në lëvizje dhe ftojnë edhe të tjerët në ngurim. Pra, nganjëherë ata nxisin vetat e tyre për ngurim dhe herë tjetër nxisin të tjerët për ngurim.

martizimin si mirësi të Zotit, ai e sheh triumfin vetëm nga ana e marrjes së plaçkave të luftës dhe me kënaqësitë materiale.

Ata hipokritë, mbartës të ngjyrave të ndryshme, për fat të keq, ndodhen në çdo shoqëri. Shumë shpejt e ndryshojnë maskën e tyre kur besimtarët përballen me triumf apo me humbje. Ata nuk bëhen pjesëtarë të besimtarëve në vështirësitë e tyre dhe as nuk i ndihmojnë ata në fatkeqësi. Por ama, ata hipokritë duan që të kenë pjesën e tyre në triumfet dhe fitoret madhështore dhe të fitojnë ato veçori që fitojnë luftëtarët besimtarë.

Ajeti 74

﴿ فَلْيُقَاتِلْ فِي سَبِيلِ اللَّهِ الَّذِينَ يَشْرُونَ الْحَيَاةَ الدُّنْيَا بِالْآخِرَةِ ۚ وَمَنْ

يُقَاتِلْ فِي سَبِيلِ اللَّهِ فَيُقْتَلْ أَوْ يَغْلِبْ فَسَوْفَ نُؤْتِيهِ أَجْرًا عَظِيمًا ۝

"Le të luftojnë në rrugën e All'llahut ata që nuk e kursejnë jetën e kësaj bote për jetën e ardhshme. Atij që lufton në rrugën e All'llahut, e vritet ose fiton, Ne, me siguri, do t'i japim shpërblim të madh."

Komentimi

Përgatitja e besimtarëve për xhihad

Pas qartësimit, në ajetin e mëparshëm, të mospranimimit e hipokritëve që të marrin pjesë në luftë me muxhahidët, ajeti dhe ai që vjen më pas, u drejtohet besimtarëve me gjuhë inkurajuese dhe u bën thirrje atyre për xhihad në rrugën e All'llahut. Zbritaj e këtyre ajeteve në kohën kur Islami kërcënohej nga armiq të ndryshëm, të brendshëm apo të jashtëm, tregon për rëndësinë e saj në edukimin e shpirtit të xhihadit tek myslimanët.

Ky ajet në fillim sqaron se pesha e rëndë e xhihadit duhet të jetë mbi shpatullat e atyre që e kanë shitur jetën e tyre materiale kalimtare në këmbim me Jetën Tjetër të përjetshme. All'llahu i

Lartësuar thotë **"Le të luftojnë në rrugën e All'llahut ata që nuk e kursejnë jetën e kësaj bote për Jetën e Ardhshme..."** Që do të thotë se vetëm luftëtarët janë të gatshëm të hyjnë në këtë marrëveshje pasi u është zbuluar pavleftësia e kësaj bote materialiste. Ata e kuptuan se kjo botë nuk ka vlerë përballë Jetës së përherëshme. Kurse ata të cilët e shohin të vërtetën tek kjo botë materialiste të ulët dhe e konsiderojnë atë (dynjanë) më të Lartë dhe më të madhe se qëllimet e shenjta hyjnore dhe qëllimet e larta njerëzore, ata kurrë nuk mund të jenë luftëtarë të vërtetë e të singertë.

Ky ajet vijon të qartësojë se fundi i luftëtarëve të vërtetë, të cilët e shitën këtë botë për Botën Tjetër ose është triumfi ndaj armiqve, ose rënia dëshmor në rrugën e All'llahut. Në të dyja gjendjet kanë fituar një shpërblim dhe fitore të madhe nga All'llahu i Lartësuar, i Cili thotë: **"... Atij që lufton në rrugën e All'llahut, e vritet ose fiton, Ne, me siguri, do t'i japim shpërblim të madh."**

Është e natyrshme se të tillë ushtarë nuk e njohin kuptimin e humbjes. Si do që të jetë, triumfojnë ndaj armikut apo bien dëshmorë në rrugë të All'llahut të Lartësuar, në të dy këto raste ato shohin veçse triumfin.

E tillë gjendje shpirtërore është sipërmarrëse për triumf dhe fitore ndaj armikut. Historia është dëshmuesi më i mirë se kjo gjendje shpirtërore ka qenë faktori i triumfit të myslimanëve ndaj armiqve të tyre që ishin më të shumtë në numër dhe më të armatosur.

Këtë e vërtetojnë edhe mendimtarët jomyslimanë të cilët kanë shkruar për fitoret e shpejta që korrnin mysliimanët në kohën e Profetit dhe në kohët e tjera.

Historiani i njohur perëndimor Gustav Lubon, në një libër të tij thotë: *"Vërtet, mysliimanët nuk i trembeshin vdekjes në rrugën e fesë së tyre të re përshkak të premtimeve hyjnore në Jetën Tjetër. Ata nuk besojnë në përjetshmërinë e kësaj jete. Për këtë heqin dorë nga kjo jetë për hir të rrugës së besimit dhe qëllimit."*¹

Këtu duhet përmendur se ky ajet dhe ajete të tjera në Kur'an e konsiderojnë xhihadin të shenjtë nëse është: në rrugën e All'lahut, për shpëtimin e njerëzimit, për ringjalljen e principeve të së vërtetës, të drejtës, të pastrës dhe të devotshmes. Ndryshe nga luftërat që kryhen me qëllim pushtimi dhe për shkak të racizmit, shtypjes dhe shfrytëzimit.

¹ Gustav Lubon, Historia e qytetërimit islam dhe arab, f. 155.

Ajeti 75

وَمَا لَكُمْ لَا تُقَاتِلُونَ فِي سَبِيلِ اللَّهِ وَالْمُسْتَضْعَفِينَ مِنَ الرِّجَالِ
وَالنِّسَاءِ وَالْوِلْدَانِ الَّذِينَ يَقُولُونَ رَبَّنَا أَخْرِجْنَا مِنْ هَذِهِ الْقَرْيَةِ الظَّالِمِ
أَهْلُهَا وَاجْعَلْ لَنَا مِنْ لَدُنْكَ وَلِيًّا وَاجْعَلْ لَنَا مِنْ لَدُنْكَ نَصِيرًا ﴿٧٥﴾

"Ç'keni ju që nuk luftoni në udhë të All'Ilahut dhe për shpëtimin e të shtypurve: për meshkujt e pafuqishëm, gratë dhe fëmijët, të cilët thërrasin: 'O Zoti ynë! Nxirrna nga ky qytet, banorët e të cilit janë keqbërës! Na cakto një mbrojtës dhe na dërgo nga ana Jote dikë që të na ndihmojë!'"

Komentimi

Kërkimi i ndihmës me ndjenjat dhe emocionet njerëzore

Ajeti i mëparshëm ftonte besimtarëve në xhihad duke u mbështetur te besimit i tyre në All'Ilahun dhe në Ditën e Gjykimit dhe gjithashtu përfshin edhe çështjen e fitimit ose të humbjes në kontekstin e thirrjes së tyre për luftë.

Ndërsa ky ajet e mbështet thirrjen e tij për xhihad tek ndjenjat dhe emocionet njerëzore duke u bërë thirrje ndjenjave dhe emocioneve të besimtarëve me demonstrimin e asaj me të cilat po përballen burrat, gratë dhe fëmijët e të shtypurve e të

privuarve nga ndëshkimi dhe padrejtësia e udhëheqësit tiran e zullumqar. Ai u kërkon besimtarëve, duke iu drejtuar ndjenjave të tyre, nëpërmjet shfaqjes së fatkeqësive dhe vuajtjeve të dhimbshme të cilat i përjetojnë të shtypurit e të privuarit, të luftojnë në rrugën e All'llahut për t'i shpëtuar këta të shtypur. All'llahu i Lartësuar thotë: **"Ç'keni ju që nuk luftoni në udhë të All'llahut dhe për shpëtimin e të shtypurve: për meshkujt e pafuqishëm¹, gratë dhe fëmijët..."**

Për të ndikuar më shumë tek ndjenjat, ajeti u thotë besimtarëve se të privuarve të përmendur përshkak të vujtjeve, rënkimeve, torturave dhe persekutimit, kanë humbur shpresën për të shpëtuar dhe janë molisur nga çdo ndihmesë e jashtme. Për këtë ata filluan t'i luten All'llahut të Lartësuar që t'i nxjerrë ata nga ai pellg i tmerrshëm i mbushur me të gjitha llojet e padrejtësisë dhe ashpërsisë: **"...të cilët thërrasin: "O Zoti ynë! Nxirrna nga ky qytet, banorët e të cilit janë keqbërës!..."** Gjithashtu, ata të privuar i kërkojnë All'llahut që t'u dërgojë atyre persona që marrin përsipër ruajtjen, mbrojtjen dhe shpëtimin e tyre prej të padrejtëve dhe tiranëve. **"...Na cakto një mbrojtës dhe na dërgo nga ana Jote dikë që të na ndihmojë!"**

Ky ajet në të vërtetë tregon se All'llahu i Lartësuar i është përgjigjur lutjes së të dobhtëve e të privuarve. Ky mesazh i madh human u është ngarkuar juve o myslimanë. Ju jeni bërë kujdestarët mbrojtës (mbikqyrës) dhe ju jeni shpëtimtarët nga ana

¹ Dallimi mes fjalës "el mustad'af" i privar, dhe "ed daiif", i dobët është i qartë sepse "daiif" është ai që nuk ka fuqi e forcë. Kurse "mustad'af" është ai që është dobësuar për shkak të goditjes së tij nga padrejtësia. Nuk ka dallim në qënien e privimit, mendor, kulturor, moral, ekonomik, poliotik dhe social. Prandaj, fraza këtu është gjithpërfshirëse dhe përfshin të gjitha llojet e privimit.

e All'lahut për t'i shpëtuar të privuarit. Prandaj, është detyrë e juaja që të ngriheni me këtë përgjegjësi dhe të shfytëzoni këtë mundësi të madhe që iu është dhënë dhe mos e humbisni atë.

Nga ky ajet përfitojmë disa gjëra të cilat janë:

1- Me të vërtetë xhihadi në rrugën e All'lahut, siç u tha më lart, nuk është për arsye për t'u marrë të tjerëve pasurinë dhe pushtetin nga duart e tyre. Po ashtu, xhihadi nuk ka si qëllim ngritjen e tregjeve për konsumimin e mallrave apo për të imponuar me forcë besime të posaçme. Por qëllimi i xhihadi është për të përhapur mirësinë, besimin dhe për mbrojtur gratë, burrat dhe fëmijët e privuar. Nga ky këndvështrim qartësohet se xhihadi ka dy qëllime gjithpërfshirëse që nënkuptohen nga ky ajet dhe ato janë: qëllimi "hyjnor" dhe qëllimi "njerëzor" të cilët plotësojnë njëri-tjetrin dhe nuk ndahen.

2- Me të vërtetë Islami ka mendimin se mjedisi në të cilin njeriu mundet të jetojë në të është mjedisi i cili i siguron lirinë njeriut dhe i garanton atij të vepruarit bazuar në atë që beson pa pengesë dhe keqbërje. Gjithashtu, Islami ka mendimin se mjedisi që është i pushtuar nga zullumi dhe terrorizmi ku myslimani nuk mundet që të shfaqë e të prezantojë besimin e tij ose të shprehë Islamin e tij, ai mjedis nuk ia vlen që myslimani të jetojë në të. Për këtë ky ajet u kërkon besimtarëve që t'i drejtohen All'lahut me lutje që t'i nxjerrë ata nga kjo klimë e mbushur me padrejtësi dhe shypje.

Megjithëse Meka ishte strehim për muhaxhirët, përhapja e padrejtësisë në të i bëri besimtarët që t'i luten All'lahut që t'i

shpëtojë nga padrejtësitë e banorëve të këtij qyteti dhe t'ua lehtësojë atyre rrugën për të dalë prej tij.

3- Në përfundim të këtij ajeti shohim se besimtarët, të cilët përjetojnë vuajtjet e mjedit të padrejtë, i drejtohen All'llahut të Lartësuar me lutje që t'u dërgojë ruajtës, kujdestar që t'i ruajë dhe të mbrojë të drejtat e tyre, ti triumfojë ata nga zullumqarët dhe t'i shpëtojë nga kthetrat e tyre. Nga ky ajet kuptohet rëndësia e udhëheqësjes së drejtë dhe rëndësia e aftësisë dhe e fuqisë së kësaj udhëheqjeje në shpëtimin e të shtypurve. Po ashtu kuptohet se kjo udhëheqje është e domosdoshme që të ketë numër dhe paisje që e mundësojnë në kryerjen e përgjegjësiave të saj.

Nga ky ajet mësojmë elementët që duhet t'i ketë çdo udhëheqje islame dhe ato janë:

a- Duhet që udhëheqja të jetë e drejtë (me gjithë kuptimin e plotë të fjalës)

b- Të jetë e fortë dhe e fuqishme (të zotërojë numrin dhe paisjet e mjaftueshme si dhe të ketë plane ushtarake që garantojnë suksesin e përdorimit të fuqisë ekzistuese.)

4- Ky ajet qartëson se besimtarët ia kërkojnë nevojat e tyre vetëm All'llahut të Lartësuar e të Plotfuqishëm dhe askujt tjetër. Përveç kësaj, ata i drejtohen All'llahut që t'u dërgojë një njeri që të marrë përsipër mbrojtjen dhe triumfin e tyre ndaj të padrejtëve.

Ajeti 76

الَّذِينَ ءَامَنُوا يُقَاتِلُونَ فِي سَبِيلِ اللَّهِ وَالَّذِينَ كَفَرُوا يُقَاتِلُونَ فِي سَبِيلِ
الطَّاغُوتِ فَفَاتِلُوا أَوْلِيَاءَ الشَّيْطَانِ إِنَّ كَيْدَ الشَّيْطَانِ كَانَ ضَعِيفًا ﴿٧٦﴾

"Ata që besojnë, luftojnë në rrugën e All'llahut, kurse ata që nuk besojnë, luftojnë në rrugën e djallit. Luftoni kundër ithtarëve të djallit, sepse vërtet, dinakëria e djallit është e dobët!"

Komentimi

Ajetet e lartpërmendura sqaruan çështjen e xhihadit dhe nxorren në pah elementët e tij, shkaqet e tij dhe se kujt i drejtohet. Në këtë ajet vërejmë se ai i nxit muxhahidinët (ata që luftojnë në rrugën All'llahut) për luftë dhe sqaron qëllimet e tyre duke dëshmuar dhe vërtetuar se ata luftojnë në rrugën e All'llahut, për interesin e robëve të Tij. Ndërsa jobesimtarët luftojnë në rrugën e tiranisë e të padrejtësisë, pra në rrugën e djallit. **"Ata që besojnë, luftojnë në rrugën e All'llahut, kurse ata që nuk besojnë, luftojnë në rrugën e djallit..."** Pra, për asnjë çast bota nuk është e zbrazët nga përpjekja dhe konflikti. Mirëpo, një grup lufton për rrugën e drejtë dhe grupi tjetër lufton për rrugën e shejtanit dhe të padrejtësisë.

Për këtë, ky ajet u kërkon përkrahësve të së vërtetës që të dalin në luftë për të luftuar ndjekësit e shejtanit pa patur frikë. All'llahu i Lartësuar thotë: **"...Luftoni kundër ithtarëve të djallit..."**

Gjithashtu, ky ajet sqaron këtë të vërtetë të rëndësishme se idhujtaria dhe forca e tiranisë së saj, sado që të posedojë fuqi në aparence, ajo është e dobët në brendësinë e saj. Kështu që ky ajet i qetëson zemrat e besimtarëve që të mos frikësohen nga ata të padrejtë sado që të kenë pushtet e numër të madh forcash sepse ata nuk kanë asnjë qëllim dhe janë të zbrazët nga besimi. Për këtë e gjithë strategjia e tyre është e dobët dhe e zbrazët njësoj si fuqia e tyre sepse ata nuk mbështeten tek All'llahu i Plotfuqishëm, por ata mbështeten tek fuqia dhe pushteti i djallit që janë të dobët. All'llahu i Lartësuar thotë: **"...sepse vërtet, dinakëria e djallit është e dobët!"**

Ndërsa prania e fuqisë së përkrahësve të së vërtetës është se ata ecin në rrugën e qëllimeve dhe të vërtetave që përshtaten me ligjin e krijimit dhe të ekzistencës. Ata (muxhahidinët) luftojnë në rrugën e çlirimit të njeriut dhe në rrugën e zhdukjes së gjurmëve të padrejtësisë dhe tiranisë. Ndërsa të padrejtët, tiranët dhe ndjekësit e tij luftojnë për arsye të përfitimit të tyre personal ose veprojnë në shërbim të tiranëve, dhe të padrejtëve duke shtypur njerëzit për të kënaqur epshet dhe egot e tyre kalimtare gjë e cila e çon shoqërinë në degradim, humbje dhe shkatërrim, sepse veprimi i të padrejtëve dhe i tiraninëve është në kundërshtim me sekretin e ekzistencës dhe me ligjin e pastër të natyrës fillestare (el fitratu). Kjo është nga njëra anë, e ndërsa nga ana tjetër, besimtarët duke u mbështetur tek fuqitë e larta

shpirtërore, gëzojnë vetëbesim dhe qetësi shpirtërore që i përgatit atyre rrugën e fitores dhe të triumfit ndaj armiqëve. Jo vetëm kaq, All'illahu u dhuron atyre forcë që t'i rezistojnë mësymjes së armikut. Ndërsa armiqtë, jobesmtarët nuk mbështeten asnjëherë mbi bazë të fortë.

Është e vlefshme të përmendet se ky ajet i ka krahasuar të padrejtët, tiranët me djallin. Kjo tregon se fuqitë tirane e të padrejta e kanë fuqinë dhe ndihmën nga burime të dobta që përfaqësohen në forcën e djallit e cila është e dobët.

Këtë përmbajtje gjithashtu e përmend ajeti 27 i sures "El A'raf", ku All'illahu i Lartësuar thotë: **"Ne i kemi bërë shejtanët miq të atyre që nuk besojnë."**

Ajeti 77

أَلَمْ تَرَ إِلَى الَّذِينَ قِيلَ لَهُمْ كُفُّوا أَيْدِيَكُمْ وَأَقِيمُوا الصَّلَاةَ وَآتُوا الزَّكَاةَ
فَمَا كُتِبَ عَلَيْهِمُ الْقِتَالُ إِذَا فَرِيقٌ مِنْهُمْ تَخَشَّوْنَ النَّاسَ كَخَشْيَةِ اللَّهِ أَوْ
أَشَدَّ خَشْيَةً ۚ وَقَالُوا رَبَّنَا لِمَ كَتَبْتَ عَلَيْنَا الْقِتَالَ لَوْلَا أَخَّرْتَنَا إِلَىٰ أَجَلٍ
قَرِيبٍ ۗ قُلْ مَتَاعُ الدُّنْيَا قَلِيلٌ وَالْآخِرَةُ خَيْرٌ لِّمَنِ اتَّقَىٰ وَلَا يُظْلَمُونَ

فَتِيلًا ﴿٧٧﴾

“A nuk i ke parë (o Muhammed) ata që janë porositur: ‘Tërhiqni duart tuaja nga lufta, falni namazin dhe jepni zekatin?!’ Por kur, pas kësaj, u urdhëruan që të luftojnë, një grup prej tyre u frikësua nga njerëzit, ashtu si i frikësohen All'Ilahut, madje edhe më tepër dhe thirrën: ‘O Zoti ynë! Pse na caktove të luftojmë? Ah, sikur të na kishe kursyer lufta edhe për një kohë të shkurtër!’ Thua ju: ‘Kënaqësitë e kësaj jete janë të vogla. Jeta Tjetër është më e mirë për ata që e kanë frikë All'Ilahun e s’bëjnë gjynahe. Juve nuk do t’ju bëhet asnjë fije padrejtësi.’”

Shkaku i zbritjes

Nga një grup komentuesish si, Shejkh Et Tusij në komentimin e tij Tibijjan dhe Kurtubij, autori i tefsirit El Manar, transmetojnë nga ibn Abasi se një grup prej myslimanëve gjatë qëndrimit të tyre në Mekë, përpara shpërnguljes, kanë përjetuar presionet dhe keqbërjet e josbesimtarëve dhe idhujtarvë. Ata shkuan te Profeti (Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe i kërkuan leje që t'i luftonin armiqtë e tyre. Profeti u tha atyre se nuk është urdhëruar akoma nga ana e All'Ilahut për xhihad (për t'i luftuar e shpallur luftë josbesimtarëve dhe idhujtarëve).

Kaluan ditë nga kërkesa e tyre derisa myslimanët emigruan për në Meidine dhe atje u plotësuan kushtet për luftë dhe All'Ilahu i Lartësuar i urdhëroi myslimanët për xhihad. Disa persona nga grupi që këmbëngulnin para Profetit për xhihad dhe për luftë kundër armiqve në Mekë, shfaqën dembelizëm dhe plogështi në zbatimin e këtij urdhëri hyjnor dhe tek ata nuk dukej aspak entuziazmi i dëshirës për xhihad sikurse e shfaqnin në Mekë. Atëherë, zbriti ky ajet i cili i nxiti myslimanët për xhihad dhe u tërheq vërejtjen dembelëve dhe të plogtëve nga ky detyrim i shenjtë dhe delikat. Ky ajet ka cekur disa prej të vërtetave të kësaj fushe.¹

¹ Tefsiri *Mexhmaul Bejjan*, vëll. 3, f. 143.

Komentimi

Populli, malli i të cilit janë fjalët dhe jo punët

Ky ajet flet në formë të habitshëm për atë grup që shfaqën dëshirë të zjarrtë për xhihad në kushte jo të përshtatshme dhe këmbëngulnin që të lejoheshin për xhihad, ndërkohë që u urdhëruan për durim dhe vetëpërmbytje. U ftuan të falin namazin dhe të japnin zekatin. Pasi erdhi momenti dhe kushtet e përshtatshme për xhihad dhe u urdhëruan për të, mbi atë grup mbizotëroi frika e paniku dhe ngritën zërin e tyre në kundërshtim të urdhërit hyjnor dhe neglizhonin për zbatimin e atij urdhëri.

Ajeti thotë: **“A nuk i ke parë (o Muhammed) ata që janë porositur: ‘Tërhiqni duart tuaja nga lufta, falni namazin dhe jepni zekatin?!’ Por kur, pas kësaj, u urdhëruan që të luftojnë, një grup prej tyre u frikësua nga njerëzit, ashtu si i frikësohen All'Ilahut, madje edhe më tepër dhe thirrën...”** Ata, në kundërshtim të urdhërit të xhihadit thonin qartë se përse All'Ilahu e përshpejtoi zbritjen e urdhërit për xhihad? Ata dëshironin që All'Ilahu i Lrtësuar ta vononte edhe pak këtë urdhër! Ose kërkonin që çështja e xhihadit t'u lihej brezave të ardhshëm: **“O Zoti ynë! Pse na caktove të luftojmë? Ah, sikur të na kishe kursyer lufta edhe për një kohë të shkurtër!”**

Në fillim Kur'ani famëlartë u përgjigjet atyre nëpërmjet kësaj fraze ku thotë **“...një grup prej tyre u frikësua nga njerëzit, ashtu si i frikësohen All'Ilahut, madje edhe më tepër...”** që do të thotë se ata në vend që t'i frikësohen All'Ilahut të Plotfuqishëm dhe Mposhtës ata i kaploi trishtimi dhe i sundoi frika e tmeri nga

njeriu i dobët dhe i paaftë. Jo vetëm kaq, frika e tyre ndaj njeriut u bë më e madhe se frika ndaj All'llahut të Lartësuar dhe Fuqiplotë.

Pastaj Kur'ani u drejtohet atyre me këtë të vërtetë: Sikur ata, pas lënies së xhihadit që t'u siguronin vetatve të tyre - përshebull- një jetë të shkurtër e të qetë, por me të vërtetë ata do të përbuznin këtë jetë sepse ajo është e shkurtër dhe patjetër kalimtare ndërsa Jeta Tjetër, të cilën All'llahu ua ka premtuar besimtarëve muxhahidë, që i frikësohen vetëm Atij dhe nuk kanë frikë askënd, është më e mirë se kjo botë kalimtare. Vërtet, të devotshmit do të marrin shpërblimin e plotë pa iu bërë aspak padrejtësi. All'llahu i Lartësuar thotë: **“...Thua ju: ‘Kënaqësitë e kësaj jete janë të vogla. Jeta Tjetër është më e mirë për ata që e kanë frikë All'llahun e s’bëjnë gjynahe. Juve nuk do t’ju bëhet asnjë fije padrejtësi.’”**

Është e domosdoshme që të hedhim një vështrim në disa pika të komentimi të këtij ajeti:

Pyetja e parë: Përse ata persona u urdhëruan që vetëm të falin namazin dhe të japin zekatin dhe nuk u urdhëruan për obligimet e tjera të shumta?

Përgjigje: Nga kjo pyetje mund të përmëdhet se namazi është sekreti i lidhjes me All'llahun e Lartësuar kurse dhënia e zekatit konsiderohet çelësi i lidhjes me robtë e All'llahut. Bazuar mbi këtë, në fillim myslimanët janë urdhëruar që të përgatisin vetat e tyre shpirtërisht dhe shoqërinë e tyre për luftë në rrugën e All'llahut nëpërmjet kryerjes së lidhjes së fortë mes tyre dhe All'llahut dhe robëve të Tij. Thënë ndryshe: të përpiqen të formojnë vetveten e tyre dhe në përgatjen e tyre. Është mëse e

natyrshme se çdo xhihad ka nevojë të domosdoshme për përgatitjen shpirtërore dhe për forcimin e lidhjeve shoqërore, sepse pa këtë nuk realizohet dhe nuk arrihet triumfi. Padyshim, që njeriu i forcon lidhjet e tij me All'llahun gjatë namazit, i përsos dhe e edukon shpirtin dhe ndjenjat e tij të brendshme me anë të namazit. Për këtë ai është i përgatitur që të sakrifikojë qoftë edhe me jetën e tij. Po ashtu, edhe zekati është mënyra për shërimin e dhimbjeve shoqërore. Përveç kësaj, zekati është një mbështetës ekonomik në rrugën e përgatitjes së profesionistëve, armatimeve luftarake për të cilat kanë nevojë myslimanët në luftë me armikun që të jenë të përgatitur që t'i bëjë ballë atij kur të vijë urdhri për luftë.

Pyetja e dytë: Është e ditur se dispozita e zekatit përmendet tek ajetet e zbritura në Medinë dhe myslimanët nuk kanë qenë të detyruar që të japin zekatin në Mekë. Atëherë si mund të thuhet që ky ajet flet për gjendjen e myslimanëve në Mekë?

Përgjigje: Esh Shejkh Tusijj¹ i përgjigjet kësaj pyetje në Tefsirin e tij Et Tibjan ku thotë: Zekati që përmendet në këtë ajet është zekati i pëlqyeshëm (mustehab), ai njihej në Mekë. Pra, Kur'ani i ka nxitur myslimanët edhe në Mekë që t'ë ndihmojnë ekonomisht ata që e meritojnë dhe të ndihmojnë ekonominë e shoqërisë së re islame në Mekë.

Ky ajet tregon për një të vërtetë të rëndësishme e cila është se myslimanët në Mekë kanë patur një metodë dhe në Medinë një

¹ Tefsiri Et Tibjan, vëll. 3, f. 261.

metodë tjetër. Në Mekë myslimanët punuan për formimin e personalitetit të tyre islam pasi u çliruan nga mbeturinat e injorancës. Përpyekjet e Profetit (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij) në Mekë ishin të përqëndruara tek edukimi i atyre që braktisën adhurimin e idhujve me qëllim që t'i bënte ata njerëz të devotshëm në përballjet dhe sfidat e myslimanëve. Triumfet dhe fitoret e mëdha që korrën myslimanët në Medinen e ndritshme kanë qenë rezultat i procesit të formimit të personalitetit islam. Ky ishte misioni i mesazhit islam në Mekë.

Myslimanët mësuan shumë në Mekë. Ata praktikuan eksperiencën të shumta dhe fituan një përgatitje të madhe shpirtërore dhe morale gjatë kohës së qëndrimit të tyre në Mekë. Argument i kësaj çështjeje është se afërsisht 90 sure nga suret e Kur'anit, që gjithësej janë 114 sure, kanë zbritur në Mekë. Më tepër përmbajtja e këtyre sureve flet për besimin, moralin dhe edukimin e veçanërisht për të përgatitur personalitetin islam. Kurse në Medinë myslimanët iu kushtuan formimit të shtetit islam dhe ndërtimit të bazave të shoqërisë së shëndoshë islame.

Ky ajet, gjithashtu, tregon se rregulli i dy detyrimeve, xhihadi dhe zekati, nuk ka zbritur në periudhën Mekase sepse xhihadi është nga detyrimet e shtetit islam, siç është edhe formimi i Thesarmbajtjes (Bejtul Mal) prej çështjeve të shtetit islam.

Ajetet 78 - 79

أَيَّنَمَا تَكُونُوا يُدْرِكُكُمُ الْمَوْتُ وَلَوْ كُنْتُمْ فِي بُرُوجٍ مُّشِيدَةٍ ۖ وَإِنْ تُصِبْهُمْ
 حَسَنَةٌ يَقُولُوا هَذِهِ ۖ مِنْ عِنْدِ اللَّهِ ۖ وَإِنْ تُصِبْهُمْ سَيِّئَةٌ يَقُولُوا هَذِهِ ۖ
 مِنْ عِنْدِكَ ۚ قُلْ كُلٌّ مِّنْ عِنْدِ اللَّهِ ۚ فَمَالِ هَؤُلَاءِ الْقَوْمِ لَا يَكَادُونَ
 يَفْقَهُونَ حَدِيثًا ﴿٧٨﴾ مَا أَصَابَكَ مِنْ حَسَنَةٍ فَمِنَ اللَّهِ ۚ وَمَا أَصَابَكَ مِنْ
 سَيِّئَةٍ فَمِنَ نَفْسِكَ ۚ وَأَرْسَلْنَاكَ لِلنَّاسِ رَسُولًا ۚ وَكَفَى بِاللَّهِ شَهِيدًا ﴿٧٩﴾

“Kudo që të gjendeni, do t’ju arrijë vdekja, madje, qofshi edhe në kështjellat më të forta!’ Sa herë që u vjen ndonjë e mirë, ata thonë: ‘Kjo është nga ana e All’liahut.’ Por, nëse i godet ndonjë e ligë, ata thonë: ‘Kjo është prej teje (o Muhammed)!’ Thuaju: ‘Të gjitha janë prej All’liahut.’ Ç’është kështu me këtë popull, që nuk kupton asgjë?”

“Çdo e mirë që të gjen ty o njeri, prej All’liahut është, kurse e keqja që të godet, është prej vetes sate. Ne të kemi sjellë ty (o Muhammed) si të Dërguar për të gjithë njerëzimin. All’llahu mjafton për dëshmitar.”

Komentimi

Nga ajetet paraardhëse dhe ajetet pasardhëse konkludojmë se këto dy ajetete në fjalë kanë si qëllim një grup hipokritësh të cilët u rradhiten në rreshtat e myslimanëve. Në ajetet e mëparshme lexuam se ata hipokritë shfaqën frikë dhe trishtim nga pjesmarrja në përgjegjësinë e xihadit dhe kur u shpall rregulli i xihadit ata i kaploi plogështia dhe dëshpërimi. Atëherë, Kur'ani i shenjtë i'u përgjigj për qëndrimin e tyre dhe u tërhoqi vëmendjen duke u thënë: **"Kënaqësitë e kësaj jete janë të vogla. Jeta Tjetër është më e mirë për ata që e kanë frikë All'llahun e s'bëjnë gjynahe..."**¹ Kjo thënie qartëson se kjo botë me të gjitha stolitë e saj shpejt do të përfundojë e ndërsa ajo çfarë fitojnë besimtarët, të cilët i frikësohen All'llahut dhe nuk i bëjnë Atij mëkate, nga mirësitë dhe shpërblimet është më e mirë se të gjitha mirësitë e kësaj jete.

Në këtë pjesë kur'anore gjendet një përgjigje tjetër ndaj atyre hipokritëve ku u qartëson se vdekja patjetër që do t'u vijë një ditë dhe nuk shpëtoni dot prej saj edhe nëse përgatitni fortifikata e kala të mëdha, sipas mendimit të tyre. Meqenëse vdekja e arrin njeriun, a nuk është më mirë që të vdesë në rrugën e frutshme dhe të drejtë siç është xihadi?!

Ajo që tërheq vëmendjen është se në shumë vende Kur'ani përdor fjalën "jekin" për vdekjen, siç është në suren "Hixhr", ajeti 99 dhe në suren "Mud'deth'thir", ajeti 48. Kuptimi i kësaj fjale kur'anore është se njeriu, si do që të jetë besimi i tij, beson në ekzistencën e vdekjes me një besim absolutisht të padyshueshëm.

¹ Sure "En Nisa", ajeti 77.

Sado që njeriu të mohojë të vërteta, ai nuk e mohon dot vdekjen që e shikon me sytë e tij dhe dëgjon për të çdo ditë. Ai njeri i cili e don këtë botë dhe imagjinon se vdekja është përfundimi dhe nuk ka jetë pas kësaj jete, gjithmonë i frikësohet përmendjes së vdekjes dhe i largohet dukurive të saj. All'llahu i Lartësuar thotë: **"Kudo që të gjendeni, do t'ju arrijë vdekja, madje, qofshi edhe në kështjellat më të forta!..."**

Këto dy ajete përforcojnë të vërtetën se nuk ka mundësi t'i shpëtosh vdekjes. Patjetër që ajo do ta arrijë njeriun një ditë. Kjo është një e vërtetë e prerë dhe e sigurtë në botën e ekzistencës. Shprehja "judrikukum", do t'ju arrijë, që përmendet në ajet ka kuptimin e ndjekjes dhe ndjekësi është vdekja që e kap njeriun. Kjo shprehje inspiron se ikja apo fshehja nuk e shpëton njeriun nga fundi i patjetërsueshëm që është vdekja. Këtë të vërtetë të përmendur e përforcon ajeti 8 i sures "Xhumua" që thotë: **"Thuaj, vdekja prej së cilës po ikni do t'ju arrijë."**

Atëherë nuk është e logjikshme që njeriu ta njohë e ta kuptojë këtë të vërtetë e më pas të largohet nga fusha e xhihadit dhe t'ia ndalojë vetes së tij vdekjen më të ndershme e cila është martirizimi në rrugën e All'llahut dhe të vdesë në shtratin e tij. Sikur njeriu pas lënies së xhihadit të jetojë ditë, javë, muaj ose vite, ai jeton një jetë rutinë dhe çdo ditë përsëritet ajo që ka vepruar në të shkuarën. A është e logjikshme që për hir të këtyre veprimeve të përsëritura njeriu t'ia ndalojë vete së vet mirësitë dhe shpërblimin e përjetshëm që fitojnë luftëtarët në rrugën e All'llahut?

Në ajetin e parë të dy ajeteve në fjalë është edhe një çështje e dytë që i duhet kushtuar interesim. Ajo është fraza "kështjellat

më të forta" e cila përforcon se vdekjen nuk e ndalojnë fortesat dhe kalatë e forta e të larta dhe sekretet në këtë çështje është se vdekja është e natyrshme dhe nuk e sulmon njeriun nga jashtë, ndryshe siç e përfytyrojnë. Ajo nuk ka nevojë të depërtojë fortesat dhe kalatë por vjen nga brendësia e ekzistencës së njeriut ku aparaturat e njeriut ndalojnë nga funksionimi pas mbarimit të fuqisë së tyre të kufizuar për të qëndruar.

Sigurisht vdekja jo e natyrshme i vjen njeriut nga jashtë ekzistencës së tij dhe për këtë ndoshta kështjellat dhe kalatë e fortikuara sjellin dobi në vonesën e kësaj lloj vdekjeje. Por, cili do të jetë përfundimi dhe rezultati? A është në gjendje kështjella dhe fortifikata që të pengojë arritjen e vdekjes së natyrshme, e cila pa dyshim që një ditë prej ditësh do ta arrijë njeriun?!

Nga vijnë fitoret dhe humbjet?

Në këto dy ajete Kur'anit famëlartë tregon një hamendësim tjetër nga hamendësimet e hipokritëve kur sqaron se nëse ata korrin fitore apo marrin mirësitë e plaçkës së luftës, ata thonë se All'llahu është Ai i cili i ka mirësuar ata dhe pretendojnë se janë meritues të këtyre mirësive. All'llahu i Lartësuar thotë: **"Sa herë që u vjen ndonjë e mirë, ata thonë: 'Kjo është nga ana e All'llahut.'"** Nëse i godet humbja apo ndonjë e keqe në fushën e betejës, fajësojnë Profetin (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe shpifin kundër tij duke thënë se ajo që i goditi ishte për fajin e tij duke i quajtur të dobëta planet e tij ushtarake. Prej atyre është ajo që ndodhi në luftën e Uhudit. Ajeti thotë: **"Por, nëse i godet ndonjë e ligë, ata thonë: 'Kjo është**

prej teje (o Muhammed)!" Disa komentues të Kur'anit supozojnë se ky ajet ka zbritur për jehudinjtë. Ata mendojnë se qëllimi në thëniet e mira dhe e keqja që përmenden në ajet është për ngjarjet e gëzueshme dhe të hidhura, sepse në kohën e dërgimit të Profetit, jehudinjtë ia dedikonin All'llahut çdo ngjarje të gëzueshme dhe të hidhëruar dhe thonin se ndodhitë e hidhura janë për shkak të pranisë së Profetit në mesin e tyre.¹ Ndërsa lidhja e ajeteve të mëparshme me ajetet e mëpasme, të cilat bëjnë fjalë për hipokritët, tregon se qëllimi në ajetin e fundit janë hipokritët.² Sido që të jetë çështja, Kur'ani famëlartë i përgjigjet hipokritëve se njeriu mysliman që shpreh monoteizmin, i cili e beson All'llahun e Lartësuar me sinqeritet dhe e adhuron Atë dhe nuk adhuron tjetërkënd përveç All'llahut, me të vërtetë beson se çdo ngjarje, ndodhi, fitore a humbje janë në dorën e All'llahut të Ditur e të Urtë. All'llahu është Ai që i dhuron njeriut atë çfarë i takon dhe i jep sipas vlerave të tij që ai ka. Ajeti thotë: **"...Thuaju: 'Të gjitha janë prej All'llahut...'"**

Në fund ky ajet mbart një qortim për hipokritët të cilët nuk meditojnë dhe nuk i kuptojnë realitetet e ndryshme të kësaj jete, ku thotë: **"Ç'është kështu me këtë popull, që nuk kupton asgjë?"**

Pas kësaj, në ajetin pasardhës, Kur'ani qartëson se çdo gjë që i vjen njeriut nga të mirat dhe dobitë dhe me çdo gjë që përballlet qenia njerëzore prej gëzimit dhe fitores janë nga ana e All'llahut. Ndërsa, e keqja dhe humbja që i ndodh njeriut është për shkak të vetë njeriut. All'llahu i Lartësuar thotë: **"Çdo e mirë**

¹ Tefsiri *Mexhmanul Bejan*, vëll. 3, f. 136-137.

² Tefsiri *Mexhmanul Bejan*, vëll. 3, f. 136-137.

që të gjen ty o njeri, prej All'Ilahut është, kurse e keqja që të godet, është prej vetes sate...."

Në fund të këtij ajeti All'Ilahu u përgjigjet atyre që e mendonin prezencën e Profetit si shkak për ndodhjen e ngjarjeve të këqija në mesin e tyre duke thënë: **"...Ne të kemi sjellë ty (o Muhammed) si të Dërguar për të gjithë njerëzimin. All'Ilahu mjafton për dëshmitar."**

Përgjigje për një pyetje të rëndësishme

Pyetja e rëndësishme e cila mund të të shkojë në mendje kur lexon këto dy ajete është: Përse i atribuohet e tërë e mira dhe e keqja në ajetin e parë All'Ilahut të Lartësuar? Përse ajeti pasardhës e kufizon të mirën me All'Ilahun dhe të keqen ia atribuon njeriut?

Përgjigje: Kur i shohim me vëmendje këto dy ajete ne përballemi me disa çështje ku secila prej tyre mund të jetë përgjigjja e kësaj pyetjeje.

1- Nëse bëjmë një analizë mbi elementet përbërës të së keqes, do të shohim se ajo ka dy drejtime: e para pozitive; e dyta negative. Drejtimi i dytë është ai që formon formën e së keqes dhe paraqitet në formën ose mënyrën e "humbjes relative". Njeriu që vret një njeri tjetër me armë zjarri apo me armë të ftohtë, ka bërë një vepër të keqe. Por cilët janë faktorët e kryerjes së kësaj vepre të keqe? Me të vërtetë, ajo vepër përbëhet nga forca e njeriut, nga logjika e tij, nga forca e armës, nga aftësia e gjuajtjes dhe e goditjes së qëllimit dhe nga përzgjedhja e vendit dhe e kohës së përshtatshme. Të gjitha këto formojnë elementët pozitivë të kësaj çështjeje sepse çdo element nga këto elementë në vetevete mund të përdoren si faktorë për një punë të mirë nëse shfrytëzohen me urtësi. Ndërsa drejtimi negativ është nëse këto elementë përdoren

dhe shfrytëzohen jo në vendin e vet. Në vend që arma të përdoret për të larguar rrezikun e kafshës së egër apo për t'u mbrojtur nga vrasësi apo krimineli i rrezikshëm, ajo përdoret për të vrarë njerëz të pafajshëm duke realizuar veprën e keqe. Në të vërtetë, forca e njeriut, logjika e tij, forca dhe aftësia e tij për të gjuajtur arma si armë dhe të gjithë këto elementë mund të përdoren në fushën e së mirës.

Kur ajeti i parë ia atribuon të mirën dhe të keqen All'Ilahut, kuptimi i kësaj është se burimi i forcës është në dorën e All'Ilahut të Gjithëditur e të Gjithëpushtetshëm deri edhe ajo forcë e cila keqpërdoret. Nga ky këndvështrim i atribuohet e mira dhe e keqja All'Ilahut sepse Ai është Dhuruesi i forcës dhe i fuqisë.

Ajeti i dytë ia atribuon të këqijat njeriut nisur nga kuptimi "i anëve negative" të çështjes dhe nga keqpërdorimi i dhuntive të All'Ilahut. Njësoj si prindi që i dhuron djalit të tij një shumë parash për të ndërtuar një shtëpi të re, por djali, në vend që t'i përdorte këto para për ndërtimin e shtëpisë së kërkuar, blen lëndë të dëmshme narkotike ose i shpenzon ato në vendet e shthurura e të këqija. Nuk ka dyshim se prindi është burimi i këtyre parave, por askush nuk ia atribuon atij veprat e djalit të vet, sepse ai ia dha paratë djalit për qëllim të mirë, porse djali i keqpërdori këto para. Pra, djali është vepruesi i së keqes. Babai i tij nuk ka të bëjë fare me të keqen.

2- Mund të thuhet se ky ajet tregon për "një çështjeje ndërmjet dy çështjeje" dhe kjo çështje është e hulumtuar tek çështja e "xhebr dhe tefuid"¹. Thënia përmbledhëse në të është se të gjitha ndodhitë në botë, të mira qofshin apo të këqija, vijnë nga

¹ Fjala "xhebr", ka kuptimin se njeriu është i detyruar në veprimet e tij, ndërsa fjala "tefuid", ka kuptimin se njeriu është i lirë në kryerjen e veprave të tij.

njëra anë që kanë lidhje me All'llahun Fuqiplotë sepse është Ai i ka dhuruar njeriut forcën, fuqinë, lirinë e zgjedhjes dhe të përzgjedhjes. Duke u bazuar mbi këtë, të gjitha ato që zgjedh njeriu dhe i vepron me dëshirën dhe lirinë e tij, nuk janë jashtë dëshirës së All'llahut. Mirëpo ky veprim i atribuohet njeriut, sepse ai buron nga qenia e tij dhe se dëshira e tij është ajo e cila përcakton drejtimin e veprimit. Bazuar në këtë, kur të mirat dhe të këqijat i atribuohen All'llahut të Lartësuar, kjo për shkak të veprueshmërisë së All'llahut në çdo gjë dhe kur i atribuohet e keqja njeriut, kjo vjen për shkak të dëshirës dhe lirisë së tij në zgjedhje. Rezultati i këtij kërkimi është se në këto dy ajete vërtetohet çështja "një çështje mes dy çështjeve" (mendo thellë!)

3- Ka një komentim të tretë për këto dy ajete i ardhur nga transmetimet e Ehlil Bejtit (Paqja qoftë mbi ta!). Ai komentim është se qëllimi me shprehjen të këqija është për ndëshkimin e veprave të këqija dhe dënimi i gjynaheve që All'llahu e zbret për gjynahqarët, përderisa dënimi është rezultat i veprave të gjynahqarëve nga robtë e Zotit.¹ Prandaj, nganjëherë i atribuohet vetë robve dhe nganjëherë i atribuohet All'llahut. Të dy atributet janë të sakta, ku mund të thuhet se në çështjen e prerjes së dorës së hajdutit është gjykatësi ai i cili ia preu dorën. Po ashtu, është e lejuar të thuhet se hajduti është shkaktar i prerjes së dorës sepse ai vodhi.

¹ Tefsir *Nurul Thakalejn*, vëll. 1, f. 511. Biharul Enuar, vëll.5, f. 202.

Ajetet 80 - 81

مَنْ يُطِيعِ الرَّسُولَ فَقَدْ أَطَاعَ اللَّهَ ۖ وَمَنْ تَوَلَّىٰ فَمَا أَرْسَلْنَاكَ عَلَيْهِمْ
 حَفِيظًا ﴿٨٠﴾ وَيَقُولُونَ طَاعَةٌ فَإِذَا بَرَزُوا مِنْ عِنْدِكَ بَيَّتَ طَائِفَةٌ
 مِّنْهُمْ غَيْرَ الَّذِي تَقُولُ ۖ وَاللَّهُ يَكْتُبُ مَا يُبَيِّتُونَ ۚ فَأَعْرِضْ عَنْهُمْ وَتَوَكَّلْ
 عَلَى اللَّهِ ۚ وَكَفَىٰ بِاللَّهِ وَكِيلًا ﴿٨١﴾

"Kush i bindet të Dërguarit, i është bindur All'Ilahut. Sa për ata që kthejnë kokën mënjane, Ne nuk të kemi dërguar që të jesh rojtar i tyre."

"Dhe ata thonë: 'Të jemi bindur', por, kur largohen prej teje, një grup nga ata natën shtjellojnë diçka tjetër nga ato që u the ti. Por All'Ilahu i shënon shtjellimet e tyre. Prandaj largohu prej tyre dhe mbështetu tek All'Ilahu! Se All'Ilahu të mjafton ty për mbrojtës."

Komentimi

Syneti i Profetit (Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) **është në gradën e Shpalljes** (uahjit).

Ajeti i parë qartëson pozitën e Profetit (Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) tek njerëzit dhe

veprat e tyre të mira e të këqija. Në fillim përforcon dhe vërteton se bindja ndaj Profetit (Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) në realitet është bindja ndaj All'Ilahut të Lartësuar ku thotë: **"Kush i bindet të Dërguarit, i është bindur All'Ilahut..."** Kuptimi i kësaj fjalie të ajetit është se nuk ka ndarje mes bindjes ndaj All'Ilahut dhe bindjes ndaj Profetit Muhammed (Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) sepse Profeti nuk hedh asnjë hap në kundërshtim me dëshirën dhe vullnetin e All'Ilahut të Lartësuar. Çdo gjë që buron nga ai, si fjala, vepra dhe miratimi janë në përputhje me dëshirën dhe vullnetin e All'Ilahut të Lartësuar.

Më pas ajeti sqaron se Profeti nuk është përgjegjës për ata që i injorojnë dhe i kundërshtojnë urdhrat e tij. Po ashtu, ai nuk është i detyruar t'i detyrojë ata që të largohen nga mëkatet, por përgjegjësia e Profetit është të ftojë në mesazhin hyjnor për të cilin është dërguar, t'i urdhërojë në të mirë dhe t'i ndalojë nga e keqja dhe të udhëzojë të humburit dhe të pavëmendëshmit siç thotë ajeti **"...Sa për ata që kthejnë kokën mënjane, Ne nuk të kemi dërguar që të jesh rojtar i tyre."**

Është e vlefshme të thuhet se fjala "hafijdh", që do të thotë rojtar, e cila përmendet në ajet është cilësi e ngjashëm e vepruesit dhe tregon përforcimin dhe vazhdueshmërinë e cilësisë dhe të cilësuesit ndryshe nga vepruesi "hafidhun". Fjala "hafijdh", rojtar, ka kuptimin e atij që mbikëqyr dhe ruan në formë të përhershme dhe në mënyrë të vazhdueshme. Nga ajeti argumentohet se detyra e Profetit është udhëheqja e njerëzve, drejtimi, udhëzimi, thirrja e tyre për të ndjekur të vërtetën, të largohen nga e kota, të luftojnë të keqen. Kur disa janë të vendosur për të ndjekur rrugën e kotë

dhe të devijimit nga rruga e vërtetë, atëherë Profeti nuk është përgjegjës për këto devijime dhe nuk kërkohet nga ai që t'i mbikëqyrë ata devijues në çdo vepër të vogël apo të madhe. Gjithashtu, nuk kërkohet prej tij që të përdorë forcën për t'i detyruar ata devijues që të heqin dorë nga devijimi i tyre.

Bazuar në këtë, ky ajet, gjithashtu, mund të tregojë luftërat, si lufta e Uhudit, ku Profeti ka qenë i detyruar vetëm për të plotësuar mundësitë potenciale nga ana ushtarake dhe për të përgatitur planet për të ruajtur myslimanët nga sulmet e armikut. Është e natyrshme që bindja ndaj Profetit në këtë çështje është edhe bindje ndaj All'Ilahut të Lartësuar. Nëse supozohet se disa persona nuk iu bindën të Dërguarit të All'Ilahut në këtë çështje dhe mosbindja e tyre çoi në humbjen e myslimanëve, atëherë vetëm mosbindësit janë përgjegjës për këtë dhe jo Profeti.

Një çështje tjetër shumë e rëndësishme në këtë ajet është se ky është ajeti më tregues, ndër ajetet e tjera, për të qenit e synetit të Profetit argument. Ai është rregull, ligj e detyrim që t'u bindesh haditheve të sakta të transmetuara nga Profeti. Duke u bazuar në këtë ajet, nuk i lejohet askujt që të pranojë vetëm Kur'anin dhe të mos i pranojë hadithet dhe synetin e Profetit (Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) sepse ky ajet është i qartë dhe bindja ndaj fjalëve të Profetit dhe haditheve të sakta të transmetuara nga ai është si bindja ndaj All'Ilahut të Lartësuar.

Nga e njëjta pikënisje vërtetohet një realitet tjetër që është domosdoshmëria e bindjes ndaj imamëve të Ehli Bejtit të Profetit (Paqja qoftë mbi ta!), të cilën e ka argumentuar hadithi "Thekalejn", hadithi "i dy të çmuarave", që është i transmetuar në burimet islame synite dhe shiite. Në këtë hadith Profeti e ka

qartësuar të qenit e haditheve të imamëve të Ehli Bejtit si argument. Nga ky hadith konkludojmë se bindja e urdhrave të tyre është bindja e Profetit dhe si rezultat, bindja ndaj All'Ilahut të Lartësuar. Meqenëse hadithet e imamëve të Ehli Bejtit janë si hadithet e Profetit, askush nuk mund të thotë se e pranon Kur'anin dhe refuzon hadithet e Ehli Bejtit, sepse kjo është kundërshtim i ajetit të përmendur.

Për këtë lexojmë në hadithet të cilat i ka transmetuar autori i tefsirit "El Burhan", në komentimin e këtij ajeti se ato argumentojnë këtë të vërtetë: Me të vërtetë, All'Ilahu i Lartësuar i ka dhuruar Profetit të Tij të drejtën e urdhrit dhe të ndalimit në këtë ajet. Profeti, në pozitën e tij, ia ka dhuruar këtë të drejtë Ali ibn Ebi Talibit dhe të gjithë imamëve që vijnë pas tij dhe njerëzit janë të detyruar që t'u binden urdhrave të atyre imamëve të pastër, sepse urdhërimi dhe ndalimi i Profetit dhe i imamëve të Ehli Bejtit është i njëjtë me urdhrat dhe ndalimet e All'Ilahut të Lartësuar. Bindja ndaj tyre është bindja ndaj All'Ilahut. Ata nuk sjellin asgjë nga vetvetja e tyre dhe të gjitha që u janë sjellë myslimanëve, janë nga ana e All'Ilahut.¹

Ndërsa ajeti i dytë tregon për gjendjen e një grupi hipokritësh apo të lëkundërit në besimin e atyre me besim të dobët, të cilët, në prani të Profetit dhe të myslimanëve hiqen (shfaqen) se janë me ta. Ata e shfaqin bindjen ndaj Profetit për të larguar të keqen nga vetja e tyre dhe për të mbrojtur interesat e tyre personale duke u shtirur si të sinqertë dhe të bindur ndaj Profetit. Ajeti thotë: **"Dhe ata thonë: "Të jemi bindur..."**


¹ Tefsiri *El Burhan*, vëll. 1, f. 396.

E pasi largohen njerëzit nga Profeti (Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe ata janë vetëm, i injorojnë premtimet e tyre ndaj bindjes së Profetit dhe thurin intriga e komplete në takimet e tyre të fshehta natën: **"...por, kur largohen prej teje, një grup nga ata natën shtjellojnë diçka tjetër nga ato që u the ti. Por All'Ilahu i shënon shtjellimet e tyre..."**

Nga ky ajet mësojmë se hipokritët në kohën e të Dërguarit të All'Ilahut janë përpjekur shumë në thurjen e kompleteve ndaj Profetit dhe në takimet e tyre të fshehta planifikonin se si t'i bënin ballë thirrjes së tij. Por All'Ilahu i Lartësuar e urdhëron Profetin (Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) që të mos i kushtojë vëmendje intrigave të tyre dhe të mos i frikësohet as atyre dhe as planeve të tyre dhe të mos u besojë atyre në projektet e tij. Ai i thotë që t'i mbështetet All'Ilahut të Lartësuar, i Cili është Triumfuesi dhe Ndihmësi më i mirë: **"...Prandaj largohu prej tyre dhe mbështetu tek All'Ilahu! Se All'Ilahu të mjafton ty për mbrojtës."**

Ajeti 82

أَفَلَا يَتَذَكَّرُونَ الْفُرَّانَ ۚ وَلَوْ كَانِ مِنْ عِنْدِ غَيْرِ اللَّهِ لَوَجَدُوا فِيهِ اخْتِلَافًا



“A nuk persiatin ata për Kur'anin! Sikur ai të mos ishte prej All'llahut, do të gjenin në të shumë kundërthënie.”

Komentimi

Zbrazëtia e Kur'anit nga ndryshimet është argument i mrekullisë së tij

Ky ajet u drejtohet hipokritëve dhe atyre që dyshojnë në vërtetësinë e Kur'anit famëlartë. Në mënyrë pyetëse kërkon prej tyre që të studiojnë dhe të verifikojnë të veçantat e Kur'anit që ta mësojnë vetë se Kur'ani është Shpallje e zbritur. Nëse nuk do të ishte i tillë, në të do të kishte shumë kontradita dhe kundërthënie. Kur atyre t'u bëhet e qartë se nuk ka ndryshime në të, atëherë ata duhet të pranojnë se ai është Shpallje e zbritur nga All'llahu i Madhërruar: **“A nuk persiatin ata për Kur'anin! Sikur ai të mos ishte prej All'llahut, do të gjenin në të shumë kundërthënie.”**

Fjala "tedebur" vjen nga lënda "dubrun" që është fundi i diçkaje dhe përfundimi i saj. Kurse "tedebur" që përmendet në këtë ajet, do të thotë kërkim rreth rezultateve të ndikimit të diçkaje. Ndryshimi mes "tedebur" - persiatje dhe "tefekur" - të menduarit,

është se “tefekur” ka kuptimin e studimit dhe të verifikimit në shkaqet dhe veçoritë e ekzistencës, kurse "tedebur" - pesiatja, është studimi në rezultatet dhe ndikimet e saj. Me këtë ajet argumentojmë disa çështje:

1) Me të vërtetë, njerëzit janë të detyruar që të kërkojnë dhe të verifikojnë në bazat e fesë dhe në çështje të ngjashme me to, si vërtetësia e thirrjes së Profetit, vërtetësia e Kur'anit etj. Dhe duhet t'i largohen imitimit dhe thënieve të ndryshme në të tilla raste.

2) Me të vërtetë, Kur'ani, në kundërshtim me atë që mendojnë disa, është i kuptueshëm dhe i perceptueshëm nga të gjithë. Nëse nuk do të ishte i tillë, nuk do të na urdhëronte All'llahu që ta persiatnim atë.

3) Një nga argumentet që vërteton se Kur'ani është i vërtetë dhe se ai është i shpallur nga All'llahu i Urtë dhe i Gjithëditur, është zbrazëtia e tij absolute nga çdo kundërshtim dhe ndryshim.

Dhe për ta qartësuar këtë të vërtetë, themi:

Me të vërtetë, ana shpirtërore e njeriut ndryshon vazhdimisht (ligji i përsosurisë). Në rrethana e kushte të zakonshme dhe të zbrazta nga situatat e veçanta, njeriu e përvetëson anën e brendshme shpirtërore dhe mendimet e tij. Me kalimin e kohës, bazuar tek ligji i përsosurisë, thëniet dhe mendimet e njeriut ndryshojnë.

Nëse i vërejmë me kujdes shkrimet e një autori, ato nuk kanë një rregull të përbashkët, por fillimi i çdo libri ndryshon nga përfundimi i tij.

Ky ndryshim është më i shpejtë kur njeriu përjeton ngjarje të mëdha, si ajo e hedhjes dhe e forcimit të revolucionit të

përgjithshëm ideologjik, shoqëror dhe fetar. Personi, i cili përjeton të tilla ndryshime të mëdha, nuk është në gjendje të thotë të njëjtat fjalë dhe nuk mund të ketë përputhje të plotë në thëniet e tij, veçanërisht kur personi është i paarsimuar dhe i rritur në një mjedis shoqëror të ndryshëm.

Kur'ani është libri që ka zbritur përgjatë 23 viteve sipas nevojave edukative dhe udhëzuese të njerëzve në rrethana të ndryshme. Tematikat e Kur'anit janë të shumëllojshme. Ai nuk ngjason me një libër të zakonshëm që është i specifikuar në hulumtim shoqëror, politik, filozofik, legjislativ a historik. Kur'ani flet për monoteizmin (teuhid) dhe të fshehtat e krijimit; paraqet ligjet, rregullat, moralin dhe etikën; flet për popujt e mëparshëm, këshillën, udhëzimin, adhurimet dhe për lidhjen e robit me Krijuesin e vet.

Gustaf Lubon thotë: *“Kur'ani, libri qiellor i myslimanëve, nuk veçohet në tematikën e tij për mësimet fetare, por ai shqyrton gjithashtu, çështjet politike dhe shoqërore për myslimanët.”*

Ky libër, me këto veçori, i harmonizuar, ekuilibruar dhe i zbrazët nga kundërshtia dhe ndryshimi, kurrë nuk mund të jetë krijim i mendimit njerëzor, por është i ardhur nga All'llahu i Madhëruar, siç e thotë edhe ajeti në fjalë.

Ajeti 83

وَإِذَا جَاءَهُمْ أَمْرٌ مِّنَ الْأَمْنِ أَوْ الْخَوْفِ أَذَاعُوا بِهِ ۖ وَلَوْ رَدُّوهُ إِلَى الرَّسُولِ
وَالِىِ الْأُمْرِ مِنْهُمْ لَعَلِمَهُ الَّذِينَ يَسْتَنْبِطُونَهُ مِنْهُمْ ۚ وَلَوْلَا فَضْلُ اللَّهِ
عَلَيْكُمْ وَرَحْمَتُهُ لَاتَّبَعْتُمُ الشَّيْطَانَ إِلَّا قَلِيلًا ﴿٨٣﴾

"Kur atyre u vjen ndonjë lajm i rëndësishëm që ka të bëjë me sigurinë ose frikën, ata e përhapin (pa e vërtetuar mirë). Por, në qoftë se këtë lajm do t'ia përcillnin (për shqyrtim) të Dërguarit dhe parisë, hulumtuesit do ta merrnin vesh prej tyre (se çfarë lajmi duhet përhapur e çfarë jo). Sikur të mos ishte mirësia e All'Ilahut dhe mëshira e Tij, ju të gjithë do të ndiqnit djallin, përveç një numri të vogël."

Komentimi

Përhapja e thashethemeve

Ky ajet bën fjalë për një lëvizje tjetër të devijuar prej lëvizjeve të hipokritëve dhe atyre me besim të dobët. Kjo lëvizje e tyre përfaqësohet nga përpjekjet e tyre për shtrembërimin e lajmit për fitoren ose humbjen e myslimanëve dhe përhapja e këtij lajmi

të shtrembëruar në mesin e njerëzve në çdo vend, pa e vërtetuar origjinën e sigurisë dhe vërtetësinë e këtij lajmi. Shumica e këtyre lajmeve ishin thashetheme të qëllimshme nga armiqtë që kishin si synim realizimin e qëllimeve të tyre të ulëta, dobësimit e anës shpirtërore të myslimanëve dhe keqbërjen ndaj tyre. All'llahu i Lartësuar thotë: **"Kur atyre u vjen ndonjë lajm i rëndësishëm që ka të bëjë me sigurinë ose frikën, ata e përhapin (pa e vërtetuar mirë)..."**

Prej detyrimeve të hipokritëve ishte çuarja e lajmeve tek udhëheqësit e tyre që të përfitojnë nga mësimet dhe mendimet e atyre udhëheqësve dhe për t'i larguar myslimanët nga gjendja e vetëpëlqimit për shkak të fitoreve dhe triumfeve imagjinare ose për dobësimit e anës shpirtërore të tyre me përhapjen e lajmit të një humbjeje që nuk është e vërtetë. All'llahu i Lartësuar thotë: **"...Por, në qoftë se këtë lajm do t'ia përcillnin (për shqyrtim) të Dërguarit dhe parisë, hulumtuesit do ta merrnin vesh prej tyre (se çfarë lajmi duhet përhapur e çfarë jo)..."**

Fjala "jestenbitune" në këtë ajet rrjedh nga fjala "nebete" që do të thotë uji i parë që nxirret nga pusi apo nga burimi. Dhe fjala "instinbat" ka kuptimin e nxjerrjes së të vërtetave nëpërmjet argumenteve, dëshmimeve dhe dokumentacioneve, qoftë ky proces në jurisprudencë, apo në filozofi, apo në politikë apo në të gjitha shkencat.

Fjala "ulul emri", udhëheqësit, paria, në këtë ajet janë ata të cilët janë të ditur për çështjet dhe të aftë që t'u qartësojnë njerëzve se cila çështje është e vërtetë dhe cila është thashethem. Së pari ata janë Profeti (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi

familjen e tij!) dhe prijësat, zëvendësit e tij, imamët e Ehli Bejtit (Paqja qoftë mbi ta!) dhe pas tyre vijnë dijetarët e specializuar në këto çështje.

Transmetohet nga imam Muhammed ibn Ali el Bakir (Paqja qoftë mbi të!) për komentimin e frazës "ulul emr" që përmendet, i cili ka thënë: "Ata janë imamët" sikurse ka ardhur në tefsirin Nurul Thakalejn. Gjithashtu, kanë ardhur transmetime të tjera për këtë rast me të njëjtin kuptim.

Ndoshta dikush i kundërshton këto transmetime duke thënë: se imamët e Ehli Bejtit nuk kanë qenë të pranishëm në atë kohë që është zbritur ky ajet dhe nuk është caktuar asnjëri prej tyre në këtë pozitë të imamatit dhe të mbikëqyrësit, si mund të thuhet se qëllimi në ajet është për ata? Përgjigja e këtij kundërshtimi është se ky ajet, si të gjithë ajetet e tjera të Kur'anit, nuk kufizohen vetëm në kohën e të Dërguarit të All'Ilahut të Lartësuar, por ajetet mbartin rregulla të përgjithshme që përfshijnë të gjitha kohët në vazhdim për t'u bërë ballë thashethemeve dhe intrigave të cilat i përhapin armiqtë ose mendjelehtët prej myslimanëve.

Dëmi i shpikje së thashethemeve dhe i përhapjes së tyre

Vërtet, shoqëritë njerëzore po vuajnë shumë prej fatkeqësive dhe problemeve madhore për shkak të shfaqjes së fenomenit të thashethemeve dhe i përhapjes së tyre në mesin e njerëzve. Ato ndikojnë shumë negativisht në anën shpirtërore të pjestarëve të shoqërisë dhe në dobësimin e shpirtit shoqëror dhe

të shpirtit të mirëkuptimit dhe të bashkëpunimit ndërmjet pjesëtarëve të një shoqërie të vetme. Thashethemet fillojnë me shpikjen e gënjeshtërs nga hipokriti, pastaj me përhapjen e saj në mesin e njerëzve mendjelehtë dhe me besim të dobët me qëllim që këta ta përhapin në mesin e pjesëtarëve të shoqërisë pa verifikim.

Jo vetëm që nuk verifikojnë se a është e vërtetë kjo thënie apo jo, por ata e ekzagjerojnë dhe e fryjnë aq shumë saqë njerëzit harxhojnë kohë dhe fuqi të mëdha duke u menduar për këtë dhe si pasojë përhapet edhe zemërimi mes tyre. Në të shumtën e rasteve thashethemi çon në humbjen e besimit tek individët dhe çon në gjendjen e neglijhencës dhe të papërgjegjesisë.

Disa shoqëri të cilat përjetojnë gjendjen e shtypjes dhe terrorit bazohen te thashethemet si metodë për hakmarrje ndaj udhëheqjeve të padrejta dhe barbare. Vetë thashethemi përbën një rrezik të madh për shoqërinë e shëndoshë. Sikur thashethemet t'u drejtohen mendimtarëve, ekspertëve, punonjësve në fusha të rëndësishme të shoqërisë, ato çojnë në një gjendje ftohtësie në aktivitetet e tyre dhe mund t'u bie reputacioni në shoqëri, mund t'u uzurpohet pozita dhe shoqëria të ndalohet nga shërbimi i tyre. Bazuar në këtë, Islami e ka luftuar me forcë shpikjen dhe përhapjen, shpifjen dhe gënjeshtëren njësoj siç lufton përhapjen e thashethemeve në këtë ajet.

Në mbyllje ky ajet përforcon se All'llahu i Lartësuar i ka ruajtur myslimanët me mirësinë e Tij nga thashethemet e hipokritëve dhe nga ata që e kanë besimin të dobët dhe i ka shpëtuar ata nga rezultati dhe përfundimi i keq i thashethemeve të tyre. Po të mos jetë shpëtimi nga ana e All'llahut, nuk do të

kishin shpëtuar nga rrëshqitjet e shejtanit vetëm pak prej tyre. All'lahu i Lartësuar thotë: **"...Sikur të mos ishte mirësia e All'lahut dhe mëshira e Tij, ju të gjithë do të ndiqnit djallin, përveç një numri të vogël."** Që do të thotë se vetëm Profeti, të zotët e mendjes dhe dijetarët janë të aftë për të qenë të ruajtur nga vesveset dhe intrigat e thashethemexhinjve. Ndërsa shumica e shoqërisë patjetër duhet që të udhëhiqet nga drejtues të shëndoshë dhe ta mbrojnë shoqërinë prej përfundimit të keq të shpikjes dhe të përhapjes së thashethemeve.

Ajeti 84

فَقَتِلَ فِي سَبِيلِ اللَّهِ لَا تَكْلَفُ إِلَّا نَفْسَكَ^ج وَحَرَضَ الْمُؤْمِنِينَ^ط عَسَى اللَّهُ
 أَنْ يَكُفَّ بَأْسَ الَّذِينَ كَفَرُوا^ج وَاللَّهُ أَشَدُّ بَأْسًا وَأَشَدُّ تَنكِيلًا

"Prandaj, lufto në rrugën e All'Ilahut! Ti je përgjegjës vetëm për veten tënde. Nxiti edhe besimtarët, se mbase All'Ilahu e pengon fuqinë e jobesimtarëve! All'Ilahu është më i fuqishmi dhe më i ashpri në dënime."

Shkaku i zbritjes

Është transmetuar në disa tefsire si "Mexhmaul Bejan", "Kurtubi" dhe "Ruhul Meanijj" se shkaku i zbritjes së këtij ajeti është: Kur Ebu Sufjani së bashku me ushtrinë e kurejshëve është kthyer fitimtarë nga lufta e Uhudit u premtuan myslimanëve ballafaqim tjetër në sezonin e "Bedru Sugra", koha e kryerjes së tregëtisë në muajin e Dhil Hixhxhes në zonën e Bedrit. Kur erdhi koha e ballafaqimit, Profeti u bëri thirrje myslimanëve që të përgatiten për t'u nisur drejt zonës së përmendur. Mirëpo një grup prej myslimanëve, të cilët akoma vuanin hidhësinë e humbjes në luftën e Uhudit, refuzuan që të shkonin me Profetin (Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Atëherë zbriti ky ajet. Profeti e përsëriti thirrjen për t'u nisur dhe atë nuk e ndoqën veçse 70 burrave prej atyre që ishin të

pranishëm në luftë. Por Ebu Sufjani, të cilin e kishte pushtuar frika në përballjen me myslimanët, nuk u paraqit në vendin e caktuar dhe i Dërguari i All'llahut së bashku me shokët e tij u kthyen shëndosh e mirë në Medine.¹

Komentimi

Çdo njeri është përgjegjës për atë që është detyruar

Pas paraqitjes së ajetëve që flisnin për xhihadin, vjen ky ajet që paraqet një çështje të re dhe të rrezikshme për të dërguarin e All'llahut se ai është i detyruar që t'u bëjë ballë dhe të luftojë armikun edhe nëse mbetet i vetëm dhe askush nga myslimanët nuk e shoqëron atë në fushën e betejës. Sepse ai është përgjegjës për kryerjen e detyrimeve të tij dhe përgjegjësia e tij ndaj të tjerëve është thirrja, nxitja dhe inkurajimi i të tjerëve për xhihad: **"Prandaj, lufto në rrugën e All'llahut! Ti je përgjegjës vetëm për veten tënde. Nxiti edhe besimtarët..."**

Ky ajet përfshin një rregull të rëndësishëm shoqëror që është i veçantë për udhëheqësit dhe u bën thirrje atyre në domosdoshmërinë e mendimit të prerë dhe në punë të zellshme në rrugën e tyre drejt qëllimit të shenjtë për të cilin punojnë dhe bëjnë thirrje për hir të tij edhe sikur të mos gjejnë mospërgjigjës të thirrjes së tyre. Kjo sepse vazhdimësia e thirrjes nuk është e kushtëzuar me përgjigjen e të tjerëve. Cilido udhëheqës që mbart këtë mendim të prerë, padyshim që është i paaftë për të kryer misionin e udhëheqjes dhe nuk ka mundësi ta vazhdojë rrugën

¹ Tefsiri Mexhmaul Bejjan, vëll. 3, f.145.

drejt realizimit të qëllimeve të dëshiruara, veçanërisht udhëheqësit hyjnorë të cilët i mbështeten All'llahut të Lartësuar që është burimi i çdo force e fuqie në ekzistencën e kësaj bote. Ai është i Plotfuqishëm mbi planet, intrigat dhe komplotet që thuren përballë thirrjes. Për këtë ajeti thotë: **"...se mbase All'llahu e pengon fuqinë e jobesimtarëve! All'llahu është më i Fuqishmi dhe më i Ashpri në dënime."**

Hulumtime

Kuptimi i fjalëve "asa" dhe "leale" në Kur'an

Në fjalën "asa", mbase, gjendet lakmi dhe shpresë kurse në fjalën "leale", ndoshta ka lakmi dhe keqardhje e mëshirë.

Këtu mund të parashtrohet pyetja: Nëse lakmia dhe shpresa janë të lejueshme për njeriun për shkak të mosnjohjes së tij me të fshehtën për shkak të kufizimit të forcës së tij dhe paaftësia e tij për veprim që të realizojë atë që dëshiron, si është e mundur përdorimi i këtyre dy fjalëve nga ana e All'llahut të Lartësuar, i Cili është i Ditur për të dukshmen dhe për të padukshmen dhe i Gjithëpushtetshëm për çdo gjë?! Lakmia dhe shpresa gjenden tek i padiuri dhe i paafti dhe All'llahu i Lartësuar është i pastër nga këto attribute.

Shumë dijetarë kanë përdorur "te'uilin" e kuptimit të këtyre dy fjalëve "asa" dhe "leale" që ndodhen në fjalën e All'llahut. Ata kanë thënë: Kur këto dy fjalë vijnë në fjalën e All'llahut të Lartësuar, e humbasin kuptimin e vërtetë origjinal dhe përfitojnë kuptime të reja. Dhe kanë thënë: Fjala "asa", kur vjen në fjalën e

All'llahut vjen me kuptimin "el uadu", premtim dhe se fjala "leale" vjen me kuptimin "et talab" kërkesë.

E vërteta është se këto dy fjalë nuk e ndryshojnë kuptimin kur vijnë në fjalën e All'llahut dhe nuk detyrojnë padituri apo pamundësi, por përdorimi i këtyre dy fjalëve vjen në vendet ku arritja në qëllim ka nevojë për disa premisa. Nëse nuk plotësohet një nga këto premisa, ose disa prej tyre, nuk mund të arrihet tek qëllimi i prerë por çështja e realizimit të qëllimit vjen në formën e mundshme dhe rregulli në këtë fushë mund të jetë i mundshëm

Për shembull, Kur'ani thotë: **"Kur të lexohet Kur'ani, dëgjoni dhe heshtni, në mënyrë që të mëshiroheni."**¹ kjo nuk do të thotë që mëshira e All'llahut të Lartësuar përfshin të gjithë ata që e dëgjojnë ose heshtin gjatë dëgjimit ose gjatë leximit të tij, por dëgjimi dhe heshtja gjatë dëgjimit janë premisë prej premisave e fitimit të mëshirës së All'llahut të Lartësuar. Por, ka edhe premisa të tjera si kuptimi i Kur'anit, persiatja e ajeteve të tij dhe zbatimi i rregullave të tij. Nga kjo qartësohet se realizimi i një premise të vetme nuk mjafton për të arritur rezultatet e kërkuara dhe nuk mund të vendoset me një vendosmëri të prerë për arritjen e rezultatit, por ajo që mund të thuhet për të është mundësia e arritjes së rezultatit. E vërteta është se të tilla fjalë kur gjenden në fjalën e All'llahut, qëllimi i tyre është t'i tërheqë vëmendjen dëgjuesit se ka kushte dhe premisa të tjera që duhen realizuar për të aritur tek qëllimi në shtesë të kushtit dhe premisë së përmendur.

¹ Sure "El A'raf", ajeti 204.

Na u qartësua se arritja e mëshirës së All'llahut nuk realizohet vetëm me dëgjimin dhe heshtjen duke dëgjuar Kur'anin, por për të arritur mëshirën e All'llahut të Lartësuar duhen plotësuar premisa. Nga këtu, ajeti që po shjegojmë thotë se: vërtet forca dhe fuqia e jobesimtarëve nuk eliminohet e as nuk dobësohet vetëm me thirrjen e besimtarëve për xhihad dhe nxitjen e tyre për të luftuar, por, gjithashtu, duhet që besimtarët të përpiqen për të realizuar premiset e tjera për të shpartalluar fuqinë e jobesimtarëve ku prej tyre janë përgatitja e mjeteve luftarake dhe ndjekja e urdhërave dhe e direktivave që vendos i Dërguari i All'llahut për të arritur qëllimin përfundimtar.

Kështu neve na sqarohet se nuk është e domosdoshme që këto dy fjalë dhe të tjera të ngjashme me këto duhet që të largohen nga kuptimi i tyre i vërtetë kur vijnë në fjalën e All'llahut të Lartësuar.¹

¹ Ragibi në librin e tij "El Mufredat" përmend një supozim tjetër në komentimin e fjalëve "asa" dhe "leale" që është: Nëse All'llahu i Madhëruar e përmend këtë, Ai e përmend që njeriu të jetë shpresues dhe jo që të jetë All'llahu ai që shpreson. Që do të thotë se: Njeriu shpreson tek All'llahu dhe jo e kundërta.

Ajeti 85

مَنْ يَشْفَعْ شَفَاعَةً حَسَنَةً يَكُنْ لَهُ نَصِيبٌ مِّنْهَا ^ط وَمَنْ يَشْفَعْ شَفَاعَةً سَيِّئَةً
يَكُنْ لَهُ كِفْلٌ مِّنْهَا ^ق وَكَانَ اللَّهُ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ مُّقِيتًا ﴿٨٥﴾

"Kush ndërmjetëson për një çështje të mirë, do të ketë pjesë në shpërblimin e saj, kurse kush ndërmjetëson për një çështje të keqe, do të ketë pjesë në ndëshkimin e saj. All'llahu është i Gjithëpushtetshëm."

Komentimi

Rezultati dhe përfundimi i nxitjes për të mirë dhe i nxitjes për të keqe

Ajeti i mëparshëm tregoi se çdo njeri është përgjegjës për veprën e tij dhe për atë çfarë është i detyruar për të kryer dhe asnjë njeri nuk pyetet për veprat e të tjerëve.

Ndërsa ky ajet ka ardhur që t'i mbyllë rrugën çdo kuptimi të gabuar për ajetin e mëparshëm dhe shpjegon se nëse një njeri nxit një njeri tjetër për të bërë një vepër të mirë apo një vepër të keqe, ai do të marrë shpërblim apo ndëshkim nga ajo e mirë apo e keqe. All'llahu i Lartësuar thotë: "**Kush ndërmjetëson për një çështje të mirë, do të ketë pjesë në shpërblimin e saj, kurse kush**

ndërmjetëson për një çështje të keqe, do të ketë pjesë në ndëshkimin e saj..."

Nxitja dhe thirrja e të tjerëve për të bërë vepra të mira dhe për zbatuar të vërtetën dhe ndalimi i të tjerëve nga kryerja e veprave të këqija, sikurse e sqaron ky ajet, tregon interesimin e Kur'anit për të përhapur shpirtin shoqëror tek myslimanët duke i ftuar ata që t'i largohen egoizmit dhe të mos injorojnë të tjerët. Dhe kjo arrihet nëpërmjet këshillimit për të mirë dhe duke i tërhequr vërejtjen për të kotën e të shtrembërën.

Dhe fjala "shfeatu", ndërmjetësim, në këtë ajet rrjedh nga folja "shfe'a" që do të thotë bashkimi i diçkaje me një të ngjashëm me të. Nganjëherë ky bashkim mund të jetë udhëzimi në vepra të mira, sigurisht në urdhërim në të mirë dhe ndalim nga e keqja. Bashkimi mund të jetë i keq në urdhërim në të keqe dhe ndalimin nga e mira.

Nëse ndërmjetësimi u arrin mëkatarëve për t'i shpëtuar ata nga rezultati i veprave të tyre të këqija, ai ndërmjetësim ka kuptimin e shpëtimit të mëkatarëve që e meritojnë ndërmjetësimin. Thënë ndryshe: "shfeati" ndërmjetësimi mund të arrihet përpara se të kryhet mëkati duke këshilluar dhe duke udhëzuar për mosbërje, ashut siç arrihet pas kryerjes së mëkatit. Ky ndërmjetësim këtu do të thotë shpëtim i gjynahqarit ose i gabimtarit nga fundi i veprave të këqia. Të dyjave këtyre gjendjeve u vërtetohet bashkimi i diçkaje tek një tjetër.

Është e mirë që këtu të tregohet, se kur Kur'ani famëlartë flet për shefatin e mirë përdor fjalën "nasijb". Ndërsa, kur flet për shefaatin e keq përdor fjalën "'kifl". Dallimi ndërmjet këtyre dy

fjalëve është se e para përdoret kur bëhet fjalë për një pjesë nga fitimi, mirësia dhe dobia. Kurse e dyta përdoret nëse bëhet fjalë për humbje, dëm dhe keqësi. Pra, "nasijb" është për pjesën e mirë, kurse "kiflun" është për pjesën e keqe.¹

Ky ajet shpjegon pikëpamjen bazë të Islamit në çështjet shoqërore. Çdo fjalë apo vepër – por edhe çdo heshtje – që çon në nxitjen e të tjerëve për të bërë vepra të mira, pa dyshim që nxitësi dhe inkurajuesi fiton një pjesë nga rezultati i asaj vepre pa asnjë mangësi.

Në hadithin e transmeuar nga i Dërguari i All'Ilahut të Lartësuar thuhet: *"Kush urdhëron për të mirë dhe ndalon nga e keqja, ose e tregon atë dhe udhëzon për në të, ai është pjesëtar në shpërblim. Kush urdhëron në të keqe, ose e tregon rrugën e keqe dhe udhëzon për në të, ai është bashkëpuntor në të."*² Ky hadith i nderuar na sqaron tri fazat për t'u bërë thirrje njerëzve në të mirë apo në të keqe.

Faza e parë: Urdhërimi, që është faza më e fortë.

Faza e dytë: Argumentimi, që është faza e mesme.

Faza e tretë: Të treguarit për veprën, që është faza më e dobët.

Duke u bazuar në këtë, vërtet nxitja e të tjerëve për bërjen e një vepre të caktuar bën që nxitësi të jetë pjestar i rezultatit të kësaj

¹ "El kiflu" është pamundësia e kafshës dhe prapanica e saj e cila është e vështirë hipja në të. Nga këtu, çdo gjynah dhe pjesë e keqe është kiflun. Fjala el kefaletu është çdo punë që përmban vështirësi dhe mundim.

² Uesailu Shia, vëll. 16, f.123.Tefsiri Nuru Thakalejn, vëll. 1, f. 524.

vepre, e cila përshtatet me forcën shtytëse apo nxitëse sipas tre fazave që i cekëm më lart.

Bazuar në këtë pikëpamje të fesë islame, ata që bëjnë gjynahe apo gabime nuk janë të vetëm por në gjynahet e tyre përfshihen edhe ata të cilët i kanë nxitur për të bërë këto gjynahe, nëpërmjet mënyrave të ndryshme informative apo nëpërmjet përgatitjes së faktorëve ndihmues deri edhe në thënien e një fjalë sado e vogël që mund të jetë nxitëse për të keq. Po kështu është shembulli edhe i atyre që nxisin të tjerët për të bërë vepra të mira, të cilët arrijnë të marrin pjesën e tyre nga shpërblimi i veprave të mira.

Nga hadithet e transmetuara në komentimin e këtij ajeti kuptohet se ndërmjetësimi me të dy llojet e tij, gjithashtu, përfshin edhe lutjen për të mirë apo për të keq për të tjerët. Lutja për të tjerët ose kundra tyre, konsiderohet një lloj ndërmjetësimi tek All'llahu i Lartësuar.

Transmetohet nga imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) se ka thënë: *"Kush bën lutje për vëllain e tij mysliman, jo në prezencën e tij, atij i pranohet lutja dhe meleku i thotë: edhe ti e ke shpërblimin sikurse ai, dhe kjo është pjesa jote."*¹

Ky komentim nuk bie ndesh me atë që përmendëm më lart por konsiderohet një lloj zgjerimi në kuptimin e shefatit. Çdo njeri që ndihmon një tjetër qoftë nëpërmjet thirrjes për të bërë mirë apo lutet për atë, apo..., ai do të fitojë pjesën e shpërblimit të kësaj ndihmese apo thirrjeje.

¹ Tefsiri Es Safij, vëll. 1, f. 476.

Me këtë formë nxitëse për të bërë vepra të mira, Islami krijon tek njeriu shpirtin social që e nxjerr atë nga egoizmi dhe e bën të besojë se nuk e godet asnjë e keqe nëse e ndihmon vëllain e vet, ose përpiket për ta ndihmuar atë. Ai, me të vërtetë do të fitojë mirësinë dhe do jetë ortak me vëllanë e tij në atë çfarë ai u përpoq.

Ky ajet dëshmon dhe përforcon një të vërtetë tjetër e cila është se All'Ilahu i Gjithëpushtetshëm që ta mbikqyrë njeriun dhe të shënojë çdo vepër që ai bën dhe pastaj t'i kërkojë llogari për atë që ai ka vepruar, duke e shpërblyer për veprën e mirë e dhe duke e ndëshkuar atë për veprën e keqe. All'Ilahu i Lartësuar thotë: **"...All'Ilahu është i Gjithëpushtetshëm."**

Fjala "mukijjt" rrjedh nga fjala "el kuut" që është ushqimi i cili e ndihmon trupin e njeriut për të mbijetuar dhe për të ekzistuar. Për këtë, fjala "mukijjt" është emër vepror (vepruesi) dhe këtu ka kuptimin e personit që u jep të tjerëve ushqim dhe ndihmë. Në këtë mënyrë ai është ruajtës për jetën e tyre. Prandaj, fjala "mukijjt", i Gjithëpushtetshëm vjen edhe me kuptimin "Hafidh" ruajtës, i cili posedon fuqi për të ruajtur. Kështu që, fjala "mukijjt" i Gjithëpushtetshëm ka edhe kuptimin "el muktedir", që është në gjendje të llogarisë veprat e njerëzve. Në këtë mënyrë, fjala "mukijjt" vjen edhe me kuptimin "hasijb", llogaritës. Ka mundësi që fjala në ajet të jetë përfshirëse e të gjitha këtyre kuptimeve.

Ajeti 86

وَإِذَا حُيِّتُمْ بِتَحِيَّةٍ فَحَيُّوا بِأَحْسَنَ مِنْهَا أَوْ رُدُّوهَا ۚ إِنَّ اللَّهَ كَانَ عَلَىٰ كُلِّ

شَيْءٍ حَسِيبًا

"Kur ju përshëndet dikush me respekt, kthejani me një përshëndetje më të mirë ose në të njëjtën mënyrë! Pa dyshim, All'llahu llogarit çdo gjë."

Komentimi

Thirrja e përballjes së të mirës me të mirë

Megjithëse disa komentues të Kur'anit mendojnë se lidhja mes këtij ajeti dhe ajeteve të mëparshme ka lindur se ajetet e mëparshme flitnin për tematikën e luftës dhe xhihadit dhe ajeti në fjalë u bën thirrje myslimanëve që t'u bëjnë ballë çdo nisme paqësore nga ana e armikut me qëndrimin që është i përshtatshëm me atë iniciativë. Por kjo lidhje nuk ndalon që ky ajet të jetë rregull i përgjithshëm që përfshin shkëmbimin e ndjenjave të mira e të virtytshme ndërmjet palëve dhe personave. Ky ajet i urdhëron myslimanët që t'i pranojnë ndjenjat e dashamirësisë e të dashurisë në formën më të mirë ose të paktën të jetë e babarbartë me të. All'llahu i Lartësuar thotë: "Kur ju përshëndet dikush me respekt, kthejani me një përshëndetje më të mirë ose në të njëjtën mënyrë!..."

Fjala "tehijjetun", përshëndetje, rrjedh nga fjala "hajat", jetë, që do të thotë lutje për të tjerët që të kenë një jetë të gjatë, sido që të jetë përshëndetja; me fjalën "selamun alejkum", apo "hajake All'llah" apo të ngjashme me këto të dyja prej thënieve përshëndetëse. Sado që të ndryshojë përshëndetja ndërmjet popujve të ndryshëm, fjala "selam" është më e qarta dhe më e vërteta nga të gjitha ato lloje përshëndetjesh. Por, në disa komentime dhe transestime përfitohet se kuptimi i përshëndetjes, gjithashtu, përfshin bashkëveprimin dashamirës ndërmjet njerëzve.

Në komentimin e Ali ibn Ibrahim transmetohet nga imam Bakiri dhe imam Sadiku të cilët kanë thënë: "*Qëllimi i përshëndetjes në ajet është për selamin dhe për veprat e tjera të mira.*"¹

Në librin "Menakib" thuhet se një vajzë e vogël i dhuroi imam Hasanit një buqetë me lule dhe ai e përqafoi. Kur e pyetën për këtë veprim që bëri, ai e argumentoi me fjalën e All'llahut të Lartësuar: "**Kur ju përshëndet dikush me respekt, kthejani me një përshëndetje më të mirë...**"²

Kështu neve na qartësohet se ky ajet përfshin rregullin e përgjithshëm që t'i përgjigjesh çdo lloj ndjenje mirësie dhe dashurie sido që të jetë me fjalë apo me vepër.

Në fund ky ajet tregon se All'llahu i Lartësuar është i Gjithëditur për çdo gjë derisa edhe për llojet e përshëndetjes dhe të selamit dhe për përgjigjen e përshtatshme dhe se Atij nuk i fshihet asgjë. Ajeti thotë: "**...Pa dyshim, All'llahu llogarit çdo gjë.**"

¹ Tefsiri Ali ibn Ibrahim Kumij, vëll.1, f.145. Tefsiri Mexhmaul Bejan, vëll. 3, f.148.

² Menakib Ali ebu Talib, vëll. 3, f. 183.

Kërkim

Selami, përshëndetja më e madhe e Islamit

Nuk mund të mohohet se çdo shoqëri njerëzore ka tradita të veçanta në përshëndetjet e tyre kur takohen me njëri-tjetrin. Me anë të përshëndetjes shkëmbejnë ndjenjat e respektit, çiltërsisë e të dashurisë. Përshëndetja, siç është formë shprehimore, gjithashtu, ajo mund të jetë lëvizje praktike me anë të së cilës faktohen ndjenjat e respektit dhe të dashurisë reciproke.

Për myslimanët, Islami ka sjellë fjalën "selam" që ata të përshëndesin njëri-tjetrin me këtë fjalë. Ajeti në fjalë edhe pse është i përgjithshëm për llojet e përshëndetjeve, mirëpo vërtetësia më e qartë dhe më e dukur e këtij ajeti qëndron tek fjala "selam".

Bazuar në këtë ajet, myslimanët janë të detyruar që ta kthejnë selamin (përshëndetjen) në formën dhe mënyrën më të mirë ose më e pakta të jetë e njëjtë me atë përshëndetje që u përshëndetën. Në një ajet tjetër të Kur'anit tregohet qartë se "selami" është përshëndetja. Në ajet thuhet: **"Kur të hyni në shtëpi, përshëndetni njëri-tjetrin me përshëndetje të mirë e të bukur nga All'Ilahu."**¹ Nga ky ajet mund të argumentojmë se shprehja "es selamu alejkum", Paqja dhe bekimi qoftë mbi ju, në origjinalin e saj është "selamull'Ilahi alejkum" që do të thotë All'Ilahu iu dhuroftë paqe, bekim e siguri. Nga këtu qartësohet se selami (përshëndetja) është argument për dashurinë dhe mirësjelljen e ndërsjelltë, sikurse është argument për refuzimin e luftës, përçarjes dhe armiqësi.

¹ Sure "Nur", ajeti 61.

Disa ajete të tjera argumentojnë se "selami" është përshëndetja e banorëve të Xhennetit. All'Ilahu i Lartësuar thotë: **"Atje do të përshëndeten me fjalën: Selam!"**¹

Dhe: **"Njerëz të tillë do të shpërblehen me Xhennet të lartë për durimin e tyre dhe do të mirëpriten dhe do të gjejnë paqe."**²

Gjithashtu, disa ajete të tjera të Kur'anit famëlartë tregojnë se selami ose shprehje të tjera të njëjta me të, kanë qenë të përhapura në mesin e popujve para Islamit. Këtë e tregon ajeti 25 në suren "Dharijat" ku All'Ilahu i Lartësuar thotë: **"Ata hynë tek ai dhe thonë: 'Paqe!' - dhe ai u tha: 'Paqe, o njerëz të panjohur!'"** Edhe në poezitë e injorancës (përpara Islamit) tregohet se selami ka qenë përshëndetja e tyre.

Në të vërtetë rëndësia, madhështia dhe vlera e lartë e përshëndetjes islame (selamit) duket kur krahasohet me përshëndetjen e popujve të tjerë.

Tekstet islame e dëshmojnë dhe e vërtetojnë selamin. Transmetohet nga Profeti Muhammed (Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) se ka thënë: *"Kush fillon të flasë para se të përshëndesë, mos iu përgjigjini atij."*³

Transmetohet nga imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) se All'Ilahu i Lartësuar ka thënë:

*"Koprrac është ai që bën koprraci me selamin."*⁴

Transmetohet nga imam Bakiri se ka thënë: *"Vërtet, All'Ilahu e do përhapjen e selamit."*⁵

¹ Sure "Ibrahim", ajeti 23.

² Sure "Furkan", ajeti 75.

³ Usul Kafijj, vëll. 2, f. 645.

⁴ Usul Kafijj, vëll. 2, f. 645.

⁵ Usul Kafijj, vëll. 2, f. 645.

Në transmetime dhe hadithe të shumta përmenden rregulla dhe etika të shumta për selamin. Prej atyre rregullave është se selami duhet që të përhapet në mesin e të gjithë individëve të shoqërisë dhe të mos kufizohet vetëm në mesin shokëve e të afërmeve. Transmetohet se i Dërguari i All'llahut është pyetur: "Cila është vepra e mirë?" Ai është përgjigjur: "Të ushqesh të varfërit dhe të përshëndesësh me selam atë që e njeh dhe atë që nuk e njeh."¹

Gjithashtu, transmetohet se prej etikës së selamit është që i hipuri në mjet të përshëndesë atë që është duke ecur në këmbë dhe ai që udhëton me mjet të shtrenjtë të përshëndesë me selam atë që udhëton me mjet të lirë.² Kjo çështje mund të jetë nxitëse për modestinë dhe për ndalimin e mendjemadhësisë. Sepse, në shumicën e rasteve, mendjemadhësia godet të pasurit dhe nga ata që kanë pozitë e famë. Në ditët e sotme shohim të kundërtën ku shtresat e ulëta duhet që t'i përshëndesin shtresat e larta me selam. Me këtë veprim çështja merr karakter shtypës dhe pagan. Ndërkohë që Profeti (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ishte i pari që i përshëndeste të tjerët me selam. Ai përshëndeste me selam edhe të vegjëlit.³

Është e natyrshme se kjo çështje nuk e mohon atë që është transmetuar në transmetimet për nxitjen e të vegjëlve që t'i përshëndesin ata të parët të mëdhenjtë me selam, sepse kjo sjellje është prej moralit të lavdëruar njerëzor dhe nuk ka lidhje me dallimin shtresor në shoqëri.

Nga ana tjetër gjejmë transmetime që ndalojnë përshëndetjen me selam të çthururit, të devijuarit, kamatçinjve

¹ Tefsiri Fi Dhilalil Kur'an, vëll. 2, f. 472.

² Usul Kafijj, vëll. 2, f. 646-647.

³ Uesaliu Shia, vëll. 12, f. 62, kreu: Pëlqimi i përshëndetjes së të vegjëlve.

dhe të ngjashmëve me ta. Kjo çështje konsiderohet si armë për të luftuar të keqen, devijimin, kamatën etj. Mirëpo, nëse selami ndikon tek i çthururi, i devijuari dhe bën që t'i largohen të keqes dhe devijimit, nuk është e ndaluar dhe nuk ka përse te jetë e ndaluar përshëndetja e tyre me selam.

Nuk duhet lënë pa sqaruar se qëllimi i kthimit të selamit në mënyrën më të mirë, është që selami të pasohet me shprehjet si "ue rahmetullah" ose "ue rahmetullahi ue berekatuhu".

Në tefsirin "Ed Durul Menthur" është transmetuar se një person shkoi te Profeti (Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe i tha: "*Es selamu alejkum.*" Dhe Profeti iu përgjigj: "*Ue alejkum selam ue rahmetullah.*" Pastaj shkoi një tjetër dhe i tha: "*Es selamu alejkum ue rahmetullah.*" Profeti iu përgjigj: "*Ue alejkum selam ue rahmetullahi ue berekatuhu.*" Më pas vjen një i tretë dhe i thotë: "*Es selamu alejkum ue rahmetullahi ue berkekatuhu.*" Profeti i tha: "*Ue alejke.*" Kur u pyet për shkakun e kësaj përgjigje të shkurtër Profeti tha: "Vërtet, Kur`ani thotë kur të përshëndetni, përshëndetni me një përshëndetje që është më e mirë se ajo. Por ti i përmende të gjitha nuk le asnjë."¹

Në të vërtetë i dërguari i All'Ilahut e ktheu përshëndetjen e dy të parëve më të mirë se përshëndetja e tyre. Ndërsa tjetrit ia ktheu me fjalën "ue alejke", që do të thotë se çdo gjë që ti më the mua është e kthyer tek ti.

¹ Ed Durrul Menthur, vëll. 2, f. 8.

Ajeti 87

اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ ۚ لِيَجْمَعَٰكُمْ إِلَىٰ يَوْمِ الْقِيَمَةِ لَا رَيْبَ فِيهِ ۚ وَمَنْ

أَصْدَقُ مِنَ اللَّهِ حَدِيثًا ﴿٨٧﴾

All'llahu! Nuk ka zot tjetër të vërtetë përveç Atij. Ai do t'ju mbledhë në Ditën e Kiametit, për të cilën nuk ka dyshim aspak! E kush është në fjalë më i vërtetë se All'llahu?"

Komentimi

Ky ajet ka ardhur si plotësues i ajetit të mëparshëm dhe parathënie për disa ajete pasardhëse. Ajeti i mëparshëm pasi urdhëronte për kthimin e përsëritjes thoshte: **"Padyshim All'llahu, llogarit çdo gjë."**

Ajeti në fjalë tregon për një çështje të fshehtë dhe shumë të rëndësishme, e cila është çështje e Ditës së Ringjalljes dhe e Llogarisë në të cilën do të jetë gjykata e drejtë dhe e përgjithshme e All'llahut për mbarë njerëzimin. Këtë çështje e ka bashkë-shoqëruar me monoteizmin (teuhidin), i cili është një parim prej parimeve të besimit. Ajeti thotë: **All'llahu! Nuk ka zot tjetër të vërtetë përveç Atij. Ai do t'ju mbledhë në Ditën e Kiametit, për të cilën nuk ka dyshim aspak!..."**

Shprehja "Ai do t'ju mbledhë" tregon për përfshirjen e të gjithë njerëzve nga i pari i tyre e deri tek i fundit, të cilët All'llahu do t'i tubojë të gjithë njerëzit në një ditë të vetme dhe ajo është Dita e Kijametit dhe e Tubimit të madh.

Në një vend tjetër të Kur'anit (tek dy ajetet, 93-94 të sures Merjem) gjithashtu tregohet kjo e vërtetë. Pra, e vërteta e Ringjalljes dhe e tubimit e të gjithë robëve të All'llahu të cilët kanë jetur mbi sipërfaqen e kësaj toke apo në sipërfaqe të tokave të tjera në një ditë të vetme.

Shprehja "Për të cilën nuk ka dyshim aspak!" që gjendet në këtë ajet dhe në ajetet e tjera, është tregues dhe argumentues i prerë dhe i pakundërshtueshëm se Dita e Kijametit do të ndodhë. Njësoj si argumenti në "ligjin e përsosmërisë", "urtësisë së krijimit" dhe "ligji i drejtësisë së All'llahut" të përmendura me detaje tek hulumtimi rreth Ringjalljes.

Në fund, ajeti dëshmon dhe përforcon të vërtetën se All'llahu i Lartësuar është më i Vërteti i të vërtetëve ku thotë: **"...E kush është në fjalë më i vërtetë se All'llahu?"**

Nga këtu, askush nuk duhet të dyshojë për atë që ka premtuar All'llahu, ku prej atyre premtimeve është edhe Ringjallja dhe Tubimi. Përgënjeshtrimi nuk buron vetëm nga injoranca, padituria, besimi i dobët dhe nevoja. S'ka dyshim se All'llahu është i Gjithëdituri për të gjitha botërat. Për Atë kanë nevojë krijesat dhe Ai absolutisht nuk ka nevojë për askënd. Ai është i pastër nga cilësia e paditurisë, nevojës dhe e dobësisë. Për këtë Ai është më i Vërteti i të vërtetëve dhe se gënjeshtra nuk ka absolutisht kuptim tek Ai.

Ajeti 88

فَمَا لَكُمْ فِي الْمُنَافِقِينَ فَعْتَيْنِ وَاللَّهُ أَرْكَسَهُم بِمَا كَسَبُوا أَتُرِيدُونَ أَنْ تَهْدُوا مَنْ أَضَلَّ اللَّهُ وَمَنْ يُضِلِلِ اللَّهُ فَلَنْ تَجِدَ لَهُ سَبِيلًا



"Përse jeni ndarë në dy grupe për çështjen e hipokritëve, kur All'Ilahu i ka flakur ata në mosbesim për shkak të veprave të tyre?! A mos vallë, dëshironi t'i ktheni në rrugë të drejtë ata që All'Ilahu i ka lënë në humbje? Për atë që All'Ilahu e lë në humbje, ti nuk mund të gjesh rrugë të drejtë."

Shkaku i zbritjes

Disa komentues transmetojnë nga ibn Abasi se një grup njerëzish nga banorët e Mekës, të cilët kishin shfaqur Islamin, refuzuan mosqinjësinë dhe u tërhoqën nga emigrimi për në Medine. Në të vërtetë, ata mbështetnin dhe përkrahnin idhujtarët. Mirëpo në fund ata u detyruan të dilnin nga Meka dhe udhëtuan me myslimanët derisa arritën në periferi të Medines. Ka mundësi që ata e bënë këtë veprim me qëllim që të largonin të keqen nga vetja e tyre ose për të spiunuar myslimanët emigrues. Ata shfaqnin gëzim për shkak të fshehjes së intrigave të tyre ndaj myslimanëve. Po ashtu, e konsideruan emigrimin e tyre në Medine se nuk do të kenë asnjë problem nga të tjerët. Myslimanët

ishin vigjilentë ndaj të vërtetës së tyre porse u ndanë në dy grupe ku një grup e shihte të domosdoshëm dëbimin e atij grupi hipokritësh, të cilët në realitet i mbronin armiqët e Islamit që ishin politeistët dhe idhujtarët. Kurse grupi tjetër prej myslimanëve, të cilët për shkak të sipërfaqësisë së tyre shihnin të jashtmen e çështjeve dhe jo të brendshmen e tyre kundërshtuan dëbimin e hipokritëve me pretekstin se nuk mund të luftohen apo të dëbohen ata që dëshmojnë Njehsimin e All'Ilahut dhe Profetësinë e Muhammedit (Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Ata thoshin se nuk lejohet gjakderdhja e tyre vetëm pse nuk emigruan me myslimanët. Atëherë zbriti ky ajet, i cili e qorton grupin e dytë për gabimin e tyre dhe i udhëzon ata për në rrugë të drejtë¹

Komentimi

Duke u mbështetur në shkakun e zbritjes së këtij ajeti, të cilin e përmendëm më lart, na qartësohet lidhja e fortë mes këtij ajeti dhe ajeteve që vijnë dhe gjithashtu ajeteve të mëparshëm që trajtuan tema dhe çështje rreth hipokritëve.

Ky ajet, në fillim u drejtohet myslimanëve dhe i qorton ata për ndarjen e tyre në dy grupe dhe çdo grup gjykon sipas asaj që i pëlqen në çështjen e hipokritëve. Ajeti thotë: **"Përse jeni ndarë në dy grupe për çështjen e hipokritëve..."**

¹ Janë përmendur shkaqe të tjera për zbritjen e këtij ajeti dhe të ajeteve pasardhës. Thuhet se ka zbritur në betejën e Uhudit, ndërsa ajetet pasardhëse flasin për emigrimin dhe nuk janë në përputhje me këtë thënie. Por ata përputhen me shkakun e zbritjes që u përmend më lart. Tefsiri Durul Menthur, vëll. 2, f.190.

Ajeti i ndalon myslimanët që të përçahen në çështjen e një grupi të cilët refuzuan të emigrojnë me ta, bashkëpunuan me idhujtarët dhe nuk pranuan të merrnin pjesë me muxhahidinët. Nga këtu u duk hipokrizia e tyre dhe për këtë argumentuan veprat e tyre. Prandaj, myslimanëve nuk u lejohet që të mashtrohen nga shtirja e tyre se gjoja janë monoteistë dhe besimtarë. Po ashtu, myslimanëve nuk u lejohet të ndërmjetësojnë për ata. Këtë e dëshmoi edhe ajeti i mëparshëm i cili thoshte: **"kurse kush ndërmjetëson për një çështje të keqe do të ketë pjesë në ndëshkimin e saj."**

Pas kësaj, ajeti sqaron se All'llahu ua ka rrëmbyer atyre hipokritëve të gjitha mundësitë për të pasur sukses dhe u ka ndaluar atyre mirësitë dhe ndihmën e Tij për shkak të asaj që vepruan. All'llahu i Lartësuar i përmbysi plotësisht përfytyrimet e tyre dhe ata u bënë si ai që qëndron me kokë dhe jo me këmbë. All'llahu i Lartësuar thotë: **"...kur All'llahu i ka flakur ata në mosbesim për shkak të veprave të tyre?!..."** Shprehja **"për shkak të veprave të tyre?!"** tregon se në çdo renegatim apo dalje nga rruga e drejtë, nga rruga e udhëzimit, e lumturisë dhe nga rruga e shpëtimit, realizohet për shkak të veprave të njeriut. Kur humbja i atribuohet All'llahut të Lartësuar, kjo do të thotë se Ai është i Gjithëpushtetshëm dhe i Drejtë dhe e shpërblen çdo njeri sipas asaj vepre që ai ka vepruar.

Në fund ky ajet u drejtohet mendjelehtëve prej myslimanëve të cilët u ndanë mes tyre dhe që mbronin naivitetin e vet ndaj hipokritëve. Ajeti u përforcon atyre se udhëzimin e atij të cilit All'llahu ia ka ndaluar mirësitë dhe mëshirën e Vet për shkak të veprave të këqija e të shëmtuara nuk mund të vërtetohet,

sepse All'Ilahu i Lartësuar ua ka caktuar atyre hipokritëve ndëshkimin dhe humbjen që meritojnë në vend të udhëzimit dhe shpëtimit: **"...A mos vallë, dëshironi t'i ktheni në rrugë të drejtë ata që All'Ilahu i ka lënë në humbje? Për atë që All'Ilahu e lë në humbje, ti nuk mund të gjesh rrugë të drejtë."**

Pra, vepra e çdo njeriu nuk ndahet prej tij dhe ky është ligji hyjnor. Atëherë, si mund të shpresohet udhëzimi i personave zemrat dhe mendjet e të cilëve janë mbushur me hipokrizi dhe bëjnë vepra për të mbrojtur armiqtë e All'Ilahut?! Vërtet, kjo është një shpresë e pabazë dhe pa argument.

Ajeti 89

وَدُّوا لَوْ تَكْفُرُونَ كَمَا كَفَرُوا فَتَكُونُونَ سَوَاءً ۖ فَلَا تَتَّخِذُوا مِنْهُمْ أَوْلِيَاءَ حَتَّىٰ
يُهَاجَرُوا فِي سَبِيلِ اللَّهِ ۚ فَإِنْ تَوَلَّوْا فَخُذُوهُمْ وَأَقْتُلُوهُمْ حَيْثُ وَجَدْتُمُوهُمْ ۖ
وَلَا تَتَّخِذُوا مِنْهُمْ وَلِيًّا وَلَا نَصِيرًا ﴿٨٩﴾

"Ata dëshirojnë që edhe ju të mos besoni, ashtu siç nuk besojnë vetë dhe të bëheni të njëjtë me ata. Kurrësi mos u bëni shokë me ata, derisa të mërgojnë për hir të All'Ilahut. Nëse ata shmangen, ndiqini e i vrisni, kudo që t'i gjeni! Dhe mos zgjidhni nga ata as miq, as mbështetës."

Komentimi

Ajeti i mëparshëm fliste për hipokritët, të cilët gëzonin mbrojtjen dhe ndërmjetësimin e një grupi prej myslimanëve të dobët në besim dhe qartësoi se ai grup hipokritësh janë të huaj në Islam. Ajeti në fjalë qartëson se hipokritët nga ekstremizmi i tyre në devijim dhe humbje donin që edhe myslimanët t'i çonin në mosbesim me qëllim që të mos ishin vetëm ata mohues: **"Ata dëshirojnë që edhe ju të mos besoni, ashtu siç nuk besojnë vetë dhe të bëheni të njëjtë me ata..."**

Për këtë shkak, hipokritët janë më të këqinj se mohuesit sepse mohuesit nuk përpiqen në zhveshjen e besimit tek të tjerët

kurse hipokritët e bëjnë këtë gjë dhe gjithmonë përpiqen për prishjen e besimit. Me këtë natyrë që kanë, atyre nuk u lejohet asnjëherë që t'i shoqërojnë myslimanët. Ajeti i begatë thotë: **"...Kurrsesi mos u bëni shokë me ata..."** vetëm nëse ata ndryshojnë vetat e tyre dhe largohen nga mosbesimi, hipokrizia dhe veprat e tyre armiqësore e shkatërruese. Që të arrihet ky ndryshim dhe të vërtetohet vërtetësia e tyre rreth këtij ndryshimi, atëherë është detyrë e tyre që të përshtatohen për në emigrim dhe të largohen nga epiqendra e mohimit dhe e hipokrizisë për në banesën e Islamit (pra, të emigrojnë nga Meka për në Medine). Ajeti thotë: **"...derisa të mërgojnë për hir të All'llahut..."** Nëse e refuzojmë emigrimin, atëherë myslimanët ta dinë se ata nuk duan që të dalin nga gjendja e mosbesimit dhe e hipokrizisë. E nëse ata e paraqesin besimin, këtë e bëjnë vetëm për dobitë dhe qëllimet e ulta të tyre dhe me qëllim që ta kenë më të lehtë spiunimin dhe intrigat ndaj myslimanëve.

Në këtë gjendje myslimanët mund t'i zënë robër ata kudo që t'i gjejnë dhe t'i vrasin ata nëse është e domosdoshme. Ajeti thotë: **"...Nëse ata shmangen, ndiqini e i vrisni, kudo që t'i gjeni!..."** Ky ajet përsërit përforcimin për myslimanët që ata t'i shmangen shoqërimit të atyre me hipokritët dhe të ngjashmëve me ta ku thotë: **"...Dhe mos zgjidhni nga ata as miq, as mbështetës."**

Me këtë rregull Kur'ani dëshmon fundin e vërtetë të çdo shoqërie që është se jeta e çdo shoqërie që kalon fazat e ndreqjes nuk mund të jetë e shëndoshë nëse nuk zhduk mikrobet shkatërruese që gjenden tek ata hipokritë apo armiq të tjerë që

hiqen si të singertë. Në të vërtetë ata janë elementë shkatërrues, spiunojnë dhe thurin intriga në dëm të interesave të përgjithshme.

Është për t'u habitur se Islami me gjithë interesimin dhe kujdesjen e tij ndaj idhtarëve të librit, jehudinjtë dhe të krishterët, dhe me gjithë ndalimin e padrejtësisë e të mësymjes ndaj tyre, ai paralajmëron shumë ndaj çështjeve të hipokritëve dhe e shikon të domosdoshme që me ta të sillesh me forcë. Edhe pse ata shfaqin Islamin, Kur'ani e thotë qartë që ata të kapen por edhe të vriten nëse e do çështja.

Kjo ashpërsi është se ata mund ta godasin Islamin nën petkun e Islamit dhe këtë nuk e bën asnjë armik tjetër.

Pyetje: Disa e shikojnë se Profeti (Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka pasur frikë që t'i vrasë hipokritët që armiqtë e Islamit mos e akuzonin se po vret shokët e vet. Ose ai nuk i ka vrarë ata me qëllim që të tjerët të mos e shfrytëzonin këtë dhe të vrasin çdo person kundërshtues me preteksin se është hipokrit. Si mund të përshtatet ky qëndrim me këtë ajet të ndershëm.

Përgjigje: E vërteta është se Profeti (Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka ndjekur këtë metodë me hipokritët e Medines të cilët nuk e kanë shfaqur haptazi armiqtë për atë dhe për Islamin. Këtë metodë e ka ndjekur me hipokritët e Mekës, të cilët e shfaqën armiqtë haptazi dhe i ndihmuan jobesimtarët kundër myslimanëve.

Ajeti 90

إِلَّا الَّذِينَ يَصِلُونَ إِلَى قَوْمٍ بَيْنَكُمْ وَبَيْنَهُمْ مِيثَاقٌ أَوْ جَاءُوكُمْ حَصِرَتْ
صُدُورُهُمْ أَنْ يُقَاتِلُوكُمْ أَوْ يُقَاتِلُوا قَوْمَهُمْ ۚ وَلَوْ شَاءَ اللَّهُ لَسَلَّطَهُمْ عَلَيْكُمْ
فَلَقَاتِلُوكُمْ ۚ فَإِنْ اعْتَزَلُوكُمْ فَلَمْ يُقَاتِلُوكُمْ وَأَلْقَوْا إِلَيْكُمُ السَّلَامَ فَمَا جَعَلَ
اللَّهُ لَكُمْ عَلَيْهِمْ سَبِيلًا ﴿٩٠﴾

"Përveç atyre që janë strehuar te një popull me të cilin ju keni marrëveshje ose atyre që kanë ardhur te ju, e u vjen rëndë që të luftojnë kundër jush ose të luftojnë kundër popullit të vet. Sikur të kishte dashur All'llahu, do t'u kishte dhënë pushtet mbi ju dhe ata do të luftonin kundër jush. Në qoftë se ata tërhiqen prej jush, nuk hyjnë në luftë kundër jush dhe ju ofrojnë paqe, atëherë për ju All'llahu nuk lë shteg që të luftoni kundër tyre."

Shkaku i zbritjes

Kanë ardhur transmetime të shumta në të cilat përfitohet se dy fiseve arabe në kohën e Profetit (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), "Benij Demretu" dhe

"Eshxha", ishin aleatë. Fisi "Demretu" bëri marrëveshje me Profetin (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) që të lënë konfliktin. Ndërsa fisi tjetër nuk kishte bërë marrëveshje me Profetin (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Disa transmetime thonë se disa myslimanë filluan të dyshojnë në sinqeritetin e fisit Demretu ndaj myslimanëve dhe i propozuan Profetit që ta sulmonin këtë fis përpara se ata t'i sulmojnë myslimanët. Profeti u përgjigj duke u thënë: *"Jo, kurrë sepse ata me të vërtetë janë arabët që sillen më mirë me prindërit, mbajnë lidhjet farefisnore dhe i mbajnë premtimet."*

Pas një periudhe kohe të shkurtër myslimanët mësuhan se fisi Eshxha me në krye kryetarin e tij Mesud ibn Rruxhejle së bashku me shtatëqind burra kishte arritur në periferi të Medines. Profeti dërgoi një delegacion që të mësonte shkakun e ardhjes së tyre në atë vend. Fisi iu përgjigj se kanë ardhur që të bëjnë pakt me myslimanët ashtu sikurse fisi Demretu. Kur Profeti e mori vesh këtë çështje, i urdhëroi shokët e tij që të merrnin një sasi hurmash dhe t'ia dhuronin këtij fisi. Pastaj Profeti u takua me ta dhe e lajmëruan atë se nga pamundësia e tyre për të ndihmuar myslimanët në luftë kundër armiqve dhe nga padëshira që të luftojnë kundër myslimanëve për shkak të afrimitetit dhe fqinjësisë, ata dëshironin që të bënin pakt me myslimanët për të ndaluar armiqësinë ndërmjet tyre. Atëherë ka zbritur ky ajet që u sqaron myslimanëve se çfarë duhet bërë në këtë rast.¹

Disa komentues të tjerë të Kur'anit thonë se një pjesë e këtij ajeti ka zbritur për çështjen "Beni Midlixh", të cilët shkuan tek Profeti (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi

¹ Tefsiri *Mexhmanul Bejan*, vëll. 3, f. 153, fundi i ajetit në fjalë.

familjen e tij!) dhe e lajmëruan atë se duan të bëjnë pakt me të që të mos sulmojnë njëri-tjetrin. E kjo për të shprehur dëshirën e tyre për të qëndruar neutral në drejtim të myslimanëve dhe thirrjes së tyre.¹

Komentimi

Mirëpritja e shprehjes së paqes

Pasi Kur'ani famëlartë i urdhëroi myslimanët në ajetet e mëparshëm që të përdorin forcën ndaj hipokritëve që bashkëpunuan me armiqtë e Islamit, ajeti në fjalë përjashton dy grupe nga rregulli i përmendur:

Grupi i parë: Kush ka pasur pakt dhe marrëveshje me aleatët tuaj: **"Përveç atyre që janë strehuar te një popull me të cilin ju keni marrëveshje..."**

Grupi i dytë: Ata të cilët nuk i kishin mundësitë që të luftonin me myslimanët. Po ashtu, mundësia e tyre nuk është në atë shkallë bashkëpunimi me myslimanët që të luftojnë fisin e tyre **"...ose atyre që kanë ardhur te ju, e u vjen rëndë që të luftojnë kundër jush ose të luftojnë kundër popullit të vet..."**

Është mëse e qartë se personat e grupit të parë duhet që të jenë të përjashtuar nga ky rregull në respekt të premtimeve dhe marrëveshjeve. Ndërsa grupi i dytë, edhe nëse nuk ishte i shfajsuar, por e ka për detyrë që t'i përgjigjet të vërtetës pasi e ka njohur atë, ai ka shpallur neutralizimin e saj dhe për këtë

¹ Tefsiri *Mexhmanul Bejan*, vëll. 3, f. 152, fundi i ajetit në fjalë. Tefsiri *El Ajashij*, vëll.1, f. 262

konfrontimi me ta bie në kundërshtim me parimet e drejtësisë dhe të humanizmit. Me qëllim që myslimanët të mos i mbulojë vetëpëlqimi prej fitoreve të mëdhaja dhe për arsye që të mos e konsiderojnë se këto rezultate janë për shkak të mundësive dhe përgatitjes së tyre ushtarake dhe që të mos provokohen ndjenjat e tyre në drejtim të këtij grupi neutral, ajeti thotë: **"...Sikur të kishte dashur All'llahu, do t'u kishte dhënë pushtet mbi ju dhe ata do të luftonin kundër jush..."**

Kjo është një kujtesë për myslimanët që ata të mos e harrojnë All'llahun e Plotfuqishëm në çdo fitore dhe t'i largohen vetëpëlqimit, mahnitjes dhe mburrjes për forcën që ata posedojnë dhe të mos e konsiderojnë faljen e të paaftëve humbje apo dëmtim të vetave të tyre.

Në fund ajeti përsërit përforcimin se All'llahu nuk i lejon myslimanët të prekin një popull që u paraqet atyre paqen dhe pajtimin. Me të vërtetë myslimanët janë të detyruar që ta pranojnë ftesën e pajtimit dhe t'ua shtrinë dorën atyre që ia kanë shtrirë atyre që duan pajtim dhe paqe: All'llahu i Lartësuar për këtë gjë thotë: **"...Në qoftë se ata tërhiqen prej jush, nuk hyjnë në luftë kundër jush dhe ju ofrojnë paqe, atëherë për ju All'llahu nuk lë shteg që të luftoni kundër tyre..."**

Ajo që tërheq vëmendjen është se Kur'ani në këtë vend dhe në vende të tjera e përmend paqen me fjalën "ia ofrojnë paqen". Ka mundësi që kjo mund të jetë treguese për distancimin e dy palëve mospajtuese përpara pajtimit.

Ajeti 91

سَتَجِدُونَ ءَاخِرِينَ يُرِيدُونَ أَنْ يَأْمَنُوكُمْ وَيَأْمَنُوا قَوْمَهُمْ كُلًّا مَا رُدُّوا إِلَى
الْفِتْنَةِ أُرْكِسُوا فِيهَا ۚ فَإِنْ لَّمْ يَعْتَزْلُوكُمْ وَيُلْقُوا إِلَيْكُمُ السَّلَامَ وَيَكُفُّوا
أَيْدِيَهُمْ فَاخْذُوهُمْ وَأَقْتُلُوهُمْ حَيْثُ ثَقِفْتُمُوهُمْ ۚ وَأُولَئِكَ جَعَلْنَا لَكُمْ
عَلَيْهِمْ سُلْطَانًا مُبِينًا ﴿٩١﴾

"Ju do të hasni në njerëz të tjerë, të cilët dëshirojnë të sigurohen nga ju dhe nga kombi i vet. Sa herë që thirren në idhujtari, menjëherë bien në të. Nëse nuk shmangen prej jush, nëse nuk ju ofrojnë paqen dhe nëse nuk heqin dorë nga luftimi kundër jush, atëherë i kapni e i vrisni kudo që t'i gjeni! Kundër tyre ju kemi dhënë të drejtë të qartë."

Shkaku i zbritjes

Janë përmendur shkaqe të ndryshme për zbritjen e këtij ajeti. Më i njohuri i atyre shkaqeve është se një grup prej banorëve të Mekës kur shkonin te Profeti (Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), e shfaqnin Islamin për mashtrim dhe përgënjeshtim. Kur ktheheshin tek kurejshitët,

adhuronin idhujt. Ata e zgjodhën këtë lloj sjelljeje dhe metode për të larguar nga vetat e tyre rrezikun e myslimanëve dhe të kurejshitëve si dhe për vazhdimësinë e interesave të tyre tek të dy palët. Ky ajet i urdhëron myslimanët që të veprojnë me ata me forcë e ashpërsi.¹

Komentimi

Dënimi i dyfytyrakut

Në të vërtetë ky ajet na paraqet një grup njerëzish kontraditorë me grupin tjetër, për të cilin fliste ajeti i mëparshëm dhe urdhëron për pranimin e pajtimit me ta. Po ashtu na paraqet edhe një grup që përbëhet nga persona oportunistë e materialistë, ku qëllimi i vetëm i tyre janë interesat e veta, të lëvizin të lirë në mesin e myslimanëve dhe kurejshitëve nëpërmjet rrugës së hipokrizisë, mashtrimit, të shtirurit dhe bashkëpunimit me të dy palët. Për këtë, ajeti i begatë thotë:

"Ju do të hasni në njerëz të tjerë, të cilët dëshirojnë të sigurohen nga ju dhe nga kombi i vet..."

Atyre personave sapo t'u jepet mundësia menjëherë ndryshojnë dhe zhyten në përçarje dhe idhujtari me kokë poshtë: **"...Sa herë që thirren në idhujtari, menjëherë bien në të..."**

Veprat dhe sjellja e tyre janë të ndryshme nga veprat dhe sjellja e grupit të mëparshëm i cili dëshironte që të qëndronte neutral. Grupi i mëparshëm hoqi dorë nga keqbërja e

¹ Tefsiri *Mexhmanul Bejan*, vëll. 3, f. 154.

myslimanëve e ndërsa ky i fundit e shpalosi personalitetin e vet në keqbërjen ndaj mysli-manëve duke mbajtur qëndrime kundra tyre. Kur'ani famëlartë e kushtëzon këtë grup me tre kushte që të jenë të sigurtë nga hakmarrja e mysli-manëve. Ato kushte janë: të shmangen nga mysli-manët; të pajtohen me ta; dhe, të ndalojnë keqbërjen ndaj tyre. Ajeti thotë: **"...Nëse nuk shmangen prej jush, nëse nuk ju ofrojnë paqen dhe nëse nuk heqin dorë nga luftimi kundër jush..."** E nëse ata i refuzojnë këto kushte dhe këmbëngulin në kundërshtime dhe rebelim, atëherë mysli-manët janë të detyruar që t'i kapin personat e atij grupi dhe t'i vrasin kudo që t'i gjejnë, siç thotë All'illahu i Lartësuar: **"...atëherë i kapni e i vrisni kudo që t'i gjeni!..."**

Meqenëse argumenti u plotësua ndaj tyre, në mbyllje ajeti thotë: **"...Kundër tyre ju kemi dhënë të drejtë të qartë."**

Ky autoritet mund të jetë në fushën e logjikës e të thënies, kur logjika e mysli-manëve mbizotëron mbi logjikën e idhujtarëve dhe jobesimtarëve. Ose mund të jetë një sundim material i dukshëm sepse ajeti ka zbritur në kohën kur mysli-manët gëzonin një autoritet dhe forcë të mjaftueshme.

Shprehja "kudo që t'i gjeni", që ka ardhur në këtë ajet, tregon se mysli-manët kanë nevojë për saktësim dhe mjeshtëri në zbulimin e këtij grupi të rrezikshëm dyfytarak sepse, ata kanë aftësi të habitshme në ngjyrim, ndryshim dhe mashtrim. Shprehja "kudo që t'i gjeni", "thekaftumukum" rrjedh nga rrënja e fjalës "thekafetu" që do të thotë arritja e diçkaje duke përdorur saktësinë dhe mjeshtërinë. Kurse fjala "gjeni", "uexhede" ka kuptimin e arritjes së diçkaje në formë të përgjithshme e të pakushtëzuar.

Ajeti 92

وَمَا كَانَ لِمُؤْمِنٍ أَنْ يَقْتُلَ مُؤْمِنًا إِلَّا خَطَاً ۚ وَمَنْ قَتَلَ مُؤْمِنًا خَطَاً
 فَتَحْرِيرُ رَقَبَةٍ مُؤْمِنَةٍ وَدِيَةٌ مُسَلَّمَةٌ إِلَىٰ أَهْلِهِ ۖ إِلَّا أَنْ يَصَّدَّقُوا ۚ فَإِنْ
 كَانَ مِنْ قَوْمٍ عَدُوٍّ لَكُمْ وَهُوَ مُؤْمِنٌ فَتَحْرِيرُ رَقَبَةٍ مُؤْمِنَةٍ ۖ وَإِنْ
 كَانَ مِنْ قَوْمٍ بَيْنَكُمْ وَبَيْنَهُمْ مِيثَاقٌ فَدِيَةٌ مُسَلَّمَةٌ إِلَىٰ أَهْلِهِ ۖ
 وَتَحْرِيرُ رَقَبَةٍ مُؤْمِنَةٍ ۖ فَمَنْ لَّمْ يَجِدْ فَصِيَامُ شَهْرَيْنِ مُتَتَابِعَيْنِ تَوْبَةً مِّنَ اللَّهِ
 ۖ وَكَانَ اللَّهُ عَلِيمًا حَكِيمًا ﴿٩٢﴾

Nuk bën që besimtari të vrasë besimtarin, përveçse gabimisht. Kush vret një besimtar gabimisht, duhet të lirojë një besimtar të robëruar dhe t'u paguajë gjakun trashëgimtarëve të të vrarit, përpos rastit kur familja e të vrarit ia fal gjakun. Nëse i vrari është nga një popull që e keni armik e njëkohësisht është besimtar, duhet të lirohet një besimtar i robëruar. Nëse i vrari është nga një popull me të cilin ju keni lidhur marrëveshje, i duhet paguar gjaku familjes së tij, duke liruar edhe një besimtar të robëruar. Ai që s'mund të gjejë rob, duhet të agjërojë dy muaj rresht. (Kjo është bërë) në shenjë pendimi para All'Ilhut. Se All'Ilahu është i Gjithëdijshtëm dhe i Urtë."

Shkaku i zbritjes

Tregojnë se një idhujtar i banorëve të Mekës i quajtur "Harith ibn Zejd", në bashkëpunim me Ebu Xhehlin, për një kohë të gjatë e torturonte një prej myslimanëve, i cili quhej Ajash ibn Ebij Rabijatu. Shkaku i torturimit të tij nuk ka qenë për arsye të ndonjë krimi që ai ka bërë, por për arsye se ai ka pranuar Islamin. Pas emigrimit të myslimanëve në Medine emigroi edhe Ajashi. Papritmas, një ditë shikon Harith ibn Zejdin në një nga rrugët e Medines dhe e vret atë duke menduar se ai akoma është armik i myslimanëve dhe nuk e dinte se Harithi ishte penduar e ishte bërë mysliman. Profeti (Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) e mori vesh këtë ngjarje dhe zbriti ky ajet që tregon rregullin në shembullin e kësaj vrasjeje të shkaktuar gabimisht.¹

Komentimi

Rregulli i vrasjes së shkaktuar gabimisht

Ajeti i mëparshëm ua liroi duart myslimanëve ndaj hipokritëve të cilët përbënin rrezik të madh për Islamin dhe i lejoi ata që edhe t'i vrasin të tillë hipokritë. Për t'ju shmangur keqpërdorimit të këtij rregulli, për t'i mbyllur rrugën qëllimeve personale që mund ta nxisin një person për ta vrarë një tjetër me akuzën se është hipokrit, dhe për të mënjанuar gjakderdhjen e të

¹ Tefsiri Mexhmaul Bejan, vëll. 3, f. 156 fundi i ajetit në fjalë.

pafajshmëve, ky ajet, dhe ai i cili vjen pas tij, sqaron rregullat e vrasjes gabimisht dhe të vrasjes me qëllim që myslimanët të jenë të kujdesshëm dhe vigjilentë në çështjen e gjakderdhjes, e cila gëzon një përkushtim të madh në Islam. Ajeti thotë: **"Nuk bën që besimtari ta vrasë besimtarin, përveçse gabimisht..."**

Në realitet ky ajet dëshmon një të vërtetë prej të vërtetave se besimtari nuk ia lejon absolutisht vetes së tij gjakderdhjen e të pafajshmit, sepse ndjenjat e besimit e bëjnë bashkësinë besimtare pjesë të një trupi të vetëm. Nga kjo e vërtetë qartësohet se ai i cili kryen krimin fillimisht akuzohet për besimin e tij.

Shprehja **"përveçse gabimisht"** nuk do të thotë se lejohet vrasja gabimisht, sepse e tillë vrasjeje nuk është nga një vendim i paraprirë dhe as vrasësi nuk është i ditur për gabimin e tij. Pastaj ky ajet shpjegon shpagimin e vrasjes gabimisht dhe e ndanë atë në tre lloje.

Lloji i parë: Vrasësi të lirojë një rob mysliman dhe të paguajë gjobën e të vrarit familjes së tij nëse familja e të vrarit janë mysliman: **"...Kush vret një besimtar gabimisht, duhet të lirojë një besimtar të robëruar dhe t'u paguajë gjakun trashëgimtarëve të të vrarit..."** Nëqoftëse familja e të vrarit ia fal gjakun, atëherë vrasësi nuk duhet të paguaj gjë. Ajeti thotë **"...përpos rastit kur familja e të vrarit ia fal gjakun..."**

Lloji i dytë: Shpagimi i vrasjes gabimisht është kur i vrari është mysliman. Mirëpo nëse familja e tij është armike e Islamit, në këtë rast duhet që të lirohet një rob mysliman dhe të mos i paguhet gjobë familjes së të vrarit. Ajeti për këtë lloj vrasjeje thotë **"...Nëse i vrari është nga një popull që e keni armik e**

njëkohësisht është besimtar, duhet të lirohet një besimtar i robëruar..." sepse Islami e refuzon forcimin material dhe monetarë të armiqëve të tij. Në shtesë të kësaj, Islami i ka shkëputur lidhjet mes këtij personi dhe familjes së tij armiqësore ndaj Islamit, kështu që nuk ka kuptim kompensimi i humbjes.

Lloji i tretë: Shpagimi i vrasjes gabimisht kur i vrari është nga një familje jomyslimane, por mes tyre dhe myslimaneve ka marrëveshje dhe besëlidhje. Në këtë rast duhet paguar shpagimi i gjakut të të vrarit tek familja e tij sikurse duhet gjithashtu lirimi i një robi mysliman në respekt të marrëveshjes dhe besëlidhjes. Ajeti thotë: **"...Nëse i vrari është nga një popull me të cilin ju keni lidhur marrëveshje, i duhet paguar gjaku familjes së tij, duke liru edhe një besimtar të robëruar..."**

Komentuesit e Kur'anit kanë mendime të ndryshme për vrasësin në rastin e tretë se a duhet të jetë prej myslimanëve apo ky rregull përfshin dhe të tjerë prej jobesimtarëve që janë nën mbrojtjen e myslimanëve?¹

Paraqitja e këtij ajeti dhe trasmetimet të cilat kanë ardhur për komentimin e tij tregojnë se qëllimi në këtë është i vrari "mysliman".

Gjithashtu, komentuesit kanë mendime të ndryshme rreth lejimit të dhënies së pagesës (fidjetu) familjes së të vrarit kur janë jomyslimanë, ku fidjetu (pagesa) konsiderohet si pjesë e trashëgimisë dhe jobesimtari nuk e trashëgon myslimanin. Mirëpo, në dukje ajeti tregon domosdoshmërinë e pagesës së

¹ Tefsiri Mexhmaul Bejan, vëll. 3, f. 157 fundi i ajetit në fjalë.

gjakut tek familja e të vrarit dhe kjo është dëshmi se Islami i respekton marrëveshjet dhe besëlidhjet.

Disa komentues kanë mendimin se pagesa në këto raste i jepet myslimanëve nga trashgimtarët e të vrarit dhe jo jobesimtarëve duke u bazuar se jobesimtari nuk e trashëgon myslimanin dhe se pagesa e gjakut është pjesë prej trashgimisë. Për këtë kuptim tregojnë gjithashtu edhe disa transmetime.

Ndërkohë, në dukje, ajeti tregon se trashgimtarët nuk janë myslimanë ku thotë: **"...nga një popull me të cilin ju keni lidhur marrëveshje..."** sepse marrëveshjet dhe besëlidhjet në atë kohë kanë qenë mes myslimanëve dhe jomyslimanëve dhe jo në mesin e myslimanëve me njëri-tjetrin.

Ajeti cek qartësimin e rregullit për ata që kryjnë vrasje gabimisht dhe për shkak të varfërisë nuk kanë mundësi as për të paguar gjakun e vrasësit dhe as për të liruar një rob si gjobë për krimin e vrasjes gabimisht. Ajeti sqaron rregullin e tyre dhe lajmëron se ata kanë për detyrim që të agjërojnë dy muaj rresht për veprën që ata kanë kryer në këmbim të pagesës së gjakut dhe lirimit të robëruarit. Këtë e konsideron si një lloj lehtësimi të ndëshkimit për ata të cilët nuk e kanë mundësinë me pagur materialisht dhe për pendimin e tyre tek All'llahu i Lartësuar si dhe shpagim për gjynahin e bërë në këtë fushë. Sigurisht, All'llahu i Lartësuar është i Gjithëditur për të fshehtat dhe se dija e Tij përfshin gjithçka ku thotë: **"...Ai që s'mund të gjejë rob, duhet të agjërojë dy muaj rresht. (Kjo është bërë) në shenjë pendimi para All'llahut. Se All'llahu është i Gjithëdijsëm dhe i Urtë."**

Hulumtime

Në këtë ajet gjenden çështje të lloj-llojshme që është e vlefshme t'i kushtohet vëmendja. Ato janë:

1) Ajeti përmend tre llojet e kompensimit kur vrasja ndodh gabimisht dhe çdo lloj në vetvete është kompesim ndaj humbjes së shkakruar nga kjo vrasje.

Lirimi i një robi mysliman konsiderohet kompesim ndaj humbjes shoqërore si rezultat i vrasjes së një personi mysliman. Kjo sepse, pasi shoqëria humbi një person të dobishëm nga pjestarët e saj për arsye të ndodhjes së vrasjes ajo kompensohet me përfshirjen në gjirin e saj me një person tjetër të dobishëm nëpërmjet liritimit të një robi. E ndërsa kompesimi material, duke paguar gjakun, është përballë humbjes materiale që e ka goditur familjen e të vrarit. Në të vërtetë pagimi i gjakut nuk është vlere e gjakut të myslimanit të vrarë e të pafajshëm sepse gjakun e tij nuk e kompenzon asnjë vlerë. Por ajo është një lloj kompensimi nga humbja materiale që i ka goditur familjarët e të vrarit për arsye të humbjes së tij.

Kurse alternativa e tretë që ka ardhur në rastin e pamundësisë për të dhënë kompesim material, ajo përfaqësohet me agjërimin e dy muajve njëri pas tjetrit të cilën e kryen vrasësi. Ai është një kompesim moral e shpirtërore për humbjen shpirtërore që i ka ndodhur vrasësit për shkak të kryerjes së vrasjes. Si fillim shpagimi realizohet me lirimin e një robi besimtar. Nëse vrasësi nuk mundet atëherë të agjërojë dy muaj rresht pa ndërprerje. Duhet patur vëmendja këtu se lirimi i një robi konsiderohet në vetvete adhurim për shkak të ndikimeve shpirtërore që ka tek robi që lirohet nga prangat e robërisë.

2) Ardhja shprehjes: **"...përpos rastit kur familja e të vrarit ia fal gjakun..."** për familjen e të vrarit, të cilët janë prej myslimanëve, do të thotë që heqin dorë nga pagimi i gjakut të të vrarit të tyre dhe kjo shprehje nuk ka ardhur për jobesimtarët. Shkakut është i qartë se mundësia e faljes tek myslimanët është më e pranishme se sa tek të tjerët ndërkohë që kjo nuk është e pranishme tek jomyslimanët në drejtim të myslimanëve. Po ashtu myslimani nuk duhet të pranojë asnjë bamirësi e mirësi nga jomyslimani në këto raste.

3) Ajo e cila tërheq vëmendjen në rastin e tretë që përmendet në ajet është se shpagimi i gjakut paraprin shpagimin e lirimit të një robi. Ky rast ka ardhur për çështjen e vrasjes gabimisht që i ndodh një personi dhe familja e tij nuk anon nga Islami. Kurse në rastin e parë, në të cilën i vrari ishte mysliman, shpagimi i lirimit paraprin shpagimin e gjakut. Nga kjo çështje mund të konkludojmë se çështja e pagimit të gjakut në kohë të vonuar- në të shumtën e rasteve- përta i përket myslimanëve ndërmjet tyre nuk lë ndonjë ndikim negativ. Kurse kur familja e të vrarit është jomyslimane duhet nxituar në pagimin e gjakut – fillimisht- për t'u ruajtur nga përçarja që të mos e komentojë familja e të vrarit dhe populli i tij çështjen e vrasjes së ndodhur se ajo ka ndodhur për prishjen e marrëveshjes nga ana e myslimanëve.

4) Ajeti i begatë nuk e ka përcaktuar sasinë apo vlerën që duhet paguar në këto tre raste. Nga kjo konkludohet se çështja e përcaktimit të saj i është lënë në dorë Syneetit i cili e ka caktuar sasinë e plotë të vlerës me njëmijë mithkal¹ flori, apo njëqind deve, apo dyqind lopë. Vlera e këtyre llojeve mund të jetë edhe me

¹ Njësi matëse.

shkëmbim monetar nëse bien dakort të dyja palët. (Është e natyrshme se përcaktimi i floririt apo i llojeve të bagëtive si shpagim për vrasjen është ligj Islam, arsyetimet e të cilave bazohen tek çështjet e natyrshme dhe nuk janë të vendosura e të ndryshueshme.)

5) Disa mund të thonë se vrasja e ndodhur gabimisht nuk duhet të ketë gjobë ose ndëshkim sepse vrasësi nuk e ka bërë këtë vrasje me qëllim apo e ka vendosur që ta bëjë më përpara këtë gabim. Gabimi nuk ka ndëshkim apo gjobë materiale.

Përgjigjja e kësaj thënieje, ose qartësimi i saj, është se vrasja nuk është e njëjtë me krimet e tjera. Në të hyn një çështje e rëndësishme që është çështja e gjakut të derdhur dhe jeta që i rrëmbehet një pjesëtari prej pjesëtarëve të shoqërisë. Islami, për të sqaruar interesimin e madh të tij ndaj njerëzve i nxit ndjekësit e tij që të jenë të kujdesshëm dhe të mos implikohen në kryerjen e këtyre gabimeve, ai ka ashpërsuar çështjen e gjobës dhe të ndëshkimit për të ruajtur jetën e pjestarëve të shoqësisë. Po ashtu, gabimi të mos bëhet shfajësues dhe mjet për gjakderdhjen e të të pafajshmëve nga njerëzit.

Shprehja e fundit në këtë ajet: "**...në shenjë pendimi para All'Ilahut...**" mund të jetë treguese se bërja e gabimit, në të shumtën e rasteve, vjen nga neglizhenca dhe nga pakujdesia dhe nëse gabimi është i madh, si vrasja, në fillim duhet të kompesohet dhe të fitohet pajtimi dhe kënaqësia e familjes së të vrarit apo gabimtarit dhe pas kësaj të pendohet para All'Ilahut.

Ajeti 93

وَمَنْ يَقْتُلْ مُؤْمِنًا مُتَعَمِّدًا فِجَزَاؤُهُ جَهَنَّمُ خَالِدًا فِيهَا وَغَضِبَ اللَّهُ عَلَيْهِ

وَلَعَنَهُ وَأَعَدَّ لَهُ عَذَابًا عَظِيمًا ﴿٩٣﴾

"Kushdo që vret një besimtar me qëllim, ndëshkimi i tij është Xhehennemi, në të cilin do të qëndrojë përgjithmonë. All'llahu është zemëruar me atë, e ka mallkuar dhe i ka përgatitur një dënim të madh."

Shkaku i zbritjes

Thonë se "El Mukijs ibn Sebabe El Kenani" e kishte gjetur vrasësin e vëllait të tij "Hisham" në lagjen e fisit "Nexhar". Për këtë ai lajmëroi Profetin. Profeti e dërgoi atë së bashku me Kajs ibn Hilal El Mehrij te paria e fisit Nexhar dhe i urdhëroi ata që vrasësin e Hishamit t'ia dorëzojnë vëllait të tij "El Mukijs". Nëse ata nuk kanë dije për atë ose për vendodhjen e tij, t'i paguajnë Mukijsit gjakun e vëllait të tij. Fisi Nexhar e paguan gjakun se nuk e dinin vendodhjen e vrasësit. Mukijski e mori pagesën e gjakut dhe u drejtua për në Medine së bashku me Kajs ibn Hilal El Mehrij. Mirëpo në rrugë e pushtoi mania e injorancës dhe mendoi se ka bërë një turp të madh që ka pranur paratë në këmbim të gjakut të vëllait të tij. Ai e vrau shokun që udhëtonte me të, Kajs

ibn Hilal i cili ishte nga fisi Nexhar si hakmarrje ndaj vëllait të tij sipas mendimit të tij. Pas këtij veprimi arratiset për në Mekë duke hequr dorë nga Islami. Profeti e lejoi gjakderdhjen e këtij vrasësi për shkak të tradhëtisë së tij. Për këtë ngjarje zbriti ky ajet, i cili qartëson dhe shpjegon rregullin e ndëshkimit të vrasësit me qëllim.¹

Komentimi

Nëshkimi i vrasjes me qëllim

Ajeti i mëparshëm shpjegoi dhe qartësoi ndëshkimin apo shpagimin e vrasjes që kryhet gabimisht. Ajeti në fjalë shpjegon dhe qartëson ndëshkimin e vrasjes që kryhet me qëllim dhe me paramendim në rast kur i vrari është prej besimtarëve. S'ka dyshim se vrasja e njeriut është nga krimet më të mëdhaja e më të rënda dhe nga mëkatet më të rrezikshme dhe se neglizhenca në luftën kundër këtyre krimeve kërcënon sigurinë e shoqërisë dhe shkakton vuajtje te pjestarët e saj. Siguria është një nga nevojat e shoqërisë së shëndoshë. Për këtë Kur'ani famëlartë, në ajetet e ndryshme, i kushton rëndësi të madhe kësaj çështjeje. Ai thotë se nëse një person vret një person tjetër është njësoj si të ketë vrarë të gjithë njerëzit me përjashtim nëse vrasja është ndëshkim për atë vrasës përshkak të vrasjes apo shkatërrimit që bën në tokë. Kur'ani thotë: **"Kush vret ndokënd, që ska vrarë njeri ose që nuk**

¹ Tefsiri Mexhmaul Bejan, vëll. 3, f. 159.

ka bërë çrregullime në tokë, është sikur të ketë vrarë të gjithë njerëzit."¹

Ky ajet, që po komentojmë, ka vendosur katër ndëshkime në Botën Tjetër për atë që vret me qëllim dhe një ndëshkim në këtë botë është ekzekutimi.

Ndëshkimet në Botën Tjetër janë:

1) Qëndrimi i përjetshëm në zjarrin e Xhehennemit ku ajeti thotë: "Kushdo që vret një besimtar me qëllim, ndëshkimi i tij është Xhehennemi, në të cilin do të qëndrojë përgjithmonë..."

2) Zemërimi i All'llahut të Lartësuar ndaj vrasësit: "...All'llahu është zemëruar me atë..."

3) Mallkimi i All'llahut për vrasësin: "...e ka mallkuar..."

4) Ndëshkimi i madh që e prët në Ditën e Kijametit: "...dhe i ka përgatitur një dënim të madh."

Këtu vërejmë se ndëshkimi në Botën Tjetër, të cilin e ka veçuar All'llahu për vrasësin që vret me qëllim, është nga llojet më të rrepta e më të ashpra dhe Kur'ani nuk përmend ndëshkim më të rreptë se ky për çështje të tjera apo gjynahe të tjera.

Ndërsa ndëshkimi në këtë jetë, detajet e të cilit përmenden në ajetin 179 të sures "El Bekare", është ekzekutimi. E kemi cekur komentimin e këtij ajeti në xhuzin e parë.

¹ Sure "Maide", ajeti 32.

Dy hulumtime

Krimi i vrasjes me qëllim dhe ndëshkimi i përhershëm

Këtu shtrohet pyetja se dënimi i përhershëm është për atë që vdes jobesimtar ndërkohë që vrasësi me qëllim mund të jetë besimtar i cili ka mundësi që të pendohet për atë që ka bërë në këtë botë dhe përpiket që ta shlyejë atë vepër që ai ka kryer. Atëherë si është e mundur që ky njeri e meriton të qëndrojë në vuajtje dhe dënim të përhershëm?

Përgjigje: Me të vërtetë përgjigjja e kësaj pyetje përfshin tre raste:

1- Ka mundësi që qëllimi me vrasjen e besimtarit që përmendet në ajetin në fjalë është për vrasjen për shkak të besimit të personit që do të thotë se ai beson në lejimin e gjakderdhjes së besimtarit. Është e qartë se ai i cili qëllisht e kryen këtë vrasje në të vërtetë ai është jobesimtarë dhe nuk ka asnjë fije besimi. Po të kishte besim, atëherë si do të ishte e mundur që besimtari të lejojë gjakderdhjen e vëllait të tij besimtar?! Bazuar në këtë, vrasësi e meriton të qëndrojë në zjarr përgjithmonë dhe e meriton ndëshkimin e përhershëm. Është transmetur nga imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) hadith rreth kësaj çështjeje.¹

¹ Në librin El Kafij dhe në tefsirin El Ajjashij në komentimin e këtij ajeti është përmendur thënia e imam Sadikut (Paqja qoftë mbi të!) i cili ka thënë: "Ai që vret një besimtar në fenë e tij ai është i qëllimshmi për të cilin All'lahu ka thënë në Librin e Tij: **"...dhe i ka përgatitur një dënim të madh."** Usulul Kafij, vëll. 7, f. 275. Tefsir El Ajjashij, vëll. 1, f. 267.

2- Sikurse ka mundësi që të vdesë bërësi jobesimtar i këtij krimi me qëllim për shkak se vrau një njeri besimtarë e të pafajshëm dhe nuk i jepet mundësia për t'u penduar për krimin që ka kryer. Kështu që në Botën Tjetër shijon ndëshkimin e përhershëm.

3- Mundet, gjithashtu, që kuptimi i fjalës "khulud", përgjithmon, që përmendet në ajet të jetë për dënimin afatgjatë dhe jo të përhershëm.

Këtu mund të bëhet një pyetje tjetër: A mund të pranohet pendimi i vrasësit me qëllim?! Kësaj pyetjeje një grup komentuesish i janë përgjigjur me mohim të prerë dhe kanë thënë se me të vërtetë krimi i përmendur në këtë ajet absolutisht nuk falet me pendimin. Po të njëjtën gjë thonë edhe trasmetimet e ardhura për këtë çështje. Ato thonë se nuk ka pendim për atë që e vret besimtarin me qëllim.

Por ajo që konkludojmë nga shpirti i mësimave islame, nga trasmetimet e imamëve (Paqja qoftë mbi ta!), nga dijetarët e mëdhenj të kësaj feje dhe nga filozofia e pendimit, e cila është ngritur mbi baza edukative dhe ruajtëse nga gjynahet në të ardhmen e personit mysliman, është se nuk ka mëkat dhe gabim që nuk falet me pendimin. Mirëpo, pendimi nga disa gjynahe është i kushtëzuar me kushte të rrepta që është e vështirë por nga njëherë e pamundur që personi t'i realizojë ato kushte dhe kriteret. Argument për këtë është fjala e All'Ilahut të Lartësuar: **"Vërtetë, All'Ilahu nuk falë që të adhurohet dikush apo diçka tjetër veç Atij, por gjynahet e tjera me të vogla ia falë kujt të doje."**¹

¹ Sure "El Nisa", ajeti 48.

Kur kemi shpjeguar komentimin e këtij ajeti kemi thënë se ai ka ardhur për çështjen e faljes së gjynaheve me anë të ndërmjetësimit. Mirëpo dihet edhe vetë idhujtaria falet nëse njeriu largohet prej saj dhe kthehet në besimin në Zotin Një, të Vetëm e të pashoq sikurse iu ndodhi me injorantët para se ta pranonin Islamin të cilët u penduan tek All'llahu i Lartësuar dhe Ai ua pranoi pendimin dhe ia fali gjynahet e mëparshme. Nga ky shpjegim i shkurtër kuptohet se çdo gjynah – qoftë edhe idhujtaria – e pranon pendimin. Këtë e përforcojnë edhe ajetet 53 e 54 të sures "El Zumer" në të cilët All'llahu thotë: **"All'llahu me siguri i fal të gjitha gjynahet. Vërtetë Ai është Falës i madh dhe Mëshirëplotë. Kthehuni tek Zoti juaj dhe nënshtrojeni Atij."**

Disa komentues thonë se ajetet që flasin për faljen e të gjitha gjynaheve janë ajete të përgjithshme të cilat pranojnë veçim – por nuk mund të gjykohej për saktësinë e këtij rregulli sepse ai është në kundërshtim me logjikën e këtij ajeti i cili e ka konsideruar pendimin një prej mirësive të All'llahut për gjynahqarët dhe këtë e vërteton me argumente. Prandaj, ky ajet nuk mund të kufizohet e as të përveçësohet, siç thuhet në terminologji: nuk e pranon kufizimin e as përveçësimin.

Në shtesë të gjitha këtyre që u përmendën, mundet që vrasësi me qëllim të strehohet tek pendimi, i bindet All'llahut me sinqeritet në pjesën e jetës së tij që i ka mbetur, i largohet gjynahëve, nuk e kundërshton All'llahun dhe nuk mendon që të bëjë krim të ngjashëm me këtë. A është e drejtë që të dëshpërohet (moliset) pedimtari - në këtë rast nga mëshira e All'llahut dhe falja e Tij? A lejohet që të thuhet se ky person me pendimin e tij do të qëndrojë në ndëshkimin e përhershëm të All'llahut? Me të vërtetë

thënia për mospranimin e pendimit të këtij njeriu bie në kundërshtim me shpirtin e mësimave fetare të cilat i sollën Profetët për edukimin dhe udhëzimin në rrugë të drejtë të mbarë njerëzimit gjatë gjithë historisë.

Ajo që vërejmë në historinë tonë islame është se Profeti (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) e fali kriminelin më të rrezikshëm "*Uahshij*" i cili vrau Hamza ibn Abdul Mutalib, xhaxhain e Profetit. Po kështu nuk mund të thuhet se kryerja e vrasjes në gjendjen e idhujtarisë ndryshon me vrasjen që kryhet në gjendjen e besimit ku të thuhet se është e mundur falja e krimit në rastin e parë dhe pamundësia e faljes së krimit në rastin e dytë. Sikurse thamë më sipër, nuk ka gjynah më të madh se sa të vënit shok All'llahut të Lartësuar. Gjithashtu, mësuam se ky mëkat mund të falet me pendim dhe All'llahu e fal shirkun nëse personi pendohet për idhujtarinë e tij dhe përqafon Islamin.

Nëse dëshirohet arritja e tij, kjo ka nevojë për shumë mund dhe sakrificë të madhe për ta kompesuar atë çfarë ka lënë krimi nga gjurmët e rrezikshme dhe të këqija në shoqëri dhe se kompesimi në këtë çështje nuk është i lehtë. Por me këtë thënie duam të qartësojmë se porta e pendimit nuk është e mbyllur për atë që dëshiron të pendohet, të besojë dhe të bëjë vepra të mira dhe pastaj udhëzohet në rrugë të drejtë edhe nëse ka kryer një krim, siç është vrasja me qëllim.

Cilat janë llojet e vrasjes?

Juristët islamë e kanë ndarë vrasjen në tre lloje, sikurse përmendet në librat e ndëshkimeve dhe shpagimeve. Për këtë

ndarje ata janë mbështetur në ajetet e Kur'anit dhe në hadithet që kanë ardhur për këtë temë. Ato lloje janë:

1- Vrasje me qëllim.

2 - Vrasje që ngjan si me qëllim.

3 - Vrasje padashje.

Vrasja me qëllim është ajo e cila arrihet duke përdorur mjetet e vrasjes dhe me praninë e vendosmërinë për kryerjen e këtij krimi. Siç është për shembull që një person vret një person tjetër duke përdorur mjetet e vrasjes si thika, arma, guri, druri ose mjete të tjera që shkaktojnë vrasje.

Ndërsa vrasja e ngjashme me qëllim është ajo vrasje që paraprihet me vendosmëri nga vrasësi për t'i bërë keq të vrarit, por pa patur qëllim vrasjen e tij porse keqbërja çon në vrasje. Siç është për shembull kur një person godet një tjetër jo me qëllim vrasjen e tij mirëpo gjuatja çon në vrasjen e të goditurit.

Vrasja gabim është një vrasje që kryhet me paqëllim dhe me pavendosmëri nga ana e vrasësit. Kjo shkaktohet për shembull në gjueti kur një person në vend që t'i gjuajë kafshës godet një person tjetër gabimisht. Janë trasmetuar shumë rregulla të ndryshëm për këto tre lloj vrasjesh në librat e jurisprudencës islame.

Ajeti 94

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا إِذَا ضَرَبْتُمْ فِي سَبِيلِ اللَّهِ فَتَبَيَّنُوا وَلَا تَقُولُوا لِمَنْ
 أَلْقَى إِلَيْكُمُ السَّلَامَ لَسْتَ مُؤْمِنًا تَبْتَغُونَ عَرَضَ الْحَيَاةِ الدُّنْيَا
 فَعِنْدَ اللَّهِ مَغَانِمُ كَثِيرَةٌ ۖ كَذَلِكَ كُنْتُمْ مِنْ قَبْلُ فَمَنْ أَكُنَّ
 عَلَيْكُمْ فَتَبَيَّنُوا ۚ إِنَّ اللَّهَ كَانَ بِمَا تَعْمَلُونَ خَبِيرًا ﴿٩٤﴾

"O ju që keni besuar! Kur të shkoni në luftë, në rrugë të All'Ilahut, shqyrtoni gjithçka me kujdes! Mos i thoni atij që ju përshëndet me selam: 'Nuk je besimtar', me qëllim që të fitoni kënaqësi të kësaj jete, ndërkohë që tek All'Ilahu ka fitime të shumta. Të tillë keni qenë edhe ju më parë e All'Ilahu ju dha mirësi; prandaj gjithmonë sqarojini mirë të gjitha punët! Se All'Ilahu është Njohës i veprave tuaja."

Shkaku i zbritjes

Komentet dhe transmetimet islame kanë përmendur shkaqe të shumta për zbritjen e këtij ajeti dhe të gjitha janë të ngjashme me njëra-tjetrën. Prej atyre është se i Dërguari i All'llahut kur u kthye nga lufta e Hajberit dërgoi Usame ibn Zejd së bashku me një grup myslimanësh tek jehudinjtë që banonin në fshatin Fedek, për arsye që t'i ftojnë ata në Islam ose të respektojnë rregullat e "Edh Dhimetu"¹. Mirdas el Jehudij, ishte njëri prej atyre që e mori vesh se po vinte ushtria islame, mori familjen dhe pasurinë e tij dhe u drejtua për në mal. Ai përshpejtoi për të pritur myslimanët duke dëshmuar Njësimin e All'llahut dhe mesazhin e të dërguarit të Tij. Usama ibn Zejd mendoi se ky Jehudi e shfaqti Islamin nga frika për të mbrojtur veten dhe pasurinë e tij dhe se në brendinë e tij nuk gjendej Islam. Usama e vrau me qëllim Jehudiun dhe vuri dorën mbi pasuritë e tij. Kur ky lajm i kësaj ngjarjeje i arrin Profetit (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ai ndjeu një keqardhje të madhe për këtë dhe tha: "Çfarë kuptimi ka që Usama nuk e dinte se çfarë kishte në brendinë e këtij njeriu dhe ndoshta ai ka pranuar në të vërtetë Islamin."

Atëherë zbriti ky ajet i cili i paralajmëron myslimanët që plaçkat e luftës ose të ngjashme me to të jenë shkak që njeriu që shfaq Islamin ta refuzojnë atë duke përforcuar domosdoshmërinë e pranimi të Islamit të një personi të tillë.²

¹ "Edh Dhimetu" nënkupton jomyslimanët që jetojnë në shtetin Islam në përshtatje me rregullat e caktuara nga ky shtet. Për më tepër mund t'i referoheni librave të jurisprudencës islame.

² Tefsiri Mexhmaul Bejan, vëll. 3, f.163.

Komentimi

Pas përmendjes së dëshmimeve të domosdoshme në ajetet e mëparshme, të cilat specifikojnë ruajtjen e jetës së njerëzve të pafajshëm, ky ajet urdhëron në maturi dhe bën thirrje për mbrojtjen dhe ruajtjen e njerëzve të pafajshëm të cilët mund të akuzohen nga të tjerët. Ajeti thotë: **"O ju që keni besuar! Kur të shkoni në luftë, në rrugë të All'llahut, shqyrtoni gjithçka me kujdes! Mos i thoni atij që ju përshëndet me selam: 'Nuk je besimtar'..."**

Ky ajet i urdhëron myslimanët që t'i presin me shumë zemërgjerësi ata që paraqesin Islamin dhe t'i largohen çdo mendimi të keq ose hamendesimi rreth besimit dhe islamit të tyre. Pas kësaj, ky ajet qorton dhe ndalon që mirësitë e kësaj bote kalimtare të jenë shkak për të akuzuar personat të cilët shfaqin Islamin. Gjithashtu, ndalon vrasjen dhe uzurpimin e pasurive të tyre me akuzën se janë armiq të Islamit: **"...me qëllim që të fitoni kënaqësi të kësaj jete..."** Ajeti përforcon se mirësitë e përjetëshme dhe më me vlere janë tek All'llahu i Lartësuar ku thotë: **"...ndërkohë që tek All'llahu ka fitime të shumta..."**

Përsëri ajeti tregon për luftrat e kohës para Islamit, të cilat ndizeshin për shkaqe materiale dhe për përvetsime pasurish. All'llahu i Lartësuar thotë: **"...Të tillë keni qenë edhe ju më parë..."** All'llahu u drejtohet myslimanëve se nën hijen e Islamit dhe mirësive të All'llahut, shpëtuan nga kjo gjendje e keqe **"...e All'llahu ju dha mirësi; prandaj gjithmonë sqarojini mirë të gjitha punët! Se All'llahu është Njohës i veprave tuaja."**

Hulimtime

Xhiahadi Islam nuk është dimension i material

Ajeti i mëparshëm sqaron qartë këtë të vërtetë se myslimani nuk duhet që të shkojë në luftë për qëllime materiale. Për këtë duhet që të pranojë prej armikut që në momentet e para që ai të shfaqë besimin e tij dhe t'i përgjigjet thirrjes për marrëveshje dhe paqe edhe sikur myslimani t'ia ndalojë vetes plaçkat e luftës. Shkaku në këtë është se qëllimi i xhihadi Islam nuk është zgjerimi dhe mbizotërimi i plaçkave të luftës, por qëllimi i xhihadi në Islam është për të liruar e çliruar njerëzit nga pasojat e idhujtarëve dhe të adhurimit të tjetër kujt përveç All'Ilahut të Lartësuar, qoftë ky tjetri tiran, apo zullumqar (i padrejtë) ose është adhurues i pasurisë apo i famës. Është detyrim i çdo myslimani të realizojë këtë sado që të jetë shkëndia e shpresës.

Ky ajet u kujton myslimanëve kohën e tyre të injorancës në të cilën mbartnin mendime të ulta materialiste para se ta pranonin Islamin. Për arsye materiale ata shkaktinin gjakderdhje. Por, prej mirësisë së Islamit dhe besimit të tyre ata shpëtuan nga ato luftra dhe ndryshoi edhe jeta e tyre.

Gjithashtu, ky ajet tregon një të vërtetë tjetër që është se myslimanët në kohën që kanë shfaqur Islamin askush nuk e dinte të vërtetën e kësaj shfaqjeje apo të vërtetën e qëllimit të shfaqjes së Islamit. Ajeti u përforcon atyre domosdoshmërinë që të zbatojnë atë çfarë kanë bërë ata në pranimin e Islamit të tyre për ata kundërshtarë të cilët e shfaqin Islamin përpara tyre.

Pyetje: Pyetja e cila mund të shkojë ndërmend është: Sikur Islami, përpara thirrjes së çdo personi që do të shprehë Islamin në momentet e para, nuk e vërteton vërtetësinë e kësaj thirrjeje, kjo do të bëhej shkak për praninë e hipokrizisë dhe dukjes së hipokritëve në gjirin e Islamit. Me këtë formë shumë armiq mund ta shfrytëzojnë këtë dukuri për të keq duke u maskuar me petkun Islam për të kryer vepra armiqësore kundër Islamit.

Përgjigja: Mund të themi se nuk ka ligj në këtë botë që nuk mund të keqshfrytëzohet. Por, e rëndësishme është që ligji të përmbajë në përgjithësi dobi për të gjithë. Nëse e refuzojmë që në momentin e parë Islamin e atyre që shfaqin atë vetëm nga mosnjohja jonë për qëllimet e tyre, ky refuzim do të çonte në shumë raste në shkatërrim. Jo vetëm kaq, ai do të ishte një dëm i madh për Islamin sepse kjo ka kuptimin e zhdukjes së parimeve njerëzore. Më pas ky refuzim mund të jetë mjet në dorën e njerëzve të cilët mbartin armiqësi me njëri-tjetrin për akuza se shfaqja e Islamit të tij nuk ka qenë e vërtetë dhe e sinqertë. Në këtë formë është bërë e mundur që të derdhet gjaku i shumë të pafajshmëve.

Ajetet 95 - 96

لَا يَسْتَوِي الْقَاعِدُونَ مِنَ الْمُؤْمِنِينَ غَيْرُ أُولِي الضَّرَرِ وَالْمُجَاهِدُونَ فِي
 سَبِيلِ اللَّهِ بِأَمْوَالِهِمْ وَأَنْفُسِهِمْ فَضَّلَ اللَّهُ الْمُجَاهِدِينَ بِأَمْوَالِهِمْ وَأَنْفُسِهِمْ
 عَلَى الْقَاعِدِينَ دَرَجَةً وَكُلًّا وَعَدَ اللَّهُ الْحُسْنَىٰ وَفَضَّلَ اللَّهُ الْمُجَاهِدِينَ
 عَلَى الْقَاعِدِينَ أَجْرًا عَظِيمًا ﴿٩٥﴾ دَرَجَتٍ مِّنْهُ وَمَغْفِرَةً وَرَحْمَةً ۚ وَكَانَ اللَّهُ
 غَفُورًا رَّحِيمًا ﴿٩٦﴾

"Nuk janë të njëjtë ata besimtarë që rrinë në shtëpitë e tyre, përveç të paaftëve, me ata që luftojnë në rrugën e All'Ilahut me pasurinë dhe jetën e tyre. All'Ilahu i ngre një shkallë më lart ata që kanë luftuar me pasurinë dhe jetën e tyre kundrejt atyre që kanë ndenjur në shtëpitë e veta. Ai u ka premtuar të gjithëve mirësi, por i ka dalluar ata që luftojnë mbi ata që nuk luftojnë me shpërblim të madh."

"Me shkallë të veçanta, me falje dhe mëshirë. All'Ilahu është Falës dhe Mëshirëplotë."

Komentimi

Ajetet e mëparshme folën për xhihadin. Këto dy ajete qartësojnë dallimin mes muxhahidinëve dhe njerëzve të tjerë që rrinë në shtëpi dhe dëshmojnë se nuk janë të barabartë me ata që e sakrifikojnë veten e tyre dhe pasurinë e tyre në rrugën e qëllimit të lartë hyjnor me ata që rrinë në shtëpi pa patur ndonjë shkak, me përjashtim të sëmundjes. All'illahu i Lartësuar thotë: **"Nuk janë të njëjtë ata besimtarë që rrinë në shtëpitë e tyre, përveç të paafteve, me ata që luftojnë në rrugën e All'illahut me pasurinë dhe jetën e tyre.**

Është e qartë nga ky ajet se qëllimi është për ata që rrinë në shtëpi, që janë besimtarët të cilët nuk marrin pjesë në luftë në rrugën e All'illahut për arsye të pavendosmërisë së tyre të plotë për këtë. Gjithashtu, ajeti shpjegon se xhihadi nuk është detyrim i domosdoshëm për të gjithë. Sikur të ishte detyrim i domosdoshëm për të gjithë nuk do të kishte folur Kur'ani me këtë gjuhë të rreptë për ata të cilët nuk marrin pjesë në luftë dhe nuk do t'u premtonte atyre shpërblim.

Duke u bazuar në këtë, mirësia e atyre që luftojnë ndaj atyre që qëndrojnë në shtëpi nuk mund të mohohet, edhe nëse xhihadi nuk është detyrim i detyrueshëm për të gjithë. Ky ajet nuk përfshin asnjë rast prej rasteve të atyre që nuk morën pjesë në luftë për hipokrizi dhe armiqësi. Duhet patur vëmendja në shprehjen ku All'illahu i Lartësuar thotë: **"...përveç të paafteve..."** e cila ka një kuptim të gjërë dhe përfshin të gjithë ata të cilët vuajnë nga mungesa e gjymtyrëve, nga sëmundja apo nga dobësia e madhe e cila i ndalon ata që të marrin pjesë në luftë. Ata janë të përjashtuar nga ky rregull.

Ajeti e përsërit çështjen e dallimit të dy grupeve të lartpërmendur në një formë të qartë dhe dëshmon në fund të këtij krahasimi se All'llahu u jep luftëtarëve një shpërblim të madh. Ai thotë: **"...All'llahu i ngre një shkallë më lart ata që kanë luftuar me pasurinë dhe jetën e tyre kundrejt atyre që kanë ndenjur në shtëpitë e veta..."**

Por, sikurse thamë, meqenëse përballë luftëtarëve qëndrojnë ata të cilët nuk e kanë detyrim xhihadin, apo nuk marrin pjesë në luftë për shkak të sëmundjes apo paaftësisë së tyre, apo për shkak të ndonjë dobësie tjetër, dhe me qëllim që të mos harrohet qëllimi i pastër, besimin dhe veprat e mira të tyre, All'llahu u ka premtuar mirësi në këtë ajet i cili thotë **"...Ai u ka premtuar të gjithëve mirësi..."** Me të vërtetë, është e pakundërshtueshme se ka një ndryshim të madh ndërmjet mirësisë, e cila u është premtuar luftëtarëve dhe ndërmjet asaj që u jepet atyre që janë të paaftë për të marrë pjesë në luftë.

Këtu ajeti kur'anor sqaron se çdo vepër e mirë është e shpërblyer ajo as nuk harrohet e as nuk neglizhohet. Në veçanti ai flet për ata të paaftët të cilët kishin dëshirë për të marrë pjesë në luftë, dhe e shikonin luftën si një gjë të shenjtë e të Lartësuar. Mirëpo, përderisa xhihadi nuk është detyrim individual, nuk u realizua ai qëllim i shenjtë. Vërtet, ata të cilët janë të paaftë në pjesëmarrje në luftë do të marrin si shpërblim aq sa dëshira e tyre për të marrë pjesë. Përsa u përket atyre që janë të paaftë për të marrë pjesë në luftë për arsye të pamundësisë apo sëmundjes, mirëpo ata kanë dëshirë të zjarhtë për të marrë pjesë në luftë, jo vetëm kaq, porse ata kanë mall për luftën, për këtë edhe ata kanë një pjesë prej shpërblimit të pamohueshëm si të luftëtarëve sikurse

ka ardhur në hadith nga i Dërguari i All'Ilahut të Lartësuar që i drejtohet ushtrisë islame duke thënë *"Ju keni lënë në Medine njerëz të cilët në udhëtim e në luginë dëshirojnë të jenë me ju, por ata i ka ndaluar ndonjë e keqe (arsye) ose ndonjë gjë tjetër. Ata i kanë qëllimet e pastërta dhe zemrat e tyre duan të marrin pjesë në luftë."*¹

Meqenëse rëndësia e xihadit në Islam është e madhe, për këtë ajeti flet përsëri për muxhahidinët dhe përforcon se ata kanë shpërblim të madh kundrejt atyre që janë të paaftë për të marrë pjesë në luftë. Ajeti thotë: **"...por i ka dalluar ata që luftojnë mbi ata që nuk luftojnë me shpërblim të madh."**

Ajeti pasardhës, pra ajeti 96 i sures "Nisa", sqaron këtë lloj shpërblimi të madh dhe thotë: **"Me shkallë të veçanta, me falje dhe mëshirë..."** Nëse personat në mesin e luftëtarëve janë implikuar në ndonjë gabim gjatë kryerjes së detyrës së tyre, All'Ilahu u ka premtuar atyre falje, siç thotë fundi i ajetit: **"...All'Ilahu është Falës dhe Mëshirëplotë."**

Dy hulumtime

1- Pika të rëndësishme rreth muxhahidinëve

1- Ajeti 95 i kësaj sureje e ka përsëritur tre herë shprehjen muxhahidinë:

Herën e parë luftëtarët përmenden me qëllimin dhe me metodën e veçantë për luftë: ku All'Ilahu i Lartësuar thotë **ata që luftojnë në rrugën e All'Ilahut me pasurinë dhe jetën e tyre..."**

¹ Tefsiru Safij, vëll. 1. f. 487.

Herën e dytë emri i luftëtarëve përmendet i shoqëruar me mjetin e xhihadit dhe nuk përmend asgjë nga qëllimi. All'illahu i Lartësuar thotë: **"...që kanë luftuar me pasurinë dhe jetën e tyre..."**

Ndërsa në herën e tretë e të fundit ajeti përmend vetëm emrin e luftëtarëve. Kjo tregon qartë formën e lartë retorike në fjalën e Kur'anit ku dëgjuesi nëpërmjet kësaj forme njihet pak e nga pak me tematikën që përcjell Kur'ani për luftëtarët. Shkalla e njohjes arrin deri në fazën ku me anë të saj dëgjuesi kupton gjithçka nëpërmjet një shenje të vetme.

2- Në fillim ky ajet tregon epërsinë e luftëtarëve ndaj atyre që rrinë në shtëpi me shprehjen në numrin njëjës që është fjala "derexhetun", një shkallë ose gradë. Kurse në ajetin pasardhës kjo fjalë (derexhetun) ka ardhur në numrin shumës "derexhatun" shkallët. Është e qartë se nuk ka kundërshtim mes këtyre dy fjalëve sepse qëllimi në shprehjen e parë është qartësimi i epërsisë së luftëtarëve në rrugë të All'illahut të Lartësuar ndaj të tjerëve. Mirëpo fjala e dytë e shpjegon këtë epërsi ku e shoqëron me fjalët "el magfiretu", falje dhe "er rahmetu", mëshirë. Thënë ndryshe: dallimi mes këtyre dy fjalëve "derexhe" dhe "derexhat" është ndryshimi midis të përgjithshmes dhe të detajuarës.

Sikurse mund të përfitohet nga shprehja "derexhat" se ajo do të thotë: që luftëtarët në rrugën e All'illahut nuk janë të gjithë në një gradë të barabartë por grada në mesin e tyre ndryshon me gradën e sinqeritetit dhe të përballimit të vështirësive. Kështu që ndryshon edhe pozita e tyre shpirtërore, sepse ata të cilët luftojnë armiq të në një rresht nuk janë të barabartë në një luftë të vetme dhe ndryshojnë gradat e sinqeritetit të secilit prej tyre. Për këtë

gjithsecili prej tyre ka një shpërblim të veçantë që i përshtatet veprës së xhihadit dhe qëllimit që ka pasur në këtë vepër.

2- Rëndësia e lartë që ka xhihadi

Me të vërtetë xhihadi është ligji i përgjithshëm në këtë botë. Çdo krijesë, qoftë nga bota bimore apo ajo shtazore, përpiqet për të larguar të keqen nëpërmjet xhihadit me qëllim që gjithë secili të ketë mundësinë për të arritur përsosmërinë e kërkuar në këtë ekzistencë.

Për shembull, rrënjët e bimëve të cilat zhvillohen për të arritur ushqim dhe fuqinë në formë të vazhdueshme, sikur ta lënë aktivitetin e tyre dhe të ndalojnë nga kërkimi i ushqimit, do të ishte e pa mundur jetëgjatësia e bimës. Këto rrënjë, kur u del përpara një pengesë në thellësi të tokës, e kalojnë atë me shpim. Është e habitshme se edhe rrënjët e vogla punojnë sikur të ishin gozhdë çeliku duke shpuar e hapur pengesat që u dalin përpara në kërkimin e ushqimit. Nëse është e pafuqishme në këtë fushë, ajo e devijon rrugën e saj duke e kaluar pengesën nëpërmjet të ngjiturit rreth pengesës. Gjithashtu, edhe në brendinë e njeriut, deri edhe në momentet e gjumit, gjendet një konflikt i habitshëm dhe i vazhdueshëm përderisa njeriu është gjallë. Dhe ai është konflikti ndëpërmjet rruazave të bardha të gjakut dhe trupave mësymës. Sikur ky konflikt të pushonte për një orë të vetme dhe rruazat e bardha të hiqnin dorë nga mbrojtja, të gjitha pjesët e trupit të njeriut do të sundoheshin nga bakteret dhe mikrobet e lloj-llojshme dhe jeta e tij do të përballej me rrezikun.

Me të vërtetë ajo përpjekje që ndodhet në mesin e shoqërive dhe kombeve në këtë ekzistencë për të qëndruar, është po e njëjta përpjekje që shpjeguar në botën bimore dhe në trupin e njeriut.

Bazuar në këtë, cilido që vazhdon "xhihadin" dhe "mbikëqyrjen" ai është gjithmonë fitues, ndërsa ata të cilët i largojë epshet, egoizmi dhe dëshirat nga xhihadi, nuk do të arrijnë gjë tjetër veçse shkatërrim, të shpejtë apo të vonuar, në vend të tyre do të vijnë njerëz aktivë, këmbëngulës dhe sakrifikues.

Kjo është ajo çfarë garanton i Dërguari i All'llahut, Muhammedi (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi famljen e tij!), i cili ka thënë: *"Kush e lën xhihadin (përpjekjen në rrugën e All'llahut), All'llahu e vesh atë me poshtërim dhe varfëri në jetën e tij dhe ia shkatërron fenë. Me të vërtetë, All'llahu e ka nderuar umetin tim me kreshtë të tij dhe përqëndrimin e luftëtarëve të saj."*¹

Në një transmetim tjetër Profeti (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi famljen e tij!) thotë: *"Luftoni që t'i trashëgoni fëmijëve tuaj krenarinë."*²

Ndërsa prijësi i besimtarëve, Ali ibn Ebi Talibi (Paqja qoftë mbi të!) në fillim të hytbes së tij rreth xhihadi thotë: *"Me të vërtetë xhihadi është portë prej portave të Xhenetit që e ka hapur All'llahu për të dashurit e Tij të posaçëm. Ai është petku i devotshmërisë, mburoja e fortë e All'llahut, Xheneti i Tij i garantuar. Kush e lë atë nga*

¹ Usulul Kafijj, vëll. 5, f. 2. Uesailu Shia, vëll. 15, f. 10.

² Usulul Kafijj, vëll. 5, f. 2.

*mosdëshira e tij, All'llahu i vesh atij pëlhurën e poshtërimin dhe atë e përfshin sprova ..."*¹

Duhet patur vëmendja se kuptimi i xhihadi nuk kufizohet vetëm për ata që bëjnë luftë me armë, porse ai është, gjithashtu, çdo përpjekje dhe sakrificë që bën njeriu drejt qëllimeve të shenjta hyjnore. Nga kjo pikënisje, në shtesë të luftërave mbrojtëse ose sulmuese, edhe rezistenca shkencore, ekonomike, kulturore dhe politike, konsiderohet lloj prej xhihadi.

¹ Nehxhul Belaga, fjalimi 27.

Ajetet 97 - 99

إِنَّ الَّذِينَ تَوَفَّيْنَاهُمْ الْمَلَائِكَةُ ظَالِمِي أَنْفُسِهِمْ قَالُوا فِيمَ كُنْتُمْ ^ط قَالُوا كُنَّا
 مُسْتَضْعَفِينَ فِي الْأَرْضِ ^ج قَالُوا أَلَمْ تَكُنْ أَرْضُ اللَّهِ وَاسِعَةً فَتُهَاجِرُوا فِيهَا ^ج
 فَأُولَئِكَ مَأْوَاهُمْ جَهَنَّمُ ^ط وَسَاءَتْ مَصِيرًا ﴿٩٧﴾ إِلَّا الْمُسْتَضْعَفِينَ مِنْ
 الرِّجَالِ وَالنِّسَاءِ وَالْوِلْدَانِ لَا يَسْتَطِيعُونَ حِيلَةً وَلَا يَهْتَدُونَ سَبِيلًا ﴿٩٨﴾
 فَأُولَئِكَ عَسَى اللَّهُ أَنْ يَعْفُو عَنْهُمْ ^ج وَكَانَ اللَّهُ غَفُورًا ﴿٩٩﴾

"Kur engjëjt ua marrin shpirtrat atyre që e kanë ngarkuar veten me fajë, u thonë: 'Ku ishit?' Ata përgjigjen: 'Ishim të pafuqishëm në Tokë.' (Engjëjt) do t'u thonë: 'A nuk qe Toka e All'Ilahut e gjerë që të mërgonit në të?' Këta janë ata (njerëz), vendbanimi i të cilëve është Xhehennemi; eh, sa i keq është ai vendbanim!"

"Me përjashtim të meshkujve të pafuqishëm, grave dhe fëmijëve, të cilët nuk kanë as fuqinë e as mundësinë të drejtohen në rrugë."

" Mbase All'Ilahu i fal, se All'Ilahu, me të vërtetë, është Shlyes dhe Falës i gjynaheve."

Shkaku i zbritjes

Paria e kurejshve, para se të fillonte lufta e Bedrit, u tërhoqi vëmendjen të gjithë banorëve të Mekës të cilët ishin në gjendje të mbanin armë, që të përgatiteshin për të luftuar kundër myslimanëve. Ata kërcënuan se kush nuk do të merrte pjesë në luftë, do t'i shembej shtëpia dhe do t'i përvetësohej e gjithë pasuria. Ky kërcënim ndikoi tek ata njerëz që e kishin pranuar Islamin në dukje, por ata refuzuan të emigronin për arsye të dashurisë së madhe që kishin për vendin dhe pasurinë e tyre. Kjo bëri që ata të detyrohen e të bashkohen me idhujtarët për të shkuar në luftë. Ata filluan të dyshojnë në triumfin e myslimanëve për shkak të numrit të tyre të vogël. Ata u vranë në luftë duke qenë në anën e idhujtarëve. Atëherë zbritën ajetet e lartpërmendura që flasin për përfundimin e zi të tyre për shkak të këmbënguljes për të qëndruar me idhujtarët.¹

Komentimi

Pas kërkimeve të veçanta rreth xhihadit, këto tre ajete tregojnë të ardhmen e zezë të atyre personave që shfaqën Islamin por refuzuan që të ndjekin planin e Islamit për të emigruar. Ata devijuan në shkarje të tmerrshme dhe rezultati i devijimit të tyre ishte vrasja që i goditi ndërkohë që po luftonin në radhët e idhujtarëve.

Kur'ani famëlartë tregon se si i pyesin melekët në kohën që ua marrin shpirtërat atyre që u bënë padrejtësi vetave të veta. I

¹ Tefsiri Mexhmaul Bejan, vëll. 3, f. 169.

pyesin ata për gjendjen e tyre në këtë botë dhe nëse ata do të ishin vërtet myslimanë përse morën pjesë në rreshtat e idhujtarëve për të luftuar myslimanët. All'llahu i Lartësuar thotë: **"Kur engjëjt ua marrin shpirtrat atyre që e kanë ngarkuar veten me fajë, u thonë: 'Ku ishit?...'"** Ata u përgjigjen se u përballën me presion në vendin e tyre dhe kjo i bëri të paaftë për të zbatuar urdhërin e All'llahut: **"...Ata përgjigjen: 'Ishim të pafuqishëm në Tokë...'"**

Por kjo arsye nuk u pranohet atyre sepse melekët u thonë: përse nuk e latë vendbanimin tuaj të idhujtarisë dhe të shpëtonit veten tuaj nga padrejtësia dhe shtypja me anë të rrugës së emigrimit për në tokë tjetër prej tokës së gjerë të All'llahut? Ajeti thotë: **"...(Engjëjt) do t'u thonë: 'A nuk qe Toka e All'llahut e gjerë që të mërgonit në të?...'"**

Në përfundim, ajeti tregon të ardhmen e tyre duke thënë se ata të cilët nuk emigruan për arsye të kota e të pabaza apo për shkak të interesit të tyre personal dhe vendosën që të qëndrojnë në mjedisin e ndotur dhe përzgjedhën shtypjen në vend të emigrimit, vendbanim i tyre do të jetë Xhehennemi dhe se fundi dhe ndëshkimi i tyre atje do të jetë i keq. All'llahu i Lartësuar thotë: **"...Këta janë ata (njerëz), vendbanimi i të cilëve është Xhehennemi; eh, sa i keq është ai vendbanim!"**

Ndërsa ajeti i dytë, prej tre ajeteve në fjalë, i përjashton të dobët dhe të paaftët e vërtetë dhe jo ata jo të vërtetë. Ai thotë se ata burra, gra e fëmijë, të cilët nuk kanë gjetur për veten e tyre rrugëdalje për të emigruar dhe nuk kanë gjetur rrugë për të shpëtuar nga mjedisi i ndotur, ata janë të përjashtuar nga ligji i ndëshkimit sepse, ata e kanë arsyen e vërtetë dhe All'llahu i Lartësuar nuk e detyron robin mbi mundësitë e tij. Ajeti thotë: **"Me përjashtim të meshkujve të pafuqishëm, grave dhe**

fëmijëve, të cilët nuk kanë as fuqinë e as mundësinë të drejtohen në rrugë."

Kurse ajeti i fundit prej këtyre tre ajeteve qartëson mundësinë që All'llahu mund t'i përfshijë ata në faljen e Tij, ku thotë: **" Mbase All'llahu i fal, se All'llahu, me të vërtetë, është Shlyes dhe Falës i gjynaheve."**

Pyetje: Këtu mund të lindë pyetja: Sikurse ata persona me të vërtetë të kishin arsye, atëherë përse ajeti nuk u premton atyre faljen e padiskutueshme të All'llahut, por e sqaron mundësinë e përfshirjes së tyre në këtë falje me shprehjen "mbase" (asaa) që dëshmon mundësinë në këtë çështje jo prerazi?

Përgjigje: Kjo pyetje ka po të njëjtën përgjigje të cilën e kemi përmendur në fund të shpjegimit të ajetit 84 të Sures "En Nisa". Nëpërmjet asaj përgjigjeje qartësuam se qëllimi në përdorimin e këtyre shprehjeve është se rregulli i ardhur në ajet është i kushtëzuar me kritere të veçanta që duhen patur parasysh. Kriteri këtu është që ata të paaftët e vërtetë të insistojnë për të emigruar pa hezitim që në momentin kur atyre u jepet mundësia dhe pa u ngurruar. E kështu ata i përfshin falja e All'llahut.

Hulumtime

1- Abstraksioni i shpirtit

Me të vërtetë përdorimi i fjalës "marrin shpirtrat", (teuafaa) që përmendët në këtë ajet në vend të fjalës "vdekje", (el meutu), në të vërtetë kjo tregon se vdekja nuk është zhdukja e plotë, por ajo është gjendja në të cilën melekët i marrin shpirtin e njeriut. Pra, në

të vërtetë melekët i marrin shpirtin njeriut, i cili është esenca e ekzistencës së tij. Ky shpirt çohet në një botë tjetër. Përdorimi i kësaj fjale në Kur'an disa herë konsiderohet prej argumenteve më të qarta kur'anore për çështjen e ekzistencës së shpirtit dhe të qëndrimit të tij pas vdekjes. Për këtë do të flasim në veçanti në komentimin e ajetit që flet për shpirtin. Kjo është përgjigje për ata të cilët thonë se Kur'ani nuk ka folur fare për çështjen e shpirtit.¹

2- Meleku (engjëlli) i vdekjes apo melekët (engjëjt) e vdekjes

Gjatë kërkimit në rreth 12 vende në Kur'anin famëlartë, në të cilët gjendet fjala "teaafa" e cila flet për vdekjen, konkludojmë se marrja e shpirtërave kryhet nga disa melekë dhe jo nga një melek i vetëm. Ata melekë janë të ngarkuar me transferimin e shpirtit të bijëve të Ademit nga kjo botë në Botën Tjetër. Në ajetin e mësipërm melekët janë përmendur në numrin shumës dhe ky është një argument se marrja e shpirtit kryhet nga një grup melekësh. Në ajetin 61 të sures "El En'am" lexojmë se All'llahu i Lartësuar thotë: **"... kur ndonjërit nga ju i vjen vdekja, ia marrin shpirtin të dërguarit Tanë..."**

Ka ajete të cilët ia atribuojnë marrjen e shpirtit melekut të vdekjes, siç thotë All'llahu i Lartësuar në ajetin 11 të sures "Es Sexhde": **"Shpirtin do t'jua marrë engjëlli i vdekjes, i cili është caktuar për ju."** Ky melek është i madhi i melekëve që marrin shpirtat dhe në hadithe ai njihet me emrin "Azrajl".

¹ Për kuptimin e fjalës "teaafa" nga ana gjuhësore shihni fundin e ajetit 55 të sures "Ali Imran" në këtë komentim.

Nga ajo që thamë më lart na qartësohet përgjigjja e atij që pyet se si ua merr një melek i vetëm shpirtërat shumë njerëzve në një kohë të vetme dhe në vende të ndryshme. Megjithatë, sikur të supozojmë se është një melek i vetëm që i merr shpirtat dhe jo një grup melekësh, edhe në këtë supozim nuk ka asnjë problem. Shkaku është se abstraksioni ekzistues i këtij meleku bën që hapësira e veprimit dhe e depërtimit të tij të jetë shumë e gjërë në formë mrekullie. Kjo sepse çdo ekzistencë abstrakte e zhveshur nga materialja mund të ketë një veprim të gjerë për specifikat e botës materiale. Është transmetuar nga imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) se kur Profeti Muhammed (Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) e ka pyetur melekun e vdekjes se si e rrethon këtë botë ai i është përgjigjur: *"E gjithë kjo dynja tek unë në krahasim me atë që më ka dhënë dhe më ka mundësuar All'Ilahu, është vetëm si një derhem në dorën e njeriut që e përdorë atë si ai të dojë."*¹

Mirëpo në disa ajete ne lexojmë se marrja e shpirtave kryhet nga ana e All'Ilahut të Lartësuar, siç thotë ajeti 42 i sures "Zumer": **"All'Ilahu ua merr shpirtat atyre që u ka ardhur çasti i vdekjes dhe atyre që nuk kanë vdekur."** Ky ajet nuk bie në kundërshtim me ajetet e mëparshme, sepse në shumë raste kur veprimi kryhet me një mjet të caktuar, nganjëherë ky veprim i atribuohet vetë mjetit e herë tjetër i atribuohet atij që e krijoi mjetin dhe që të dy atribuimet janë të sakta.

Është e mahnitshme se Kur'ani shumë prej ndodhive në këtë botë ia atribuon melekëve të cilët janë të ngarkuar nga ana e All'Ilahut të Lartësuar. Ne e dimë se fjala "melaike" ose "melek" ka

¹ Biharul Enuar, vëll. 6, f. 141. Tefsiri Nuru Thakalejn, vëll.1, f. 539.

kuptim të gjerë që sillet rreth kuptimit "të krijesave abstarkte logjike" e deri te kuptimi "i forcave dhe fuqive natyrore."

3- Kush është i pafuqishmi ose i paafti?

Gjatë kërkimit të ajeteve dhe të haditheve të transmentuesve të ndryshme konkludojmë se i pafuqishmi është ai person i cili vuan nga dobësia mendore, apo trupore, apo ekonomike që e pengon atë për t'u njohur me të vërtetën dhe me të pavërtetën. Ose është ai i cili mund të njihet me besimin e drejtë e të vërtetë, mirëpo, për shkak të vuajtjes nga dobësia trupore, apo materiale, apo për shkak të pengesave që ia detyron mjedisi ku jeton, ai është i paaftë për të kryer detyrat e tij për të cilat është i detyruar po ashtu është i paaftë për të emigruar.

Transmetohet nga prijësi i besimtareve, Ali ibn Ebi Talib (Paqja qoftë mbi të!), i cili ka thënë: *"Nuk quhet i pafuqishëm ai të cilit i arritur argumenti dhe e ka dëgjuar me veshët e tij dhe e ka kuptuar në zemrën e tij."*¹

Transmetohet nga imam Musa ibn Xhafer (Paqja qoftë mbi të!), i cili kur është pyetur se cilit popull (grup njerëzish) i thuhet i pafuqishëm, ai është përgjigjur me shkrim: *"I pafuqishëm është ai, të cilit nuk i ka arritur argumenti dhe nuk e njeh ndryshimin. Nëse e njeh ndryshimin, nuk është i pafuqishëm."*²

Është e qartë nga transmentimet e sipërpërmendura se i pafuqishëm është ai i cili vuan nga dobësia mendore dhe

¹ Tefsiri Nurul Thakalejn, vëll. 1, f. 539.

² Tefsiri Nurul Thakalejn, vëll. 1, f. 536.

ideologjike. Mirëpo, ajeti në fjalë dhe ajeti 75 i po kësaj sureje tregojnë se i pafuqishëm është ai i cili nuk është në gjendje të veprojë. Ai e di të vërtetën dhe e dallon atë por shtypja, prej së cilës ai vuan në mjedisin ku jeton, nuk e lejon që të veprojë sipas të vërtetës që ai e di dhe njeh.

Ajeti 100

﴿ وَمَنْ يُهَاجِرْ فِي سَبِيلِ اللَّهِ يَجِدْ فِي الْأَرْضِ مُرَغْمًا كَثِيرًا وَسَعَةً ۚ وَمَنْ
تَخْرُجْ مِنْ بَيْتِهِ مُهَاجِرًا إِلَى اللَّهِ وَرَسُولِهِ ثُمَّ يُدْرِكْهُ الْمَوْتُ فَقَدْ وَقَعَ
أَجْرُهُ عَلَى اللَّهِ ۗ وَكَانَ اللَّهُ غَفُورًا رَحِيمًا ﴾

"Kush mërgon për çështjen e All'Ilahut, ai gjen shumë vendbanime dhe begati në tokë. Kush lë shtëpinë e vet, duke u shpërngulur për tek All'Ilahu dhe i Dërguari i Tij dhe ndodh që t'i vijë vdekja, All'Ilahu me siguri do ta shpërblejë. Se All'Ilahu është Falës dhe Mëshirëplotë."

Komentimi

Emigrimi, rregull konstruktiv Islam

Pasi ajetet e mëparshme hulumtuan rreth atyre personave të cilët ranë viktimë e poshtërimit dhe përçmimit për arsye të moskryerjes së detyrimit të emigrimit nga ana e tyre, ajeti në fjalë, që është edhe ajeti i fundit për këtë çështje, e sqaron rëndësinë e emigrimit në formë të qartë e të prerë në dy grupe:

Grupi i parë: Ky ajeti tregon për mirësitë dhe begatitë që ka emigrimi në këtë botë ku thotë se ai që emigron në rrugë të All'Ilahut të Lartësuar, në çdo skaj të kësaj bote të gjerë, do të gjejë

shumë vende të gjera e të sigurta për t'u vendosur në to dhe do të punojë me të vërtetën e të drejtën: **"Kush mërgon për çështjen e All'Ilahut, ai gjen shumë vendbanime dhe begati në tokë..."**

Duhet të dihet se fjala "meragim" që rredh nga rrënja e fjalës "rigam", do të thotë tokë. Kurse fjala "irkam", do të thotë me u përly në tokë dhe poshtërim. Fjala "meragim" ka formën e kundrinorit dhe emrit vendor. Kjo fjalë ka ardhur në këtë ajet me kuptimin e emrit vendor që do të thotë: vendi në të cilin mund të realizohet dhe të zbatohet e vërteta. Po ashtu, në atë vend mund të dënohen kundërshtarët e të vërtetës dhe t'u ulet hunda përtokë.

Grupi i dytë: Pas kësaj ajeti tregon anën shpirtërore dhe atë të ahiretit që ka emigrimi. Ajeti thotë **"...Kush lë shtëpinë e vet, duke u shpërngulur për tek All'Ilahu dhe i Dërguari i Tij dhe ndodh që t'i vijë vdekja, All'Ilahu me siguri do ta shpërblejë. Se All'Ilahu është Falës dhe Mëshirëplotë."**

Duke u bazuar mbi këtë, në çdo rast emigruesit do të arrijnë fitore të madhe, arrijnë apo nuk arrijnë tek vendi që synojnë me qëllim që të kënaqen me lirinë e veprimit dhe me detyrat e tyre. Edhe pse është e natyrshme që punëmirët e kanë shpërblimin e tyre tek All'Ilahu i Lartësuar, mirëpo ky ajet e përfocon dhe e thotë qartë këtë gjë duke thënë: **"...All'Ilahu me siguri do ta shpërblejë..."** Kjo tregon madhështinë e shpërblimit nga ana e All'Ilahut të Lartësuar për atë që emigron për hir të All'Ilahut.

Hulumtime

Islami dhe emigrimi

Me të vërtetë Islami, bazuar në këtë ajet dhe në ajete të tjera të shumta, i urdhëron qartë myslimanët që të emigrojnë nga mjedisi në të cilin vuajnë për shkaqe të veçanta nga pamundësia për të kryer detyrimet në mjedise të sigurta. Shkaku për këtë është i qartë sepse Islami nuk kufizohet as me vend dhe as me mjedis të caktuar. Për këtë, kapja ekstreme e vendlindjes dhe marrëdhëniet e tjera të ndryshme nuk janë pengesë për emigrimin e myslimanëve sipas pikëpamjes së Islamit.

Për këtë shikojmë shkëputjen e të gjitha këtyre lidhjeve në fillim të Islamit me qëllim ruajtjen dhe përparimin e tij. Rreth kësaj një historian perendimor thotë se fisi dhe familja janë pema e vetme e cila mbin në shkretëtirë dhe askush nuk mund të jetojë pa u strehuar tek ato. Mirëpo, Muhammedi e shkuli këtë pemë, e cila u zhvillua me mishin dhe gjakun e familjes së tij. Këtë e bëri për hir të Zotit të vet dhe Krijuesit të tij. (I dërguari i All'llahut të Lartësuar i shkëputi lidhjet me kurejshët për hir të rrugës së Islamit)¹

Nga ajo që u përmend më lart, në mesin e të gjitha krijesave të gjalla, kur një individ apo grupi u kanoset jeta me rrezik, ata detyrohen që ta lënë vendin dhe të emigrojnë drejt një vendi apo strehe tjetër të sigurtë. Shumë njerëz në të shkuarën janë detyruar të emigrojnë nga vendbanimet e tyre për shkak të ndryshimit të

¹ Muhamedi, vula e Profeteve, vëll. 1.

rrethanave gjeografike dhe kanë shkuar në vende të tjera për të vazhduar jetesën. Nuk janë vetëm njerëzit ata që praktikuan emigrimin, por ka lloje të ndryshme kafshësh që njihen me emrin kafshë emigruese, si për shembull zogjtë, të cilët detyrohen t'i sillen përqark tokës për të gjetur ushqim e strehim dhe për të vazhduar jetën e tyre. Disa prej këtyre zogjve shtegtojnë nga Poli i Veriut drejt Polit të Jugut. Herë-herë përshkruajnë afërsisht 18 mijë kilometra për të arritur tek vendi në të cilin duan të jetojnë.

Këto dëshmi janë argumenti më i mirë se emigrimi është një nga ligjet e përhershme për jetën. A mund të jetë njeriu më me pak fat se sa kafshët në këtë çështje?

Kur jeta e tij shpirtërore, ekzistenca e tij dhe qëllimet e tij të shenjta të cilat janë gjëja më e shtrejtë se jeta e tij materiale përballen me rrezikun, a mundet që ky njeri të qëndrojë në vende të rrezikshme duke mbartur poshtërimin, nënçmimin, shtypjen, privimin dhe ajo që është më e rëndësishmja e të gjitha këtyre mosarritja e qëllimit të tij?! Apo ai duhet të zgjedhë ligjin natyror të emigrimit, ta lërë atë vend dhe të zgjedhë një vend tjetër që i mundëson zhvillimin material dhe shpirtëror?

Ajo çfarë është interesante në çështjen e emigrimit – sigurisht që bëhet fjalë për atë emigrim që është për të ruajtur veten dhe legjislacionin Islam - është se ajo konsiderohet parimi bazë ose fillimi i historisë islame. Kështu që ajo është struktura kryesore e të gjitha ngjarjeve politike, informative dhe shoqërore për myslimanët.

Le të shikojmë përse u zgjodh emigrimi i Profetit (Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) që të jetë parim dhe fillim për historinë islame?

Kësaj teme ia vlen t'i kushtohet vëmendje, sepse ne e dimë se çdo shoqëri njerëzore, e madhe apo e vogël, kanë një parim ose fillim historik me anë të të cilit llogarit historinë e vet. Për shembull, të krishterët e kanë si fillim të historisë së tyre vitin në të cilin ka lindur hazreti Isai (Paqja qoftë mbi të!). Ndërsa myslimanët, megjithëse para emigrimit (hixhretit) kanë ndodhur ngjarje të mëdha e të rëndësishme si: lindja e të Dërguarit të All'Ilahut, ardhja e Profetësisë, zbritja e Kur'anit, etj, por, ata nuk kanë marrë asnjë nga këto ngjarje si parim apo fillim të historisë së tyre, por ndodhinë e hixhretit (emigrimit) e kanë konsideruar si fillim i historisë islame.

Me të vërtetë historia thotë se myslimanët filluan të mendojnë për të caktuar fillimin e historisë së tyre, e cila ka një rëndësi të madhe e të përgjithshme, në kohën e halifit të dytë, në kohën e të cilit u zgjeru perimetri i shtetit Islam. Dhe myslimanët pas kërkimit të shumtë në këtë çështje përzgjedhën mendimin e Ali ibn ebu Talibit që ngjarjen e emigrimit të Profetit të ndershëm (Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ta vendosin si parim dhe fillim të historisë islame.¹

Në të vërtetë kjo zgjedhje ishte caktimi sepse emigrimi ka qenë ngjarja më e rëndësishme dhe programi më e ndritshëm i historisë islame. Emigrimi ka qenë fillimi i një epoke të re e të rëndësishme në historinë islame. Myslimanët, gjatë pranisë së tyre

¹ Tarikh Et Tabarij, vëll. 2, f. 112.

në Mekë i mësonin çështjet e jetës së tyre sipas fesë së tyre të re (Islamit) dhe nuk kanë patur asnjë mundësi ose forcë politike e shoqërore. Por pas emigrimit ata formuan menjëherë shtetin Islam, i cili përparoi me një shpejtësi marramendëse në të gjithë sferat si ato fetare, politike, ushtarake e administrative. Sikur myslimanët të mos iu përgjigjeshin urdhërit të Dërguarit të All'llahut në përzgjedhjen e emigrimit dhe të qëndronin në Mekë, nuk do t'u jepej mundësia që Islami të shtrihej jashtë kufijve të Mekës, por ka qenë e mundur që Islami të varrosej në Mekë dhe të shuheshin gjurmët e tij.

Ne na sqarohet se emigrimi nuk ka qenë një rregull i veçantë për kohën e të Dërguarit të All'llahut të Lartësuar, por ai është i detyrueshëm për myslimanët në çdo kohë që përballen me situata të ngjashme prej të cilave Profeti dhe shokët e tij u detyruan të linin Mekën dhe të emigronin në Medinë.

Kur'ani famëlartë e konsiderin emigrimin si themelin bazë të pranisë së lirisë dhe të zhvillimit. Për këtë çështje tregon dhe ajeti 41 i sures "En Nahl" që thotë: **"Ata që, pasi vuajtën të shtypur, u shpërngulën për hir të All'llahut, Ne do t'i vendosim në vendbanime të mira në këtë botë. Natyrisht, shpërblimi që i pret në botën tjetër (Xhenneti), është edhe më i madh. Ah! Sikur ta dinin ata."**

Gjithashtu, është e vlefshme të thuhet se emigrimi në këndvështrimin e Islamit nuk kufizohet me emigrimin e vendit të jashtëm, por para kësaj duhet që myslimani të realizojë emigrimin e brendshëm në vetveten e tij dhe të braktisë çdo gjë që është në kundërshtim me dinjitetin njerëzor me qëllim që me anë të kësaj të lehtësojë rrugën për emigrimin e jashtëm. Kështu që emigrimi i

brendshëm është më i domosdoshëm përpara se njeriu të fillojë emigrimin e jashtëm.

Esenca e emigrimit është largimi nga "errësi" për në "dritë", largimi nga mosbesimi në besim dhe nga mëkati e gabimi në nënshtrimin ndaj All'llahut të Lartësuar. Nëpër hadithe lexojmë se emigrantët të cilët emigrojnë me trupat e tyre, pa realizuar emigrimin e brendshëm të tyre, nuk janë në gradën e emigrantëve. Ndërsa, ata të cilët e realizojnë emigrimin e brendshëm shpirtëror dhe nuk kanë patur mundësi ose nuk kanë patur nevojë për emigrimin e jashtëm, me të vërtetë janë në rradhët e emigrantëve.

Nga prijësi i myslimanëve Ali ibn ebi Talibi (Paqja qoftë mbi të!) transmetohet se ai ka thënë: *"Personi thotë kam emigruar, por ai nuk ka emigruar. Me të vërtetë emigrantët janë ata të cilët u largohen të këqijave dhe nuk i veprojnë ata."*¹

Nga i Dërguari i All'llahut (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) transmetohet se ai ka thënë: *"Kush ka emigruar për fenë e tij nga një vend në një vend tjetër, edhe nëse ajo tokë është një pëllëmbë, e meriton Xhennetin dhe është shoqëruar me Muhammedin dhe Ibrahimin (Paqja qoftë mbi ta!)."*² Sepse këta dy Profetë janë udhëheqësit dhe imamët e emigrantëve në këtë botë.

¹ Sefijjnetul Bihar, vëll. 1, f. 697.

² Tefsiri Nuru Thakalejn, vëll. 1, f. 541.

Ajeti 101

وَإِذَا ضَرَبْتُمْ فِي الْأَرْضِ فَلَيْسَ عَلَيْكُمْ جُنَاحٌ أَنْ تَقْصُرُوا مِنَ الصَّلَاةِ
إِنْ خِفْتُمْ أَنْ يَفْتِنَكُمُ الَّذِينَ كَفَرُوا ۚ إِنَّ الْكَافِرِينَ كَانُوا لَكُمْ عَدُوًّا

مُبِينًا

"Kur të udhëtoni, nuk është gjynah që ta shkurtoni namazin, nëse druheni që jobesimtarët do t'ju bëjnë ndonjë dëm. Me të vërtetë, jobesimtarët janë armiqtë tuaj të hapur."

Komentimi

Namazi i udhëtarit

Pas ajeteve që flisnin për xhihadin dhe emigrimin ajeti në fjalë thotë: "Kur të udhëtoni, nuk është gjynah që ta shkurtoni namazin, nëse druheni që jobesimtarët do t'ju bëjnë ndonjë dëm. Me të vërtetë, jobesimtarët janë armiqtë tuaj të hapur.", që është dhe tema jonë e kërkimit dhe që flet për namazin e udhëtarit dhe sqaron se nuk ka asnjë pengesë për myslimanin që ta shkurtojë namazin e tij kur ai është në udhëtim dhe nëse ka frikë nga rreziku i jobesimtarëve, të cilët janë armiqtë e hapur të myslimanëve. Ky ajet ka përdorur për udhërtimin shprehjen

"goditje në tokë", sepse udhëtari e godet tokën me këmbët e tij gjatë udhëtimit.¹

Këtu shtrohet pyetja: Ky ajet e ka bërë frikën nga armiku kusht për të shkurtuar namazin, ndërkohë që ne lexojmë në librat e jurisprundencës islame se rregulli i shkurtimit të namazit konsiderohet rregull i përgjithshëm dhe përfshin të gjitha llojet e udhëtimit, ekziston apo nuk ekziston frika nga armiku. Kanë ardhur trasmetime të shumta nga burimet shiite dhe synite për çështjen e shkurtimit të namazit ku të gjitha ato përforcojnë se rregulli i shkurtimit të namazit është i përgjithshëm dhe përfshin të gjithë llojet e udhëtimit të lejuar.²

Në përgjigje të kësaj pyetjeje duhet thënë se kufizimi i rregullit të shkurtimit të namazit me frikën ka mundësi të kenë shkak njërin prej shpjegimeve të mëposhtme:

A- Kushtëzimi ka ardhur për arsye të gjendjes së myslimanëve në fillim të epokës islame dhe terminologjisht këtij kushtëzimi i thuhet "kufizim i shumtë" që do të thotë se shumica e udhëtimeve të myslimanëve në atë kohë kanë qenë të mbushura me frikë. Në shkencën e bazave të Jurispudencës islame thuhet se shumica e kushtëzimeve nuk kanë kuptim duke e argumentuar me ajetin 23 të sures "En Nisa" që thotë: **"me vajzën e gruas suaj që gjendet nën kujdestarinë tuaj."**, që do të thotë se vajzat e grave tuaja, të cilat ju i edukoni dhe ato janë nga burri i mëparshëm, ato janë të ndaluara për ju (për martesë).

Në këtë ajet përballemi po me të njëjtën çështje të "kushtëzimit të shumtë" sepse vajzat e gruas konsiderohen të ndaluara për burrin, qofshin tek ai apo jo. Por meqenëse shumica

¹ Mufredatu Ragib, lënda "darebe".

² Uesailu Shijja, vëll. 8, f. 433-517. Sunen El Bejhakij, vëll. 3, f. 134, e në të tjera libra.

e grave të divorcuara, të cilat martohen për herë të dytë, janë të reja dhe kanë fëmijë të vegjël, atëherë edukimi i tyre kryhet nën kujdestarinë e burrit të ri. Prandaj, në këtë ajet ka ardhur me kushtin "**që gjenden nën kujdestarinë tuaj.**"

B- Disa komentues të Kur'anit mendojnë se namazi i shkurtuar është bërë detyrim që në fillim të kohës së frikës, sikurse ka ardhur në ajetin në fjalë, dhe më pas ky rregull është zgjeruar dhe ka përfshirë të gjitha rastet.

C- Gjithashtu, supozohet që në këtë kushtëzim të ketë përforcim që do të thotë se namazi i shkurtuar është detyrim për udhëtarin kudo që të jetë. Porse në rastin e frikës nga armiku, namazi i shkurtuar duhet të jetë më tepër i domosdoshëm.

Sido që të jetë, nuk ka dyshim se shkurtimi i namazit, duke marrë në konsideratë edhe transmentimet që komentojnë këtë ajet, nuk është vetëm në rastin e frikës. Për këtë arsye, edhe i Dërguari i All'Ilahut në udhëtimet e tij, deri edhe në periudhën e Haxhit ai e ka shkurtuar namazin e tij.

Pyetje: Këtu bëhet një pyetje tjetër . Ky ajet ka ardhur me frazën: "**nuk është gjynah**" dhe në këtë frazë nuk ka argument të prerë për këtë rregull, pra nuk vendos prerazi që udhëtar i ta shkurtojë namazin. Atëherë, si mund të thuhet që shkurtimi i namazit është detyrë (i detyrueshëm) për çdo person udhëtar dhe nuk është detyrë zgjedhëse?

Përgjigje: Këto dy pyetje u janë drejtuar drejtuesve të Islamit dhe si përgjigje për to ata kanë përmendur tri pika të rëndësishme:

Pika e parë: Fraza "**nuk është gjynah**", është përdorur në disa vende në Kur'an për të treguar detyrim. Për shembull, në ajetin 158 të sures "El Bekare" All'llahu i Lartësuar thotë: "**Kodrinat Safa dhe Merva (në Mekë) janë pjesë e simboleve të All'llahut, prandaj ai që viziton Qaben për Haxh ose Umre , s'ka kurrëfarë gjynahu nëse sillet mes tyre.**" Ndërkohë të gjithë myslimanët e dinë se ecja ndërmjet Safas dhe Mervas është detyrim qoftë në Haxh apo në Umre.

Profeti (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), imamët (Paqja qoftë mbi ta!) dhe myslimanët e kanë kryer përsheptimin (ecjen) mes Safas dhe Mervas si detyrim. Për këtë përmbajtje është transmetuar edhe një hadith nga imam Bakiri (Paqja qoftë mbi të!).¹

Thënë ndryshe se fraza "**nuk është gjynah**", që gjendet në këtë ajet dhe në ajetin e Haxhit, kanë ardhur për të mohuar të ndaluarën për shkak se disa mysliman në fillim të Islamit, për arsye të pranisë së idhujve mbi kodrinën e Safas dhe të Mervas, mendonin se ecja mes këtyre të dyjave (Safas dhe Mervas) është nga zakonet e idhujtarëve, ndërkohë që nuk është ashtu. Dhe për këtë ka ardhur fraza "**nuk është gjynah**" për të larguar këtë hamendësi.

Pika e dytë: Disa transmetime tregojnë se shkurtimi i namazit në udhëtim është një lloj lehtësimi nga ana e All'llahut dhe duhet që ky lehtësim as të moskundërshtohet dhe as të mosinjorohet.

¹ Tefsiri Nurul Thakalejn, vëll.1, f. 542.

Në transmetimet e Ehli Synetit ka ardhur nga Profeti (Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) për çështjen e shkurtimit të namazit se ai të ketë thënë: *"Ai është lëmoshë (sadeka) e All'lahut për juve, prandaj pranojeni lëmoshën e Tij."*¹

Po ashtu, si ky hadith është transmetuar edhe në burimet shiite ku transmetohet nga imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) se Profeti (Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: "Mosagjërimi në udhëtim dhe shkurtimi i namazit janë dy dhurata të All'lahut. Ai që u largohet atyre është bërë refuzues i udhëzimit të All'lahut."²

Ndërsa pika e tretë, ndaj së cilës duhet patur kujdes, është se disa myslimanë kanë menduar se ajeti 101 i sures "En Nisa" shpjegon rregullin e namazit të frikës (gjatë luftës dhe të ngjashme me këtë) dhe e argumentojnë këtë me frazën: **"nëse druheni"** që përmendet në ajet. Por fraza: **"kur të udhëtoni"** ka një kuptim të përgjithshëm që përmbledh të gjitha llojet e udhëtimit, qoftë udhëtim i zakonshëm apo udhëtim për diçka tjetër, që e shpjegon në mënyrë të veçantë ajeti në vazhdim.

Atëherë, fraza: **"nëse druheni"**, siç e thamë edhe më lart, konsiderohet prej kushtëzimeve dhe kushteve në përgjithësi, ku shumica e udhëtimeve të myslimanëve në atë kohë kanë qenë të shoqëruara me frikë dhe me rrezik. Për këtë nuk ka argument që ajeti të kufizohet me shkurtimin vetëm në rastin e frikës. Në shtesë të asaj që u tha, frika nga sulmi i armikut ekziston gjatë luftës dhe

¹ Sunen Bejhakijj, vëll. 3, f. 134, përcjellë nga Sahihu Myslim. Gjithashtu, është përmendur edhe në librat e tefsirit dhe të jurisprudencës.

² Uesailu Shia, vëll. 8, f. 520.

nuk është me vend që t'i thuhet atij që është në fushën e betejës "**nëse druheni**" nga sulmi i armikut. Ky është një argument tjetër që tregon se ajeti flet për të gjitha llojet e udhëtimit në të cilët mund të supozohet se në to ka rreziqe.

Po ashtu, duhet patur parasysh se kushtet e namazit të udhëtarit nuk përmenden në Kur'an. Sikurse nuk përmenden as kushtet dhe as përshkrimet e rregullave të tjera islame. Por këto rregulla i tregon syneti i Profetit të ndershëm.

Nga ato kushte është se shkurtimi i namazit nuk duhet të bëhet në ato udhëtime largësia e të cilëve nuk ka arritur në tetë farsakh¹, sepse udhëtari në ato ditë përshkuante në një ditë të vetme largësinë e tetë farsakh në mënyrë të zakonshme.

Dhe kushti tjetër është se kur puna dhe profesioni i udhëtarit ose një pjesë nga programimi i jetës së tij të përditshme është në udhëtim, ky është i përjashtuar nga rregulli i shkurtimit të namazit, sepse udhëtimi për këta persona është diçka e zakonshme dhe nuk është çështje e përjashtuar.

Po ashtu, ai që udhëton për të bërë gjynah (që bie në kundërshtim me rregullat islame), atë nuk e përfshin rregulli i shkurtimit të namazit, pra, atij nuk i lejohet që të shkurtojë namazin. Arsyeja është se shkurtimi i namazit konsiderohet si lehtësim hyjnor për udhëtarin. Atëherë nuk është e mundur që ta përfshijë ky rregull atë të cilin ecën në rrugë për të bërë mëkat ndaj All'Ilahut të Lartësuar .

¹ Fjala "Farsakh" ka kuptimin e njësisë matëse. Një "farsakh" është i barabartë me 5.5 km.

Gjithashtu, nëse udhëtari nuk ka arritur "hadu terakhus", kufirin e lejimit të shkurtimit të namazit , (që është pika në të cilën nuk mundet që ta dëgjojë zërin e ezanit të qytetit ku ai banon ose nuk mundet të shikojë kufijtë e qytetit të tij) ai nuk mund ta shkurtojë namazin e tij sepse ai në këtë rast nuk konsiderohet prej udhëtarëve.

Në shtesë të këtyre që u përmendën, ka edhe rregulla të tjera për këtë çështje që përmenden të detajuara në librat e jurisprudencës dhe në librat e haditheve.

Ajeti 102

وَإِذَا كُنْتَ فِيهِمْ فَأَقَمْتَ لَهُمُ الصَّلَاةَ فَلْتَقُمْ طَافِةٌ مِنْهُمْ مَعَكَ وَلْيَأْخُذُوا
أَسْلِحَتَهُمْ فَإِذَا سَجَدُوا فَلْيَكُونُوا مِنْ وَرَائِكُمْ وَلْتَأْتِ طَافِةٌ أُخْرَى
لَمْ يُصَلُّوا فَلْيُصَلُّوا مَعَكَ وَلْيَأْخُذُوا حِذْرَهُمْ وَأَسْلِحَتَهُمْ ۗ وَدَّ الَّذِينَ
كَفَرُوا لَوْ تَغْفُلُونَ عَنْ أَسْلِحَتِكُمْ وَأَمْتِعَتِكُمْ فَيَمِيلُونَ عَلَيْكُمْ مَيْلَةً
وَاحِدَةً ۗ وَلَا جُنَاحَ عَلَيْكُمْ إِنْ كَانَ بِكُمْ أَذًى مِنْ مَطَرٍ أَوْ كُنْتُمْ مَرْضَى
أَنْ تَضَعُوا أَسْلِحَتَكُمْ ۖ وَخُذُوا حِذْرَكُمْ ۗ إِنَّ اللَّهَ أَعَدَّ لِلْكَافِرِينَ عَذَابًا

مُهينًا

"Kur të jesh ti (o Muhammed) në mes të besimtarëve dhe të prish faljen e namazit (në luftë), atëherë njëri grup prej tyre le të falet me ty dhe le t'i mbajnë pranë edhe armët e veta! Pastaj këta, le të rrinë pas jush dhe le të vijë grupi tjetër, i cili nuk është falur dhe, le të falet me ty! Le të jenë syçelë dhe t'i mbajnë armët e veta! Jobesimtarët dëshirojnë që të jeni të pakujdesshëm ndaj armëve dhe pajimeve tuaja, që t'ju sulmojnë me tërë fuqinë. Nuk ka gjynah për ju nëse hasni në ndonjë shqetësim

prej shiut ose sëmundjes e i lini armët, por edhe atëherë, bëhuni syçelë. All'illahu, me të vërtetë, ka përgatitur dënim poshtërues për jobesimtarët."

Shkaku i zbritjes

Profeti (Paqja dhe bekimet e All'illahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) së bashku me disa myslimanë kur po shkonin për në Mekë, zbriti në tokën e Hudejbijes. Kurejshit dëgjuan për këtë dhe dërguan Halid ibn Velidin në krye të dyqind personave për t'i bllokuar rrugën Profetit dhe myslimanëve të cilët ishin me të dhe për t'i ndaluar që të arrijnë në Mekë. Halidi dhe ata që e shoqëronin atë u vendosën në një kodër afër Mekës.

Kur hyri koha e namazit të drekës, Bilali thirri ezanin dhe Profeti fali namazin me xhemat së bashku me myslimanët. Halidi e pa namazin e myslimanëve dhe mendoi planin e sulmit kundër tyre. Ai i lajmëroi njerëzit e tij që të shfrytëzonin momentin e faljes së namazit të ikindisë të cilin e konsiderojnë më të shtrenjtë se sytë e tyre, dhe t'i mësyjnë ata në mënyrë të papritur kur të jenë duke u falur dhe t'i eliminojnë ata. Në këto momente ka zbritur ajeti me rregullin e namazit të frikës, i cili i ruan myslimanët nga çdo sulm i papritur.

Ky ajet është një nga mrekullitë e Kur'anit famëlartë sepse i lajmëroi ata se do të ndodhë sulmi përpara se armiqtë të zbatonin

planin e tyre dhe me këtë plani i tyre dështoi dhe thuhet se Halidi e pranoi Islamin kur pa këtë ngjarje me sytë e tij.¹

Komentimi

Pas ajeteve të mëparshëm të xhihadit ky ajet u tregon myslimanëve mënyrën e namazit të frikës që kryhet në fushën e betejës. Ajeti i drejtohet Profetit (Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe i thotë: **"Kur të jesh ti (o Muhammed) në mes të besimtarëve dhe të prish faljen e namazit (në luftë), atëherë njëri grup prej tyre le të falet me ty dhe le t'i mbajnë pranë edhe armët e veta!..."** Kur një grup bie në sexhde dhe kryhet rekati i parë i namazit duhet që Profeti të qëndrojë në vendin e tij dhe xhemati të kryejnë - shpejt - rekatin e dytë dhe të kthehen në fushën e betejës për t'i bërë ballë armikut. Pas kësaj të vijë grupi i dytë, të cilët nuk janë falur, dhe të zërë vendin e grupit të parë dhe të falen me Profetin. All'Ilahu i Lartësuar thotë **"...Pastaj këta, le të rrinë pas jush dhe le të vijë grupi tjetër, i cili nuk është falur dhe, le të falet me ty!..."** Është detyrë e grupit të dytë të mos i lënë në tokë armët e tyre por t'i mbajnë me vete: **"...Le të jenë syçelë dhe t'i mbajnë armët e veta!..."**

Ajeti tregon formën se si të kryhet namazi (në rast lufte) për arsye që myslimanët të qëndrojnë të sigurtë nga çdo mësymje e papritur që mund të kryejë armiku ndaj tyre sepse ai gjithmonë shfrytëzon momentin për të sulmuar dhe uron që myslimanët t'i

¹ Tefsir Et Tibjan, vëll. 3, f. 311.

lënë armët apo të jenë të pavëmendshëm ndaj armëve dhe paisjeve të tyre që t'i sulmojnë me tërë fuqinë: **"...Jobsimtarët dëshirojnë që të jeni të pakujdesshëm ndaj armëve dhe pajimeve tuaja, që t'ju sulmojnë me tërë fuqinë..."**

Meqenëse në mbartjen e armëve dhe pajimeve të tjera mbrojtëse (armët e duhura për luftë) është e vështirë siç është rasti i disa myslimanëve të cilët ankohen nga dobësia trupore, nga sëmundja apo plagët që kanë marrë në fushën e betejës në përfundim ajeti i urdhëron duke u thënë: **"...Nuk ka gjynah për ju nëse hasni në ndonjë shqetësim prej shiut ose sëmundjes e i lini armët..."**

Ky është kusht që myslimanët t'i ruajnë paisjet mbrojtëse të luftës siç janë mburojat dhe të tjera si këto qoftë edhe në rastin e pranisë së arsyes si dobësia apo sëmundja. Kjo është për të ruajtur vetat e tyre kur armiqtë planifikojnë mësymjen e papritur. All'Ilahu i Lartësuar thotë: **"...por edhe atëherë, bëhuni syçelë. All'Ilahu, me të vërtetë, ka përgatitur dënim poshtërues për jobsimtarët."**

Hulumtime

1- Është e qartë se prania e Profetit (Pagja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) në mesin e myslimanëve në kohën e faljes së namazit të frikës nuk do të thotë se ky namaz nuk kryhet vetëm me praninë e Profetit, por qëllimi këtu në këtë ajet është që luftëtarët dhe muxhahidat të kenë imam

apo udhëheqës që t'u prijë atyre në namazin me xhemat gjatë luftës. Nga kjo spikatje shohim që imam Aliu dhe imam Husejni e kanë kryer namazin e frikës. Po ashtu edhe disa udhëheqës të ushtrive myslimane si Hudhejfe, e kanë kryer këtë adhurim islam në kohët e domosdoshme.¹

2- Ajeti e urdhëron grupin e parë prej myslimanëve që t'i ruajnë e t'i mbajnë armët ngjeshur në trup gjatë kryerjes së namazit të frikës. Kurse grupit të dytë i thotë që të mos i lënë në tokë mjetet e tyre mbrojtëse siç janë mburojat e të tjera armë. Është e mundur që ndryshimi mes këtyre dy grupeve është se armiku nuk është në dijeni me planin e myslimanëve gjatë kryerjes së namazit nga grupi i parë dhe në këtë rast është e dobët mundësia e sulmit të armikut ndaj myslimanëve. Ndërsa, përsa i përket grupit të dytë, kur armiku e kupton planin e myslimanëve për namaz, atëherë mundësia e sulmit ndaj tyre është më e madhe.

3- Në të vërtetë qëllimi i mbajtjes së paisjeve të kërkuara prej myslimanëve në këtë ajet është që ata të ruajnë edhe mjetet e tjera luftarake dhe personale që kanë marrë me vete, ushqimet dhe kafshët, si dhe të mbrojnë vetat e tyre.

4- Është e qartë se kryerja e namazit me xhemat nuk është i detyrueshëm në Islam por është e pëlqyeshme shumë e përforcuar. Ky ajet konsiderohet një nga argumentet e gjalla për sa i përket përforcimit të rëndësisë së kryerjes së namazit me xhemat në Islam, i cili kryehet edhe në fushën e betejës duke përfutur nga forma dhe mënyra e faljes së namazit të frikës. Nga kjo tematikë argumentohet edhe rëndësia e vetë namazit duke

¹ Kenzul Irfan, vëll.1, f. 191.

shtuar edhe rëndësinë e kryerjes së namazit me xhemat (bashkarisht).

Është e natyrshme që namazi me xhemat ka ndikim psikik dhe shpirtëror tek luftëtarët si nga ana e harmonisë ashtu edhe e qëllimit. Po ashtu ai ndikon edhe tek armiqtë kur i shohin myslimanët të cilët edhe në fushën e betejës i japin rëndësi të madhe kryerjes së detyrimeve të tyre fetare.

5- Mënyra e faljes së namazit të frikës në ajetin në fjalë nuk është qartësuar plotësisht. Dhe kjo është metodologjia e Kur'anit, i cili i sqaron të përgjithshmet e rregullave dhe qartësimin e detajuar të tyre ia lë Synetit të begatë.

Mënyra e faljes së namazit të frikës, sikurse e shpjegon syneti, është që namazi me katër rekate të shndërrohet në namaz me dy rekate. Pra, për shembull, shndërrimi i namazit të drekës dhe ikindisë, që kanë nga katër rekate, në dy rekate. Grupi i parë fal rekatën e parë me imam pastaj e fal rekatën e dytë secili vetë pa imam, pastaj kthehen në frontin e luftës. Më pas vjen grupi i dytë, i cili zë vendin e grupit të parë dhe falin rekatën e parë me imam kurse rekatën e dytë e falin tek e tek (janë trasmetuar forma të tjera të kryerjes së namazit të frikës, por më e njohura është kjo që treguam më lart).

Ajeti 103

فَإِذَا قَضَيْتُمُ الصَّلَاةَ فَادْكُرُوا اللَّهَ قِيَمًا وَقُعُودًا وَعَلَىٰ جُنُوبِكُمْ^ج
فَإِذَا أَطْمَأْنَنْتُمْ فَأَقِيمُوا الصَّلَاةَ^ج إِنَّ الصَّلَاةَ كَانَتْ عَلَى الْمُؤْمِنِينَ

كِتَابًا مَّوْقُوتًا ﴿١٠٣﴾

"Pasi të kryeni namazin, përmendeni All'llahun duke qëndruar në këmbë, ulur dhe të shtrirë. Kur të jeni jashtë rrezikut, atëherë faleni namazin të plotë, sepse namazi është detyrë për besimtarët në kohë të caktuar."

Komentimi

Rëndësia e detyrimit të namazit

Pasi ajeti i mëparshëm përmendi namazin e frikës dhe përforcoi domosdoshmërinë e kryerjes së tij deri edhe në përballje me armikun në fushën e betejës, ajeti në fjalë thotë: **"Pasi të kryeni namazin, përmendeni All'llahun duke qëndruar në këmbë, ulur dhe të shtrirë. Kur të jeni jashtë rrezikut, atëherë faleni namazin të plotë, sepse namazi është detyrë për besimtarët në kohë të caktuar."** Ky ajet i nxit myslimanët që të mos harrojnë përmendjen e All'llahut pas faljes së namazit dhe ta përmendin Atë kur janë në këmbë, ndenjur por edhe gjatë gjumit dhe t'i kërkojnë Atij ndihmë

dhe triumf. Kjo përmendje mund të kryhet edhe gjatë kohës së pushimit që mund të kenë luftëtarët apo edhe në kohën luftimit.

Me të vërtetë ky ajet tregon për një të vërtetë të rëndësishme në çështjet islame dhe argumenton se kryerja e namazit në kohë të caktuar nuk ka kuptimin që njeriu ta harrojë All'llahun në raste e periudha të tjera. Namazi është një urdhër disiplinues që gjallëron dhe ripërtërin shpirtin që me anë të tij njeriu i drejtohet All'llahut të Madhëruar. Ai ka mundësi që edhe në kohë të tjera përveç kohës së namazit ta përmendë All'llahun me mendjen e tij kudo që të jetë, në fushën e betejës apo në ndonjë vend tjetër. Në shumë transmetime ky ajet është komentuar se sqaron mënyrën e faljes së namazit të njerëzve të sëmurë. Që do të thotë se nëse ata mund ta falin namazin në këmbë le ta falin, nëse nuk mund ta falin në këmbë le ta falin ulur dhe nëse nuk mund ta falin ulur, le ta falin të shtrirë.

Në të vërtetë, ky komentim është një lloj përgjithësimi dhe zgjerimi në kuptimin e ajetit edhe pse nuk ka të bëjë me këtë fushë.¹

Ky ajet përforcon se rregulli i namazit të frikës është një rregull i posaçëm dhe emergjent dhe është detyrim i myslimanëve që kur të largohet gjendja e frikës, ta kryejnë namazin në formën e tyre të zakonshme, siç thotë ajeti: **"...Kur të jeni jashtë rrezikut, atëherë faleni namazin të plotë..."**

Në mbyllje ajeti tregon sekretin e domosdoshmërisë së namazit dhe se namazi është detyrim konstant që nuk pranon ndryshim. Ajeti thotë: **"...sepse namazi është detyrë për besimtarët në kohë të caktuar."**

¹ Për t'u njohur më shumë me hadithet e ardhura për këtë çështje, shih tefsirin Nuru Thakalejn, vëll. 1, f. 545.

Fjala "meukuten", në kohë të caktuar, buron nga fjala "uaktun" kohë. Bazuar në këtë ajeti sqaron se myslimanët duhet ta kryejnë këtë detyrim islam edhe në fushën e betejës, sepse për namazin ka kohë të caktuar e cila nuk mund të neglizhohet.¹ Por transmetimet e shumta që kanë ardhur në shpjegimin e këtij ajeti tregojnë se fjalët "meukuten", në kohë të caktuar, do të thotë konstant² dhe i detyrueshëm³ e cila gjithashtu nuk e mohon kuptimin e ajetit dhe si rezultat të dyja i afrohen kuptimit të parë.

Pyetje: Disa thonë se nuk e mohojnë filozofinë, rëndësinë e namazit dhe ndikimet e tij edukative, por ata pyesin për domosdoshmërinë e kryerjes së namazit në kohë të caktuara. Ata mendojnë se do të ishte më mirë që njeriu të lihej i lirë dhe gjithë secili ta kryente namazin kur t'i jepej mundësia ose kur të jetë i përgatitur shpirtërisht për ta kryer këtë detyrim?

Përgjigje: Përvoja dhe eksperiencia kanë vërtetuar se çështjet edukative nëse nuk do t'u nënshtroheshin kushteve dhe kriterëve të caktuara, shumë njerëz do t'i injoronin dhe do t'i linin këto çështje. Dhe ky injorim do të çonte në lëkundjen e bazave të këtyre çështjeve. Për këtë, çështjet edukative dhe morale duhet t'u nënshtrohen kriterëve të veçanta dhe të caktohen kohë për kryerjen e saj dhe të mos lejohet askush që t'i shkelë ato kriterë apo t'i injorojë ato kohë të caktuara. Padyshim që kryerja e detyrimit, sikurse është namazi, në kohë të caktuar dhe me xhemat (bashkarisht), paraqet madhështinë e tij dhe ndikimin e tij të fortë që nuk mund ta mohojë askush. Në të vërtetë namazi është një ndër faktorët më të rëndësishëm në edukimin e njeriut dhe në formimin e personalitetit të tij.

¹ Usulul Kafijj, vëll. 3, f. 270. Uesailu Shia, vëll. 4 f. 8 dhe 29.

² Usulul Kafijj, vëll. 3, f. 270. Uesailu Shia, vëll. 4 f. 8 dhe 29.

³ Tefsiri El Ajashij, vëll. 1, f. 274. Tefsiri Durul Menthur, vëll. 2, f. 215.

Ajeti 104

وَلَا تَهِنُوا فِي ابْتِغَاءِ الْقَوْمِ ۚ إِن تَكُونُوا تَأْلُمُونَ فَإِنَّهُمْ يَأْلُمُونَ كَمَا
تَأْلُمُونَ ۚ وَتَرْجُونَ مِنَ اللَّهِ مَا لَا يَرْجُونَ ۚ وَكَانَ اللَّهُ عَلِيمًا حَكِيمًا ﴿١٠٤﴾

"Mos u tregoni të dobët në ndjekjen e jobesimtarëve! Nëse ndieni dhimbje prej luftës, edhe ata ndiejnë dhimbje ashtu si edhe ju. Mirëpo ju shpresoni prej All'Ilahut atë që ata nuk e shpresojnë. All'Ilahu është i Gjithëditur dhe i Urtë."

Shkaku i zbritjes

Transmetohet nga ibn Abasi dhe komentues të tjerë se Profeti (Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), pas ndodhive të dhimbshme në betejën e Uhudit, u ngjit në malin e Uhudit dhe mbi mal qëndronte Ebu Sufjani i cili iu drejtua Profetit me gjuhën e triumfuesit duke i thënë: "O Muhammed, sot u barazua me ditën e Bedrit!" Me këtë, Ebu Sufjani pati si qëllim se fitorja e tyre në Uhud ka qenë përgjigje për humbjen e tyre në betejën e Bedrit. Profeti u kërkoi myslimanëve që t'i kthejnë përgjigje menjëherë. Ndoshta me këtë Profeti (Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dëshironte që t'i tregonte Ebu Sufjanit se kush është edukuar nën hijen e mesazhit Islam gëzon botëkuptim të plotë. Myslmanët iu përgjigjën Ebu Sufjanit duke i thënë: "Është e largët që të jetë e barabartë gjendja ndërmjet myslimanëve dhe idhujtarëve, sepse

dëshmorët besimtarë janë në Xhennet kurse të vrarët e idhujtarëve janë në zjarr të Xhehennemit."

Ebu Sufjani iu përgjigj me zë të lartë e me krenari: "Për ne është krenaria dhe ju nuk keni krenari." Myslimanët iu përgjigjën: "All'llahu është Kujdestari ynë që ne e adhurojmë dhe ju nuk keni kujdestarë." Kur Ebu Sufjani u bë i pamundur për t'iu përgjigjur këtij slogani Islam u largua nga idhulli i vet "el uz'za" dhe shkoi kah idhulli tjetër "el hubel" duke kërkuar ndërmjetësimin e tij dhe duke thënë: "Hubeli është më i madhi, Hubeli është më i larti." Myslimanët iu përgjigjën me një përgjigje të fortë që ua mësoi Profeti Islam (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!): "All'llahu është më i Madhi dhe më i Madhërishmi."

Pasi e kuptoi Ebu Sufjani se sloganet e tij idhujtare nuk sollën dobi, tha me zë të lartë: "Takimi ynë do të jetë në tokën e Bedrit të vogël."

Myslimanët u kthyen nga fusha e betejës të lodhur nga plagët. Në kohën që ndienja e dhimbjes për ngjarjen e Uhudit i kishte mbuluar mysli-manët, ka zbritur ajeti i mësipërm që i paralajmëron mysli-manët nga pakujdesia ndaj idhujtarëve dhe u kërkon atyre që t'i ndjekin idhujtarët pa lodhje e mundim dhe të mos ndikohen nga ngjarjet e dhimbshme si ajo e Uhudit. Atëherë, në atë gjendje që ishin, mysli-manët u ngritën në ndjekje të armikut. Kur idhujtarët dëgjuan për vendosmërinë e mysli-manëve, shpejtuan largimin nga Medina dhe u kthyen në Mekë.¹

Shkaku i zbritjes së këtij ajeti na mëson se mysli-manët duhet që të jenë të vëmendshëm ndaj taktikave që përdor armiku

¹ Tefsiri Tîbijjan, vëll. 3, f. 314. Tefsiri Mexhmaul Bejjan, vëll. 3, f.180.

dhe të përballen me të gjitha metodat luftarake që ai përdor, qoftë mënyrë luftarake apo psikologjike me anë të metodës islame që është më e fortë dhe më e ashpër sesa metoda e armikut. Të përballen me logjikën e armikut me një logjikë më të fortë dhe më të ashpër, t'u përballen armëve të tyre me një armë më të fortë. Po ashtu edhe sloganet dhe parrullat e armikut duhet të përballohen me sloganet dhe parrullat më të forta, përndryshe erërat do të fryjnë ashtu siç i dëshiron armiku.

Nga kjo kuptojmë se ne myslimanët në vend që të rrimë, të qajmë e të derdhin lot për atë çfarë ka kaluar nga ngjarjet e dhimshme e të hidhura, na del për detyrë që të fillojmë të veprojmë e të punojmë dhe t'i drejtohem armikut me të gjitha fuqitë dhe ta frenojmë atë. T'i drejtohem predikimit të humbur dhe helmues me formën e informacioneve dhe informatikës që ta shkatërrojë atë dhe të përballemi me qendrat e tyre të dëfrimit shfrenues për të ndërtuar qendra dëfrimi të pastra e të rregullta për rininë tonë. Të godasim mendimet dhe sugjerimet e partive, medh'hebeve politike, ekonomike e shoqërore me mendimin Islam të kompletuar dhe me mënyra bashkëkohore që ta kuptojnë të gjithë.

Nëse mundemi që t'i bëjmë ballë armiqëve në këtë formë kemi shpëtuar dhe ruajtur strukturën tonë islame dhe me këtë i paraqesim botës një formë shoqërore, përparimtare e origjinale.

Komentimi

Ky ajet vjen pas ajeteve të mëparshme që flisnin për xhihadin dhe emigrimin, të cilat kishin si qëllim ringjalljen e shpirtit dhe të sakrificës tek myslimanët. Ajeti thotë: **"Mos u tregoni të dobët në ndjekjen e jobesimtarëve!..."**

Dhe ky ajet përforcon dhe vërteton domosdoshmërinë që myslimanët të mos u drejtohen armiqëve të tyre me një mënyrë mbrojtëse, por është detyrim që të ballafaqohen me armikun me shpirtin sulmues e të vazhdueshëm, sepse kjo forma e fundit ka një ndikim mposhtës tek armiqët dhe tek ana e tyre shpirtërore. Këtë gjë myslimanët e provuan në përballjen e tyre me armikun pas ndodhisë së Uhudit, në të cilën ata humbën, duke i detyruar armiqët që të largohen, edhe pse ai shijonte shijen e fitores në Uhud. Kur e mësuan idhujtarët ardhjen e myslimanëve për t'i sulmuar, u frikësuan nga kthimi i tyre për në fushën e betejës dhe shpejtuan të largoheshin nga Medina.

Pas kësaj vjen ajeti me një argument të gjallë e të qartë duke i pyetur myslimanët përse kjo dobësi? Nëse juve ju godet e keqja në fushën e betejës padyshim që do ta godasë edhe armikun tuaj por me një dallim sepse myslimanët shpresojnë në ndihmën e All'llahut dhe se do t'i përfshijë ata mëshira e gjerë e Tij, ndërkohë jobesimtarët nuk e kanë këtë shpresë. Ajeti thotë: **"...Nëse ndieni**

dhimbje prej luftës, edhe ata ndiejnë dhimbje ashtu si edhe ju. Mirëpo ju shpresoni prej All'llahut atë që ata nuk e shpresojnë..."

Në mbyllje, ajeti kërkon prej myslimanëve që të mos e harrojnë dijen e All'llahut për të gjitha çështjet. Ai i di dhimbjet e myslimanëve, problemet, vuajtjet, përpjekjet dhe sakrificat e tyre. Ai e di se nganjëherë i kaplon neglizhenca dhe dobësia. Ajeti thotë: **"...All'llahu është i Gjithëdijshtëm dhe i Urtë."** Dhe do ta shohin myslimanët rezultatin e të gjitha këtyre rasteve.

Ajetet 105-106

إِنَّا أَنْزَلْنَاهُ إِلَيْكَ بِالْحَقِّ لَتَحْكُمَ بَيْنَ النَّاسِ بِمَا أَرَاكَ اللَّهُ ۚ وَلَا
تَكُنْ لِلْخَائِبِينَ خَصِيمًا ﴿١٠٥﴾ وَأَسْتَغْفِرِ اللَّهَ ۖ إِنَّ اللَّهَ كَانَ غَفُورًا
رَحِيمًا ﴿١٠٦﴾

"Vërtet, Ne (o Muhammed) ta kemi zbritur Kur'anin me të drejtën, në mënyrë që ti të gjykosh ndërmjet njerëzve sipas asaj që të ka shpallur All'Ilahu. Dhe mos u bëj mbrojtës i mashtruesve!"

"Kërko falje prej All'Ilahut! Se All'Ilahu është Falës e Mëshirëplotë."

Shkaku i zbritjes

Kanë transmetuar një ngjarje të detajuar për shkaku e zbritjes së këtyre dy ajeteve. Përmbledhja e saj është se në fisin e njohur Beni el Ibijrk kanë qenë tre vëllezër: "Bishr", "Beshir" dhe "Mubeshir". Beshiri hyri në shtëpinë e një myslimani të quajtur "Refeatu" dhe i vodhi shpatën, mburojën dhe një sasi ushqimesh. Djali i vëllait të tij, i cili ishte prej luftëtarëve të Bedrit dhe quhej "Kadate" e lajmëroi Profetin (Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) për këtë ndodhi.

Mirëpo tre vëllezërit akuzuan një person prej myslimanëve që quhej "Lubejd", i cili banonte në një shtëpi me ata. Lubejdi u

lëndua shumë nga kjo akuzë e pabazë. Ai mori shpatën e tij dhe shkoi tek tre vëllezërit dhe u tha me zë të lartë: "A po më akuzoni mua për vjedhje ndërkohë që ju jeni të njohur për këtë vepër? Ju jeni ata hipokritë të cilët i jeni drejtuar Profetit dhe kurejshitëve me fjalë dhe me vjersha thumbuese. Ose argumentojeni atë që më mvishni mua ose au preva kokat me shpatën time."

Kur vëllezërit e hajdutit panë këtë skenë u munduan ta qetësojnë Lubejdin. Por kur ata e morën vesh se çështja ka arritur te Profeti nëpërmjet Katades u strehuan tek një orator i fisit të tyre dhe i kërkuan atij që të shkojë së bashku me një grup njerëzish tek Profeti që të shtiren sikur e drejta është në anën e tyre me qëllim që të shfajësonin hajdutin dhe të akuzohet Kadate se po shpif akuzë për vëllanë e tyre. Bazuar në domosdoshmërinë e të vepruarit me aparencën, Profeti e pranoi dëshminë e atij grupi dhe e qortoi Kadaten për këtë veprim.

Kadate, i cili e njihte veten e tij të pafajshëm, u zemërua për këtë ndodhi dhe u kthye tek xhaxhai i tij dhe i tregoi për ngjarjen duke i shprehur keqardhjen e tij për atë që ka ndodhur. Xhaxhai i tij ia lehtësoi gjendjen duke i thënë: "Mos u shqetëso o Katade se me të vërtetë All'Ilahu do të na ndihmojë."

Atëherë zbritën dy ajetet e lartpërmendura që lajmërojnë për pafajsinë e këtij personi dhe i qortojnë mashtruesit e vërtetë.¹

Gjithashtu kanë transmetuar një ndodhi tjetër për shkakun e zbritjes së këtyre dy ajeteve e cila është: Një mburojë e njërit prej ensarëve ishte vjedhur në një ndër lufrat dhe dyshimi vërtitej rreth një personi nga fisi "Ibijk".

Kur hajduti e mori vesh se dyshimi sillej rreth tij, e hodhi mburojën në oborrin e një jehudiu dhe kërkoi nga fisi që të

¹ Tefsiri Mexhmaul Bejan, vëll. 3, f. 181-182.

dëshmonin para Profetit se është i pafajshëm duke e argumentuar këtë pafajsi me praninë e mburojës në oborrin e jehudiut. Kur Profeti e shikoi çështjen në këtë formë, e shfajësoi hajdutin, sipas aparencës së dëshmisë që ishte në favor të tij dhe u gjykua burri jehudit për këtë vjedhje. Atëherë zbritën këto dy ajete për të sqaruar këtë të vërtetë.¹

Komentimi

Ndalimi i mbrojtjes së mashtruesve

Në fillim të ajetit 105 të sures "Nisa", All'Ilahu i Lartësuar e mëson të Dërguarin e Tij, Muhammedin (Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) se qëllimi i zbritjes së Kur'anit është realizimi i parimeve të drejta e të vërteta në mesin e njerëzve. Ajeti thotë: **"Vërtet, Ne (o Muhammed) ta kemi zbritur Kur'anin me të drejtën, në mënyrë që ti të gjykosh ndërmjet njerëzve sipas asaj që të ka shpallur All'Ilahu..."**

Pastaj e paralajmëron Profetin (Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) për mbrojtjen e mashtruesve duke i thënë: **"...Dhe mos u bëj mbrojtës i mashtruesve!"**

Edhe pse ajeti i drejtohet Profetit Muhammed (Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), nuk ka dyshim se ky rregull është rregull i përgjithshëm për të gjithë gjykatësit. Kjo thënie që i drejtohet Profetit nuk ka kuptimin se Profeti është i nxituar në shembullin e këtyre veprave. Rregulli i lartpërmendur i përfshin të gjithë individët.

¹ Tefsiri Mexhmaul Bejan, vëll. 3, f. 181-182.

Ndërsa ajeti tjetër e urdhëron Profetin që t'i kërkojë falje All'llahut të Lartësuar. Ai thotë: **"Kërko falje prej All'llahut! Se All'llahu është Falës e Mëshirëplotë."**

Rreth shkakut të kërimit të faljes në këtë ajet ka mendime të ndryshme.

E para: Me të vërtetë, kërkimi i faljes është për të lënë në fillim atë çfarë ka ndodhur për shkak të përshpejtimit dhe nxitimit në gjykim dhe si rrjedhojë e këtij gjykimi kanë zbritur këta dy ajete. Pra, edhe pse ajo mënyrë pohimi dhe dëshmia e dy palëve ishin të mjaftueshme për Profetin për dhënien e vendimit, sërish do të ishte më mirë që të bëhej verifikim më shumë për këtë çështje.

E dyta: Profeti Muhammed (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) e ka gjykuar këtë çështje sipas ligjeve islame. Meqenëse argumentet që sollën mashtruesit kanë qenë të forta, ai u dha të drejtë atyre. Por pasi u zbulua e vërteta dhe e drejta i shkoi të zotit, erdhi urdhri për t'i kërkuar falje All'llahut të Lartësuar, jo për gjynahun e bërë, por për përballjen e së drejtës së myslimanit në rrezik për shkak të mashtrimit të disa personave. Pra, është kërkimi i faljes, sipas terminologjisë, për shkak të gjykimit të vërtetë dhe jo për shkak të gjykimit në dukje. Disa kanë supozuar që kërkimi i faljes të bëhet nga të dyja palët ankuese. Në hadithin e trasmetuar nga Profeti Muhammed (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), ai ka thënë: *"Me të vërtetë, unë jam njeri dhe ju vini të gjykoheni tek unë. Ndoshta disa prej jush kanë argument më të fortë se tjetri dhe unë gjykoj sipas asaj që dëgjoj. Nëse unë gjykoj me të*

*drejtën e vëllait të vet diçka, mos t'ia marrë atë, se me të vëtetë atij i heq një pjesë prej zjarrit."*¹

Nga ky hadith na qartësohet se Profeti është i detyruar që të gjykojë sipas paraqitjes së çështjes dhe duke u mbështetur në argumentet e dy palëve. Është e natyrshme se në këtë rast e drejta i shkon poseduesit të saj. Nganjëherë ndodh që paraqitja e argumentit dhe dëshmia e dëshmitarëve të mos përputhen më të vërtetën. Atëherë këtu duhet patur kujdes që gjykimi i gjykatësit të mos ndryshojë asgjë nga e vërteta dhe të mos bëhet e vërteta e pavërtetë dhe e pavërteta e vërtetë.

¹ Tefsir El Menar, vëll. 5, f. 394, i transmetuar nga Buhariu vëll. 8, f. 112.

Ajetet 107 - 109

وَلَا تُجَادِلْ عَنِ الَّذِينَ يَخْتَانُونَ أَنْفُسَهُمْ ۚ إِنَّ اللَّهَ لَا يُحِبُّ مَن كَانَ
 خَوَّانًا أَثِيمًا ﴿١٠٧﴾ يَسْتَخْفُونَ مِنَ النَّاسِ وَلَا يَسْتَخْفُونَ مِنَ اللَّهِ وَهُوَ
 مَعَهُمْ إِذْ يُبَيِّتُونَ مَا لَا يَرْضَىٰ مِنَ الْقَوْلِ ۚ وَكَانَ اللَّهُ بِمَا يَعْمَلُونَ مُحِيطًا
 ﴿١٠٨﴾ هَآأَنْتُمْ هَآؤَآءِ جَدَلْتُمْ عَنْهُمْ فِي الْحَيَوةِ الدُّنْيَا فَمَنْ يُجَادِلُ اللَّهَ
 عَنْهُمْ يَوْمَ الْقِيَمَةِ أَمْ مَن يَكُونُ عَلَيْهِمْ وَكِيلًا ﴿١٠٩﴾

"Dhe mos i mbro ata që mashtrojnë vetveten! Se All'Ilahu nuk i do mashtruesit dhe gjynahqarët."

"Ata fshihen nga njerëzit, por nuk fshihen dot nga All'Ilahu. Ai është pranë tyre edhe natën, kur trillojnë gjëra me të cilat Ai nuk është i kënaqur. Se All'Ilahu përfshin (me dijen e Tij) gjithçka që ata bëjnë."

"Ja, ju i mbrojtët ata në këtë botë, por kush do t'i mbrojë tek All'Ilahu në Ditën e Kiametit ose kush do të bëhet përfaqësues i tyre?"

Komentimi

Pas ajeteve që kanë ardhur për ndalimin e mbrojtjes së mashtruesve, këto tre ajete paraqesin rreptësinë e ndalimit të mbrojtjes së mashtruesve, veçanërisht atyre që mashtrojnë vetet e tyre.

Këtu duhet patur vëmendja se ajeti: **"Dhe mos i mbro ata që mashtrojnë vetveten! Se All'illahu nuk i do mashtruesit dhe gjynahqarët."** tregon për ata që e mashtrojnë veten e tyre, ndërsa ajo që mësuam nga shkaku i zbritjes së ajeteve të mëparshme është se ato zbritën për ata që mashtrojnë të tjerët. Kjo tregon për kuptimin për të cilin tërheq vëmendjen Kur'ani në disa ajete, që është se çdo punë që bën njeriu, ai ndikohet nga rezultati i saj, qoftë ajo vepër e mirë apo e keqe, siç thuhet në ajetin 7 të sures "El Isra": **"Nëse bëni mirësi, e keni bërë për veten tuaj. E, nëse bëni keq, ia keni bërë po vetes."**

Ka mundësi që ajeti i përmendur të tregojë për një temë tjetër, të cilin e përforcon Kur'ani dhe ajo është se të gjithë njerëzit së bashku janë si një trup i vetëm. Nëse dikush i bën keq tjetrit është sikurse i ka bërë keq vetvetes. Pra, është njësoj si ai që i bën keq vetes së tij me veten e tij.

Në ajet gjendet edhe një çështje tjetër që është se ajeti nuk është i veçantë për ata të cilët tradhtojnë veten e tyre njëherë e pastaj pendohen për atë çfarë kanë bërë, ku nuk është nevoja që të përdoret ashpërsia ndaj tyre, por ata kanë nevojë për më shumë zemërbutësi. Ashpërsia duhet të përdoret tek ata të cilët e perfeksionojnë mashtrimin dhe ai bëhet pjesë e jetës së tyre.

Argument për këtë është fjala e ardhur në këtë ajet

"jekhtanune" (mashtrojnë), e cila është folje e kohës së tashme që tregon vazhdimësi. Përveç kësaj, është edhe argumenti tjetër që kuptohet nga fjala "khauan", që do të thotë shumë mashtrues dhe nga fjala "ethijm", që kuptohet ai që bën shumë gjynahe. Fjala e fundit "ethijm", ka ardhur për të përforcuar fjalën "khauan" (tradhëtar), që është në këtë ajet, sikurse ka ardhur fjala "khainun" në ajetin e mëparshëm në formën e vepruesit, i cili ka një kuptim cilësues që tregon përsëritjen e veprimit.

Në ajetin tjetër, mashtruesit përballen me qortimin. Ajeti thotë se ata turpërohen para njerëzve, nëse u shfaqet brendia e veprave dhe e sekreteve të tyre. Mirëpo ata nuk kanë turp përpara All'Ilahut të Lartësuar. Ajeti thotë: **"Ata fshihen nga njerëzit, por nuk fshihen dot nga All'Ilahu..."** Ata nuk frikësohen kur planifikojnë planet mashtruese në errësirën e natës dhe bisedojnë për ato që All'Ilahu nuk është i kënaqur, i Cili i sheh ata dhe mbikëqyr veprat e tyre kudo që të jenë. Ajeti vazhdon e thotë: **"...Ai është pranë tyre edhe natën, kur trillojnë gjëra me të cilat Ai nuk është i kënaqur. Se All'Ilahu përfshin (me dijen e Tij) gjithçka që ata bëjnë."**

Pas kësaj, ajeti 109 i ajeteve në fjalë flet për një person hajdut, të cilin e mbrojtën duke thënë: "Po supozojmë që këta lloj personash u mbrojtën në këtë botë, por kush do t'i mbrojë ata në Ditën e Gjykimit dhe kush e merr përsipër që të jetë avokati i tyre që t'ua ndreqë punët dhe gjendjet?!" All'Ilahu i Lartësuar thotë: **"Ja, ju i mbrojtët ata në këtë botë, por kush do t'i mbrojë tek All'Ilahu në Ditën e Kiametit ose kush do të bëhet përfaqësues i tyre?"**

Pa dyshim që mbrojtja e atyre mashtruesve në këtë botë ka pak ndikim, sepse ata nuk do të gjejnë askënd që t'i mbrojë ata përpara All'llahut në Botën Tjetër të përhershme.

E vërteta është se tre ajetet e fundit, në fillim, mbartin udhëzime për çdo gjykatës i cili dëshiron të gjykojë me drejtësi që të kenë kujdes dhe të mos i shkelin të drejtat e të tjerëve nëpërmjet mjeteve falso dhe dëshmitarëve të rremë.

Pas kësaj, ajeti i paralajmëron mashtruesit dhe mbrojtësit e tyre se fundi i punëve të këqija do të jetë ndëshkimi si në këtë jetë, ashtu edhe në Jetën Tjetër.

Në këto ajete ka të fshehta prej të fshehtave të retorikës së Kur'anit që kanë përfshirë të gjitha anët e kësaj çështjeje dhe kanë paraqitur udhëzimet dhe vërejtjet e domosdoshme në çdo aspekt, edhe pse çështja duket e vogël në pamje të jashtme. Ajo flet për një mburojë të vjedhur, për produkte ushqimore dhe për një jehudi nga armiqtë e Islamit.

Ajeti, gjithashtu, trajton çështjen e Profetit (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), i cili është njeri i ruajtur nga mëkatet (ma'sumun). Po ashtu, tregon për ata persona të cilët e kanë profesion mashtrimin dhe për ata të cilët i mbrojnë mashtruesit bazuar në racizmin dhe në lidhje fisnore.

Ajetet 110 - 112

وَمَنْ يَعْمَلْ سُوءًا أَوْ يَظْلِمْ نَفْسَهُ ثُمَّ يَسْتَغْفِرِ اللَّهَ يَجِدِ اللَّهَ غَفُورًا
 رَحِيمًا ﴿١١٠﴾ وَمَنْ يَكْسِبْ إِثْمًا فَإِنَّمَا يَكْسِبُهُ عَلَى نَفْسِهِ ۚ وَكَانَ اللَّهُ
 عَلِيمًا حَكِيمًا ﴿١١١﴾ وَمَنْ يَكْسِبْ خَطِيئَةً أَوْ إِثْمًا ثُمَّ يَرْمِ بِهِ بَرِيئًا فَقَدِ
 احْتَمَلَ بُهْتَانًا وَإِثْمًا مُّبِينًا ﴿١١٢﴾

"Kush punon vepër të keqe ose i bën padrejtësi vetes së vet, pastaj i kërkon falje All'llahut, do të gjejë se All'llahu është Falës e Mëshirëplotë."

"Kush bën gjynah, ai ia ka bërë shpirtit të vet. All'llahu është i Gjithëditur dhe i Urtë."

"Kush bën ndonjë gjynah ose të keqe, pastaj ia vesh atë një të pafajshmi, atëherë ai e ka ngarkuar veten me fajin e shpifjes dhe me një gjynah të qartë."

Komentimi

Këto tre ajete sqarojnë tre rregulla të përgjithshme, pasi ajetet e mëparshme folën për çështjen e veçantë të tradhëtisë dhe të akuzës.

1- Ajeti i parë (110), i këtyre tre ajeteve, fillimisht tregon një të vërtetë, se dera e pendimit është e hapur përpara gjynahqarëve në çdo rast. Nëse dikush i ka bërë padrejtësi vetes apo të tjerëve dhe është penduar sinqerisht për veprimin e tij dhe i kërkon falje All'Ilahut të Lartësuar për mëkatën e tij, do ta gjejë All'Ilahun e Lartësuar Falës e Mëshirues. Ajeti thotë: "Kush punon vepër të keqe ose i bën padrejtësi vetes së vet, pastaj i kërkon falje All'Ilahut, do të gjejë se All'Ilahu është Falës e Mëshirëplotë.**"**

2- Duhet patur parasysh se ajeti i parë tregon dy lloje mëkatesh, ku në të gjendet fjala "suun", që do të thotë e keqe dhe fjala "dhulm" që do të thotë padrejtësi ndaj vetvetes. Duke parë argumentin e fjalës "suun", e cila këtu ka kuptimin e dëmit ndaj tjetrit, nga ajeti kuptohet se çdo lloj gjynahu, qoftë prej llojit dëmtues ndaj të tjerëve apo dëmtues për veten, mund të falen nëse vepruesi i tyre pendohet me pendim të vërtetë e të sinqertë dhe përpiqet për t'i shlyer mëkatet. Gjithashtu, nga shprehja kur'anore: "...do të gjejë se All'Ilahu është Falës e Mëshirëplotë**", kuptohet se pendimi i vërtetë ka ndikim dhe personi pendues e gjen rezultatin e tij në brendinë e tij. Nga njëra anë, qortimi i ndërjegjes që e bën vepruesi i mëkatit largohet prej tij duke parë faljen që fiton nga All'Ilahu Falës. Nga ana tjetër, njeriu pendues**

ndien afrim tek All'Ilahu i Lartësuar për arsye të mëshirës së All'Ilahut.

3- Ajeti i dytë nga këto tre ajete, tregon po të njëjtën të vërtetë, e cila ka ardhur në formë përmbledhëse në ajetet e mëparshme, ku dëshmon dhe përforcon se çdo gjynah apo mëkat që bën njeriu, do të jetë në të keq të vetes së tij me atë gjynah që vepron. Ajeti thotë: **"Kush bën gjynah, ai ia ka bërë shpirtit të vet.."**

Në fund, ajeti dëshmon dhe tregon se All'Ilahu i Lartësuar është i Gjithëditur për veprat e robve të Vet dhe është i Urtë ku çdo njeri e shpërblen për atë që meriton: **"...All'Ilahu është i Gjithëditur dhe i Urtë."**

Me një përmendje kalimtare themi se dëmet e mëkateve, sado që të ndryshojnë, ka raste që nganjëherë ndjekin tjetrin dhe herën tjetër ndjekin vetë vepruesin. Por me një analizë përfundimtare, me të vërtetë gjynahu, në fund, i kthehet vetë gjyhnahqarit. Shenjat e këqija të gjynahut, në radhë të parë, shfaqen në shpirtin e vetë personit gjynahqar.

4- Ajeti i fundit i këtyre tre ajeteve tregon rrezikun e të akuzuarit të njerëzve të pafajshëm. Ai thotë: **"Kush bën ndonjë gjynah ose të keqe, pastaj ia vesh atë një të pafajshmi, atëherë ai e ka ngarkuar veten me fajin e shpifjes dhe me një gjynah të qartë."** Ky ajet e ka ndarë gjynahin, që e bën personi dhe ia atribuon (mvesh) një tjetri, në dy lloje: -të parin e ka quajtur "khatijeh" (gabim apo gjynah) dhe të dytin "ithm" (mëkat).

Shumë komentues kanë thënë se ka ndryshim mes këtyre dy lloje mëkatesh. Thënia më e afërt në mendje është se "khatietu" rrjedh nga fjala "hutaun", e cila ka kuptimin e gjynahut që bëhet

pa qëllim nga vepruesi. Nganjëherë këtë gjynah e përfshin shpagimi dhe gjoba. Mirëpo, gradualisht kuptimi i fjalës "khatietun" është zgjeruar dhe ka përfshirë çdo gjynah, me qëllim apo pa qëllim. Kur njeriu bën një gjynah, me ose pa qëllim, kjo nuk përputhet me pozitën e njeriut.

Rezultati i kësaj fjale është se gabimi ka kuptim të gjerë, që përfshin gabimin me qëllim apo pa qëllim. Ndërsa fjala "ithm" (mëkat), përdoret zakonisht për gabimet që bëhen me qëllim, që do të thotë se është diçka që nuk e pengon njeriun që të bëjë një vepër të caktuar. Është me vend të tregojmë se ajeti ka përdorur hipërbolën e bukur për akuzën duke e konsideruar gjynahun në këtë fushë si shigjetë dhe e ka bërë atribuimin e tij një tjetri si gjuajtje e shigjetës në goditjen e qëllimit.

Kjo tregon se përderisa goditja me shigjetë e ekzekuton njeriun, atëherë edhe t'i mvëshësh një njeriu të pafajshëm një gjynah që nuk e ka bërë, është njësoj si shigjeta e cila shkatërron dinjitetin e tij dhe dinjiteti i njeriut është si t'ia derdhësh gjakun e tij.

Është e natyrshme se shpifja dhe ndëshkimi i kësaj vepre përherë mbetet mbi shpatullat e personit i cili shpif dhe akuzon të tjerët. Fjala "ihtemele" e përmendur në këtë ajet do të thotë mbajtje mbi shpatulla. Kjo fjalë ka ardhur për të argumentuar barrën dhe rëndesën e kësaj përgjegjësie.

Hulumtime

Krimi i shpifjes

Me të vërtetë, akuzimi i një njeriu të pafajshëm konsiderohet në veprat nga më të shëmtuara, të cilën Islami e dënon shumë ashpër.

Ajeti i fundit, nga këto tre ajete, që ka ardhur për këtë çështje dhe transmetimet e tjera islame e qartësojnë mendimin e Islamit për këtë vepër.

Imam Xhafer ibn Muhammed Sadik (Paqja qoftë mbi të!) ka përcjellë nga një i urtë i cili ka thënë: "*Vërtet, shpifja ndaj një njeriu të pafajshëm është më e rëndë se malet e palëkundur.*"¹

Dhe: "*Nëse besimtari shpif për vëllain e vet, atij i shkrihet besimi në zemrën e tij sikurse shkrihet kripa në ujë*" pra, besimi shkrihet, tretet dhe ikën nga zemra e besimtarit për shkak të akuzimit dhe të shpifjes ndaj vëllait të tij besimtar, ashtu siç tretet kripa në ujë dhe humbet nga shikimi.²

Akuzimi dhe shpifja, në të vërtetë, janë ndër llojet më të shëmtuara të mëkatit, sepse përveçse përmbajnë të këqijat e gënjeshtërs, po ashtu, përmbajnë edhe dëmin e përgojimit, të cilat janë prej llojeve më të këqija të padrejtësisë. Për këtë shkak, Profeti ka thënë: "*Ai që shpif për besimtarin dhe për besimtare dhe thotë për ata gjëra që nuk i kanë, All'Ilahu do t'i ringjallë në Ditën e Gjykimit mbi*

¹ Biharul Enuar, vëll. 72, f. 194. Sefijnetul Bihar, vëll. 1, f. 111.

² Usulul Kafij, vëll. 12, f. 361. Uesailu Shia, vëll. 2, f. 302.

një kodër me zjarr dhe do të qëndrojnë aty derisa të dalin prej tij ato që kanë thënë."¹

E vërteta e kësaj çështjeje është se përhapja e kësaj vepre të frikshme në mesin e njerëzve çon në shkatërrimin e sistemit të drejtësisë shoqërore, në përzierjen e të vërtetës me të pavërtetën, në quajtjen e të pafajshmit gjynahqar, në quajtjen e gjynahqarit të pafajshëm dhe në zhdukjen e mirëbesimit në mesin e njerëzve.

¹ Sefijnetul Bihar, vëll. 1, f. 111. Tefsir Kurtubij, vëll. 12, f. 29.

Ajeti 113

وَلَوْلَا فَضْلُ اللَّهِ عَلَيْكَ وَرَحْمَتُهُ لَهَمَّتْ طَائِفَةٌ مِّنْهُمْ أَنْ يُضِلُّوكَ وَمَا يُضِلُّونَ إِلَّا أَنْفُسَهُمْ ۖ وَمَا يَضُرُّونَكَ مِنْ شَيْءٍ ۚ وَأَنْزَلَ اللَّهُ عَلَيْكَ الْكِتَابَ وَالْحِكْمَةَ وَعَلَّمَكَ مَا لَمْ تَكُن تَعْلَمُ ۚ وَكَانَ فَضْلُ اللَّهِ عَلَيْكَ

عَظِيمًا ﴿١١٣﴾

"Sikur të mos e kishe mirësinë e All'Ilahut dhe mëshirën e Tij, një grup i atyre do të përpiquej që të të nxirrte nga udha e drejtë. Ata me këtë e humbin vetëm vetveten, kurse ty nuk të bëjnë kurrfarë dëmi. All'Ilahu të shpalli ty Librin (Kur'anin) dhe Urtësinë e plotë, si dhe të mësoi atë që nuk e ke ditur. Dhuntia e All'Ilahut për ty është shumë e madhe."

Komentimi

Ky ajet tregon për një ndodhi tjetër të fisit Beni el Ibijrk, për të cilin folëm kur përmendëm shkakun e zbritjes së ajeteve të mëparshme. Kjo dëshmon dhe përforcon se All'Ilahu i Lartësuar, me mirësinë dhe mëshirën e Tij e ka ruajtur të Dërguarin e Vet nga intrigat dhe komplotet që thurnin hipokritët ndaj tij për ta devijuar atë nga rruga e drejtë. Mëshira e All'Ilahut ka qenë më

afër Profetit dhe e ka ruajtur nga intrigat e tyre. Ajeti thotë: "**Sikur të mos e kishe mirësinë e All'llahut dhe mëshirën e Tij, një grup i atyre do të përpiquej që të të nxirrte nga udha e drejtë...**"

Hipokritët, me anë të akuzimit dhe të përfshirjes së Profetit Muhammed (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) në këtë ndodhi, në fillim, synonin goditjen e personalitetit të Profetit, si në anën shoqërore, ashtu edhe në atë shpirtërore dhe së dyti donin të realizonin dëshirat e tyre të ulta duke nëpërkëmbur të drejtat e njeriut të pafajshëm mysliman. All'llahu i Plotfuqishëm dhe i Gjithëditur i mbikëqyrte ata. Ai e ruajti Profetin e Vet nga ai komplot. Ai e shkatërroi planin dhe veprën e hipokritëve.

Disa komentues kanë përmendur një shkak tjetër për zbritjen e këtij ajeti dhe ai është se një grup nga fisi "Beni Thekijf" shkuan tek Profeti Muhammed (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe i thanë se ishin të gatshëm t'i jepnin besën me dy kushte:

I pari: T'i detyronte personat e këtij fisi për thyerjen e idhujve të tyre me duart e veta.

I dyti: T'i lejonte ata të vazhdonin adhurimin e idhullit të tyre (el Uz-za) vetëm për një vit. Atëherë, zbriti urdhri i All'llahut për Profetin (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) që të mos shfaqte asnjë lakueshmëri përpara atyre. Ky ajet zbriti që të lajmëronte se mirësia dhe mëshira e

All'lahut e përfshinë Profetin dhe e ruajtën atë nga intrigat dhe cytjet e tyre.¹

Pas kësaj, ky ajet tregon se ai popull e hedh veten në humbje dhe nuk i bën asnjë të keqe Profetit me veprat e tij. Ai thotë: **"...Ata me këtë e humbin vetëm vetveten, kurse ty nuk të bëjnë kurrfarë dëmi..."**

Në fund, ajeti tregon shkakun e ruajtjes së Profetit (Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) nga gjynahu. Ai përmend se All'lahu i ka zbritur Profetit Librin dhe Urtësinë dhe i mësoi atij ato gjëra që ai nuk i ka ditur më parë: **"...All'lahu të shpalli ty Librin (Kur'anin) dhe Urtësinë e plotë, si dhe të mësoi atë që nuk e ke ditur...."** Në fund ajeti thotë: **"...Dhuntia e All'lahut për ty është shumë e madhe."**

Hulumtime

Burimi i pagabueshmërisë (ismetu) së Profetëve

Ky është ajeti i fundit, nga ajetet e tjera që tregojnë për mbrojtjen e Profetit nga gjynahet. Ai thotë se ndihma All'lahut, e cila e ka përfshirë Profetin, është ajo që e ruan atë nga gabimet dhe humbja, të cilën ia uronin hipokritët, por falë kësaj ndihme të All'lahut, ata u bënë të paafte për t'i realizuar intrigat e tyre dhe Profetin nuk e preku asnjë e keqe nga kompleti i tyre.

Po kështu, All'lahu e ka ruajtur dhe e ka mbrojtur Profetin e Tij nga çdo gabim, harresë apo gjynah që Profeti të bëhej

¹ Tefsiri *Mexmaul Bejan*, vëll. 3, f. 188.

shembull i mirë për ymetin islam dhe udhëzues i tij për të bërë vepra të mira e të dobishme. Atë e ka ruajtur All'llahu i Gjithpushtetshëm nga kryerja e çdo gabimi që mund të bëjë cilido udhëheqës. Gjithashtu, Ai e ka mbrojtur që të largojë ymetin islam nga çdo mëdyshje rreth çështjes së bindjes së të Dërguarit të All'llahut. Vërtet, All'llahu e ka mbrojtur Profetin e Tij, Muhammedin (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) nga çdo gabim që të garantojë besimin e plotë të myslimanëve për të dhe ky besim të konsiderohet nga kushtet parësore të udhëheqjes së Zotit.

Në fund të këtij ajeti vjen në një formë përmbledhëse një prej argumenteve kryesorë për çështjen e ruajtjes së Profetit. Ky argument është fjala e All'llahut të Lartësuar. Ai i mësoi Profetit të Tij dijet dhe njohuritë nën hijen e të cilave Profeti të jetë i ruajtur për të rënë në çdo gabim apo gjynah, sepse rezultati përfundimtar i dijes dhe i njohjes është ruajtja e njeriut nga gjynahet.

Për shembull, doktori, pasi ka bërë analizat e ujit dhe ka zbuluar se ai është i ndotur me mikrobe të rrezikshme, kurrë nuk e pi atë ujë.

Nga shembulli arrijmë në përfundimin se shkenca e mjekësisë, të cilën e mësoi ky doktor, është shkak për ruajtjen e doktorit dhe për ndalimin e pirjes së ujit të ndotur me mikrobe vrasëse.

Kjo dituri i siguroi mbrojtje doktorit që të mos bënte ndonjë gabim. Mirëpo, ai njeri, i cili e injoron rrezikun nga ky ujë, ka mundësi që ta pijë atë.

Nga këtu vërehet se burimi i çdo gabimi është padituria rreth fazave fillestare të veprimit dhe përfundimi i atij veprimi. Për këtë, kush e njeh mesazhin e Zotit dhe çështjet e ndryshme i bazon tek ai, nuk bie në gabim, nuk bën asnjë gjynah dhe nuk e humb rrugën.

Dije që ka Profeti është nga ana e All'llahut të Lartësuar. Kjo do të thotë se Profeti nuk është i imponuar që të punojë sipas dijes së tij, por ai e praktikon veprën e tij me vetëdije të plotë.

Pyetje: Nëse dikush pyet se përse All'llahu ka përfshirë me këtë dhunti vetëm Profetin e Tij dhe nuk ka të tjerë?

Përgjigja: Me të vërtetë, kjo tregon përgjegjësinë e madhe e të rrezikshme që ka udhëheqja që i është dhënë Profetit dhe se mbajtja e saj është një barrë e rëndë mbi supet e tij, kurse të tjerët nuk e kanë këtë barrë të rëndë. Për këtë, All'llahu është i Butë dhe i Mirinformuar për t'i dhuruar robit të Vet forcë dhe mundësi për aq përgjegjësi që i është vendosur këtij rob mbi supet e tij. All'llahu nuk e detyron atë mbi mundësitë dhe fuqitë e tij, prandaj duhet thellim rreth kësaj çështjeje.

Ajeti 114

﴿ لَا خَيْرَ فِي كَثِيرٍ مِّنْ نَّجْوَاهُمْ إِلَّا مَنْ أَمَرَ بِصَدَقَةٍ أَوْ مَعْرُوفٍ أَوْ إِصْلَاحٍ بَيْنَ النَّاسِ ۚ وَمَن يَفْعَلْ ذَلِكَ ابْتِغَاءَ مَرْضَاتِ اللَّهِ فَسَوْفَ نُؤْتِيهِ أَجْرًا عَظِيمًا ۝۱۱۴﴾

"S'ka kurrëfarë të mire në shumë prej bisedave të tyre të fshehta, përveç rastit kur ndokush kërkon që të jepet sadaka ose të kryhet një vepër e mirë apo paqësim ndërmjet njerëzve. Atij që e bën këtë për të fituar kënaqësinë e All'lahut, Ne do t'i japim një shpërblim të madh."

Komentimi

Biseda e fshehtë dhe pëshpëritja

Ajetet e mëparshme treguan për tubimet e fshehta djallëzore që organizonin disa hipokritë apo të ngjashëm me ta. Ky ajet e shpjegon këtë çështje në mënyrë më të detajuar. Fjala "nexhua" nuk do të thotë vetëm pëshpëritje në bisedë, por përdoret për çdo tubim të fshehtë, sepse ajo rrjedh nga rrënja e

fjalës "nexhuehe" që do të thotë tokë e lartë. Meqenëse toka e lartë është si e veçuar nga tokat e tjera rreth saj, edhe tubimet e fshehta dhe pëshpëritjet kryhen veçmas nga njerëzit përreth. Për këtë është quajtur "nexhua".

Disa thonë se fjala "nexhua" rrjedh nga fjala "nexhat", që do të thotë lirim. Pra, pjesa e lartë është e shpëtuar nga rreziku i erozionit dhe përmytja. Kështu edhe tubimet e fshehta apo pëshpëritjet janë më të sigurta nga njohja e të tjerëve.

Ajeti përmend se në përgjithësi, këto tubime të fshehta, kanë qëllime djallëzore e të këqija, janë të padobishme dhe nuk përmbajnë asnjë mirësi. Ajeti thotë: **"S'ka kurrëfarë të mirë në shumë prej bisedave të tyre të fshehta..."**

Ky ajet ka sjellë shembuj si premisa për të qartësuar një rregull të përgjithshëm, që të mos hamendësohet se çdo bisedë, përshtpëritje apo tubim i fshehtë, është një vepër e keqe dhe e ndaluar. Ai ka sqaruar rastet se kur lejohet biseda e fshehtë, siç është rasti kur një njeri porosit një tjetër për të dhënë lëmoshë, për të ndihmuar të tjerët, për të kryer një punë të dobishme apo për të pajtuar mes njerëzve. Ajeti thotë **"...përveç rastit kur ndokush kërkon që të jepet sadaka ose të kryhet një vepër e mirë apo paqësim ndërmjet njerëzve..."**

Nëse kjo bisedë apo ky tubim i fshehtë nuk ka brenda hipokrizi, por është për të arritur kënaqësinë e All'Ilahut, atëherë, All'Ilahu për këto vepra do të ketë një shpërblim të veçantë dhe të madh, ku thotë: **"...Atij që e bën këtë për të fituar kënaqësinë e All'Ilahut, Ne do t'i japim një shpërblim të madh."**

Kur'ani thotë se bisedat dhe tubimet e fshehta, në parim, janë vepër e shejtanit, siç thotë në ajetin 10 të sures "El Muxhadele": **"Intrigat e fshehta vijnë vetëm nga djalli."** Shkaku është se këto vepra në përgjithësi kryhen për qëllime të këqija, sepse vepra e mirë dhe e dobishme, zakonisht, nuk ka nevojë që të mbesë e fshehtë nga njerëzit. Për këtë nuk është nevoja që për të tilla vepra të bisedohet fshehur apo të mbahen tubime të fshehta.

Ka raste kur këto situata të veçanta e detyrojnë njeriun në përfitimin nga mënyra e bisedës së fshehtë në vepra të mira. Ky përjashtim është përsëritur disa herë në Kur'an, siç lexojmë në ajetin 9 të sures "El Muxhadele": **"O ju që keni besuar! Kur të bisedoni fshehtas mes jush, mos flisni për gjynahe, armiqësi dhe mosbindje ndaj të Dërguarit të All'Ilahut, por bisedoni për mirësi dhe drejtësi."**

Ka raste që mendohet për keq edhe për një bisedë apo tubim të fshehtë që bëhet mes shokëve dhe miqve. Bazuar në këtë, është më mirë që njeriu të mos ndërmarrë asnjë hap për biseda apo tubime të fshehta, vetëm nëse e kërkon domosdoshmëria. Kjo është filozofia e këtij rregulli të përmendur në Kur'an.

Është e natyrshme se reputacioni i njeriut nganjëherë e detyron që të ndjekë rrugën e bisedimit të fshehtë. Prej atyre rasteve është rasti i ndihmës sociale, në të cilën, Kur'ani e ka lejuar përdorimin e fshehtësisë, për arsye të ruajtjes së dinjitetit të personave që i marrin këto ndihma.

Një fushë tjetër për bisedën e fshehtë është urdhërimi në të mirë. Sepse, nëse kjo çështje kryhet haptazi, ndodh që të bëhet shkak i turpërimit të atij njeriu që urdhërohet për të mirë në prani

të të tjerëve. Gjithashtu, nëse kryhet haptazi urdhërimi në të mirë, mund të bëhet shkak i refuzimit dhe i mospranimit të këtij urdhërimi, të cilin e përmend edhe Kur'ani në këtë ajet.

Një rast tjetër ku lejohet biseda e fshehtë, është rasti i pajtimit mes njerëzve, ku ndonjëherë është detyrim që të jetë i fshehtë për të arritur rezultatin e duhur. Ka mundësi që nëse do të kryhej haptazi, nuk do të arrihej pajtimi. Për këtë, duhet që pajtimi të realizohet duke biseduar me të dy palët në mënyrë të fshehtë.

Pra, biseda e fshehtë është e lejuar dhe nganjëherë mund të jetë e domosdoshme, siç u përmend në tre rastet e lartpërmendura dhe në raste të ngjashme me to.

Ajo që tërheq vëmendjen në ato tre rastet e lartpërmendura është se të gjitha vijnë në brendinë e kuptimit të fjalës "sadaka". Kjo, për shkak se kush urdhëron në të mirë, jep zekatin e dijes së tij dhe kush garon në pajtimin mes njerëzve, ka dhënë zekatin e forcës së tij dhe shkallën e ndikimit të vet tek njerëzit.

Është trasmetuar nga prijësi i besimtarëve, Ali ibn ebu Talibi (Paqja qoftë mbi të!) thënia e tij: *"Me të vërtetë, All'llahu ju ka detyruar në dhënien e zekatit të personalitetit tuaj, ashtu siç ju ka detyruar të jepni zekatin e asaj që keni në duart tuaja."*¹

Trasmetohet nga Profeti (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) se ai i ka thënë ebu Ejubit: *"A të të tregoj ty një lëmoshë që e do All'llahu dhe i Dërguari i Tij? - Të pajtosh mes njerëzve, kur ata grinden dhe të afrosh mes tyre, nëse ata largohen."*²

¹ Tefsiri *Nurul Thakalejn*, vëll. 1, f. 550.

² Tefsiri *Kurtubij*, vëll. 3, f. 385.

Ajeti 115

وَمَنْ يُشَاقِقِ الرَّسُولَ مِنْ بَعْدِ مَا تَبَيَّنَ لَهُ الْهُدَىٰ وَيَتَّبِعْ غَيْرَ سَبِيلِ
الْمُؤْمِنِينَ نُوَلِّهِ مَا تَوَلَّىٰ وَنُصْلِهِ جَهَنَّمَ ۖ وَسَاءَتْ مَصِيرًا ﴿١١٥﴾

"Këdo që e kundërshton të Dërguarin, pasi i është dhënë udhëzimi dhe ndjek rrugë tjetër nga ajo e besimtarëve, Ne e lëmë të ecë andej nga është nisur dhe do ta përcëllojmë në zjarrin e Xhehennemit. Eh, sa vendbanim i keq që është ai!"

Shkaku i zbritjes

Në shkakun e zbritjes së ajetit të mëparshëm thamë se Beshir ibn Ibijrk vodhi një prej myslimanëve dhe akuzoi një njeri të pafajshëm. Me anë të gënjeshtres që krijoi para Profetit (Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), arriti ta shfajësonte veten. Por, kur zbritën këto ajete, u demaskua çështja e tij dhe në vend që të zgjidhte rrugën e pendimit, ai vazhdoi rrugën e mosbesimit dhe u bë kundërshtar i hapur, duke hequr dorë nga Islami. Atëherë, zbriti ky ajet që tregon për këtë tematikë në shtesë të sqarimit të rregullit të përgjithshëm islam.¹

¹ Tefsiri *Mexhmanul Bejan*, vëll. 3, f. 189.

Komentimi

Kur njeriu bën gabim dhe e di gabimin, për atë ka dy rrugë:

Rruga e parë: Është rruga e kthimit dhe e pendimit, për të cilën treguan ajetet e mësipërme (ndikimi i tij, larja e gjynaheve të njeriut).

Rruga e dytë: Është që njeriu të ndjekë rrugën e kokëfortësisë. Ajeti i fundit tregon për shenjat dhe për përfundimin e keq të kësaj rruge. Ai flet hapur se kush i drejtohet Profetit (Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) me kokëfortësi dhe kundërshtim dhe nuk ecën në rrugën e besimtarëve, pasi i është qartësuar e vërteta, me të vërtetë që All'Ilahu nuk do ta udhëzojë në rrugë të drejtë dhe në Ditën e Kiametit, All'Ilahu do ta fusë në Xhehennem. Eh sa vend i keq është ai që e pret atë! All'Ilahu i Lartësuar thotë: **"Këdo që e kundërshton të Dërguarin, pasi i është dhënë udhëzimi dhe ndjek rrugë tjetër nga ajo e besimtarëve, Ne e lëmë të ecë andej nga është nisur dhe do ta përcëllojmë në zjarrin e Xhehennemit. Eh, sa vendbanim i keq që është ai!"**

I duhet kushtuar vëmendje fjalës "jushakik", e cila rrjedh nga fjala "shikak" e që do të thotë kundërshtim i qartë i shoqëruar me smirë dhe mëri. Këtë kuptim e përforcon edhe thënia e ajetit: **"...pasi i është dhënë udhëzimi..."**.

Në të vërtetë, kush e ka këtë fat apo rrisk, nuk do të ketë përfundim të mirë. Ai do të ketë një përfundim të keq në këtë jetë dhe përfundimi në Jetën Tjetër do të jetë edhe më i dhimbshëm. Ajeti thotë se ai në këtë botë ecën në rrugën e devijuar, të cilën po ai vetë e ka zgjedhur. Gjatë përshkrimit të kësaj rruge, zgjerohet rrethi i devijimit nga rruga e drejtë. Sigurisht, kjo është rruga që ai

vetë e zgjedhi për veten e tij dhe themelet e saj i ndërtoi me dorën e vet. Për këtë zgjedhje, këtyre njerëzve nuk u është ushtruar asnjë padrejtësi.

Thënia: **"...Ne e lëmë të ecë andej nga është nisur..."**, tregon për privimin e tyre nga suksesi shpirtëror për të dalluar të vërtetën dhe tregon për vazhdimin e tyre në rrugën e humbur dhe të gabuar.

Kur ajeti thotë: **"...dhe do ta përcëllojmë në zjarrin e Xhehennemit..."**, ai tregon për fundin e tyre në Ditën e Kiametit. Është edhe një komentim tjetër për thënien: **"...Ne e lëmë të ecë andej nga është nisur..."**, pra, ai dhe të tjerë si ai i mbështesin çështjet e tyre tek zotat e rremë, të cilët i zgjedhin për veten e tyre.

Hulumtime

Argumenti i unanimitetit (el ixhma')

Unanimiteti është një nga katër argumentet e jurisprudencës islame. Kjo ka kuptimin e se dijetarët dhe mendimtarët islam janë të një mendimi rreth një çështjeje juridike islame. Ata përmendin në shkencat e dijes së "Parimeve të Jurisprudencës" argumente të ndryshme për të konstatuar argumentin e unanimitetit. Prej tyre është edhe ajeti i lartpërmendur, ku disa e konsiderojnë atë argument i unanimitetit sepse ai thotë: **"...dhe ndjek rrugë tjetër nga ajo e besimtarëve, Ne e lëmë të ecë andej nga është nisur dhe do ta përcëllojmë në zjarrin e Xhehennemit..."**

Bazuar në këtë ajet, çfarëdo rruge që zgjedh besimtari -në çfarëdo çështjeje- duhet që të gjithë të ecin në atë rrugë.

Në të vërtetë, ky ajet nuk ka lidhje me çështjen e argumentit të unanimitetit dhe të, as nga afër dhe as nga larg. (Natyrisht, ne e pranojmë argumentin e unanimitetit, i cili na zbulon thënien e të pamëkatshmit.)

Shkaku që ne nuk e pranojmë këtë ajet si tregues për argumentin e unanimitetit është se së pari, ajeti përcakton ndëshkimin e atyre personave që kundërshtojnë hapur dhe me dije Profetin (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!) dhe nuk zgjedhin rrugën e besimtarëve. Këto dy elementë formojnë shkakun për të ardhmen e zyrtër, duke përforcuar që kjo e ardhme realizohet nëpërmjet zgjedhjes së vetë personave dhe kështu, kjo temë nuk ka asnjë lidhje me argumentin e unanimitetit.

Çështja e dytë është se qëllimi me thënien: "...nga ajo e besimtarëve", është se rruga e tyre është rruga e monoteizmit dhe e nënshtrimit ndaj një Zotit të Vetëm, që është edhe parimi i Islamit. Ajo nuk ka kuptimin e opinioneve juridike (*fetuave fikhije*) apo të rregullave dytësore dhe këtë të vërtetë e argumenton paraqitja e këtij ajeti dhe ajo çfarë është thënë për shkakun e zbritjes së tij.

Transmetohet se kur prijësi i besimtarëve, Ali ibn ebu Talibi (Paqja qoftë mbi të!) ka qenë në Kufe, një grup njerëzish shkuan tek ai dhe i kërkuan që t'i caktonte atyre një imam për të falur namazin me xhemat (që të falnin pas tij namazin e taravisë, të cilin Umer ibn Khatabi, në kohën e tij, e kishte urdhëruar që të falej bashkërisht). Imami nuk iu përgjigj kërkesës së tyre dhe e ndaloi që të falej namazi bashkërisht, sepse namazi me xhemat nuk është i lejuar në namazet nafile. Por ky grup, që e dëgjoji këtë rregull të

qartë nga imam Aliu, vazhdoi me kokëfortësi, filloi të kundërshtonte dhe të bërtiste dhe u bëri thirrje njerëzve që ta kundërshtonin rregullin e Imamit.

Një grup tjetër shkoi tek imam Aliu dhe e lajmëroi se ata njerëz e kishin kundërshtuar urdhrin e tij. Imami u tha që t'i linte ata në atë që zgjodhën.¹ Pastaj Imami lexoi ajetin e lartëpërmendur.

¹ Tefsiri Nurul Thekalejn, vëll. 1, f. 551. Uesailu Shia, vëll. 8, f. 47.

Ajeti 116

إِنَّ اللَّهَ لَا يَغْفِرُ أَنْ يُشْرَكَ بِهِ وَيَغْفِرُ مَا دُونَ ذَلِكَ لِمَنْ يَشَاءُ وَمَنْ

يُشْرِكْ بِاللَّهِ فَقَدْ ضَلَّ ضَلَالًا بَعِيدًا ﴿١١٦﴾

"Vërtet, All'Ilahu nuk fal që të adhurohet dikush apo diçka tjetër veç Atij, por gjynahet e tjera më të vogla ia fal kujt të dojë. Kushdo që i bën shok All'Ilahut (në adhurim), ai me të vërtetë, ka humbur dhe është larguar shumë prej udhës së drejtë."

Komentimi

Idhujtaria (shirku), gjynahu që nuk falet

Ky ajet tregon edhe një herë rrezikun e gjynahut të idhujtarisë, të cilin e konsideron gjynah të pafalshëm dhe nuk mund të imagjinohet se ekziston gjynah më i madh se ai. Ky ajet vjen pas ajeteve të mëparshme që folën rreth hipokritëve dhe atyre që braktisin Islamin.

Në ajetin e 48 të po kësaj sureje u fol për një përmbajtje të ngjashme me këtë ajet dhe përsëritja e këtyre çështjeve edukative nuk është gjë tjetër, veçse një argument i retorikës së Kur'anit, sepse çështjet themelore kërkojnë përsëritje në vende të ndryshme, me qëllim ngulitjen në mendje dhe në shpirt.

Në të vërtetë, mëkatet u ngjajnë sëmundjeve. E shohim të arsyeshme që ta ilustrim këtë ngjashmëri duke marrë si shembull sëmundjen. Nëse sëmundja nuk ka prekur pjesë të rëndësishme të trupit të njeriut dhe nuk ka paralizuar asnjë pjesë të tij, atëherë trupi mbart në vetëvete shenja shërimi dhe përmirësimi. Por nëse sëmundja prek pjesë të rëndësishme të trupit të njeriut, si për shembull mendjen ajo shkakton paralizimin e saj, kështu që porta e shpresës për shërim dhe përmirësim është e mbyllur dhe pritët që atij njeriu t'i vijë vdekja.

Edhe idhujtaria është si sëmundja e fundit, e cila paralizon epiqendrën e ndenjave në shpirtin e njeriut dhe përhap errësirën në brendinë e tij. Nëse idhujtaria vazhdon, nuk ka shpresë që njeriu të shpëtojë. Por nëse mbetet e gjallë e vërteta e monoteizmit dhe e adhurimit të një Zoti të Vetëm e të Pashoq, që është burimi i çdo mirësie, atëherë tek njeriu nuk shkëputet shpresa e faljes së gjynaheve të tij në Jetën Tjetër. Për këtë ajeti i begatë thotë: **"Vërtet, All'Ilahu nuk fal që të adhurohet dikush apo diçka tjetër veç Atij, por gjynahet e tjera më të vogla ia fal kujt të dojë..."**

Më parë thamë që ky ajet është përsëritur dy herë në këtë sure. Kjo është vetëm për të zhdukur përgjithmonë shenjat e idhujtarisë nga shpirtat e atyre njerëzve, ku idhujtaria ka formuar folenë e saj për një kohë të gjatë.

Mirëpo në fund këta dy ajete kanë vetëm një ndryshim të vogël mes tyre. Sepse ky ajet thotë: **"...Kushdo që i bën shok All'Ilahut (në adhurim), ai me të vërtetë, ka humbur dhe është larguar shumë prej udhës së drejtë."**, ndërsa ajeti 48 thotë: **"...Kushdo që i bën shok All'Ilahut (në adhurim), ka bërë gjynah të tmerrshëm."**

Në të vërtetë, ajeti i mëparshëm tregon për shkatërrimin e madh që sjell idhujtaria, veçanërisht në atë që i përket njohjes së All'llahut. Ndërsa ajeti tjetër sqaron dëmet e mëdha që i shkakton idhujtaria shpirtit të njeriut. Ajeti i parë (ajeti 48) hulumton anën teorike të çështjes, kurse ajeti në fjalë flet për anën praktike dhe rezultatet e saj të jashtme.

Nga kjo sqarohet dhe qartësohet se këto dy ajete konsiderohen për njëri-tjetrin si "el lazim" të nevojshëm dhe "el melzum" të detyrueshëm, sipas terminologjisë.

Ajetet 117 - 121

إِنْ يَدْعُونَ مِنْ دُونِهِ إِلَّا إِنْتَا وَإِنْ يَدْعُونَ إِلَّا شَيْطَانًا مَرِيدًا
 ۞ لَعَنَهُ اللَّهُ ۞ وَقَالَ لَأَتَّخِذَنَّ مِنْ عِبَادِكَ نَصِيبًا مَفْرُوضًا ۞
 وَلَا ضِلَّتْهُمْ وَلَا مَنِيتْهُمْ وَلَا مَرَنَّهُمْ فَلَيَبْتَئِكُنَّ ءَاذَانَ الْأَنْعَمِ وَلَا مَرْهَمَ
 فَلْيَغَيِّرَنَّ خَلْقَ اللَّهِ ۞ وَمَنْ يَتَّخِذِ الشَّيْطَانَ وَلِيًّا مِّنْ دُونِ اللَّهِ فَقَدْ
 خَسِرَ خُسْرَانًا مُّبِينًا ۞ يَعِدُهُمْ وَيُمَنِّيهِمْ ۞ وَمَا يَعِدُهُمُ الشَّيْطَانُ إِلَّا
 غُرُورًا ۞ أُولَئِكَ مَأْوَاهُمْ جَهَنَّمُ وَلَا يَخْرُجُونَ عَنْهَا مَحِيصًا ۞

"Ata nuk adhurojnë tjetër, veçse idhuj femërorë dhe nuk thërrasin tjetër, përveç djallit kryengritës."

"Të cilin e ka mallkuar All'Ilahu, sepse (djalli) ka thënë: 'Unë, doemos do të marr një pjesë të caktuar të robve të Tu.'"

"Doemos do t'i shpie ata në rrugë të shtrembër, do t'i josh me shpresa të kota dhe, me siguri, do t'i urdhëroj që t'u presin veshët bagëtive, e pastaj do t'i urdhëroj që të ndryshojnë krijesën e All'Ilahut. 'Kush merr djallin për mbrojtës në vend të All'Ilahut, ai ka pësuar humbje të qartë.'"

"Ai (djalli) u premtun atyre dhe i josh me shpresa, por ato që premtun djalli, janë vetëm mashtrime."

"Për ata, vendbanim është Xhehennemi dhe nuk mund të gjejnë shpëtim prej tij."

Komentimi

Kurthet e shejtanit

Me të vërtetë, ajeti i parë, prej pesë ajeteve në fjalë, shpjegon gjendjen e idhujtarëve, të cilën e përmend edhe ajeti i mëparshëm. Ajeti në fjalë sqaron shkakun e humbjes së idhujtarëve dhe përmend se ata vuajnë nga një ngushtim i rëndë në horizontin e mendimit të tyre, sepse nuk adhurojnë All'llahun, Krijuesin e kësaj gjithësie të gjerë dhe i përulen krijesave, të cilat nuk kanë qoftë edhe më të voglin ndikim pozitiv në këtë ekzistencë, madje, nganjëherë çojnë në humbje si shejtani. All'llahu i Lartësuar thotë: **"Ata nuk adhurojnë tjetër, veçse idhuj femërorë dhe nuk thërrasin tjetër, përveç djallit kryengritës."**

Ajo që tërheq vëmendjen në këtë ajet është se ai i kufizon idhujt e idhujtarëve në dy lloje krijesash, "femra" dhe "djall kryengritës". Fjala "inath" rrjedh nga rrënja e fjalës "enethe", që do të thotë krijesë delikate dhe e butë. Për këtë shkak, arabët thonë: "enethe hadijdu", që do të thotë "është zbutur hekuri", nëse zbutet në zjarr. Edhe gjinia femërore është quajtur "el inath", sepse ajo është më delikate, më e butë se burri.

Disa komentues të Kur'anit thonë se Kur'ani, në këtë ajet, flet për idhujt, të cilët kanë qenë të njohur tek fiset arabe, ku çdo fis zgjidhte një idhull nga këto idhuj dhe i emërtonin me emra femërorë. Idhulli "Latë" është quajtur kështu për të qenë femëror për fjalën "All'illah", ndërsa idhulli "Uza", është gjinia femërore e fjalës "Eaz". Po kështu, është edhe me idhujt e tjerë, si "Menat", "Naileh" dhe të tjerë si këto.

Disa komentues të tjerë prej komentuesve më të mëdhej kanë thënë se qëllimi me fjalën "inath", që do të thotë femëror, që ka ardhur në këtë ajet, nuk është kuptimi i njohur i gjinisë femërore, por qëllimi me këtë është rrënja gjuhësore, nga e cila rrjedh kjo fjalë. Kjo do të thotë se idhujtarët adhuronin krijesa të dobëta dhe nënshtruese që ndodheshin në duart e njerëzve dhe se e gjithë ekzistenca e këtyre krijesave ndikohej përballë ndodhive të ndryshme. Thënë më qartë: Këto krijesa nuk zotërojnë as dëshirë, as zgjedhje. Ato nuk sjellin as dobi e as dëm.

Fjala "murijd", nga rrënja gjuhësore vjen nga fjala "merede", që do të thotë rënia e gjetheve dhe e degëve të pemëve. Për këtë, edhe djali i ri, të cilit nuk i kanë dalë qimet në fytyrë, quhet me fjalën "emred". Bazuar në këtë, shejtani kryengritës është ai shejtani, të cilit i kanë rënë të gjitha cilësitë e mira dhe që nuk i ka mbetur asgjë nga burimet e fuqisë. Ka mundësi që kjo fjalë të jetë e huazuar nga fjala "el murud", që do të thotë tirani dhe mizori. Sigurisht, adhurimi i atyre idhujtarëve është shejtani kryengritës.

Vërtet, Kur'ani famëlartë i ka ndarë idhujt e idhujtarëve në dy grupe: - disa plotësisht të dobët në vullnet; - disa të tjerë mizorë dhe të padrejtë. Këtë e bën me qëllim që të qartësojë se ai

që e pranon udhëheqjen e tyre dhe i bindet këtyre idhujve, me të vërtetë, jeton në një humbje të qartë.

Pas gjithë kësaj, ajeti tregon cilësitë e shejtanit, qëllimet e tij dhe armiqësinë e tij, veçanërisht ndaj bijve të Ademit. Ajeti trajton shpjegimin e disa planeve të ulta të tij. Por përpara çdo gjëje, ajeti dëshmon dhe përforcon se All'llahu i Lartësuar e ka larguar shejtanin nga mëshira e Tij, ku thotë: **"...të cilin e ka mallkuar All'llahu."**

Në të vërtetë, baza e mjerimit të shejtanit është largimi i tij nga mëshira e All'llahut për shkak të mendjemadhësisë dhe kryeneçësisë së tij. Është e natyrshme se kush është larg mëshirës së All'llahut, si shejtani, është i zbrazët nga çdo mirësi dhe nuk mund t'i bëjë mirë as të tjerëve, sepse ai që nuk e zotëron diçka, nuk mund ta japë atë. Ai njeri, jo vetëm që nuk sjell dobi, por do të jetë gjithashtu i dëmshëm.

Pastaj, ajeti në vazdim tregon se shejtani është betuar se do të zbatojë disa nga planet e tij:

I pari: Do të marrë nga robtë e All'llahut një pjesë të caktuar. Ajeti, duke përmendur fjalët e shejtanit, thotë: **"...sepse (djalli) ka thënë: 'Unë, doemos do të marr një pjesë të caktuar të robve të Tu.'"**

Shejtani e di paaftësinë e tij për mashtrimin e të gjithë robve të All'llahut, sepse kush i dorëzohet dëshirës së shejtanit, kush i bindet atij, kush ec pas egos dhe epsheve, nuk ka besim ose e ka besimin e dobët.

I dyti: Planin e shejtanit e përmbledh ajeti me shprehjen: **"Doemos do t'i shpie ata në rrugë të shtrembër..."**

I treti: Dhe do t'i josh ata me shpresa të shumta e të kota: **"...do t'i josh me shpresa të kota..."**

I katërti: Në këtë, shejtani u bën thirrje ndjekësve të tij që të kryejnë vepra pagane, si prerja e veshëve të bagëtive, sikurse ka ardhur në ajet: **"...dhe, me siguri, do t'i urdhëroj që t'u presin veshët bagëtive..."** Kjo tregon për një ndër veprat më të shëmtuara që bënin injorantët idhujtarë, duke u prerë veshët disa bagëtive. Ata e kishin të ndaluar, jo vetëm hipjen mbi këto kafshë, por edhe çfarëdolloj dobie e përfitimi prej tyre.

I pesti: Një nga planet e shejtanit, për të cilin është betuar se do ta zbatonte kundër njeriut, është ai çfarë ka ardhur me gjuhën e tij në këtë ajet: **"...e pastaj do t'i urdhëroj që të ndryshojnë krijesën e All'Ilahut..."** Kjo fjali tregon se All'Ilahu ka vendosur në natyrën e pastër të njeriut, që kur e ka krijuar atë, besimin në monoteizëm dhe adhurimin e All'Ilahut të Vetëm, duke shtuar edhe cilësi të tjera lavdëruese. Por cytjet e shejtanit, bestytnitë, dëshira dhe egoja e largojnë njeriun nga rruga e drejtë dhe e çojnë në rrugën e shtrembër. Dëshmues për këtë është edhe ajeti 70 i sures "Rrum", ku All'Ilahu i Lartësuar thotë: **"Drejtohu me përkushim në fenë e pastër monoteiste, natyrën fillestare, në të cilën All'Ilahu i ka krijuar njerëzit. S'ka ndryshim të krijimit të All'Ilahut, kjo është feja e drejtë, por shumica e njerëzve nuk e dinë."**

Transmetohet nga imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) se kur e ka komentuar këtë ajet: **"...e pastaj do t'i urdhëroj që të**

ndryshojnë krijesën e All'Ilahut..." ka thënë se ndryshimi i përmendur këtu është ai ndryshim i natyrës së njeriut dhe devijimi i tij nga Njësimi i All'Ilahut dhe i urdhrave të Tij.¹

Këtë dëmtim, që nuk mund të shlyhet, shejtani ia bën njeriut në llogari të lumturisë së tij, duke ia përmbysur dhe duke ia shtrembëruar të vërtetat, duke ia zëvendësuar ato me një grumbull iluzionesh dhe paganizmash, që e çojnë njeriun në mjerim dhe e largojnë nga lumturia. Në fund, ajeti e përforcon këtë parim të përgjithshëm që është se çdo njeri që adhuron shejtanin dhe e merr atë si sipërmarrës në vend të All'Ilahut, vërtet ai ka vepruar një gjynah të madh e të qartë. All'Ilahu i Lartësuar thotë: **"Kush merr djallin për mbrojtës në vend të All'Ilahut, ai ka pësuar humbje të qartë."**

Ajeti në vazhdim ka ardhur me disa pika për të përforcuar argumentin e ajetit të mëparshëm, ku tregon se shejtani vazhdon të bëjë premtime të rreme për njerëzit dhe u jep shpresa të mëdha e të kota. Në të vërtetë, ai nuk u paraqet gjë tjetër, vetëm se mashtrim. All'Ilahu i Lartësuar thotë: **"Ai (djalli) u premtonte atyre dhe i josh me shpresa, por ato që premtonte djalli, janë vetëm mashtrime."**

Ajeti i fundit i këtyre pesë ajeteve qartëson të ardhmen e atyre që ndjekin shejtanin. Fundi i tyre do të jetë banimi në Xhehennem, ku nuk mund të largohen nga ai vend asnjëherë. All'Ilahu i Lartësuar thotë: **"Për ata, vendbanimi është Xhehennemi dhe nuk mund të gjejnë shpëtim prej tij."**

¹ Tefsiri Tîbjan, vëll. 3, f. 334.

Ajeti 122

وَالَّذِينَ ءَامَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ سَنُدْخِلُهُمْ جَنَّاتٍ تَجْرَى مِنْ
تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا أَبَدًا وَعَدَ اللَّهُ حَقًّا وَمَنْ أَصْدَقُ مِنَ اللَّهِ

قِيلًا

"Ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, Ne do t'i shpiem në kopshte të Xhennetit, nëpër të cilat rrjedhin lumenj. Aty do të qëndrojnë vazhdimisht e përgjithmonë. Ky është premtimi i vërtetë i All'Ilahut. E kush është më i vërtetë se All'Ilahu në fjalë?!"

Komentimi

Ajetet e mëparshme sqaruan se ata të cilët e marrin shejtanin për shok e ndihmës, në të vërtetë, do të dëmtohen shumë, sepse shejtani u premtonte mashtrim, pabesi dhe gënjeshtëri dhe i çoroditi me shpresa të shumta e të kota.

Ky ajet flet për veprat e besimtarëve dhe shpërblimin që do të arrijnë në Ditën e Gjykimit. Ata do të jenë në Xhennet, në kopshte e lumenj që rrjedhin, ku All'Ilahu i Lartësuar thotë: "...Ata

që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, Ne do t'i shpiem në kopshte të Xhennetit, nëpër të cilat rrjedhin lumenj..."

Sigurisht që kjo është mirësi e madhe dhe e përhershme. Ajo nuk është si mirësitë e kësaj bote kalimtare. Në Xhennet besimtarët do të kënaqen me ato mirësi të përhershme që do t'u jepen. All'Ilahu i Lartësuar thotë: **"...Aty do të qëndrojnë vazhdimisht e përgjithmonë..."** Padyshim që ky premtim është premtim i vërtetë dhe nuk është si premtimi i shejtanit mashtrues. All'Ilahu thotë: **"...Ky është premtimi i vërtetë i All'Ilahut..."**

Është mëse e pakundërshtueshme se askush nuk mund të jetë kurrë më i vërtetë se fjala e All'Ilahut të Lartësuar në premtime e në fjalë, siç thotë ajeti: **"...E kush është më i vërtetë se All'Ilahu në fjalë?!"** Është e natyrshme se mosmbajtja e premtimit është si pasojë e paaftësisë, e paditurisë, etj. All'Ilahu i Lartësuar është i Pastër nga këto cilësi e të meta. (I Lartësuar je Ti, o All'Ilah.)

Ajetet 123 - 124

لَيْسَ بِأَمَانِيكُمْ وَلَا أَمَانِي أَهْلِ الْكِتَابِ مَنْ يَعْمَلْ سُوءًا يُجْزَ بِهِ وَلَا
يَجِدْ لَهُ مِنْ دُونِ اللَّهِ وَلِيًّا وَلَا نَصِيرًا ﴿١٢٣﴾ وَمَنْ يَعْمَلْ مِنَ الصَّالِحَاتِ
مِنْ ذَكَرٍ أَوْ أُتِيَ وَهُوَ مُؤْمِنٌ فَأُولَٰئِكَ يَدْخُلُونَ الْجَنَّةَ وَلَا يُظْلَمُونَ
نَقِيرًا ﴿١٢٤﴾

"(Shpëtimi në Jetën Tjetër) nuk do të jetë as sipas dëshirës suaj (o myslimanë), as sipas dëshirës së ithtarëve të Librit. Por kushdo që bën një të keqe, do të ndëshkohet për atë dhe nuk do të gjejë as mbrojtës, as mbështetës tjetër në vend të All'Ilahut."

"Dhe kushdo që bën vepra të mira, qoftë ai mashkull ose femër, duke qenë besimtar, do të hyjë në Xhennet dhe nuk do t'i bëhet asnjë padrejtësi."

Shkaku i zbritjes

Në tefsirin Mexhmaul Bejan dhe në tefsirë të tjerë, thuhet se myslimanët dhe ithtarët e Librit i krenoheshin njëri-tjetrit. Ithtarët e Librit krenoheshin se Profeti i tyre ishte dërguar përpara Profetit të Islamit dhe se Libri i tyre ishte zbritur para Librit të myslimanëve. Ndërsa myslimanët krenoheshin se Profeti i tyre

ishte vula e të gjithë Profetëve dhe se Libri i tyre është libri i fundit qiellor, më i plotë dhe që nuk ka libër tjetër qiellor pas tij.¹

Në një transmetim tjetër thuhet se jehudinjtë pretendonin se ishin populli i zgjedhur dhe se zjarri i Xhehennemit nuk do t'i prekte ata, por vetëm për disa ditë të caktuara, siç thuhet në ajetin 80 të sures "Bekare": **"Ata thanë: 'Zjarri do të na prekë vetëm ca ditë të numëruara'."**

Myslimanët, si përgjigje ndaj fjalëve të jehudinjtë, thonin se ata ishin populli më i mirë, sepse në ajetin 110 të sures "Ali Imran" All'llahu thotë: **"Ju jeni populli më i mirë i dalë për njerëzimin."** Për këtë ka zbritur ky ajet që i sqaron të gjitha ato pretendime dhe ka përcaktuar vlerën e çdo personi me atë punë që vepron.²

Komentimi

Ky ajet sqaron një ndër pikat më të rëndësishme të Islamit që është se vlera e ekzistencës së çdo njeriu dhe se çfarë arrin nga shpërblimi dhe ndëshkimi, nuk ka asnjë lidhje me pretendimet dhe dëshirat e njeriut, por ajo vlerë ka lidhje të fortë me veprën e njeriut dhe me besimin e tij. Ky parim është i përhershëm dhe është një ligj i pandryshueshëm. Të gjithë njerëzit janë të barabartë para tij. Për këtë, All'llahu i Lartësuar, në fillim të këtij ajeti, thotë: "(Shpëtimi në Jetën Tjetër) **nuk do të jetë as sipas dëshirës suaj (o myslimanë), as sipas dëshirës së ithtarëve të Librit...**" Pastaj

¹ Tefsiri Mexhmaul Bejan, vëll. 3, f. 197.

² Biharul Enuar, vëll. 46, f. 176.

vazhdon e thotë: **"...Por kushdo që bën një të keqe, do të ndëshkohet për atë dhe nuk do të gjejë as mbrojtës, as mbështetës tjetër në vend të All'llahut."**

Po kështu, edhe ata të cilët punojnë vepra të mira dhe janë besimtarë, qofshin burra apo gra, me të vërtetë, që do të hyjnë në Xhennet dhe nuk do t'i godasë as më e vogla padrejtësi. Ajeti thotë: **"Dhe kushdo që bën vepra të mira, qoftë ai mashkull ose femër, duke qenë besimtar, do të hyjë në Xhennet dhe nuk do t'i bëhet asnjë padrejtësi."**

Në këtë mënyrë, mesazhet kur'anore ftojnë në zhdukjen e çdo lloj racizmi, duke i kondiseruar të gjitha pretendimet, lidhjet farefisnore, apo shoqërore dhe të tjera si këto sa për t'u dukur. Baza kryesore në parimet e fesë është besimi.

Në komentimin e ajetit të parë, burimet shiite dhe synite transmetojnë një hadith që thotë se kur ka zbritur ky ajet, myslimanët i kaploi tmerri dhe filluan të qanin nga frika kur kuptuan se njeriu mund të gabonte. Sikur të mendonin se nuk ekzistonte falja, me të vërtetë që çështja do të ishte e vështirë. Për këtë ata u strehuan tek Profeti (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe i përmendën atij se ky ajet ia kishte humbur atyre të gjitha shpresat. Profeti iu betua në All'llahun se çfarë kishte ardhur në këtë ajet ishte e vërtetë, por ai i përgëzoi ata se ajeti ishte faktori më i mirë për t'i nxitur ata që të afroheshin tek All'llahu, të bënë vepra të mira dhe çfarë do t'i godiste ata nga sprovat dhe fatkeqësitë, do të ishte shpagim për gjynahet e tyre.¹

¹ Tefsiri Nurul Thekalejn, vëll. 1, f. 553.

Është e mundur që disa me thënien e këtij ajeti: "**...dhe nuk do të gjejë as mbrojtës e as mbështetës tjetër në vend të All'llahut.**" të argumentojnë se çështja e ndërmjetësimit është anuluar plotësisht. Këtë ajet e konsiderojnë argument për anulimin e ndërmjetësimit në formë të prerë.

Më parë treguam se ndërmjetësim nuk do të thotë që ndërmjetësuesit, si: Profetët, imamët e sinqertë dhe punëmirët e devotshëm kanë një sistem të pavarur veprimi, që i kundërvihet fuqisë së All'llahut të Lartësuar, por e vërteta është se ndërmjetësuesit ndërmjetësojnë vetëm me lejen e All'llahut.

Ajetet 125 - 126

وَمَنْ أَحْسَنُ دِينًا مِّمَّنْ أَسْلَمَ وَجْهَهُ لِلَّهِ وَهُوَ مُحْسِنٌ وَاتَّبَعَ مِلَّةَ إِبْرَاهِيمَ حَنِيفًا
 وَاتَّخَذَ اللَّهُ إِبْرَاهِيمَ خَلِيلًا ﴿١٢٥﴾ وَلِلَّهِ مَا فِي السَّمَوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ
 وَكَانَ اللَّهُ بِكُلِّ شَيْءٍ مُّحِيطًا ﴿١٢٦﴾

"Kush është besimtar më i mirë se ai që i dorëzohet sinqerisht All'Ilahut, duke qenë punëmirë dhe ndoqi fenë e pastër të Ibrahimit, të cilin All'Ilahu e ka marrë për mik të ngushtë?!"

"All'Ilahut i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe gjithçka që gjendet në Tokë dhe All'Ilahu i përfshin të gjitha (në dijen e Tij)."

Komentimi

Ajetet e mëparshme folën për ndikimin e besimit dhe të veprës së mirë. Gjithashtu, sqaruan se ndjekja e çfarëdo medh'hebi apo ligji tjetër, përveç ligjit të All'Ilahut, nuk i sjell asnjë dobi njeriut. Ajeti në fjalë qartëson çdo hamendësim që mund t'i shkojë ndër mend njeriut nga konteksti i ajeteve të mëparshme. Ai qartëson edhe përsosurinë e legjislacionit islam, i cili është superior ndaj të gjithë ligjeve të tjerë ekzistues: "Kush

është besimtar më i mirë se ai që i dorëzohet sinqerisht All'llahut, duke qenë punëmirë dhe ndoqi fenë e pastër të Ibrahimit..." Edhe pse ky ajet ka ardhur në mënyrë pyetjeje, ai ka për qëllim që dëgjuesi të mësojë e të përfitojë nga e vërteta që sqaron ai.

Ajeti në fjalë sqaron tri çështje, të cilat janë masë për dallimin mes legjislacioneve (ligjeve) dhe nxjerr në pah atë që është më i miri i tyre. Ato janë:

1- Dorëzimi dhe përulja e plotë ndaj All'llahut të Madhëruar. Ajeti thotë: "...ai që i dorëzohet sinqerisht All'llahut..."

2- Kryerja e veprave të mira: "...duke qenë punëmirë". Qëllimi me kryerjen e veprave të mira këtu është për çdo vepër të mirë që e kryen njeriu me zemrën, me gojën dhe me gjymtyrët e tij.

Autori i komentimit "Thekalejn", në komentimin e tij, përmend se e kanë pyetur Profetin Muhammed (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) për përkufizimin e kuptimit të "ihsanit" dhe ai është përgjigjur: *"Të adhurosh All'llahun sikur ti e shikon Atë. Nëse ti nuk e shikon Atë, Ai të sheh ty."*¹

Pra, fjala "ihsan" në këtë ajet është për çdo vepër që e bën njeriu dhe me të ka për qëllim adhurimin e All'llahut dhe afrimin tek Ai. Me kryerjen e kësaj veprë, njeriut i duket sikur e sheh

¹ Tefsiri Nurul Thekalejn, vëll. 1, f. 554. Biharul Enuar, vëll. 62, f. 116.

All'llahun, edhe pse në të vërtetë, është i paaftë për ta parë Atë, por All'llahu e shikon atë dhe dëshmon për veprat e tij.

3- Ndjekja e fesë së pastër dhe të çiltër të Ibrahimit (Paqja qoftë mbi të!) siç thotë ajeti: "...**dhe ndoqi fenë e pastër të Ibrahimit...**"¹ Argumenti për t'u mbështetur në fenë e hazreti Ibrahimit është thënia në mbyllje të këtij ajeti që thotë: **!...të cilin All'llahu e ka marrë për mik të ngushtë?!"**

Cili është kuptimi i miqësisë?

Fjala "khalijl" mund të rrjedhë nga rrënja e fjalës "khiletun", që do të thotë miqësi. Por edhe mund të rrjedhë nga rrënja e fjalës "khiletun", që do të thotë nevojë.

Komentuesit e Kur'anit kanë mendime të ndryshme se cili nga këto dy kuptime është më i drejtë në këtë ajet. Disa prej tyre kanë thënë se kuptimi i dytë është më afër së vërtetës në këtë ajet, sepse Ibrahim (Paqja qoftë mbi të!) besonte se kishte nevojë për All'llahun. Kurse komentuesit e tjerë thonë se përderisa ajeti flet për pozitën të cilën ia ka dhuruar All'llahu Profetit të Tij, Ibrahimit (Paqja qoftë mbi të!), atëherë qëllimi me fjalën "khalijl", që ka ardhur në këtë ajet, është për mikun. Pra, All'llahu e ka përzgjedhur Ibrahimin mik të Tij. Dihet se të gjitha krijesat kanë nevojë për All'llahun e Madhëruar, siç thotë ajeti 15 i sures "Fatir":

¹ Fjala "miletun", që gjendet në ajetin e lartpërmendur, ka kuptimin e "fesë dhe të sheriatit". Dallimi mes "el milil-letu" dhe "ed dijn" është se e para nuk i atribuohet All'llahut dhe nuk thuhet "mil-letullah". Ajo mund t'i atribuohet Profetit (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!). Ndërsa fjala "ed dijn" apo "esh sheriatu" mund t'i shtohet emrit të All'llahut dhe të thuhet "nijnullah" apo "sheriattullah". Këto mund t'i atribuohen edhe Profetit (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!). Fjala "hanijfen" ka kuptimin e njeriut që i braktis fetë e kota dhe ndjek fenë e drejtë.

"O njerëz! Ju jeni të varfër e nevojtarë për All'llahun." Kjo është e kundërta e miqësisë me All'llahun, ku të gjitha krijesat nuk janë të barabarta.

Në një transmetim të ardhur nga imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!), thuhet: *"Me të vërtetë, All'llahu e ka marrë Ibrahimin mik për shkak të nënshtrimit të tij dhe jo se All'llahu ka nevojë për miqësinë e tij."*¹ Ky transmetim tregon se fjala "khalijl", e ardhur në këtë ajet, do të thotë mik e jo tjetër gjë.

Bazuar në këtë, le të shohim se për çfarë është dalluar Ibrahim (Paqja qoftë mbi të!) për të arritur këtë gradë të lartë tek All'llahu. Për këtë, transmetimet kanë treguar shkaqe të ndryshme që janë argumente për këtë përzgjedhje. Prej atyre transmetimeve është edhe thënia e imam Sadikut (Paqja qoftë mbi të!): *"Me të vërtetë, All'llahu e ka marrë Ibrahimin për mik, sepse ai nuk i është përgjigjur askujt dhe nuk i është lutur askujt, përveç All'llahut."*²

Nga këto transmetime përfitohet se Ibrahim (Paqja qoftë mbi të!) e ka arritur këtë gradë se ai i ka bërë shumë sexhde All'llahut të Lartësuar, ka ushqyer të uriturit, ka falur namazin e natës dhe është përpjekur për të arritur kënaqësinë e All'llahut dhe për t'iu bindur Atij.

Pas kësaj, ajeti në vazhdim flet për sundimin e All'llahut dhe se Ai është i Gjithëditur për të gjitha gjërat. Ajeti thotë: **"All'llahut i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe gjithçka që gjendet në Tokë dhe All'llahu i përfshin të gjitha (në dijen e Tij)."**

¹ Tefsiri Mexhmaul Bejjan, vëll. 3, f. 201.

² Ujjunul Akhbaru Rrida, vëll. 2, f. 76. Es-Safijj, vëll. 1, f. 505. Tefsiri Burhan, vëll. 1 f. 417.

Kjo tregon se kur All'llahu e ka përzgjedhur Ibrahimin (Paqja qoftë mbi të!) për mik, nuk e ka bërë se kishte nevojë për të, sepse Ai nuk ka nevojë për askënd. Por kjo përzgjedhje u realizua për shkak të cilësive të veçanta e të përkryera që gjendeshin tek hazreti Ibrahim, të cilat nuk gjendeshin tek askush tjetër përveç tij.

Ajeti 127

وَدَسْتَفْتُونَكَ فِي النِّسَاءِ ۖ قُلِ اللَّهُ يُفْتِيكُمْ فِيهِنَّ وَمَا يُتْلَىٰ عَلَيْكُمْ فِي
 الْكِتَابِ فِي يَتِمَى النِّسَاءِ الَّتِي لَا تُوْتُونَهُنَّ مَا كُتِبَ لَهُنَّ وَتَرْغَبُونَ أَن
 تَنْكِحُوهُنَّ ۚ وَالْمُسْتَضَعَفِينَ مِنَ الْوِلْدَانِ وَأَن تَقُومُوا لِلْيَتَامَىٰ
 بِالْقِسْطِ ۚ وَمَا تَفْعَلُوا مِنْ خَيْرٍ فَإِنَّ اللَّهَ كَانَ بِهِ عَلِيمًا



"Ata kërkojnë prej teje (o Muhammed) që t'i sqarosh lidhur me çështjet e grave. Thuaju: 'Për çështjet e tyre ju sqaron All'Ilahu dhe Libri që ju lexohet, si për femrat jetime, të cilave nuk u jepni dhuratën e caktuar për to, edhe pse dëshironi të martoheni me to, ashtu edhe për fëmijët e mitur. All'Ilahu ju udhëzon që të silleni drejt me jetimët.' All'Ilahu është në dijeni të çdo të mire që bëni."

Komentimi

Edhe një herë për të drejtat e gruas

Ky ajet i përgjigjet pyetjeve që bënë myslimanët rreth gruas, veçanërisht rreth atyre që janë jetime. Ajeti i drejtohet Profetit (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe i sqaron atij se është All'llahu Ai, i Cili u përgjigjet pyetjeve të drejtuara ty, o Muhammed, rreth rregullave të veçanta për të drejtat e grave. Ajeti thotë: **"Ata kërkojnë prej teje (o Muhammed) që t'i sqarosh lidhur me çështjet e grave. Thuaju: 'Për çështjet e tyre ju sqaron All'llahu...'"**

Ajeti tregon se çfarë ka ardhur në Kur'an rreth vajzave jetime. Ai thotë se ju shpenzoni nga pasuritë e tyre, nuk martoheni me to dhe as nuk ia dorëzoni atyre pasurinë e vet që të martohen me të tjerë. Kjo i përgjigjet një grupi tjetër nga pyetjet tuaja dhe ju qartëson juve punët e këqija që ju keni bërë. Ndër to vërehet padrejtësia ndaj atyre grave. Ajeti thotë: **"...dhe Libri që ju lexohet, si për femrat jetime, të cilave nuk u jepni dhuratën e caktuar për to, edhe pse dëshironi të martoheni me to..."**

Pastaj, ajeti këshillon për fëmijët e vegjël meshkuj, të cilët nuk trashëgonin sipas traditës së injorancës (para Islamit). Ai përforcon domosdoshmërinë e mbrojtjes së të drejtave të tyre: **"...ashtu edhe për fëmijët e mitur..."**

Po ashtu, ajeti përsërit përforcimin e të drejtave të jetimëve dhe përmend se All'llahu ju këshillon që të ruani drejtësinë në bashkëpunimin me jetimët, ku thotë: **"...All'llahu ju udhëzon që të silleni drejtë me jetimët..."**

Në mbyllje, ky ajet tërheq vëmendjen se çdo vepër e mirë që ju bëni, veçanërisht kur bëhet fjalë për të drejtën e jetimëve, të të privuarve dhe nevojtarëve, ajo është e ditur tek All'lahu dhe ju në fund do të arrini shpërblimin e kësaj vepre. Për këtë ajeti thotë: **"...All'lahu është në dijeni të çdo të mire që bëni."**

Duhet patur kujdes se shprehja **"jesteftinuke"** që rrjedh nga fjala "fetua", do të thotë përgjigje për çdo pyetje delikate dhe të vështirë. Meqenëse kjo fjalë kthehet në origjinën e fjalës "feta", që do të thotë djalë i ri adoleshent, është e mundur që fjala "fetua", është përdorur si përgjigje për pyetjet e reja dhe pas kësaj është përdorur në një mënyrë të përgjithshme për të gjitha llojet e pyetjeve dhe në veçanti për çështje të zgjedhura.

Ajeti 128

وَإِنْ أَمْرًا خَافَتْ مِنْ بَعْلِهَا نُشُوزًا أَوْ إِعْرَاضًا فَلَا جُنَاحَ عَلَيْهِمَا أَنْ يُصْلِحَا بَيْنَهُمَا صُلْحًا وَالصُّلْحُ خَيْرٌ وَأُحْضِرَتِ الْأَنْفُسُ الشُّحَّ
وَإِنْ تُحْسِنُوا وَتَتَّقُوا فَإِنَّ اللَّهَ كَانَ بِمَا تَعْمَلُونَ خَبِيرًا

"Nëse gruaja druan nga burri i saj se do të sillet keq ose nuk do ta përfillë, atëherë nuk ka gjynah për ata, nëse pajtohen ndërmjet tyre. Pajtimi është më i mirë. Njerëzit janë të prirur nga koprracia. Por në qoftë se ju silleni mirë dhe ruheni prej të këqijave, All'Ilahu e di mirë çfarë veproni."

Shkaku i zbritjes

Në shumë libra të tefsirit dhe të haditheve, për shkakun e zbritjes së këtij ajeti, thuhet se në kohën e Profetit ka qenë një person i quajtur Rafiu ibn Khudejxh, i cili ka pasur dy gra. Njëra prej tyre ka qenë e madhe në moshë dhe tjera e re. Për shkak të mosmarrëveshjeve ndërmjet tyre, Rafiu e divorcoi gruan e moshuar. Por para se asaj t'i mbaronte koha e pritjes për divorc, ai i propozoi asaj që të pajtoheshin, me kusht që të mos shqetësohej kur t'i sillte asaj gruan e re ose të duronte derisa të mbaronte koha e menstruacioneve të saj dhe të kryhej ndarja midis tyre. Gruaja e

pranoi sugjerimin e parë dhe u pajtuan. Atëherë zbriti ky ajet i bekuar, duke qartësuar rregullin e këtij veprimi.¹

Komentimi

Pajtimi është më i mirë

Në shpjegimin e ajeteve 34 dhe 35 të kësaj sureje, thamë se fjala "nushuz" rrjedh nga rrënja e fjalës "nesheze", që do të thotë "tokë e lartë". Kur kjo fjalë përdoret në çështjen e burrit dhe të gruas, do të thotë "mendjemadhësi" dhe "padrejtësi".

Ajetet e mëparshme e sqaruan rregullin e mosbindjes dhe të kokëfortësisë së gruas. Këtu tregohet për mosbindjen dhe kokëfortësinë e burrit. Ajeti flet për gruan, e cila e ndien mosbindjen dhe kokëfortësinë e bashkëshortit ndaj saj dhe qartëson se nuk ka pengesë që të heqë dorë nga disa të drejta të saj dhe të pajtohet me burrin e vet për të ruajtur lidhjet bashkëshortore nga konflikti. Ajeti thotë: **"Nëse gruaja druan nga burri i saj se do të sillet keq ose nuk do ta përfillë, atëherë nuk ka gjynah për ata, nëse pajtohen ndërmjet tyre..."**

E nëse gruaja heq dorë nga disa të drejta të saj me dëshirë e jo me dhunë e imponim, nuk ka gjynah në këtë vepër, sepse edhe ajeti e ka përshkruar këtë me shprehjen: **"nuk ka gjynah"** për argumentimin e të vërtetës që përmendëm.

¹ Tefsiri Mexhmaul Bejan, vëll. 3, f. 205.

Kur vërejmë shkakun e zbritjes, vërejmë dy çështje të jurisprudencës:

E para: Rregulli i ndarjes së ditëve të javës ndërmjet bashkëshortëve është më tepër shenjë e të drejtës sesa shenjë e rregullit. Për këtë, është e mundur që gruaja të heqë dorë plotësisht ose pjesërisht nga kjo e drejtë nëse dëshiron.

E dyta: Pajtimi dhe pëlqimi nuk është kusht që të bëhet me pasuri, por lejohet që të jetë edhe nga heqja dorë nga disa të drejta prej të drejtave.

Pas kësaj, ajeti argumenton se pajtimi është më i mirë dhe më i përkryer, ku thotë: "**...Pajtimi është më i mirë...**". Kjo fjali e shkurtër, edhe pse ka ardhur në rastin e mosmarrëveshjeve familjare, qartëson një rregull të përgjithshëm dhe gjithpërfshirës, duke garantuar e përforcuar se pajtimi është parimi bazë në këto raste dhe se problemet, konfliktet dhe ndarjet nuk duhet të ekzistojnë në natyrën e pastër të njeriut. Për këtë, kjo natyrë nuk udhëzon kah konflikti.

Kjo çështje është e kundërta e asaj që mendojnë materialistët se konflikti, për arsye të ekzistencës, është parimi bazë i jetës së gjallesave. Ata thonë se përsosuria arrihet nëpërmjet këtij konflikti.

Ky lloj mendimi ka qenë shkak për shfaqjen e shumë konflikteve dhe luftrave të përgjakshme në shekujt e fundit. Mirëpo njeriu nuk krahasohet me kafshët grabitqare, për shkak se ai ka mendje dhe ndjenja dhe se përsosuria e tij plotësohet nën hijen e bashkëpunimit me njëri-tjetrin dhe jo nën hijen e

konflikteve. Këtu themi se konflikti, për arsye të ekzistencës, edhe te kafshët nuk konsiderohet parim i pranuar për përsosurinë.¹

Pas kësaj, ajeti tregon se njeriun, për shkak të instiktit të dashurisë ndaj vetes, e rrethojnë dallgët e koprracisë, ku çdo njeri garon për të arritur të drejtat e tij pa hequr dorë nga asgjë, qoftë edhe e pakët. Ky është shkaku dhe burimi i konfliktit dhe i luftës. Ajeti thotë: **"...Njerëzit janë të prirur nga koprracia..."**

Për këtë, nëse secili nga bashkëshortët e ndien se koprracia është burimi më i madh i konfliktit dhe e njohin të vërtetën e koprracisë se ajo është prej cilësive të këqija dhe nxitojnë për t'u pajtuar mes tyre duke shfaqur faljen, atëherë ky veprim nuk do t'i çojë në konflikte e mosmarrëveshje, por do t'i çojë në largimin e shumë konflikteve shoqërore.

Me qëllim që burrat të mos e keqpërdorin këtë rregull që përmend ajeti në fjalë, në mbyllje, ajeti u drejtohet atyre dhe i fton ata që të bëjnë punë të mira dhe të jenë të devotshëm. Atyre u është tërhequr vëmendja se All'Ilahu i mbikëqyr gjithmonë veprat e tyre, prandaj të kenë kujdes nga devijimi nga rruga e drejtë dhe e vërtetë. Ajeti thotë: **"...Por në qoftë se ju silleni mirë dhe ruheni prej të këqijave, All'Ilahu e di mirë çfarë veproni..."**

¹ Për t'u njohur më shumë rreth kësaj çështjeje, shiko fundin e komentimit të ajetit 251 të sures "Bekare" në këtë komentim.

Ajetet 129 - 130

وَلَنْ تَسْتَطِيعُوا أَنْ تَعْدِلُوا بَيْنَ النِّسَاءِ وَلَوْ حَرَصْتُمْ^ط فَلَا تَمِيلُوا كُلَّ
الْمِيلِ فَتَذَرُوهَا كَالْمُعَلَّقَةِ^ج وَإِنْ تَصْلَحُوا وَتَتَّقُوا فَإِنَّ اللَّهَ كَانَ غَفُورًا
رَحِيمًا ﴿١٢٩﴾ وَإِنْ يَتَفَرَّقَا يُغْنِ اللَّهُ كُلًّا مِّن سَعَتِهِ^ج وَكَانَ اللَّهُ وَاسِعًا
حَكِيمًا ﴿١٣٠﴾

"Ju nuk do të mund të silleni drejt midis grave tuaja, edhe sikur të dëshironi. Prandaj, mos anoni krejtësisht vetëm nga njëra, duke e lënë tjetrën si të varur. Nëse ju i përmirësoni marrëdhëniet dhe ruheni nga padrejtësia, ta dini se All'Ilahu është vërtet Falës dhe Mëshirëplotë."

"E nëse ata ndahen, All'Ilahu me begatinë e Tij, çdonjërin prej tyre e bën të pavarur. Se All'Ilahu është Dorëgjërë dhe i Urtë."

Komentimi

Drejtësia, kusht i poligamisë

Nga fjalja e fundit e ajetit të mëparshëm, e cila u drejtohet burrave që të bëjnë vepra të mira dhe t'i përkushtohen devotshmërisë ndaj All'Ilahut, arrijmë në përfundimin se ajo

konsiderohet një lloj kërcënimi për bashkëshortët që ta mbikëqyrin gjendjen e tyre dhe të mos devijojnë aspak nga rruga e vërtetë dhe nga drejtësia gjatë jetës me gratë e tyre.

Këtu mund të vijë një kundërshtim që thotë: Realizimi i drejtësisë në fushën e dashurisë dhe të lidhjeve me zemrën është një çështje e largët për t'u arritur. Atëherë, duke qenë gjendja e tillë, si mund zbatohet drejtësia me gratë?

Në përgjigje të këtij kundërshtimi, ajeti 129 i kësaj sureje e qartëson se realizimi i drejtësisë në fushën e dashurisë mes grave është një çështje e paarritur, sado që të mundohet njeriu në këtë fushë. Ajeti thotë: **"Ju nuk do të mund të silleni drejt midis grave tua, edhe sikur të dëshironi..."** Nga shprehja **"...edhe sikur të dëshironi..."** sqarohet se në mesin e myslimanëve gjendeshin persona që ishin përpjekur shumë për ta realizuar këtë drejtësi të kërkuar. Ka mundësi që përpjekja e tyre në këtë drejtim ka qenë për hir të rregullit të përgjithshëm, i cili i kërkon myslimanëve që të zbatojnë drejtësinë me gratë e tyre. Kjo përmendet në ajetin 3 të sures "Nisa", ku thotë: **"...E, nëse frikësoheni se nuk do të jeni të drejtë ndaj të gjithave njësoj, atëherë mjaftohuni me një grua..."**

Është e pakundërshtueshme se çdo rregull i All'llahut nuk mund të zbresë në kundërshtim me natyrën njerëzore. Gjithashtu, ai rregull nuk mund të jetë detyrim mbi mundësinë. Meqenëse lidhjet e zemrës vijnë për shkak të faktorëve, ku disa janë të jashtëm e disa të brendshëm, All'llahu nuk ka gjykuar për realizimin e drejtësisë në rastin e dashurisë së zemrës ndërmjet bashkëshorteve. Kurse, përsa i përket veprave, mënyrës së bashkëveprimit dhe të ruajtjes së të drejtave mes bashkëshorteve, të cilat njeriu mund t'i realizojë, në to duhet zbatuar drejtësia.

Por, nuk duhet që burrat ta keqpërdorin këtë rregull. Ajeti u kërkon burrave që të mos shfaqin anim të plotë kah njëra prej grave, nëse është e vështirë për ata që ta realizojnë barazinë në dashurinë e tyre, me qëllim që të mos humbasë e drejta e të tjerave. Ajeti thotë: **"...Prandaj, mos anoni krejtësisht vetëm nga njëra, duke e lënë tjetrën si të varur..."**

Në fund, ajeti i paralajmëron ata të cilët nuk i zbatojnë të drejtat e grave të tyre dhe u kërkon atyre që të ndjekin rrugën e pajtimit e të devotshmërisë dhe të heqin dorë nga e shkuara, që All'Ilahu i Lartësuar t'i përfshijë në mëshirën dhe në faljen e Tij. Ajeti thotë: **"...Nëse ju i përmirësoni marrëdhëniet dhe ruheni nga padrejtësia, ta dini se All'Ilahu është vërtet Falës dhe Mëshirëplotë."**

Kanë ardhur transmetime të cilat përfshijnë çështjet e realizimit të drejtësisë ndërmjet grave dhe sqarojnë madhështinë e këtij rregulli dhe këtij ligji islam.

Transmetohet nga Xhafer ibn Muhammed, nga babai i tij dhe ai nga baba i tij se Profeti (Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të!), kur ishte i sëmurë, shkonte tek gratë e tij, i vizitonte e qëndronte me to.¹

Muadh ibn Xhebeli ka pasur dy gra dhe që të dyja i vdiqën nga sëmundja e murtajës. Ai hodhi short se cilën të varroste të parën.²

¹ Tefsiri Tîbjan, vëll. 3, f. 350. Uesailu Shija, vëll. 21, f. 343.

² Tefsiri Tîbjan, vëll. 3, f. 350. Uesailu Shija, vëll. 21, f. 343.

Përgjigja e një pyetjeje të domosdoshme

Në shpjegimin e ajetit 3 të kësaj sureje thamë se disa të paditur, të cilët e bashkuan atë ajet me këtë në fjalë, arritën në përfundimin se poligamia (martesa me më shumë se një grua) është e kufizuar me realizimin e drejtësisë mes tyre. Megjithatë realizimi i drejtësisë mes grave është diçka e pamundur, ata thanë se për këtë Islami e ka ndaluar poligaminë.

Nga transmetimet islame kuptohet se i pari që e ka propozuar këtë mendim ka qenë ibn ebi Auxha. Ai ka qenë mbështetës i grupit materialist dhe prej bashkëkohësve të imam Sadikut (Paqja qoftë mbi të!). Këtë propozim të tij ai e ka shprehur në një diskutim me mendimtarin e palodhur islam Hisham ibn Hakem. Pasi Hishami e dëgjoi përgjigjen, doli nga qyteti i tij Kufe për në Medinen e Ndritur për të mësuar përgjigjen nga imam Sadiku. Imami u habit për ardhjen e tij përpara periudhës së Haxhit dhe të Umres. Hishami e lajmëroi imamin për pyetjen e ibn ebi Auxhas. Përgjigja e imam Sadikut ka qenë se qëllimi me drejtësinë në ajetin e tretë të sures "Nisa" është drejtësia në shpenzim, domosdoshmëria e ruajtjes së të drejtave bashkëshortore dhe mënyra e bashkëveprimit me ta. Ndërsa drejtësia që ka ardhur në ajetin 129 të kësaj sureje (e cila konsiderohet si një çështje e pa arritur), është për drejtësinë e animit të zemrës. Bazuar në këtë, poligamia nuk është as e ndaluar dhe as e pamundur, nëse në të ruhen kushtet islame. Kur u kthye Hishami me këtë përgjigje tek ibn ebi Auxha, ky i fundit u betua se kjo përgjigje është nga ana e tij.¹

¹ Duhet përmendur se Hishami doli nga vendbanimi i tij dhe shkoi në Medinen e Ndritur për të marrë përgjigjen e duhur për çështjen dhe t'ia paraqesë pyetësit. Ky është një mësim i madh për të gjithë myslimanët dhe veçanërisht për predikuesit islamë.

Është e ditur se komentimi ynë për fjalën drejtësi, ka ardhur në ajetin e tretë dhe në ajetin 129 të sures "Nisa", me dy kuptime, sepse gjendet argument i qartë për secilin ajet. Ajeti i fundit e urdhëron njeriun që të mos anojë plotësisht nga njëra grua dhe t'i lërë të tjerat të çoroditura e të pakënaqura në çështjet e tyre. Për këtë, ajeti tregon për lejimin e martesës me më shumë se një grua, me kusht që të mos i bëhet padrejtësi asnjërës në kurriz të tjetrës. Gjithashtu thotë se është i pamundur realizimi i barazisë në dashurinë me zemër. Në ajetin e tretë të kësaj sureje është thënë qartë se lejohet poligamia.

Ajeti i dytë prej këtyre dy ajeteve të fundit e tregon këtë të vërtetë: Nëse është e pamundur që të vazhdohet jeta bashkëshortore nga të dyja palët dhe është i pamundur pajtimi mes tyre, atëherë në këtë gjendje, ata nuk janë të detyruar që ta vazhdojnë një jetë të dhimbshme dhe të urryer. Ata të dy mund të ndahen dhe të marrin një vendim të prerë në këtë çështje pa u frikësuar për të ardhmen. Nëse ndahen me të vërtetë, All'llahu është i Ditur dhe i Urtë dhe do t'i përfshijë në mëshirën dhe mirësinë e Tij. Prandaj, ata nuk duhet ta humbasin shpresën për një jetë më të mirë në të ardhmen. Për këtë, ajeti i bekuar thotë: **"E nëse ata ndahen, All'llahu me begatinë e Tij, çdonjërin prej tyre e bën të pavarur. Se All'llahu është Dorëgjërë dhe i Urtë."**

Ajetet 131 - 134

وَلِلَّهِ مَا فِي السَّمَوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ ۚ وَلَقَدْ وَصَّيْنَا الَّذِينَ أُوتُوا الْكِتَابَ
 مِنْ قَبْلِكُمْ وَإِيَّاكُمْ أَنْ اتَّقُوا اللَّهَ ۚ وَإِنْ تَكْفُرُوا فَإِنَّ لِلَّهِ مَا فِي السَّمَوَاتِ
 وَمَا فِي الْأَرْضِ ۚ وَكَانَ اللَّهُ غَنِيًّا حَمِيدًا ﴿١٣١﴾ وَلِلَّهِ مَا فِي السَّمَوَاتِ وَمَا فِي
 الْأَرْضِ ۚ وَكَفَى بِاللَّهِ وَكِيلًا ﴿١٣٢﴾ إِنْ يَشَأْ يُذْهِبْكُمْ أَيُّهَا النَّاسُ وَيَأْتِ
 بِآخَرِينَ ۚ وَكَانَ اللَّهُ عَلَىٰ ذَٰلِكَ قَدِيرًا ﴿١٣٣﴾ مَنْ كَانَ يُرِيدُ ثَوَابَ الدُّنْيَا
 فَعِنْدَ اللَّهِ ثَوَابُ الدُّنْيَا وَالْآخِرَةِ ۚ وَكَانَ اللَّهُ سَمِيعًا بَصِيرًا ﴿١٣٤﴾

"E All'Ilahut është gjithçka që gjendet në qiej dhe në Tokë. Ne i kemi porositur ata që u është shpallur Libri para jush dhe juve: 'Jini të devotshëm ndaj All'Ilahut! Nëse mohoni, dijeni se All'Ilahut i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe në Tokë. All'Ilahu është i Vetëmjaftueshëm dhe i Denjë për çdo lavdërim.'"

"All'Ilahut i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe në Tokë. All'Ilahu është Mbrotjësi juaj i mjaftueshëm."

"Nëse do, Ai ju dëbon ju o njerëz dhe sjell të tjerë. All'Ilahu ka fuqi ta bëjë këtë."

"Kush dëshiron shpërblimin e kësaj bote, (le ta dijë se) tek All'Ilahu janë shpërblimi i kësaj dhe i Botës Tjetër. All'Ilahu dëgjon dhe vështron çdo gjë."

Komentimi

Ajeti i mëparshëm na sqaroi se kur është e domosdoshme që dy bashkëshortët të ndahen nga njëri-tjetri dhe nuk gjendet ndonjë zgjidhje tjetër, atëherë nuk është e ndaluar ndarja dhe ata nuk duhet t'i frikësohen Jetës Tjetër, sepse All'Ilahu i Lartësuar do t'i përfshijë ata në bujarinë dhe mirësinë e Tij dhe do t'ia largojë nevojën me mëshirën dhe begatinë e Tij.

Ajeti në fjalë e përforcon fuqinë e All'Ilahut në plotësimin e nevojave, sepse Ai është Poseduesi i gjithçkaje që ndodhet në qiej e në Tokë. Ajeti thotë: **"E All'Ilahut është gjithçka që gjendet në qiej dhe në Tokë..."** Me të vërtetë, All'Ilahu është Ai i Cili ka fuqi absolute në sundimin e Tij. Ai kurrë nuk është i paaftë për kryerjen e nevojave të robve të Vet.

Për ta përforcuar domosdoshmërinë e devotshmërisë në këtë rast, ajeti tregon se jehudijve, të krishterëve dhe të gjithë atyre që kanë patur libër qiellor para myslimanëve, u është kërkuar që të kujdeseshin për devotshmërinë. Ajeti thotë: **"...Ne i kemi porositur ata që u është shpallur Libri para jush dhe juve: 'Jini të devotshëm ndaj All'Ilahut!'"**

Pas kësaj, ajeti u drejtohet myslimanëve duke u përfocuar atyre se zbatimi i rregullit të devotshmërisë do t'i sjellë atyre dobi dhe All'Ilahu nuk ka asnjë nevojë për devotshmërinë e tyre.

Gjithashtu, ai dëshmon dhe përforcon se nëse bëjnë gjynahe dhe e kundërshtojnë Atë, nuk i bëjnë asnjë të keqe All'Ilahut,

sepse All'llahu është Poseduesi i gjithçkaje që ndodhet në qiej e në Tokë dhe Ai nuk ka nevojë për askënd. Është e drejta e Tij që robtë e Vet ta falënderojnë gjithmonë Atë. Në ajet thuhet: **Nëse mohoni, dijeni se All'llahut i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe në Tokë. All'llahu është i Vetëmjaftueshëm dhe i Denjë për çdo lavdërim."**

Vetëmjaftueshmëria dhe mospasja nevojë për askënd janë dy cilësitë mëse të vërteta të All'llahut të Lartësuar. Kjo sepse All'llahu është i Vetëmjaftueshëm. Plotësimi i nevojave të të tjerëve arrihet me ndihmën dhe furnizimin e Tij. Të gjitha krijesat në vetvete kanë nevojë për All'llahun dhe për këtë Ai e meriton që të falënderohet nga krijesat dhe robtë e Tij. Po ashtu, edhe përsosuritë e Tij që e bëjnë meritues për t'u falënderuar nuk janë jashtë Vetes së Tij dhe Ai nuk është si krijesat, të cilat zotërojnë cilësi plotësuese të fituara.

Ajeti dëshmon dhe përforcon për të tretën herë se çdo gjë që ndodhet në qiej e në Tokë është pronë e All'llahut dhe se All'llahu i Lartësuar është Ruajtësi, Administruesi dhe Sunduesi i të gjitha krijesave. Ai thotë: **"All'llahut i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe në Tokë. All'llahu është Mbrojtësi juaj i mjaftueshëm."**

Këtu shtrohet pyetja se cili është shkaku i përsëritjes tri herë i temës me të njëjtën përmbajtje të vetme dhe shumë të afërt në tekst. A është kjo përsëritje për shkak të përforcimit të kësaj çështjeje apo ka ndonjë sekret tjetër?

Duke u thelluar në përmbajtjen e këtyre ajeteve, ne vërejmë se tematika e përsëritur për çdo rast përmban një çështje të veçantë: Herën e parë, ajeti mbart premtimin për dy bashkëshortët, se nëse ata të dy ndahen, All'llahu do t'i furnizojë

ata. Për të konstatuar fuqinë e Tij për këtë gjë, All'llahu përmend pushtetin e Tij në qiej e në Tokë.

Herën e dytë, ajeti porosit për devotshmëri. Me qëllim që të mos ndodhë hamendesim se bindja ndaj këtyre çështjeve përmban dobi për All'llahun dhe që kundërshtimi i tyre përmban dëm për Atë, është përsëritur shprehja për vërtetuar dhe për të përforcuar se All'llahu nuk ka nevojë për asgjë. Ai është Poseduesi dhe Sunduesi i gjithçkaje që ndodhet në qiej e në Tokë.

Kjo thënie është e ngjashme me thënien e prijësit të besimtarëve, imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!) në fillim të hytbes së Hammamit, në librin "Nehxhul Belaga", ku ka thënë: "*Vërtet, All'llahu i Lartësuar i ka krijuar krijesat dhe Ai është i Panevojshëm për bindjen e tyre dhe i Ruajtur nga mëkatet e tyre, sepse Atë nuk e dëmton mëkati i mëkatarit dhe nuk i sjell dobi bindja e bindësit.*"¹

Herën e tretë, All'llahu i Plotfuqishëm përmend pushtetin e Tij absolut që ka në qiej e në Tokë si premisë për përmbajtjen e ajetit 133. Pastaj, All'llahu i Madhëruar sqaron se Ai nuk heziton që ta zhdukë një popull nga ekzistenca dhe të sjellë në vend të tij një popull tjetër më të aftë, më të vendosur dhe më të përkushtuar në bindjen dhe adhurimin e Tij: "**Nëse do, Ai ju dëbon ju o njerëz dhe sjell të tjerë. All'llahu ka fuqi ta bëjë këtë.**"

Në tefsirin "Et Tibjan" dhe në tefsirin "Mexhmaul Bejan" është transmetuar nga Profeti Muhammed (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) se kur ka zbritur ky ajet është mbështetur në shpatullën e Selman Farisiut dhe ka thënë se kuptimi i fjalës "të tjerë" në këtë ajet, është për një popull joarab.²

¹ Nehxhul Belaga, fjalimi 193.

² Tefsiri Mexhmaul Bejan, vëll. 3, f. 210.

Për ajetin e fundit nga këto katër ajete, ka ardhur një transmetim që tregon për disa njerëz, të cilët thonë se jemi myslimanë, marrin pjesë në fushën e betejës, zbatojnë rregullat islame, por nuk i bëjnë për hir të All'llahut. Qëllimi i tyre është për të arritur përfitime materiale, siç është plaçka e luftës. Ky ajet u thotë atyre që kërkojnë të mirat materiale të kësaj jete se ata janë hamendësues në kërkesën e tyre, sepse tek All'llahu i Lartësuar është shpërblimi i kësaj bote dhe i Botës Tjetër. Ajeti thotë: **"Kush dëshiron shpërblimin e kësaj bote, (le ta dijë se) tek All'llahu janë shpërblimi i kësaj dhe i Botës Tjetër..."**

Përse ata nuk kërkojnë dhe nuk shpresojnë në shpërblimin e të dy botëve? All'llahu i di qëllimet e të gjithëve. Ai dëgjon çdo zë, shikon gjithçka dhe është i Gjithëditur për veprat e hipokritëve: **"...All'llahu dëgjon dhe vështron çdo gjë."**

Ky ajet i fundit përsërit të vërtetën se Islami nuk shikon vetëm anën shpirtërore dhe Botën Tjetër, por i nxit ndjekësit e tij për lumturinë materiale dhe shpirtërore së bashku.

Ajeti 135

﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا كُونُوا قَوَّامِينَ بِالْقِسْطِ شُهَدَاءَ لِلّٰهِ وَلَوْ عَلَىٰ
 أَنفُسِكُمْ أَوِ الْوَالِدِينَ وَالْأَقْرَبِينَ ۚ إِن يَكُنْ غَنِيًّا أَوْ فَقِيرًا فَاللّٰهُ أَوْلَىٰ بِهِمَا
 ۖ فَلَا تَتَّبِعُوا أَهْوَىٰ ۚ أَن تَعْدِلُوا ۚ وَإِن تَلَوُّرًا أَوْ تَعْرِضُوا فَإِنَّ اللَّهَ كَانَ بِمَا
 تَعْمَلُونَ خَبِيرًا ۝﴾

"O ju që keni besuar! Bëhuni zbatues të palëkundur të drejtësisë, duke dëshmuar në emër të All'Ilahut, qoftë edhe kundër jush ose kundër prindërve dhe të afërmve tuaj. Qoftë i pasur ose i varfër ai (për të cilin dëshmoni), All'Ilahu është për ata vlerësuesi më i drejtë. Dhe mos shkoni pas epsheve tuaja e të shtrembëroni drejtësinë! Nëse ju ngatërroni dëshminë ose i shmangeni asaj, vërtet që All'Ilahu e di se çfarë bëni ju."

Komentimi

Drejtësia shoqërore

Në vazhdim të rregullave të përmendura në ajetet e mëparshme rreth zbatimit të drejtësisë me jetimët dhe gratë, ky ajet tregon një parim thelbësor dhe një ligj të përgjithshëm në fushën e zbatimit të drejtësisë në të gjitha çështjet, pa përjashtim.

Ai i urdhëron të gjithë besimtarët që të zbatojnë drejtësinë, ku thotë: **"O ju që keni besuar! Bëhuni zbatues të palëkundur të drejtësisë..."**

Fjala "kauamine", që përmendet në këtë ajet, është shumësi i fjalës "kauam" dhe ajo është hipërbolë e fjalës "kaim", që do të thotë "shumë zbatues". Pra besimtarët duhet ta zbatojnë drejtësinë në çdo rast, në çdo vepër dhe në çdo kohë e vend, me qëllim që drejtësia të bëhet pjesë e natyrës dhe e moralit të tyre, kurse devijimi nga drejtësia të jetë në kundërshtim me natyrën dhe shpirtin e tyre.

Ardhja e fjalës "kijam" në këtë vend mund të jetë për shkak se kur njeriu dëshiron të kryejë një punë, në përgjithësi, ai duhet të ngrihet në këmbë dhe të vazhdojë kryerjen e saj. Bazuar mbi këtë, përdorimi i fjalës "kijam" këtu është metaforë për vendosmërinë dhe dëshirën e fortë për të kryer një punë, qoftë kjo punë edhe ajo e gjykatësit, i cili nuk ka nevojë për t'u ngritur që të kryejë punën e tij.

Mundet që përshkrimi me fjalën "kijam" të jetë zbatim apo ngritje. Ai ka ardhur për një arsye tjetër dhe ajo është fjala "kaim", që zakonisht përdoret për diçka që qëndron në formë vertikale e të drejtë mbi tokë pa u devijuar as djathtas e as majtas. Për këtë, kuptimi i ardhur në këtë ajet është përforcues për domosdoshmërinë e zbatimit të drejtësisë pa asnjë devijim të vogël në çfarëdo drejtimi.

Për të përforcuar temën, në ajet përmendet fjala "esh shehadetu", e cila përforcon edhe më shumë domosdoshmërinë e largimit nga çdo sugjerim dhe lajkatim gjatë kryerjes së dëshmisë

dhe qëllimi i dëshmisë të jetë vetëm fitimi i kënaqësinë së All'Ilahut, edhe nëse dëshmia i sjell dëm vetë dëshmuesit, familjes apo të afërmve të tij. Ajeti thotë: **"...duke dëshmuar në emër të All'Ilahut, qoftë edhe kundër jush ose kundër prindërve dhe të afërmve tuaj..."**

Kjo çështje është e përhapur në çdo shoqëri, veçanërisht në shoqëritë injorante, ku dëshmia mateg me sasinë e dashurisë dhe të urrejtjes dhe në llojin e afrimitetit mes njerëzve dhe dëshmuesit, pa zbatuar aspak drejtësinë dhe të vërtetën në ato që bënin.

Është transmetuar nga ibn Abasi një hadith, nga i cili përfitohet se myslimanët e rinj, pasi arritën në Medine, nuk jepnin dëshmi kur kishte lidhje të afërt dhe kur dëshmia dëmtonte interesat e të afërmve të tyre. Atëherë zbriti ky ajet që u tërheq vërejtjen atyre.¹

Sikurse tregon ajeti, me të vërtetë, kjo vepër nuk përshtatet me shpirtin e besimit, sepse besimtari i vërtetë është ai person, i cili nuk i jep rëndësi konsideratave në fushën e së vërtetës e të drejtësisë; nuk e vë re dobinë e tij dhe dobinë e të afërmeve të tij në zbatimin e së vërtetës dhe të drejtësisë. Nga ky ajet përfitohet se të afërmit kanë të drejtën e dëshmisë, në interes apo në dëm të njëri-tjetrit, por me kusht që të ruhet parimi i drejtësisë.

Pas kësaj, ajeti tregon faktorët e devijimit nga parimi i drejtësisë dhe sqaron se pasuria e të pasurve nuk duhet të pengojë dhënien e dëshmisë së drejtë. Po ashtu, edhe ndjenjat që lëvizin në brendinë e njeriut për të varfërit, nuk duhet ta pengojnë dhënien e dëshmisë së drejtë, edhe nëse përfundimi i saj është në dëm të

¹ Tefsiri El Manar, vëll. 5, f. 455.

tyre, sepse All'llahu e di më mirë se kushdo tjetër gjendjen e atyre që dëshmojnë drejtë edhe kur është kundër tyre. As sundimtari e as pushtetari nuk mund ta dëmtojë një njeri që është nën mbrojtjen e All'llahut dhe as i varfri nuk do të qëndrojë i uritur për shkak të zbatimit të drejtësisë. Për këtë ajeti thotë: **"...Qoftë i pasur ose i varfër ai (për të cilin dëshmoni), All'llahu është për ata vlerësuesi më i drejtë..."**

Ajeti e gjykon ndjekjen e egos dhe të epshit me qëllim që të mos mbetet asnjë pengesë përpara rrugëtimit të drejtësisë dhe realizimit të saj. Ajeti thotë: **"...Dhe mos shkoni pas epsheve tuaja e të shtrembëroni drejtësinë."**¹

Nga kjo shprehje qartësohet se burimi i padrejtësisë është ndjekja e egos dhe e epsheve. Shoqëria, të cilën nuk e udhëheq epshi, është e siguruar nga padrejtësia.

Për shkak të rëndësisë së tematikës së realizimit të drejtësisë Kur'ani e përforcon përsëri këtë rregull dhe sqaron se All'llahu është i Ditur për veprat e robve dhe Ai dëshmon dhe shikon çdo gjë që e pengon të zotin e së drejtës nga e drejta e tij, devijimin e së vërtetës dhe kundërshtimin e të drejtës pas sqarimit të saj. All'llahu i Lartësuar thotë: **"...Nëse ju ngatërmoni dëshminë ose i shmangeni asaj, vërtet që All'llahu është i Mirëinformuar për atë që bëni ju."**

¹ Ka mundësi që fjala "ta'diluu" ose të rrjedhë nga lënda "el adaletu" ose nga lënda "el uduul". Nëse rrjedh nga lënda "el adaletu", atëherë fjalia kur'anore ka këtë kuptim: Prandaj, mos shkoni pas epsheve, që të bëni drejtësi, pra të mund të realizoni drejtësinë. Nëse rrjedh nga lënda "el uduul", kuptimi i fjalisë është kështu: Mos shkoni pas epsheve në rrugën e devijimit nga e vërteta.

Fjala **"nëse ju ngatërrohi dëshminë"**, në të vërtetë, tregon për devijimin e së vërtetës dhe ndryshimin e saj, kurse fjala **"ose i shmangeni asaj"** tregon për ndalimin e gjykimit me drejtësi. Kjo fjalë është po e njëjta gjë e transmetuar nga imam Bakiri (Paqja qoftë mbi të!).

Është interesante se ajeti përfundon me fjalën "khabijr", që do të thotë "i Mirëinformuar" dhe nuk përfundon me fjalën "alijm", që do të thotë "i Gjithëditur". Kjo vjen sepse fjala "khabijr" (i Mirëinformuar) përdoret për atë që di imtësisht një çështje të veçantë. Në këtë ka argument se All'llahu di edhe devijimin më të vogël që kryen njeriu.

Ajeti konstaton interesimin e Islamit për çështjen e drejtësisë shoqërore. Në vende të përsëritura në këtë ajet sqarohet ky interesim që i kushton Islami çështjeve delikate njerëzore e shoqërore.

Është për të ardhur keq kur shohim dallim të madh mes veprave të myslimanëve dhe këtij rregulli të madhërueshëm islam. Sigurisht, ky është sekreti i prapambetjes së myslimanëve.

Ajeti 136

يٰۤاَيُّهَا الَّذِيْنَ ءَامَنُوْا ءَامِنُوْا بِاللّٰهِ وَرَسُوْلِهِۦ ۚ وَٱلْكِتٰبِ الَّذِى نَزَّلَ عَلٰى
 رَسُوْلِهِۦ ۚ وَٱلْكِتٰبِ الَّذِىۤ اُنزِلَ مِنْ قَبْلُ ۚ وَمَنْ يَّكْفُرْ بِاللّٰهِ وَمَلٰٓئِكَتِهٖ
 وَكُتُبِهٖ وَرُسُلِهٖ ۚ وَٱلْيَوْمِۤ اٰخِرِ فَقَدْ ضَلَّ ضَلٰلًاۢ بَعِيْدًا ﴿١٣٦﴾

"O ju që keni besuar! Besoni All'llahun, të Dërguarin e Tij, Librin, që ia ka zbritur të Dërguarit të Tij dhe Librin që e ka zbritur më parë. Kushdo që mohon All'llahun, Melekët e Tij, Librat e Tij, të Dërguarit e Tij dhe Ditën e Kiametit, ai, me të vërtetë, ka humbur larg prej udhës së drejtë."

Shkaku i zbritjes

Është transmetuar nga ibn Abasi se ky ajet ka zbritur për çështjen e një grupi prej personaliteteve të mëdhenj të ithtarëve të Librit si: Abdullah ibn Selam, Esed ibn Ka'b, vëllai i tij Usejd ibn Ka'b dhe disa të tjerë. Shkaku është se ata, që në fillim, shkuan tek Profeti (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe i thanë atij se kanë besuar në të, në librin e Zotit, në Musain (Paqja qoftë mbi të!) dhe në Teuratin dhe nuk besojnë në Profetët e tjerë. Atëherë zbriti ky ajet dhe u mësoi atyre

domosdoshmërinë e besimit në të gjithë Profetët dhe në të gjithë librat e Zotit.¹

Komentimi

Nga shkak u zbritjes qartësohet se fjalët në këtë ajet u drejtohen një grupi besimtarësh prej ithtarëve të Librit, të cilët e pranuan Islamin. Për shkak të fanatizmit të tyre, ata kundërshtuan besimin në Profetët dhe në librat e Zotit që erdhën para Islamit, me përjashtim të fesë që ishin më parë. Ky ajet ka ardhur që t'i këshillojë ata se është i domosdoshëm besimi dhe pohimi i të gjithë Profetëve dhe i librave të Zotit, sepse të gjithë kanë një qëllim të vetëm dhe janë të dërguar nga All'llahu i Vetëm e i Pashoq. (Secili prej tyre ka gradën e tij të veçantë dhe secili prej tyre ka ardhur për të plotësuar atë fe dhe sheriat që solli Profeti.)

Për këtë, nuk ka kuptim pranimi i disa prej tyre dhe mohimi i disa të tjerëve nga ata Profetë dhe të dërguar. E vërteta është një dhe fanatizmi nuk mund të qëndrojë përballë të vërtetave. Për këtë, ajeti thotë: **"O ju që keni besuar! Besoni All'llahun, të Dërguarin e Tij, Librin që ia ka zbritur të Dërguarit të Tij dhe Librin që e ka zbritur më parë..."**

Pavarësisht shkakut të zbritjes që u përmend më lart, ne në komentimin tonë të këtij ajeti, themi se fjalët janë për të gjithë besimtarët në përgjithësi. Këto fjalë janë për ata që e përqaftuan Islamin e që akoma Islami nuk ka depërtuar në thellësi të zemrave të tyre. Për këtë arsye, Islami u kërkon atyre që të jenë besimtarë në brendësinë e tyre. Një alternativë tjetër mund të jetë që këto fjalë në këtë ajet janë për të gjithë besimtarët të cilët kanë besuar

¹ Tefsiri Mexhmaul Bejan, vëll. 3, f. 214. Tefsiri Durul Menthur, vëll. 2, f. 234.

në formë të përgjithshme në All'llahun dhe në Profetët e Tij, mirëpo ata akoma nuk i kanë njohur detajet e doktrinës islame. Nga kjo pikënisje, Kur'ani qartëson se besimtarët e vërtetë duhet të besojnë në të gjithë Profetët, në të gjithë librat e mëparshëm qiellorë dhe në melekët e All'llahut, sepse mosbesimi në to, tregon mohimin e urtësisë së All'llahut. A mundet All'llahu t'i lërë popujt e mëparshëm pa prijës dhe udhëheqës që t'i udhëzojë ata në jetën e tyre?!

Melekët e përmendur në këtë ajet janë vetëm melekët e Shpalljes, besimi tek të cilët është si besimi i domosdoshëm në Profetët dhe në librat qiellorë apo janë të gjithë melekët në përgjithësi? Ashtu sikurse disa melekë janë të ngarkuar me çështjen e Shpalljes dhe të legjislacionit, po ashtu edhe një grup tjetër janë të ngarkuar me detyra të tjera në këtë botë. Me të vërtetë besimi në to është pjesë e besimit në All'llahun e Lartësuar. Në mbyllje, ajeti qartëson të ardhmen e atyre që i injorojnë këto të vërteta, ku thotë: **"...Kushdo që mohon All'llahun, Melekët e Tij, Librat e Tij, të Dërguarit e Tij dhe Ditën e Kiametit, ai, me të vërtetë, ka humbur larg prej udhës së drejtë."**

Në këtë ajet besimi konsiderohet i detyruar në pesë parime. Në shtesë të besimit në fillimin e krijimit e të Ringjalljes, besimi është i domosdoshëm dhe i detyruar edhe në librat qiellorë, në Profetët dhe në melekët.

Me të vërtetë shprehja kur'anore: **"...ka humbur larg..."** është një shprehje që do të thotë se ata të cilët nuk besojnë në këto pesë parime të përmendura më lart, kanë devijuar nga rruga e drejtë e parimeve dhe se kthimi i tyre në këtë rrugë nuk realizohet lehtë.

Ajetet 137 - 139

إِنَّ الَّذِينَ ءَامَنُوا ثُمَّ كَفَرُوا ثُمَّ ءَامَنُوا ثُمَّ كَفَرُوا ثُمَّ ءَزَدُوا كُفْرًا لَّمْ
يَكُنِ اللَّهُ لِيَغْفِرْ لَهُمْ وَلَا لِيَهْدِيَهُمْ سَبِيلًا ﴿١٣٧﴾ بَشِّرِ الْمُنَافِقِينَ بِأَنَّ لَهُمْ
عَذَابًا أَلِيمًا ﴿١٣٨﴾ الَّذِينَ يَتَّخِذُونَ الْكَافِرِينَ أَوْلِيَاءَ مِنْ دُونِ الْمُؤْمِنِينَ
أَيَّتَعُوثَ عِنْدَهُمُ الْعِزَّةَ فَإِنَّ الْعِزَّةَ لِلَّهِ جَمِيعًا ﴿١٣٩﴾

"Ata që në fillim besojnë dhe pastaj e mohojnë besimin, më pas sërish besojnë dhe sërish e mohojnë besimin dhe thellohen në mosbesim, All'Ilahu, me të vërtetë, nuk do t'i falë dhe nuk do t'i shpjerë në rrugë të drejtë."

"Paralajmëroji hipokritët (o Muhammed) për dënimin e mjerueshëm që i pret."

"Ata që miqësohen me mohuesit e jo me besimtarët! Vallë, tek ata kërkojnë fuqi, kur, në të vërtetë, e gjithë fuqia i përket vetëm All'Ilahut!"

Komentimi

E ardhmja e hipokritëve kokëfortë

Në vazhdim të hulumtimit të mëparshëm, i cili trajtoi gjendjen e jobesimtarëve dhe humbjen e largët të tyre, këto ajete tregojnë gjendjen e një grupi prej jobesimtarëve të cilët çdo ditë ngjyrosen me ngjyra të ndryshme si kameleon. Një ditë ata janë pranë besimtarëve dhe në një ditë tjetër janë pranë jobesimtarëve, pastaj kthehen tek besimtarët dhe në fund janë pranë jobesimtarëve kokëfortë derisa vdesin në këtë gjendje.

Ajeti i parë prej këtyre tre ajeteve flet për të ardhmen e njerëzve jobesimtarë dhe dëshmon se All'llahu nuk i fal kurrë dhe nuk i udhëzon në rrugën e drejtë. Ajeti thotë: **"Ata që në fillim besojnë dhe pastaj e mohojnë besimin, më pas sërish besojnë dhe sërish e mohojnë besimin dhe thellohen në mosbesim, All'llahu, me të vërtetë, nuk do t'i falë dhe nuk do t'i shpjerë në rrugë të drejtë."**

Me të vërtetë, kjo është një sjellje kameleoni në ngjyrim të vazhdueshëm. Kjo sjellje, ose buron nga injoranca dhe mosnjohja e bazave themelore të Islamit, ose është plan të cilin e zbatuan hipokritët dhe jobesimtarët ekstremistë nga ithtarët e Librit për t'ia lëkundur besimin mysliimanëve të vërtetë. Këtë temë e kemi shpjeguar në ajetin 72 të sures "Ali Imran".

Ajeti në fjalë nuk tregon për mospranimin e pendimit të tyre, por flet për persona që vdesin dhe janë në mosbesim të ashpër. Si pasojë e veprave të tyre, nuk e meritojnë faljen dhe udhëzimin vetëm nëse ndryshojnë sjelljen e tyre.

Pastaj, ajeti në vazhdim tregon llojin e ndëshkimit që meritojnë, ku thotë: "**Paralajmëroji hipokritët** (o Muhammed) **për dënimin e mjerueshëm që i pret.**"

Përdorimi i shprehjes "beshir", në këtë ajet ka ardhur si përçmim dhe tallje për mendimet e kota dhe boshe që e mbartin atë hipokrit. Mundet që fjala rrjedh nga rrënja "bishrun" - fytyrë. Në këtë mënyrë, kjo fjalë mbart kuptime të gjera dhe përfshin çdo lajm që ndikon në pamjen e fytyrës së njeriut, qoftë lajm i gëzuar a i hidhur.

Ajeti i fundit tregon se hipokritët, me të vërtetë, i marrin jobesimtarët shokë dhe të dashur për ta në vend të besimtarëve, ku thotë: "**Ata që miqësohen me mohuesit e jo me besimtarët!...**"

Pastaj në këtë ajet vjen pyetja se cili është qëllimi i hipokritëve në shoqërimin e jobesimtarëve. A dëshirojnë ata me të vërtetë që të përfitojnë krenari dhe fuqi nëpërmjet kësaj shoqërie e miqësie? Ajeti thotë: "**...Vallë, tek ata kërkojnë fuqi...**", ndërkohë që fuqia dhe krenaria i takojnë All'llahut: "**...kur, në të vërtetë, e gjithë fuqia i përket vetëm All'llahut!**", sepse fuqia buron nga dija dhe forca dhe jobesimtarët nuk kanë as fuqi dhe as dije. Për këtë, dija e tyre, gjithashtu, nuk është asgjë dhe nuk mund të bëjnë asgjë që të jenë burim i krenarisë dhe i fuqisë.

Me të vërtetë, ky ajet është paralajmërim për myslimanët që të mos kërkojnë forcë dhe krenari në çështjet e tyre ekonomike, politike, shoqërore e kulturore apo të mos kërkojnë rrugë për të krijuar lidhje miqësore e shoqërore me armiqtë e Islamit. Por, është detyrim i tyre që të mbështeten tek All'llahu i Plotfuqishëm, i Cili është burimi absolut i krenarisë dhe i fuqisë. Armiqtë e

Islamit nuk kanë fuqi që t'ia dhurojnë atë të tjerëve. Edhe sikur ta kenë, nuk do të ishte e mundur për t'u mbështetur tek ata, sepse me të mbaruar interesin e tyre, e braktisin aleatin më të afërt dhe nxitojnë pas interesave të veta. Ata hiqen sikur nuk i njohin aleatët e mëparshëm. Historia bashkëkohore është argumenti më i mirë për këtë sjellje dobiprurëse dhe oportuniste.

Ajeti 140

وَقَدْ نَزَّلَ عَلَيْكُمْ فِي الْكِتَابِ أَنْ إِذَا سَمِعْتُمْ آيَاتِ اللَّهِ يُكْفَرُ بِهَا وَيُسْتَهْزَأُ
بِهَا فَلَا تَقْعُدُوا مَعَهُمْ حَتَّى تَخُوضُوا فِي حَدِيثٍ غَيْرِهِ ^ج إِنَّكُمْ إِذَا مِثْلُهُمْ ^ق
إِنَّ اللَّهَ جَامِعُ الْمُنَافِقِينَ وَالْكَافِرِينَ فِي جَهَنَّمَ جَمِيعًا ﴿١٤٠﴾

"Ai jua ka shpallur në Libër: Kur të dëgjoni se mohohen fjalët e All'Ilahut dhe bëhet tallje me to, atëherë mos rrini me ata (njerëz që veprojnë kështu), derisa të ndërrojnë bisedë, përndryshe do të ishit si ata. All'Ilahu do t'i tubojë në Xhehennem të gjithë hipokritët dhe mohuesit."

Shkaku i zbritjes

Transmetohet nga ibn Abasi se një grup prej hipokritëve janë paraqitur në tubimet e dijetarëve të jehudijve duke u tallur me ajetet e Kur'anit dhe ka zbritur ky ajet që qartëson përfundimin e tyre pesimist për këto tubime.¹

Komentimi

¹ Tefsiri Mexhmaul Bejan, vëll. 3, f. 217.

Ndalimi i pjesëmarrjes në tubimet, ku i bëhet mëkat All'Ilahut

Në ajetin 68 të sures "El En'am" përmendet një urdhër i qartë i Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) që të largohet nga ata njerëz të cilët tallen me ajetet e Kur'anit dhe flasin për to fjalë që nuk u ka hije. Natyrisht që ky rregull nuk është i kufizuar vetëm për Profetin, por konsiderohet rregull dhe urdhër i përgjithshëm dhe duhet që të gjithë myslimanët ta zbatojnë atë. Ky rregull ka ardhur në formë bisede që i drejtohet Profetit dhe filozofia e tij është shumë e qartë.

Ky ajet e përsërit rregullin e cekur më lart për të dytën herë dhe i paralajmëron myslimanët duke u kujtuar atyre rregullin e mëparshëm në Kur'an që i ndalon ata të marrin pjesë në tubimet ku tallet dhe mohohet Kur'ani, me qëllim që organizatorët e këtyre tubimeve të ndalojnë fyerjet dhe të bisedojnë për diçka tjetër: **"Ai jua ka shpallur në Libër: Kur të dëgjoni se mohohen fjalët e All'Ilahut dhe bëhet tallje me to, atëherë mos rrini me ata (njerëz që veprojnë kështu), derisa të ndërrojnë bisedë..."**

Pas kësaj ajeti na sqaron rezultatin e kësaj vepre dhe përforcon se kush merr pjesë në tubimet ku tallet Kur'ani, ai është si pjesëmarrësit e tjerë dhe e ardhmja e tij do të jetë si e ardhmja e atyre që tallen. Ajeti thotë: **"...përndryshe do të ishit si ata..."**

Pastaj ajeti e përsërit përforcimin duke thënë se pjesëmarrja në tubimet e përmendura tregon shpirtin e hipokrizisë, të cilën e mbartin pjesëmarrësit dhe me të vërtetë All'Ilahu i bashkon hipokritët dhe jobesimtarët në Xhehennem, në të cilin ka

ndëshkim të dhimbshëm. Ajeti thotë: **All'lahu do t'i tubojë në Xhehennem të gjithë hipokritët dhe mohuesit."**

Hulumtime

Ajeti na lajmëron për disa çështje:

1- Me të vërtetë, pjesëmarrja në tubimet e mëkatarëve është si pjesëmarrja në mëkat, edhe nëse pjesëmarrësi rri në heshtje dhe nuk merr pjesë në talljet me fjalë, sepse heshtja në këto raste është argument se personi që hesht është i kënaqur me mëkatin e bërë.

2- Nëse ndalimi nga e keqja është i vështirë të bëhet në një formë pozitive, patjetër ndalimi duhet të realizohet qoftë edhe në formë negative, siç mund të jetë largimi dhe mosprania në ato tubime.

3- Ata që i nxisin mëkatarët me heshtjen e tyre dhe me praninë e tyre në këto tubimet mëkatore, në të vërtetë, ata do të ndëshkohen siç do të ndëshkohen mëkatarët.

4- Nuk është problem pjesëmarrja në tubimin e jobesimtarëve, nëse ata nuk tallen dhe nuk i mohojnë ajetet e All'lahut dhe ky tubim nuk mbart ndonjë rrezik tjetër. Ai tregon për lejimin e pjesëmarrjes në tubimin e jobesimtarëve, të cilët nuk i bëjnë mëkat All'lahut në to, ku thotë: **"...derisa të ndërrojnë bisedë..."**.

5- Në të vërtetë, lajkatimi dhe komplimentet me mëkatarët tregojnë ekzistencën e shpirtit të hipokrizisë te personi lajkatar. Kjo sepse myslimani i vërtetë e realist nuk mund të marrë pjesë në

tubimet në të cilat i bëhet mëkat All'llahut dhe tallen në të ajetet dhe rregullat e Tij madhështore. Ai nuk rri duarkryq kur dëgjon talljet dhe mohimet, por i kundërshton ato ose nuk merr pjesë fare në ato tubime.

Ajeti 141

الَّذِينَ يَتَّبِعُونَ بِكُفْرٍ فَإِنْ كَانَ لَكُمْ فَتْحٌ مِّنَ اللَّهِ قَالُوا أَلَمْ نَكُن مَّعَكُمْ
وَإِنْ كَانَ لِلْكَافِرِينَ نَصِيبٌ قَالُوا أَلَمْ نَسْتَحِذْ عَلَيْكُمْ وَنَمْنَعَكُمْ مِّنَ
الْمُؤْمِنِينَ ۚ فَاللَّهُ يَحْكُمُ بَيْنَكُمْ يَوْمَ الْقِيَمَةِ ۖ وَلَنُجْزِلَنَّ اللَّهُ لِلْكَافِرِينَ
عَلَى الْمُؤْمِنِينَ سَيِّئًا ﴿١٤١﴾

"Ata përgjojnë se çfarë do të bëhet me ju. Kështu, nëse ju vjen fitorja nga All'Ilahu, ata thonë: 'A nuk ishim vallë ne me ju?' E, nëse mohuesit arrijnë fitore, hipokritët u thonë: 'A thua nuk ju ndihmuam deri në fitore dhe ju mbrojtëm prej besimtarëve të vërtetë?' All'Ilahu do të gjykojë ndërmjet jush në Ditën e Kiametit. All'Ilahu nuk do t'iu japë kurrë rast mohuesve që t'i shkatërrojnë besimtarët."

Komentimi

Cilësitë e hipokritëve

Ky ajet, si dhe ajetet në vazhdim, tregojnë një pjesë tjetër të cilësive të hipokritëve dhe të mendimeve të tyre konfuze e të sëmura. Ajeti dëshmon dhe përforcon se hipokritët gjithmonë garojnë për të shfrytëzuar çdo ndodhi apo ngjarje në dobi të tyre.

Kur triumfonin myslimanët, hipokritët mundoheshin që të hynin në rreshtat e besimtarëve duke pretenduar se ata morën pjesë me besimtarët në realizimin e fitores dhe pretendonin se u kanë dhënë ndihmesë besimtarëve në këtë fushë. Me këtë kërkonin shoqërimin e besimtarëve në frytet shpirtërore e materiale për fitoren. Ajeti thotë: **"Ata përgjojnë se çfarë do të bëhet me ju. Kështu, nëse ju vjen fitorja nga All'illahu, ata thonë: "A nuk ishim vallë ne me ju?"**

Kur fitorja e jashtme u takon armiqve të Islami, hipokritët i ndryshojnë faqet e tyre dhe u afrohen atyre armiqëve duke u shfaqur atyre kënaqësi dhe u thonë se ishin ata që i nxitën për të luftuar me myslimanët dhe të mos u dorëzoheshin atyre. Ata pretendojnë se janë partnerë në fitoren që realizuan armiqtë e Islamit. Ajeti thotë: **E, nëse mohuesit arrijnë fitore, hipokritët u thonë: "A thua nuk ju ndihmuam deri në fitore dhe ju mbrojtëm prej besimtarëve të vërtetë?"**

Me këtë formë hipokritët u munduan ta shfrytëzonin momentin e fitores së myslimanëve që edhe ata të kenë pjesë nga kjo fitore dhe të merrnin pjesë në ndarjen e plaçkave të luftës dhe për t'iu mburrur myslimanëve. Ndërsa, në rastin e humbjes së myslimanëve, ky grup shfaqte kënaqësinë dhe gëzimin tek jobesimtarët dhe i nxisin ata që të këmbëngulnin në mosbesimin e tyre, spiunonin për interesat e tyre dhe u pregatisin atyre shkaqet e fitores materiale. Pra, ata herë bëhen shoqërues me jobesimtarët dhe herë tjetër bëhen partnerë të tyre në krim. Në këtë mënyrë ata e kalojnë jetën e tyre me ngjyrosje, hipokrizi dhe lojë me litarë të ndryshëm.

Por, Kur'ani i shenjtë me një shprehje të vetme sqaron të ardhmen e tyre dhe përfundimin e tyre të zyrtë. Ai sqaron se për ata, padyshim, do të vijë ajo ditë në të cilën do të hiqen perdet dhe do të zbulohen krimet e tyre dhe do të çirret maska nga fytyrat e tyre të urryera. Në atë ditë, që është Dita e Kijametit, All'llahu do të jetë Gjykuesi i tyre dhe Ai është Gjykuesi më i mirë. Ajeti thotë: **"...All'llahu do të gjykojë ndërmjet jush në Ditën e Kiametit..."**

Me qëllim që Kur'ani t'i qetësojë besimtarët e vërtetë nga rreziku i atyre, ky ajet përforcon në fund të tij se All'llahu nuk do t'i mundësojë kurrë jobesimtarët që të triumfojnë apo të sundojnë mbi myslimanët ku thotë: **"...All'llahu nuk do t'iu japë kurrë rast mohuesve që t'i shkatërrojnë besimtarët."**

Meqenëse fjala "*sebijl*" është e pashquar dhe ka ardhur në kontekstin mohues, ajo përçon një kuptim të përgjithshëm. Për këtë, nga ajeti kuptohet se mohuesit, jo vetëm që nuk triumfojnë logjikisht ndaj besimtarëve, por ata kurrë nuk do të triumfojnë e nuk do t'i sundojnë besimtarët në asnjë fushë ushtarake, politike, kulturore, ekonomike etj.

Nëse shohim triumf të mohuesve ndaj myslimanëve në disa fusha të ndryshme, shkaku është se ata myslimanë kanë harruar etikën dhe traditat e tyre të besimit, kanë harruar përgjegjësinë dhe detyrat e tyre dhe nuk i kryejnë detyrimet fetare. Nuk ka fjalë për bashkim, unitet dhe vllazërim islam ndërmjet tyre dhe as ata nuk e kryejnë detyrën e xhihazit me kuptimin e tij. Gjithashtu, nuk interesohen për ta kërkuar e përfituar diturinë, të cilën u ka detyruar Islami dhe e ka bërë atë detyrë për çdo mysliman dhe myslimane. Ai fton në kërkimin e dijes nga lindja e deri në vdekje, siç ka thënë Profeti Muhammed

(Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!): "*Kërkoje diturinë që nga djepi deri në varr.*"

Meqenëse u bënë të tillë, e merituan të jenë të mposhtur nga jobesimtarët.

Disa juristë islamë (fukahatë) me këtë ajet kanë argumentuar se jobesimtarët nuk mund të sundojnë mbi myslimanët nga ana e të drejtave dhe të qeverisjes. Duke parë përgjithësinë në këtë ajet, nuk është e largët që ky ajet gjithashtu ta përfshijë këtë çështje.

Ajo që tërheq vëmendjen në këtë ajet është fitorja e myslimanëve. Është përdorur fjala "fet'h" për fitoren e myslimanëve, ndërsa për fitoren e jobesimtarëve është përdorur fjala "nasijb". Kjo tregon se fitorja e jobesimtarëve është pjesë e kufizuar dhe kalimtare, kurse fitorja dhe triumfi i vërtetë në fund u takon besimtarëve.

Ajetet 142 - 143

إِنَّ الْمُنْفِقِينَ يُخَدِّعُونَ اللَّهَ وَهُوَ خَدِيعُهُمْ وَإِذَا قَامُوا إِلَى الصَّلَاةِ

قَامُوا كُسَالَى يُرَآؤُنَ النَّاسَ وَلَا يَذْكُرُونَ اللَّهَ إِلَّا قَلِيلًا ﴿١٤٢﴾

مُذَبِّبِينَ بَيْنَ ذَلِكَ لَا إِلَى هَؤُلَاءِ وَلَا إِلَى هَؤُلَاءِ وَمَنْ يُضِلِلِ اللَّهُ فَلَنْ

يُجِدَ لَهُ سَبِيلًا ﴿١٤٣﴾

"Në të vërtetë, hipokritët përpiqen të mashtrojnë All'llahun, por është Ai që i mashton ata. Kur ata ngrihen për namaz, ngrihen me përtesë, vetëm sa për t'u dukur para botës dhe All'llahun e përmendin fare pak."

Luhaten në mëdyshje, - nuk janë as me këta, as me ata. Këdo që All'llahu shpie në humbje, ti (o Muhammed!) nuk do të mundesh t'ia gjesh rrugën."

Komentimi

Në këtë ajet, me pak fjalë, përmenden pesë cilësi të hipokritit, që janë:

1- Ata hipokritë, për të realizuar qëllimet e tyre të ulta, ndjekin rrugën e mashtimit. Sipas mendimit të tyre, ata dëshirojnë, gjithashtu, të mashtrojnë All'llahun e Lartësuar.

Mirëpo, në të njëjtën kohë që duan të mashtrojnë, ata pa e

ndier bien në kurthin e mashtrimit dhe të intrigës së tyre. Me qëllim që të fitojnë pasuri të pavlera materiale, ata humbasin pasuritë më të mëdha që ndodhen në brendinë e tyre. Për këtë, ajeti thotë: **"Në të vërtetë, hipokritët përpiqen të mashtrojnë All'llahun, por është Ai që i mashtron ata..."**

Në një histori tregohet se një njeri me post i këshillonte punëtorët profesionistë të vendit të tij që të kishin kujdes nga mashtrimet e udhëtarëve të huaj. Njëri prej tyre tha: "Si është e mundur që të huajt që janë primitivë dhe nuk dinë asgjë nga vendndodhja e qytetit dhe e banorëve të tij, të mashtrojnë punëtorët profesionistë?" Ai u përgjigj se qëllimi i tij me këtë mashtrim të të huajve ishte në kuptimin që ata të merrnin nga të mirat materiale me mashtrim dhe të humbisnin me këtë mashtrim pasurinë më të madhe besimin.

2- Me të vërtetë, hipokritët janë larg mëshirës së All'llahut dhe për këtë ata nuk e shijojnë adhurimin e Tij dhe as afrimin tek Ai. Këtë e tregon argumenti se ata kur dëshirojnë të falin namazin ngrihen me përtaci, ku ajeti thotë: **"...Kur ata ngrihen për namaz, ngrihen me përtësë..."**

3- Përderisa hipokritët nuk besojnë në All'llahun dhe në premtimet e Tij, kur ngrihen për të kryer një adhurim të veçantë, atë e bëjnë për t'u dukur dhe për t'u shtirur dhe jo për të arritur kënaqësinë e All'llahut të Lartësuar. Ajeti thotë: **"...vetëm sa për t'u dukur para botës..."**

4- Nëse shprehin me gojët e tyre diçka nga përmendja e All'llahut, kjo përmendje nuk e kalon kufirin e gojës, sepse ajo përmendje nuk është nga zemrat e tyre dhe nuk buron nga

vetëdija dhe mendja e tyre. Nëse ndodh kjo gjë, ajo është shumë e rrallë. Ajeti thotë: **"...dhe All'Ilahun e përmendin fare pak."**

5- Në të vërtetë, hipokritët jetojnë gjithmonë të çoroditur pa asnjë qëllim apo plan të caktuar në mënyrën e jetës. Për këtë ata jetojnë në gjendje dyshimi e lëkundjeje dhe nuk janë as me besimtarët dhe as nuk qëndrojnë në anën e mohuesve. Ajeti thotë:

"...Luhaten në mëdyshje, - nuk janë as me këta, as me ata..."

Është e dobishme që t'i kushtohet vëmendje fjalës "*mudhebdhebe*". Ky është emër vetvetor që rrjedh nga rrënja e fjalës "*dhebdhebe*" që do të thotë zë i veçantë që dëgjohet kur lëviz diçka e varur kur e godet era. Fjala "*mudhebdhebun*" përdoret edhe për njeriun e luhatur e të çoroditur, i cili nuk ka asnjë qëllim, asnjë plan e asnjë rrugëdalje për jetën.

Ky është një nga përshkrimet më të saktë që ka përdorur Kur'ani për hipokritët. Po ashtu, kjo shprehje është treguese për mundësinë e njohjes së hipokritëve nëpërmjet rrugës së luhatjes dhe të pavendosmërisë në lëvizjet dhe në thëniet e tyre. Gjithashtu, nga kjo shprehje mund të kuptohet se hipokritët janë si diçka e varur që lëviz pa qëllim dhe pa drejtim të caktuar, por atë e lëviz era nga një vend në një vend tjetër dhe e çon në atë anë që era lëviz.

Në mbyllje, ajeti sqaron të ardhmen e atyre hipokritëve dhe qartëson se ata janë njerëz që All'Ilahu nuk i ruan dhe as nuk i mbron për shkak të veprave të tyre. All'Ilahu i lë ata të vazhdojnë rrugën e devijuar që ata vetë e zgjodhën me dëshirën e tyre. Ata kurrë nuk do të udhëzohen në rrugën e shpëtimit, sepse All'Ilahu u ka shkruar atyre humbje si rezultat i veprave të veta. Ajeti thotë: **"...Këdo që All'Ilahu shpie në humbje, ti (o Muhammed!) nuk do të mundesh t'ia gjesh rrugën."**

Ajetet 144 - 146

يَتَأْتِيهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا لَا تَتَّخِذُوا الْكَافِرِينَ أَوْلِيَاءَ مِنْ دُونِ الْمُؤْمِنِينَ^ج
 أُرِيدُونَ أَنْ تَجْعَلُوا لِلّٰهِ عَلَيْكُمْ سُلْطٰنًا مُّبِينًا ﴿١٤٤﴾ إِنَّ الْمُنٰفِقِينَ فِي
 الدَّرَكِ الْاَسْفَلِ مِنَ النَّارِ وَلَنْ تَجِدَ لَهُمْ نَصِيرًا ﴿١٤٥﴾ اِلَّا الَّذِينَ تَابُوا
 وَاصْلَحُوا وَاعْتَصَمُوا بِاللّٰهِ وَأَخْلَصُوا دِيْنَهُمُ لِلّٰهِ فَاولٰئِكَ مَعَ
 الْمُؤْمِنِينَ^ص وَسَوْفَ يُؤْتِ اللّٰهُ الْمُؤْمِنِينَ اَجْرًا عَظِيْمًا ﴿١٤٦﴾

"O ju që keni besuar! Mos i zgjidhni mohuesit për miq - në vend të besimtarëve! A mos vallë doni t'i jepni All'Ilahut dëshmi të qartë kundër vetvetes?"

"Pa dyshim që hipokritët do të jenë në thellësinë më të madhe të Xhehennemit dhe ti kurrësesi nuk do t'u gjesh atyre ndihmës."

"Por ata që pendohen, përmirësohen, mbështeten fort tek All'Ilahu dhe që besimin e tyre e kanë sinqerisht vetëm për All'Ilahun, do të jenë me besimtarët e vërtetë. All'Ilahu do t'u japë shpërblim të madh besimtarëve."

Komentimi

Ajetet e mëparshme treguan për disa nga llojet të cilësive të hipokritëve. Ajetet në vazhdim i paralajmërojnë dhe i urdhërojnë besimtarët që të mos mbështeten tek hipokritët dhe jobesimtarët por të mbështeten tek besimtarët dhe të mos kërkojnë ndihmë nga ata hipokritë. All'Ilahu i Lartësuar thotë: **"O ju që keni besuar! Mos i zgjidhni mohuesit për miq - në vend të besimtarëve!**

Ajeti sqaron se mbështetja tek mohuesit konsiderohet krim, shkelje e ligjit hyjnor dhe idhujtari ndaj All'Ilahut. Bazuar në ligjin e drejtësisë së All'Ilahut, ky krim e meriton ndëshkimin e ashpër të cilin e përforcon edhe ajeti ku thotë: **"...A mos vallë doni t'i jepni All'Ilahut dëshmi të qartë kundër vetvetes?"**¹

Në ajeti i dytë prej ajeteve në fjalë gjendet sqarim i gjendjes së hipokritëve, të cilët disa të pavëmendshëm nga besimtarët i zunë miq për vetvetat e tyre. Ajeti tregon qartë se në Ditën e Kijametit hipokritët do të jenë në shkallën më të ulët të Xhehennemit dhe askush nuk mundet t'i ndihmojë apo t'i shpëtojë. Ajeti thotë: **"Pa dyshim që hipokritët do të jenë në thellësinë më të madhe të Xhehennemit dhe ti kurrsesi nuk do t'u gjesh atyre ndihmës."**²

¹ Fjala "*sultan*" rrjedh nga fjala "*salatatun*", që ka kuptimin e forcës për të mposhtur të tjerët. Në fjalën "*sultan*" gjendet kuptim edhe për emrin burimor, i cili përdoret për të gjitha llojet e sundimit. Për këtë shkak, fjala "*sultan*" përdoret edhe për shkakun që e bën njeriun të sundojë të tjerët. Po ashtu, përdoret edhe për poseduesit e pushtetit, të fuqisë dhe të depërtimit. Mirëpo, në ajetin e lartpërmendur ka kuptimin e argumentit dhe të faktit.

² Fjala "*derkun*" ka kuptimin e pikës më të ulët në thellësinë e detit. Edhe fundi i litarit i bashkuar me mjetin që e çon njeriun në thellësi të detit quhet "*derkun*". Duket se këto kuptime janë nxjerrë nga "*derku shej*" që do të thotë mbërritja tek ai. Po ashtu, edhe shkallët që e çojnë njeriun në vende të ulta, siç është pushi, quhen "*derkun*". Kjo fjalë është e kundërta e shkallëve me të cilat njeriu ngjitet në lartësi.

Nga ky ajet sqarohet se hipokrizia në mendimin islam është prej llojeve me të rrepta të mosbesimit dhe se hipokritët janë krijesat me të largëta nga All'llahu. Për këtë arsye, vendi i tyre përfundimtar do të jetë në pikën e fundit të Xhehennemit dhe ata me të vërtetë e meritojnë këtë ndëshkim, sepse rreziqet që u kanosen njerëzve nga këta hipokritë janë rreziqet më të ashpra. Ata hipokritë, si rezultat i mbrojtjes së tyre me besimin e dukshëm e të pasinqertë, i godasin pas shpine besimtarët me armët helmuese. Është e natyrshme që të tillë njerëz, të cilët maskohen me rrobën e miqësisë të jenë më të rrezikshëm se armiqtë e njohur, të cilët e shfaqin publikisht armiqësinë e tyre. Në të vërtetë, hipokrizia është sjellje e çdo personi të dyshuar, frikacak, të devijuar dhe që nuk ka personalitet.

Ajeti i tretë dhe i fundit, prej ajeteve në fjalë, qartëson se mundësia për pendim është e hapur, deri edhe për njerëzit më të ndotur me mëkate. Të pendohen për veprat e tyre, të ndreqin vetet, të garojnë për të shlyer të mirat e shkuara, të kthehen te mëshira e All'llahut dhe të kapen fort pas litarit (fesë) të All'llahut, të besojnë në Të dhe të jenë të sinqertë ndaj Tij. Ajeti thotë: **"Por ata që pendohen, përmirësohen, mbështeten fort tek All'llahu dhe që besimin e tyre e kanë sinqerisht vetëm për All'llahun..."**

Penduesit, në fund, do të jenë prej të shpëtuarve dhe që e meritojnë shoqërinë e besimtarëve. Ajeti thotë: **"...do të jenë me besimtarët e vërtetë..."**

Me të vërtetë, All'llahu i Lartësuar do t'u dhurojë shpërblime të mëdha besimtarëve: **"...All'llahu do t'u japë shpërblim të madh besimtarëve."**

Ajo që tërheq vëmendjen është se ajeti sqaron se ata pendues janë me besimtarët. Ky është argument se pozita e besimtarëve të patundur është më e madhe në botë se pozita e penduesve. Besimtarët me besim të ngulitur janë baza, kurse të penduarit janë degët. Ajo pastërti dhe dritë që u duket atyre është se ata janë në shoqërinë e besimtarëve të patundur në besim.

Është edhe një çështje tjetër që duhet patur parasysh në këtë ajet. Ajo është se ajeti sqaron në formë të qartë e të prerë fundin e hipokritëve dhe se atyre u është caktuar vendi më i ulët në Xhehennem si vendqëndrim për ta. Ndërsa për besimtarët është përgatitur një shpërblim i madh, i cili nuk kufizohet dhe nuk përshkruhet, sepse buron nga madhështia dhe butësia e All'Ilahut të Lartësuar.

Ajeti 147

مَا يَفْعَلُ اللَّهُ بِعَذَابِكُمْ إِن شَكَرْتُمْ وَءَامَنْتُمْ ۚ وَكَانَ اللَّهُ شَاكِرًا عَلِيمًا



"Përse t'ju ndëshkojë All'llahu, nëse ju e falënderoni dhe e besoni?! All'llahu është Mirënjohës dhe i Gjithëditur."

Komentimi

Hakmarrja nuk është shkak i dënimit të All'llahut

Ajetet e mëparshme treguan dhe sqaruan formën dhe mënyrën e ndëshkimit të mohuesve dhe të hipokritëve. Ajeti në fjalë tregon një të vërtetë konstante se ndëshkimi i Zotit që u drejtohet njerëzve mëkatarë nuk është për shkak hakmarrjeje dhe as për të shfaqur fuqinë. Po ashtu, nuk është kompensim për humbjet e ardhura nga mëkatet e bëra. Të gjitha këto ndodhin te krijesa që në natyrën e saj ka mangësi dhe është nevojtare. Mirëpo All'llahu i Lartësuar është i Pastër nga çdo mangësi dhe nuk ka nevojë për asnjë dhe për askënd.

Atëherë ndëshkimi që e kap njeriun është për veprat mëkatore që ai bën. Ai ndëshkim është si rezultat i mëkateve, qofshin veprorë apo mendore. Për këtë, All'llahu i Lartësuar thotë: **"Përse t'ju ndëshkojë All'llahu, nëse ju e falënderoni dhe e**

besoni?!..." Duke parë se e vërteta e falënderimit është që njeriu t'i shfrytëzojë të mirat që All'llahu ia ka dhuruar atij në drejtime të posaçme, në natyrë e në krijim, na qartësohet se qëllimi i këtij ajeti është se kush beson, bën vepra të mira dhe shfytëzon mirësitë e Zotit në fushat e caktuara të krijimit, pa keqpërdorur ato mirësi, nuk ka dyshim se këtë njeri besimtar nuk e godet asnjë ndëshkim nga ana e All'llahut të Lartësuar. Për ta përforcuar edhe më shumë këtë gjë, ajeti shton se All'llahu është i Ditur për veprat dhe qëllimet e robve të Tij dhe Ai e shpërblen çdo njëri që bën vepra të mira për të arritur kënaqësinë e All'llahut të Lartësuar: **"...All'llahu është Mirënjohës dhe i Gjithëditur."**

Në këtë ajet falënderimi është përmendur para besimit, për të qartësuar këtë të vërtetë: Nëse njeriu nuk i percepton mirësitë dhe dhuntitë e All'llahut dhe nuk e falënderon Atë, ai nuk mund ta arrijë njohjen e Tij dhe nuk mund të besojë në Të, sepse mirësitë e Tij, me të vërtetë, janë mjete për njohjen e Tij. Në librat e besimit islam shumë hulumtues dhe studiues, të cilët e argumentojnë njohjen e All'llahut me domosdoshmërinë e falënderimit, e kanë bërë detyrim të natyrshëm falënderimin e Dhuruesit të këtyre mirësive dhe e kanë quajtur argument për domosdoshmërinë e njohjes së Tij.

PËRMAJTJA E LIBRIT

TEMA

Ajeti 24	5
Komentimi.....	6
Martesa e përkohshme në islam.....	9
Hulumtime.....	12
1-A është anuluar ky rregull (ligj)?.....	12
2-Martesa e përkohshme është një domosdoshmëri shoqërore.....	18
3- Kritikrat për martesën e përkohshme.....	20
4 - "Rasell" dhe martesa e përkohshme.....	23
Ajeti 25	26
Komentimi.....	27
Martesa me robërshat	27
Ajetet 26 - 28	33
Komentimi.....	34
Përse këto kritere?.....	34
Ajetet 29 - 30	37
Komentimi.....	38

Siguria shoqërore ka lidhje me sigurinë ekonomike.....	38
Ajeti 31.....	42
Komentimi.....	42
Gjynahet e mëdha dhe gjynahet e vogla	42
Hulumtim.....	45
Kur shndërrohet gjynahu i vogël në gjynah të madh?.....	45
Ajeti 32.....	47
Shkaku i zbritjes.....	47
Komentimi.....	48
Kërkim.....	51
Përse ky dallim natyror ndërmjet njerëzve?.....	51
Ajeti 33.....	55
Komentimi.....	55
Ajeti 34.....	58
Komentimi.....	59
Autoriteti në sistemin familjar	59
Gratë e pabindura dhe neglizhente.....	62
1- Këshilla.....	62
2 - Distançimi nga shtrati	62
3 - Rrahja.....	63

Ajeti 35	66
Komentimi.....	66
Gjykimi i pajtimit familjar.....	66
Ajeti 36	70
Komentimi.....	70
1 - “Adhuroni All’llahun dhe mos i shoqëroni Atij asgjë (në adhurim)...”	71
2 - “...silluni mirë me prindërit...”	71
3- “...me të afërmit...”	72
4 - “...me jetimët...”	72
5 - “...me të varfërit...”	73
6 - “...me fqinjët e afërt...”	73
7- “...dhe të largët...”	74
8- “...me atë që keni pranë...”	76
9- “...me udhëtarin (që ka mbetur ngushtë)...”	77
10 - “...dhe me ata që janë robër nën pushtetin tuaj...”	77
Ajetet 37- 39	79
Komentimi.....	80
Shpenzimi për t’u dukur dhe shpenzimi për hir të All’llahut.....	80
Ajeti 40	84

Komentimi.....	84
Çfarë është grimca?.....	84
Ajeti 40	87
Komentimi.....	87
Dëshmitarët në Ditën e Kiametit.....	87
Ajeti 43	93
Komentimi.....	94
Disa rregulla të jurisprudencës	94
1- Ndalimi i faljes së namazit në gjendje të dehur:.....	94
2- Namazi i parregullt në gjendje xhunublëku.....	96
3- Lejimi i faljes së namazit dhe kalimi në xhami pas larjes.....	97
4- Tejemumi për ata që kanë arsye.....	97
Hulumtime.....	98
Dobia morale.....	100
Dobia shëndetësore.....	100
Ajetet 44 - 45	102
Komentimi.....	102
Ajeti 46	104
Komentimi.....	105
Një vepër tjetër e jehudinje.....	105

Ajeti 47	108
Fundi i të pabindurve.....	108
Ajeti 48	112
Komentimi.....	112
Hapësira e gjerë e ajeteve të Kur'anit	112
Hulumtime.....	114
Shkaqet e faljes së gjynaheve.....	114
Ajetet 49 - 50	117
Shkaku i zbritjes.....	117
Komentimi.....	118
Pastrimi i shpirtit.....	118
Ajetet 51 - 52	121
Shkaku i zbritjes.....	122
Komentimi.....	123
Lajkatarët	123
Idhujt dhe hyjnitë e rreme.....	124
Ajetet 53 - 55	127
Komentimi.....	128
Hulumtime.....	131
Roli i smirës në krime.....	131

Ajetet 56 - 57.....	134
Komentimi.....	135
Hulumtime.....	136
Ajeti 58.....	138
Shkaku i zbritjes.....	138
Komentimi.....	139
Dy rregulla të rëndësishme islame.....	139
Hulumtime.....	142
Rëndësia e amanetit dhe drejtësia në Islam.....	142
Ajeti 59.....	144
Komentimi.....	144
Kërkim.....	146
A - Kush janë udhëheqësit "ulul emri"?.....	146
B- Përgjigje e pyetjeve.....	153
C- Dëshmia e haditheve.....	156
Ajeti 60.....	159
Shkaku i zbritjes.....	159
Komentimi.....	160
Udhëheqja e tiranëve.....	160
Ajetet 61 - 63.....	162
Komentimi.....	163

Rezultati i gjykimit të idhujtarisë.....	163
Ajeti 64	167
Komentimi.....	167
Ajeti 65	172
Shkaku i zbritjes.....	172
Komentimi.....	173
Dorëzimi përpara së vërtetës.....	173
Ajetet 66-68	177
Komentimi.....	177
Ajetet 69 - 70	181
Shkaku i zbritjes.....	181
Komentimi.....	182
Shoqëruesit në Xhennet.....	182
Ajeti 71	186
Komentimi.....	186
Ajetet 72 - 73	190
Komentimi.....	190
Ajeti 74	193
Komentimi.....	193
Përgatitja e besimtarëve për xhihad.....	193

Ajeti 75	196
Komentimi.....	196
Kërkimi i ndihmës me ndjenjat dhe emocionet njerëzore.....	196
Ajeti 76	200
Komentimi.....	200
Ajeti 77	203
Shkaku i zbritjes.....	204
Komentimi.....	205
Populli, malli i të cilit janë fjalët dhe jo punët.....	205
Ajetet 78 - 79	209
Komentimi.....	210
Nga vijnë fitoret dhe humbjet?.....	212
Përgjigje për një pyetje të rëndësishme.....	214
Ajetet 80 - 81	217
Komentimi.....	217
Syneti i Profetit (Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) është në gradën e Shpalljes (uahjit).....	217
Ajeti 82	222
Komentimi.....	222

Zbrazëtia e Kur'anit nga ndryshimet është argument i mrekullisë së tij.....222

Ajeti 83.....225

Komentimi.....225

Përhapja e thashethemeve.....225

Dëmi i shpikje së thashethemeve dhe i përhapjes së tyre.....227

Ajeti 84.....230

Shkaku i zbritjes.....230

Komentimi.....231

Çdo njeri është përgjegjës për atë që është detyruar.....231

Hulumtime.....232

Kuptimi i fjalëve "asa" dhe "leale" në Kur'an.....232

Ajeti 85.....235

Komentimi.....235

Rezultati dhe përfundimi i nxitjes për të mirë dhe i nxitjes për të keq.....235

Ajeti 86.....240

Komentimi.....240

Thirrja e përballjes së të mirës me të mirë.....240

Kërkim.....242

Selami, përshëndetja më e madhe e Islamit.....242

Ajeti 87	246
Komentimi.....	246
Ajeti 88	248
Shkaku i zbritjes.....	248
Komentimi.....	249
Ajeti 89	252
Komentimi.....	252
Ajeti 90	255
Shkaku i zbritjes.....	255
Komentimi.....	257
Mirëpritja e shprehjes së paqes.....	257
Ajeti 91	259
Shkaku i zbritjes.....	259
Komentimi.....	260
Dënimi i dyfytirakut.....	260
Ajeti 92	262
Shkaku i zbritjes.....	263
Komentimi.....	263
Hulumtime.....	267
Ajeti 93	270

Shkaku i zbritjes.....	270
Komentimi.....	271
Nëshkimi i vrasjes me qëllim.....	271
Ndëshkimet në Botën Tjetër.....	272
Krimi i vrasjes me qëllim dhe ndëshkimi i përhershëm.....	273
Cilat janë llojet e vrasjes?.....	276
Ajeti 94.....	278
Shkaku i zbritjes.....	279
Komentimi.....	280
Hulumtime.....	281
Xhihadi Islam nuk është dimension i material.....	281
Ajetet 95 - 96.....	283
Komentimi.....	284
Dy hulumtime.....	286
1- Pika të rëndësishme rreth muxhahidinëve.....	286
2- Rëndësia e lartë që ka xhihadi.....	288
Ajetet 97 - 99.....	291
Shkaku i zbritje.....	291
Komentimi.....	292
Hulumtime.....	294

1- Abstraksioni i shpirtit.....	294
2- Meleku (engjëlli) i vdekjes apo melekët (engjëjt) e vdekjes.....	295
3- Kush është i pafuqishmi ose i paafiti?.....	297
Ajeti 100	299
Komentimi.....	299
Emigrimi, rregull konstruktiv Islam.....	299
Hulumtim.....	301
Islami dhe emigrimi.....	301
Ajeti 101	306
Komentimi.....	306
Namazi i udhëtarit.....	306
Ajeti 102	313
Shkaku i zbritjes.....	314
Komentimi.....	315
Hulumtime.....	316
Ajeti 103	319
Komentimi.....	319
Rëndësia e detyrimit të namazit.....	319
Ajeti 104	322

Shkaku i zbritjes.....	322
Komentimi.....	325
Ajetet 105 - 106.....	327
Shkaku i zbritjes.....	327
Komentimi.....	329
Ndalimi i mbrojtjes së mashtruesve.....	329
Ajetet 107-109.....	332
Komentimi.....	333
Ajetet 110 - 112.....	336
Komentimi.....	337
Hulumtim.....	340
Krimi i shpifjes.....	340
Ajeti 113.....	342
Komentimi.....	342
Hulumtime.....	344
Burimi i pagabueshmërisë (ismetu) së Profetëve.....	344
Ajeti 114.....	347
Komentimi.....	347
Ajeti 115.....	351

Shkaku i zbritjes.....	351
Komentimi.....	352
Hulumtime.....	353
Argumenti i unanimitetit (el ixhma').....	353
Ajeti 116.....	356
Komentimi.....	356
Ajetet 117 - 121.....	359
Komentimi.....	360
Kurthet e shejtanit.....	360
Ajeti 122.....	365
Komentimi.....	365
Ajetet 123 - 124.....	367
Shkaku i zbritjes.....	367
Komentimi.....	368
Ajetet 125 - 126.....	371
Komentimi.....	371
Ajeti 127.....	376
Komentimi.....	378
Edhe një herë për të drejtat e gruas	378

Ajeti 128	379
Shkaku i zbritjes.....	379
Komentimi.....	380
Pajtimi është më i mirë.....	380
Ajetet 129 - 130	383
Komentimi.....	383
Drejtësia, kusht i poligamisë.....	383
Përgjigja e një pyetjeje të domosdoshme.....	386
Ajetet 131 - 134	388
Komentimi.....	389
Ajeti 135	393
Komentimi.....	393
Ajeti 136	398
Shkaku i zbritjes.....	398
Komentimi.....	399
Ajetet 137 - 139	401
Komentimi.....	402
E ardhmja e hipokritëve kokëfortë	402
Ajeti 140	405

Shkaku i zbritjes.....	405
Komentimi.....	406
Ndalimi i pjesëmarrjes në tubimet, ku i bëhet mëkat All'lahut.....	406
Hulumtime.....	407
Ajeti 141	409
Komentimi.....	409
Cilësitë e hipokritëve.....	409
Ajetet 142 - 143	413
Komentimi.....	413
Ajetet 144 - 146	416
Komentimi.....	417
Ajeti 147	420
Komentimi.....	420
Hakmarrja nuk është shkak i dënimit të All'lahut	420

أالمثل فى تفسير كتاب الله المنزل

مؤلف: العلامة الفقيه المفسر ناصر مكارم الشيرازى

الجزء الخامس

الترجمة الى اللغة الألبانية: وُلُنتْ مَرِيَا و آگيم رچای

تيرانا: 2016

نام کتاب: الامثل فی تفسیر کتاب الله المنزل (جزء پنجم)

نویسنده: فقیه مفسر حضرت آية الله العظمی ناصر مکارم شیرازی (دام ظلّه)

ترجمه به زبان آلبانی: وُلُتْ مِرْیَا و آگیم رچای

زیر نظر: وُلُتْ مِرْیَا

تایپ: کمریه کاظمی

ویرایش: لیسدا رامای

مقابله: ویولسا کارای

صفحه بندی و جلد: صبریه فرا

ناشر: جمعیت "نسیم"

چاپ: انتشارات "لیلو"

تیرانا: 2016